



**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**MBI**  
**“AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE FINANCIAR”**

**“BASHKIA HAS”**

**Tiranë 2023**



## PËRMBAJTJA

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b> .....	4
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit .....	5
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	6
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	10
<b>II. HYRJA</b> .....	13
1. Objektivat e auditimit.....	13
2. Qëllimi i auditimit .....	13
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....	14
5. Përgjegjësitë e audituesve.....	14
6. Kriteret e vlerësimit .....	14
7. Standardet e auditimit .....	15
8. Metodologjia e auditimit.....	15
9. Dokumentimi i auditimit .....	16
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b> .....	17
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	17
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	17
2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik.....	17
2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit. ....	22
2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin mbi pasqyrat financiare për vitin 2022. ....	46
2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.....	62
2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.....	109
2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtës së Territorit të Njësisë Vendore.....	121
2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm ..	123
2.8 Të ndryshme të dala gjatë auditimit .....	142
<b>IV. GJETJE DHE REKOMANDIME</b> .....	144
<b>V. ANEKSET</b> .....	159

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektiv vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Has, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi mbuloi periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022 për përputhshmërinë dhe 01.01.2022 deri më 31.12.2022 për anën financiare. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi kryesore nga Bashkia Has si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Struktura e auditit të brendshëm për vitin 2022 nuk ka funksionuar. Gjatë këtij viti nga Bashkia Has nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim.
- Nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite, ndërsa gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Vlera e detyrimeve më 31.12.2022 është **11,333,143** lekë.
- Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është **4,645,585** lekë.
- Gjendja e debitorëve progresiv në fund të vitit 2022 është në vlerën **42,557,390** lekë.
- Bashkia Has nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe taksën e ndërtesës. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifave të tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak.
- Në Bashkinë Has nuk është hartuar regjistër dhe nuk llogaritet detyrim për kategorinë e taksapaguesve familjar për taksën mbi tokën bujqësore.
- Detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet më 31.12.2022 janë në vlerën **10,620,347** lekë për 276 debitorë.
- Detyrimet nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 8 subjekte qiramarrës janë në vlerën **2,965,416** lekë.
- Gjendja e llogarisë 202 "*Studime dhe Kërkime*" në fund të vitit 2022, rezulton në vlerë neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike 9,729,027 lekë, që i përket 27 projekt-studimeve për investime të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar.
- Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 "*Financim i pritshëm nga buxheti*" në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 28,103,657 lekë, dhe nuk rakordon me shumën e gjendjeve të llogarisë analoge 4342 "*Operacione me shtetin (të drejta)*" në vlerën 28,103,657 lekë dhe llogarisë 486 "*Shpenzime të periudhave të ardhshme*" në vlerën 11,333,144 lekë, ndërkohë që vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2022 është 39,436,801 lekë.
- Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua:
  - 1 praktikë tek e cila nuk pasqyrohej dokumentacioni i plotë i pronësisë për të gjithë sipërfaqen që do të zhvillohet;
  - 2 praktika tek të cilat nuk ishte konvertuar statusi i pronësisë nga tokë "arë" në tokë "truall";

- 4 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane, të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensitetit të ndërtimit, lartësia e ndërtimit;
- 3 praktika tek të cilat evidentohej e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen në planvendosje të distancës nga kufiri i pronës dhe mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës;
- 2 praktika tek të cilat evidentohej e njëjta situatë, në lidhje me mos përcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe respektimin e distancave midis ndërtimeve;
- 1 praktika tek e cila nuk pasqyrohej e saktë distanca ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës;
- 1 praktikë tek e cila tipologjia e ndërtimit dhe e objektit nuk ishte në përputhshmëri me tipologjinë e ndërtimit të lejuar në zonë.

- Në Bashkinë Has për vitin 2022 struktura e IMTV-së nuk ka qenë funksionale. Kjo vjen si rezultat i mungesës së një Sektori të Mbrojtjes së Territorit dhe mungesës së Kryeinspektorit.
- Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është e saktë duke sjellë një diferencë të kësaj takse prej **265,845.521** lekë.
- Nga auditimin e 6 procedurave të prokurimit për vitin 2021 me vlerë të fondit limit 21,878,340 lekë pa TVSh, ka rezultuar se në të 6 procedurat janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike.
- Nga auditimin i 8 procedurave të prokurimit për vitin 2022 me vlerë totale të fondit limit 41,707,499 lekë pa TVSh, kanë rezultuar me shkelje të kuadrit ligjor për prokurimin publik 6 procedura me vlerë totale të fondit limit 29,866,666 lekë pa TVSh ose 72% e fondit limit.

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Has, KLSH ka dhënë “*Opinion të pamodifikuar*” për pasqyrat financiare dhe “*Opinion të modifikuar*” për përputhshmërinë. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse.

## **1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit**

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Has si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditimi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare, planifikimi dhe zhvillimi i procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Has 8 akt konstatime dhe 2 akt verifikime. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Has të cilat janë trajtuar në përputhjeve me përcaktimet e Rregullores së Procedurave të Auditimit të KLSH-së.

## 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjeve	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Struktura e auditit të brendshëm për vitin 2022 ka funksionuar vetëm më një auditues, nga tre që përcakton kuadri rregullator në fuqi.</p> <p>Rezulton se për vitin 2022 nga Bashkia Has nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim, duke mos kryer detyrën funksionale dhe duke mos i dhënë titullarit të njësisë publike këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe siguri për realizimin e objektivave. (faqe 17-22 të RPA)</p>	E lartë	<p>Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë ose, shërbimi i auditit të brendshëm të kryhet nga njësia e auditit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse.</p>
2	<p>Nga auditimi u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite, ndërsa gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Në fillim të vitit buxhetor 2022 detyrimet e prapambetura kanë vlerën 19,089,192.8 lekë, është krijuar detyrim i ri gjatë vitit 2022 në vlerën 5,338,526 lekë, prej të cilave është likuiduar vlera 13,920,155 lekë, duke e çuar vlerën e këtyre detyrimeve më 31.12.2022 në vlerën 11,333,143.8 lekë. (faqe 22-46 të RPA)</p>	E lartë	<p>Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Has dhe kontraktorëve, brenda afatit 30 ditor pas ardhjes së faturës tatimore, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.</p>
3	<p>Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është 4,645,585 lekë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Detyrimet nga taksat dhe tarifatat për biznesin në shumën 2,589,724 lekë;</li> <li>- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 52,120 lekë;</li> <li>- Detyrime nga qiratë e tregut (markata) në shumën 653,133 lekë;</li> <li>- Taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,337,708 lekë;</li> <li>- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore në vlerën 12,900 lekë</li> </ul> <p>Në uljen e debitorëve kanë ndikuar pagesat e kryera për detyrimet debitorë të viteve para vitit 2021 në vlerën 2,514,241 lekë, dhe për vitin 2022 në vlerën 2,131,344 lekë. Gjendja e debitorëve progresiv në fund të vitit 2022 është në vlerën 42,557,390 lekë. (faqe 22-46 të RPA)</p>	E lartë	<p>Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive <b>42,557,390 lekë</b> e përbërë nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 26,825,739 lekë për 187 subjekte private (biznesi i madh dhe i vogël);</li> <li>- 4,861,266 lekë për qiratë e ambienteve të tregut (Markata e Qytetit Krume);</li> <li>- 10,619,005 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet;</li> <li>- 96,900 lekë nga kontratat e dhënies me qira të aseteve;</li> <li>- 154,480 lekë nga institucione publike;</li> </ul> <p><i>a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.</i></p> <p><i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).</i></p> <p><i>c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i></p> <p><i>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Spektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</i></p> <p><i>e- Spektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Has, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</i></p> <p><i>f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e</i></p>

			ndërrmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.
4	Nga auditimi u konstatua se <b>taksa mbi tokën bujqësore</b> është realizuar 35 mijë lekë nga 67 mijë lekë e planifikuar ose në masën 52%. Nga auditimi konstatohet se në Bashkinë Has nuk është hartuar regjistër dhe nuk llogaritet detyrim për kategorinë e taksapaguesve familjar për taksën mbi tokën bujqësore. Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet taksa e tokës bujqësore. (faqe 22-49 të RPA)	E lartë	Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.
5	Nga auditimi i ecursionit të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet <b>rezulton se</b> , në Bashkinë Has ka detyrime të pa paguara në vlerën 9,282,639 lekë për 239 objekte objekte që janë legalizuar që nga viti 2017 deri në 31.12.2020 Nga korespondenca zyrtare e Bashkisë Has me ASHK në vitin 2022 rezulton se: - <b>Për vitin 2021</b> janë kryer 25 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përlllogaritur prej 1,338,065 lekë, ku janë debitorë 19 individë në vlerën 1,090,592 lekë - <b>Për vitin 2022</b> janë kryer 12 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përlllogaritur prej 545,206 lekë, ku janë debitorë 8 individë në vlerën 247,216 lekë Pra gjatë vitit 2022 listës së debitorëve i janë shtuar 37 individë për taksën e infrastrukturës është 1,337,708 lekë, ndërsa në vlerë progresive deri në 31.12.2022 është 10,620,347 lekë për 276 objekte, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has. (faqe 22-46 të RPA)	E lartë	Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë <b>për 276 debitorë në vlerën 10,620,347 lekë</b> si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Has të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.
6	Bashkia Has në kuadër të administrimit të aseteve për krijimin e të ardhurave ka lidhur 26 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi apo në përdorim. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik për afate kohore nga 1-30 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, për aktivitet bujqësor, për pemtari, objekte banimi, Antena, vend depozitim minerali dhe ngritje fabrike përpunimi, studim-kërkim-zbulim, agroturizëm etj. Referuar tabelës së kontratave të qirave me të dhënat të nxjerrë dokumentacioni i dosjeve nga rezulton se në fund të vitit 2022 paraqiten 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të paguara në <b>vlerën 2,965,416 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has</b> . Gjithashtu për qiramarrësit, që nuk kanë paguar detyrimet e qirasë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk është llogaritur kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës. Theksojmë se në rastin e qiramarrësit <b>“F” SHPK</b> kontrata bazë 9 vjeçare e datës 12.01.2015 me tarifë qiraje 465,000 lekë është amenduar me kontratën e datës 01.06.2016, ku sipërfaqja e marrë me qira dhe afati nuk ndryshon, por ka ndryshuar vlera e kontratës në 91,350 lekë i pa shoqëruar me relacion për shpjegimin arsyeve të ndryshimit të vlerës së qirasë vjetore. Kjo ka sjellë diferencën në pagesë nga qiramarrësi prej 2,241,900 lekë (2,790,000 - 465,000), e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has, e cila është pjesë e shumë debitorëve të mësipërme.	E lartë	Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të paguara në <b>vlerën 2,965,416 lekë</b> dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave. Gjithashtu nga strukturat drejtuese për 21 rastet e subjekteve subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare e inertesh, që ushtrojnë aktivitetin e licencuar në parcelat e fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Has, të shqyrtohet dokumentacioni i tyre dhe të kryhen kontrolli dhe matja në terren i parcelave që shfrytëzohen dhe finalizimi i procesit me lidhjen e kontratave të qiradhënies për sigurimin e të ardhurave dhe rehabilitimin e sipërfaqeve nga shfrytëzimi nga ana e këtyre subjekteve të aseteve të bashkisë. Nëse ka pengesë në realizimin e këtij procesi të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse deri në pezullimin e veprimtarisë.

	Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Has ushtrojnë aktivitetin 21 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Has. Nga bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitim mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere dhe shtrati lumi, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Has. (faqe 22-46 të RPA)		
7	Gjendja e llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime" në fund të vitit 2022, rezulton në vlerë neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike 9,729,027 lekë, që i përket 27 projekt-studimeve për investime të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv apo në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktiv afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. (faqe 46-63 të RPA)	E lartë	Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës 1,791,490 lekë që i përket 27 projekt-studimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktiv afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Më pas të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.
8	Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 28,103,657 lekë, vlerë kjo, e cila nuk rakordon me shumën e gjendjeve të llogarisë analoge 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)" në vlerën 28,103,657 lekë dhe llogarisë 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" në vlerën 11,333,144 lekë të bilancit, pasi kjo gjendje duhet të pasqyrohet detyrimin e plotë, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, ndërkohë që vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2022 është 39,436,801 lekë. (faqe 46-63 të RPA)	E lartë	Drejtoria e Buxhetit, Financës, Takasave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve, që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog.7206 "Financim i pritshëm nga buxheti"). Këto veprime t'i kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.
9	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat nuk ishte konvertuar statusi i pronësisë nga tokë "arë" në tokë "truall", për të gjithë sipërfaqen e parcelës që do të zhvillohej ndërtimi, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe legjislacionin në fuqi, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt: 1."Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H.ShPK dhe aplikues E.M., në fshatin "Vranisht", Has dhe 2. "Objekt Banimi 2-katësh me papafingo", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has. (faqe 110-122 të RPA)	E lartë	Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar statusin e pronësisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e njësisë përkatëse dhe konvertimin e të gjithë sipërfaqes së pasurisë në truall për të vijuar më tej me zhvillimin e ndërtimit.
10	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 4 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane, të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensitetit të ndërtimit, lartësia e ndërtimit, të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt: 1: "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H.ShPK dhe aplikues E.M., në fshatin "Vranisht", Has; 2."Shtesë anësore dhe 2-kat në lartësi në	E lartë	Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar të gjitha materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, dokumentacionin e pronësisë, planvendosjen me të gjithë elementët përbërës të saj, projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.



	ndërtimin ekzistues”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 18, datë 26.08.2021, me zhvillues A. Sh.dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has; 3.“Projekt zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 26, datë 20/05/2022, me zhvillues Q. P. dhe aplikues Dh. P., Rruga e Kukësit, Has; 4. “Objekt Banimi 2-katesh me papafingo” për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has. <i>(faqe 110-122 të RPA)</i>		
11	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat evidentohet e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen në planvendosje të distancës nga kufiri i pronës dhe mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt:1. “Lokal 2 kate+ podrum”, për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H. ShPK dhe aplikues E.M., në fshatin "Vranisht", Has; 2. “Shtesë anësore dhe 2 kat në lartësi në ndërtimin ekzistues”, për të cilën është marrë vendimi me Nr.18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has; 3.“Objekt Banimi 2-katesh me papafingo” për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has. <i>(faqe 110-122 të RPA)</i>	E lartë	Nga DPZHT Has të merren masa që të verifikohen pasqyrimi i distancave ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës në planvendosjen e miratuar, si edhe distancat të jenë në përputhje me distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.
12	Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat evidentohet e njëjta situatë, në lidhje me mos përcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe respektimin e distancave midis ndërtimeve, në bazë të legjislacionit në fuqi, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt: 1.“Projekt-zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 26, datë 20/05/2022, me zhvillues Q. P. dhe aplikues Dh. P., Rruga e Kukësit, Has; 2. “Shtesë anësore dhe 2-kat në lartësi në ndërtimin ekzistues”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç., Krumë. <i>(faqe 110-122 të RPA)</i>	E lartë	Nga DPZHT Has të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në lidhje me përcaktimin e numrit të kateve të objektit, duke i verifikuar me projektin e ndërtimit dhe respektimin e distancave ndërmjet ndërtimeve.
13	Në Bashkinë Has për vitin 2022 struktura e IMTV-së nuk ka qenë funksionale. Kjo vjen si rezultat i mungesës së një Sektori të Mbrojtjes së Territorit dhe mungesës së Kryeinspektorit. Në strukturën e vitit 2022 janë 2 punonjës të emëruar në pozicionin e Inspektorit të Terrenit, 1 në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës dhe 1 në NjA Golaj. Inspektorët nuk kanë plane pune mujore ku të jetë parashikuar edhe mbikëqyrja që ato duhet të bëjnë në vazhdimësi për zbatimin e kushteve të lejeve të dhëna nga bashkia. Bashkia Has nuk ka blloqe që të kenë një numër serial të fletëve për procesverbalet që mban në rastet e konstatimit të kundërvajtjes, të marrjes së masës së pezullimit të punimeve apo të marrjes së masës së prishjes së ndërtimit. Proces verbalet e konstatimit të kundërvajtjes janë një model që inspektorët i printojnë rast pas rasti dhe i plotësojnë kur janë në terren. Gjatë inspektimeve në terren janë mbajtur proces verbale dhe janë vendosur gjoba vetëm me firmën e një inspektori. Nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Has nuk mund të vendosen gjoba apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit. <i>(faqe 122-124 të RPA)</i>	E lartë	Kryetari i Bashkisë Has të marrë të gjitha masat për të plotësuar strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit. Kryeinspektori të marrë masat e nevojshme për të hartuar planet mujore të punës ku të parashikohet edhe mbikëqyrja që ato duhet të bëjnë në vazhdimësi për zbatimin e kushteve të lejeve të dhëna nga bashkia. Kryeinspektori të marrë masa që të verifikohen në terren të gjitha proces verbalet që janë mbajtur vetëm me firmën e një inspektori. Në përfundim të këtyre verifikimeve të merren masat administrative përkatëse për të gjithë kundërvajtësit. Kryeinspektori të marrë masat që për inspektimet që do të kryhen të përdoren dokumentet e duhura duke filluar nga procesverbalet që mbahen në rastet e konstatimit të kundërvajtjes, për pezullimin e punimeve, për prishjen e ndërtimit apo në rastet e vendosjes së gjobave. Këto dokumente të kenë një numër serial të fletëve duke zvogëluar mundësinë për gabime apo abuzime.
14	Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk	E lartë	1. Nga Bashkia Has të merren masa për arkëtimin e vlerave që përbëjnë një dëm ekonomik ndaj buxhetit

	është llogaritur në mënyrën e duhur, në bazë të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuara për leje ndërtimi, me objekt: “Ambiente shërbimi, punime dhe infrastrukture mbështetëse për pemëtoren me arra”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 23, datë 16/03/2022, me zhvillues K.C.2020 ShPK dhe aplikues K.P., Fshati Helshan, Has, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej 265,845.521 lekë. (faqe 110-122 të RPA)		të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë. 2. Kryetari i Bashkisë Has të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës 265,845.521 lekë, nga subjekti "K.C. 2020" ShPK, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
15	Nga auditimin e 6 procedurave të prokurimit për vitin 2021 me vlerë të fondit limit 21,878,340 lekë pa TVSh, ka rezultuar se në të 6 procedurat janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike. Në këto 6 procedura ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të dokumenteve të tenderit, si dhe përmendja e markës së prodhimit në preventivin e artikujve në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 21,878,340 lekë. Nga auditimin i 8 procedurave të prokurimit për vitin 2022 me vlerë totale të fondit limit 41,707,499 lekë pa TVSh, kanë rezultuar me shkelje të kuadrit ligjor për prokurimin publik 6 procedura me vlerë totale të fondit limit 29,866,666 lekë pa TVSh ose 72% e fondit limit. Përkatësisht, shkelje janë konstatuar në hartimin e fondit limit dhe të preventivit të punimeve në 5 procedura. Në hartimin e kriterëve të vendosura jo në përputhje me objektin e kontratës si dhe nuk është bërë argumentimi i tyre në rastin e 3 procedurave. Janë kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë kriteret e vendosura në DT dhe kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur për 6 procedura. (faqe 63-110 të RPA)	E lartë	1. Titullari i AK të marrë masa që Komisioni për Hartimin e Fondit Limit të argumentojë zërat e punimeve, volumin dhe vlerën e tyre me qëllim shmangien e ndryshimit të pa argumentuar gjatë hartimit dhe miratimit të preventivit të punimeve. 2. Titullari i AK duhet të marrë masa që NJP në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifikime teknike që janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar. 3. Titullari i AK dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë. Gjithashtu, të bëhet argumentimi i saktë i skualifikimit apo kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit Opinioni i auditimit:

#### I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2022:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Has për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një **opinion të pamodifikuar/pakualifikuar me theksim të çështjes** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Has, duke arritur në përfundimin se, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin e Pakualifikuar”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të njësisë vendore më 31 dhjetor 2022, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes, janë adresuar disa çështje (jo thelbësore), të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes” dhe duhet të jenë në vëmendje të njësisë vendore për sistemin e tyre.

### **Baza për opinion mbi pasqyrat financiare:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 5,061 mijë lekë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

#### **“Theksimi i çështjes”**

- Gjendja e llogarisë 202 “*Studime dhe Kërkime*” në fund të vitit 2022, rezulton në vlerë neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike 9,729,027 lekë, që i përket 27 projekt-studimeve për investime të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar.

- Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Sektori i Financës i mungon libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera nga ditaret deri në bilanc. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël, çka tregon se veprimet me llogaritë nuk kanë ndjekur rrjedhën logjike kontabël për nxjerrjen e bilancit.

- Gjendja e llogarisë 423-429 “*Personeli, paradhënie, deficite, gjoba*” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2021 dhe në fund të vitit 2022. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson

- -Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “*Financim i pritshëm nga buxheti*” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 28,103,657 lekë, vlerë kjo, e cila nuk rakordon me shumën e gjendjeve të llogarisë analoge 4342 “*Operacione me shtetin (të drejta)*” në vlerën 28,103,657 lekë dhe llogarisë 486 “*Shpenzime te periudhave te ardhshme*” në vlerën 11,333,144 lekë të bilancit, ndërkohë që detyrimi i plotë, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara në fakt në fund të vitit 2022 është 39,436,801 lekë.

### **II. Opinioni mbi përputhshmërinë**

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, mbi zbatimin e buxhetit dhe menaxhimin e të ardhurave, mbi menaxhimin e aseteve si dhe zbatimin në teren të kontratave të punimeve të lidhura midis autoritetit kontraktor dhe operatorëve të shpallur fitues si dhe. Në opinionin tonë, bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Has, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar të përputhshmërisë.

### **Baza për dhënien e opinionit të modifikuar<sup>1</sup>**

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

- Nga auditimin e 6 procedurave të prokurimit për vitin 2021 me vlerë të fondit limit 21,878,340 lekë pa TVSh, janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike në të 6 procedurat. Në këto procedura ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të dokumenteve të tenderit, si dhe përmendja e markës së prodhimit në preventivin e artikujve në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 21,878,340 lekë.

- Nga auditimin i 8 procedurave të prokurimit për vitin 2022 me vlerë totale të fondit limit 41,707,499 lekë pa TVSh, kanë rezultuar me shkelje të kuadrit ligjor për prokurimin publik 6 procedura me vlerë totale të fondit limit 29,866,666 lekë pa TVSh ose 72% e fondit limit. Përkatësisht, shkelje janë konstatuar në hartimin e fondit limit dhe të preventivit të punimeve në 5 raste. Në hartimin e kriterëve të vendosura jo në përputhje me objektin e kontratës si dhe nuk është bërë argumentimi i tyre në rastin e 3 raste. Janë kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë kriteret e vendosura në DT dhe kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur në 6 raste.

- Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve konstatohet se detyrimet që subjekteve fizikë/juridikë kanë për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022 janë në vlerën progresive **42,557,390 lekë** e përbërë nga:

- 26,825,739 lekë për 187 subjekte private (biznesi i madh dhe i vogël);
- 4,861,266 lekë për qiratë e ambienteve të tregut (Markata e Qytetit Krume);
- 10,619,005 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet;
- 96,900 lekë nga kontratat e dhënies me qira të aseteve;
- 154,480 lekë nga institucione publike;

### **Përgjegjësitë e drejtuesve të Bashkisë Has.**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Has.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së.**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar, si dhe nëse hartimi i kriterëve të DT, vlerësimi i ofertave dhe zbatimi i kontratave të punimeve janë në përputhshmëri me kriteret e fushës së prokurimeve publike dhe kriteret e kontratave të lidhura. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përgjegjësia e audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme për shkallën e përputhshmërisë së

<sup>1</sup> *Opinion i modifikuar jepet sipas përcaktimeve të Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH-së, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 245, datë 19.12.2022, fq. 102.*

aktivitetit të institucionit të audituar me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi dhe të japë opinion për këtë.

## **II. HYRJA**

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 24/1 Prot, datë 09.01.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 16.01.2023 deri në datën 10.03.2023, në subjektin Bashkia Has u krye “Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë” për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. E. V. – *Përgjegjës Grupi*
2. E. K. – *Auditues*
3. I. Sh. – *Auditues*
4. O. F. – *Auditues*

### **1. Objektivat e auditimit**

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Has ka si objektiva kryesor:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)<sup>2</sup>;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

### **2. Qëllimi i auditimit**

Objekivi i auditimit financiar në Bashkinë Has është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

### **3. Identifikimi i çështjes**

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Has dhe përgjegjësisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

**Pika 1.** Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

**Pika 2.** Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave. vlerësimi i mbledhjes së tyre.

<sup>2</sup>Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

**Pika 3.** Vlerësimi i raportimit financiar.

**Pika 4.** Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike.

**Pika 5.** Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimin e territorit.

**Pika 6.** Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtës të Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)

**Pika 7.** Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

**Pika 8.** Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

#### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Has, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

#### **5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

#### **6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Has është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Has. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;

- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ”Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;
- Etj.

## **7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Has grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200:  
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

## **8. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

### 5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

## 7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Has me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

## 8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

### *Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale<sup>3</sup>.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH<sup>ja</sup> aplikon<sup>4</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

## **9. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

<sup>3</sup> ISSAI 1315

<sup>4</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit



### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin**

Auditimi në subjektin “Bashkia Has”, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për t’u audituar.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave.

Bashkia Has është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”.

#### **Profili i Bashkisë Has**

Bashkia Has kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Kukës dhe në lindje me Republikën e Kosovës. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Krumës. Sipas Censurit të vitit 2011, Hasi ka një popullsi prej 16,790 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, ka 21,247 banorë. Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 399.62 km<sup>2</sup> me një densitet prej 53.16 banorë/km<sup>2</sup>. Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 29 fshatra. Pasuritë nëntokësore të këtij rajoni kanë nisur të shfrytëzohen në vitet ’30 nga italianët. Deri në mesin e viteve ’90 ka funksionuar miniera dhe fabrika e pasurimit të bakrit në Golaj, 6 kilometra larg qytetit të Krumës si dhe disa miniera më të vogla, ku ishin të punësuar mbi 3000 punëtorë. Jo vetëm banorët, por edhe specialistët thonë se nëntoka ende nuk është prekur. Për mineralin e bakrit dallohen zona Nikoliq Golaj, Krumë dhe Zahrisht në rrethin e Hasit. Relievi i zonës shtrihet nga rreth 300 metra mbi nivelin e detit deri në malet e larta të Gajrepit, Pashtrikut dhe Maja e Kunorës, të cilat gjenden në lartësitë 1400-1900 metra mbi nivelin e detit.

#### **2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**

##### **2.1 Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar publik**

*1. Për “Testimin e funksionimit të kontrolleve kryesore të entitetit, përfshi zbatimin e kuadrit rregullator për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në Bashkinë Has, për vitin 2022.*

#### **I. Mbi mjedisin e kontrollit**

##### **Mbi hartimin dhe miratimin e Rregullores Organizative**

Për periudhën objekt auditimi Bashkia Has ka funksionuar me Rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së saj në nivel institucional dhe gjithëpërfshirës me nr. 05, datë 03.01.2019.

Kjo rregullore ka si pjese integrale të saj Kodin e Etikës së miratuar me nr. 05/1, datë 03.01.2019, sipas Ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 20; Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit 3.1. Mjedisi i kontrollit të brendshëm.

### **Mbi përgatitjen e gjurmës së auditimit**

Nga auditimi u konstatua se, nuk janë miratuar gjurmët standarde të auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike Bashkia Has, konkretisht në fushat me risk siç janë prokurimet me vlerë më të madhe se 800.000 lekë pa TVSh, prokurimet me vlerë më të vogël se 800.000 lekë pa TVSh, zbatimi i buxhetit, mbledhja e taksave, etj. Kjo sjell mos dokumentim të operacioneve të njësisë publike në atë formë, që nuk iu mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 16; Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. III “Procesi i implementimit të Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i MFK-së”, pika 3.3. Aktivitetet e Kontrollit, Hapi “Gjurmët e auditimit”.

*Për sa më lart mban përgjegjësi Z. L. M., Kryetar i Bashkisë Has.*

### **Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:**

Për vitin 2022, numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Has së bashku me njësitë e varësisë, është gjithsej 275 punonjës sipas Urdhrit nr. 191, datë 01.04.2022 “Për strukturën organizative të Bashkisë Has”, nga të cilët në pozicione pune trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, janë 58 pozicione, nga të cilët 39 (35 me status dhe 4 në proces për marrje statusi) pozicione janë me status të nëpunësit civil dhe 19 të klasifikuara si nëpunës civil janë plotësuar me pozicione sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës Shqipërisë” i ndryshuar me të cilët janë lidhur kontrata pune tip, 7 pozicione pune janë funksionarë politik (Kryetar, zv. Kryetar, Administratorët e NjA dhe Sekretari i Këshillit). Funksionarët e deleguar janë 91 vende pune dhe 3 janë specifike, si dhe për diferencë 275-159=116 pozicione sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës Shqipërisë” i ndryshuar.

Njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore e ngarkuar me menaxhimin e nëpunësve civilë të institucionit si dhe eprori direkt i Bashkisë Has, për vitin 2022 kanë nisur apo zhvilluar procedurat individuale për marrjen e statusit të nëpunësit civil për të gjithë ata punonjës të administratës, të cilët janë të punësuar në pozicionet që trajtohen sipas statusit të nëpunësit civil, përkatësisht për vitin 2022 janë hapur procedura konkurrime për 5 punonjës.

Gjithashtu, janë bërë ndryshime në strukturën organizative, specifikisht largimet si më poshtë:

1. Urdhri nr. 84, datë 10.02.2022, “Për largim të punonjësit, Bashkia Has”, shkurtim i vendit të punës nga Bashkia Has, kaluar në Drejtorinë e Bujqësisë;
2. Urdhri nr. 347, datë 20.06.2022, “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, Bashkia Has”, largim me dorëheqje;
3. Urdhri nr. 740, datë 01.11.2022, “Për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, Bashkia Has”, mbushje të moshës për pension pleqërie.

Nga auditimi u konstatua se, në këto raste të ndryshimeve të emërtimeve të drejtuesve sipas strukturës Organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi përkatës, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” Kreu III, pika 27 dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, Kreu VII, pika 49, 52, 52.

Mbi nivelin e përdorimit të programeve elektronike

Për periudhën objekt auditimi në Bashkinë Has, nuk janë aplikuar programe elektronike për kontrollin, menaxhimin e veprimeve financiare, kontabilizimin dhe pasqyrat financiare si dhe ato për vjeljen e të ardhurave për tatim taksat lokale.

## **II. Mbi menaxhimin e riskut**

Mbi përgatitjen e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut

**Nga auditimi u konstatua se,** nga ana e titullarit të njësisë publike Bashkia Has nuk është hartuar dhe miratuar Strategji e Menaxhimit të Riskut, por është plotësuar vetëm Formati i Regjistrimit të Riskut. Kjo sjellë mungesë identifikimi, vlerësimi dhe kontrolli mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, të datës 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 21; Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”; Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010.

## **III. Mbi veprimtaritë e kontrollit**

Për vitin 2022, është hartuar Vendimi nr. 10, datë 11.01.2021 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik dhe ekipe të menaxhimit të programeve për hartimin e PBA-së 2022-2024, për Bashkinë Has” dhe caktimin e Koordinatorit të riskut me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 689, datë 28.10.2022, sipas ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Kreu II, neni 8 “Përgjegjshmëria menaxheriale e Titullarit”, pika 2 dhe 8. b dhe neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, germa “ç”.

**Nga auditimi u konstatua se,** gjatë veprimtarisë së GMS-së, kjo strukturë nuk ka qenë në përputhje me kërkesat ligjore, për arsye se:

1. “GMS, nuk ka miratuar plane zhvillimi strategjike me afat jo më pak se sa 5 vjet, kërkesë e ligjit nr. 68-2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 dt. 29.3.2012 “Procedura e përgatitjes së Buxhetit afatmesëm”, Kap. V;
2. Nuk janë përcaktuar rregulla me shkrim mbi veprimtaritë e kontrollit dhe ndarja e detyrave në mënyrë që ndarja e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

## **IV. Informacioni dhe komunikimi**

Informimin dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar edhe në rregulloren e brendshëm.

Përveç kësaj mënyre, informimi realizohet në faqen zyrtare elektronike të Bashkisë Has si edhe nëpërmjet publikimeve dhe njoftimeve të adresuara për publikun veçanërisht lidhur me vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 23.

## **V. Monitorimi**

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës monitorimit në vijueshmëri ose komisionet përkatëse si për marrjen në dorëzim të punimeve të kontraktuara, në rastet e identifikimit të detyrimeve për tatim taksat lokale etj.

Një formë e monitorimit, është deklarata e vetëvlerësimit të sisteme të kontrollit të brendshëm, bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 8.07.2010, neni 24.

*Për sa më lart mban përgjegjësi Z. L. M., Kryetar i Bashkisë Has, Zj. D. G., Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore.*

**Titulli i Gjetjes 1:** *Sistemi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nuk ka funksionuar në mënyrë efektive.*

- Bashkia Has nuk ka hartuar dhe miratuar Gjurmën e Auditimit në kundërshtim me kërkesat e ligjit për MFK-në;

- Bashkia Has nuk ka hartuar një strategji për menaxhimin e riskut. Jo të gjitha strukturat e bashkisë, njësitë administrative dhe ndërmarrjet e varësisë, kanë hartuar regjistrat e tyre të riskut;

- Grupi i Menaxhimit Strategjik nuk është mbledhur rregullisht si dhe nuk ka hartuar asnjë raport periodik mbi kontabilitetin dhe menaxhimin, progresin e bërë në arritjen e objektivave të Bashkisë Has, identifikimin dhe menaxhimin e risqeve, etj.

**Situata:** Nuk është miratuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike, si prokurimet publike, shpenzimet, të ardhurat etj.

Nga titullari nuk është nxjerrë akt i brendshëm ku të përcaktohen detyrat e punonjësit dhe strukturave përkatëse të Bashkisë Has gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës.

Nga ana e titullarit të njësisë publike Bashkia Has nuk është hartuar dhe miratuar Strategji e Menaxhimit të Riskut, por është plotësuar vetëm Format i Regjistratit të Riskut.

Ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

**Kriteret:** - Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 8, pika 2, 8\B, neni 9 pika ç dhe neni 16 pika 2 dhe 3;

- VKM nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” Kreu III, pika 27;

- VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, Kreu VII, pika 49, 52, 52;

- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”;

- Ligjit nr. 68-2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 dt. 29.3.2012 “Procedura e përgatitjes së Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.

**Ndikimi:** Nuk janë identifikuar aktivitetet me risk të lartë si rezultat nuk janë marrë masat e duhura për minimizimin e risqeve që ndikojnë në arritjen e objektivave të secilës strukturë. Sistemet e informacionit dhe komunikimit nuk sigurojnë një komunikim efektiv si dhe nuk sigurohet dokumentimi i të gjitha veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve për vijueshmërinë dhe monitorimin me qëllim mirë menaxhimin e fondeve publike.

**Shkaku:** Mosnjohje sa dhe si duhet e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nga niveli i lartë drejtues, si dhe mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.

Dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës.

**Rëndësia:** E mesme.

**Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa që hartohet dhe miratohet strategjia e risku. Titullari i Bashkisë Has të miratojë gjurmën e auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme.

Koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore me qëllim vlerësimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave të MFK-së.

Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has të marrë masa që për çdo largim punonjësish nga puna të ndiqet procedura për dorëzimin e detyrës.

*2. Për organizimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm si dhe zbatimin e rekomandimeve të tyre në Bashkinë Has për vitin 2022.*

*Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e Njesisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Has, konstatua se, për periudhën objekt auditimi, nuk ka një Njësi të Auditimit të Brendshëm që funksionon në përputhje Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, pika 1. *Të gjitha njësitë publike, të përfshira në neni 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm.* Njësia e auditit të brendshëm për sa i përket numrit të audituesve që duhet të ketë në strukturë, nuk është ngritur në përputhje me kërkesat e Vendimin Nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3, ndërsa faktikisht është vetëm një auditues i brendshëm (Specialist i Auditit të Brendshëm) për vitin 2022, i emëruar me Urdhrin nr. 696, datë 31.10.2022.*

Në zbatim të Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Neni 11, “Përgjegjësitë e titullarëve të njësive publike”, titullari i Bashkisë Has nuk ka ngritur një strukturë për auditimin e brendshëm të bashkisë për të siguruar këtë shërbim.

Rezulton se për vitin 2022 nga Bashkia Has nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim.

*Për sa më lart mban përgjegjësi Z. L. M., Kryetar i Bashkisë Has.*

## **Titulli i Gjetjes 2: Mungesë e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm**

**Situata:** Struktura e auditit të brendshëm për vitin 2022 ka funksionuar vetëm me një auditues, nga tre që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Rezulton se për vitin 2022 nga Bashkia Has nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim, duke mos kryer detyrën funksionale dhe duke mos i dhënë titullarit të njësive publike këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe siguri për realizimin e objektivave.

**Kriteri:** Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, pika 1, *Të gjitha njësitë publike, të përfshira në neni 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm dhe neni 11, Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3.*

**Ndikimi:** Mungesa e ngritjes së strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm nuk sjell një veprimtari të pavarur që jep siguri objektive dhe këshillim për të përmirësuar performancën e institucionit

**Shkaku:** Mos ngritje të Njesisë së Auditit të Brendshëm

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësive ose, shërbimi i auditit të brendshëm të kryhet nga njësia e auditit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse.

## 2.2 Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

- *Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin e PBA-së dhe programimit të buxheteve vjetore.*

### Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA-së 2022-2024 rezultoi se, në realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Vendimi i Këshillit Bashkiak për miratimin e Kalendarit të Përgatitjes së PBA-së e buxhetit vjetor dhe Urdhri i Titullarit të Institucionit për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) si dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP), dhe këto dokumente janë përgatitur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave. Urdhrat e Titullarit për ngritjen e GMS dhe EMP janë :

**Në vitin 2020** është miratuar Kalendarit i Përgatitjes së PBA-së 2022-2024 me VKB Nr.106 datë 25.12.2020.

Është marrë vendimi Nr.10 datë 11.01.2021 për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Ekipëve të Menaxhimit të Programeve (EMP) për hartimin e PBA-së 2022-2024. Buxhetit Vjetor për vitin 2022 është miratuar me vendimin e këshillit bashkiak Nr.80 datë 22.12.2021 dhe konfirmuar nga Prefekti me Verifikim ligjshmërie Nr.3/62 datë 07.01.2022

Në fazën përfundimtare duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, duke respektuar tavanet buxhetore të miratuara nga Këshilli Bashkiak në fazën e parë të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor trevjeçar sipas programeve si për shpenzimet korrente, investimet dhe të ardhurat. Në përfundim të fazës së parë të përgatitjes së PBA me shkresën nr. 971 datë 31.05.2021 është dërguar në MFE projekt dokumenti i PBA 2022-2024.

-Hartimi i PBA-së dhe Buxhetit Vjetor i përgatitur është miratuar në këshillin bashkiak në tre faza, faza e parë në muajin Qershor, faza e dytë në muajin shtator dhe faza e tretë në muajin Dhjetor.

Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA 2022-2024 rezultoi se, janë respektuar kërkesat e Udhëzimit të MFE Nr. 8, datë 28.02.2019 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022" dhe të Udhëzimit plotësues të MFE nr.20, datë 10.07.2019 "Për përgatitjen e buxhetit vendor".

Në këtë program risi është futja e Instrumentit të planifikimit financiar i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet ( detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogaria e ekonomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme. (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).

Në dokumentin e PBA janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, por nuk është bërë analiza e zërave të buxhetit në tre vite dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin kjo PBA 2022-2023-2024.

Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit, në bujqësi për të thithur projekte investimi me financim nga FZHR.

Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat etj. Kërkesat buxhetore për PBA janë dërguar në MFE me shkresat përkatëse.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore,

nëpërmjet procesit të “Buxhetimit me pjesëmarrje”, gjë që e konfirmon raporti i publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Has

➤ Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2022

Buxheti vjetor 2022 është miratuar në Këshillin Bashkiak dhe është konfirmuar nga Institucioni i Prefektit Qarku Kukës, konkretisht:

Buxheti është miratuar me Vendim të KB Nr.80, datë 22.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Kukës me shkresën Nr.3/62 datë 07.01.2022.

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022	
		Të Ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëg. nga viti paraardhës	14,749	0
2	Transferta pakush. trashëg. viti paraardhës	316	0
3	Trashëguar nga Transferta specifike	0	0
4	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	35,054	0
5	Transferta e pakushtëzuar	157,418	0
6	Transferta specifike	91,502	0
7	Transferta e Kushtëzuar	281,414	0
8	Paga (600)	0	160,140
9	Sigurime shoqërore (601)	0	25,651
10	Shpenzime operative (602)	0	84,078
11	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë	0	372,695
12	Inv (230 +231) Të ardhurat e Tr. Pakush.	0	27,089
13	Investime nga FZhSh dhe Min.e Linjës	0	10,800
14	Te tjera (166, 651, 603, 604, 606)	0	0
<b>Totali i buxhetit</b>		<b>680,453</b>	<b>680,453</b>

Sipas tabelës së mësipërme buxheti i vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite. Buxheti nuk është hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësitë administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë, ndërmarrja e shërbimeve dhe ujisjellësi, etj, gjë që vërteton se prej tyre nuk janë marrë kërkesat për nevojat reale, ku mbi bazën e tyre të hartohet buxheti.

Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA-ja 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan fillestar 2022	Sipas PBA 2022-2024	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga të ardhur, grant i pakush. e spec.)	165,705	165,705	0
2	Shpenzime (602.604.609) (nga ardhura e grant i pakushtëz e specifik)	241,969	241,969	0
3	Investime Bashkia (nga të ardhura dhe grant i pakushtëzuar)	23,234	23,234	0
4	Investime nga FZhSh	0	0	0
	<b>Total i planit fillestar</b>	<b>265,203</b>	<b>265,203</b>	<b>0</b>
	<b>Shtesat nga Pushteti Qendror</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
1	Investime grant i kushtëzuar	0	0	0
2	Shpenzime për pagat (600+601)	0	0	0
3	Shpenzime (602.604.609)	0	0	0
	<i>Grant i kushtëzuar (230-231)</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
	<b>Gjithsej</b>	<b>265,203</b>	<b>265,203</b>	<b>0</b>

**Burimi:** Nga Përpunimi i të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti

Në planin e buxhetit 2022 në krahasim me PBA 2022-2024, nuk ka diferenca në mes të planeve të parashikuara.

➤ Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Has dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit dhe në MFE.

Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit Has. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Has dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, investime, shpërblime lindje, etj, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me vendim të Këshillit Bashkiak, e përcaktuar kjo në ligjin për buxhetin dhe udhëzimin e MFE për zbatimin e buxhetit.

Ndryshimet buxhetore për vitin ushtrimor 2022, sipas VKB paraqiten në tabelën e paraqitur më poshtë:

Nr	Emërtesa	Nr	Date	Vlere
1	Shtese ne Buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022	4	28.01.2022	20,065,484
2	Ndryshim ne Buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022	20	25.02.2022	1,000,000
3	Shtese dhe rishperndarje ne Buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022	55	29.07.2022	776,225
4	Shtese ne Buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022	57	29.07.2022	1,500,000
5	Rishperndarje ne Buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022	60	31.08.2022	13,901,760
6	Shtese ne Buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022	61	31.08.2022	1,000,000
7	Shtese dhe rishperndarje ne Buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022	74	30.09.2022	1,087,408
8	Rishperndarje ne Buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022	78	27.10.2022	9,199,000
9	Shtese ne Buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022	92	22.12.2022	2,604,000

Ndryshimet buxhetore per vitin 2022 (Vendimet e Kryetarit te Bashkisë)

Nr.	Emërtesa	Nr	Date	Vlere
1	Rishperndarje ne Buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022	482	19.08.2022	17,158,090
2	Per disa ndryshime brenda programeve, ne buxhetin e Bashkise Has per 2022	654	14.10.2022	13,393,384
3	Per disa ndryshime brenda programeve, ne buxhetin e Bashkise Has per 2022	735/1	01.12.2022	5,891,898
4	Rishperndarje ne Buxhetin e Bashkise Has per vitin 2022	915	30.12.2022	4,430,000

**Konkluzion:** Referuar tabelës që paraqet vendimet për shtesat dhe pakësimet të kryera në buxhet gjatë vitit buxhetor konstatohet se, janë kryer ndryshime të vazhdueshme, ku për vitin 2022 kanë ndodhur 13 ndryshime me VKB, ku një pjesë e këtyre ndryshimeve kanë ndodhur për efekt të shtesave të fondeve për mbulimin e niveleve të reja të pagave të ndryshuara me VKM, një pjesë e këtyre ndryshimeve brenda zërave të të njëjtit program apo në të njëjtin zë për programe të ndryshme, për të cilat mungojnë relacion shpjegues lidhur me arsyet e ndryshimit dhe nuk ka një analizë se si ndikon ky ndryshim në realizimin e objektivave të synuar të bashkisë.

- *Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.*



Për zbatimet e buxheteve vjetore është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Has, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Has, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektive të realizuar me Vendime të Këshillit Bashkiak, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit, me rritjen e limit nga të ardhurat e realizuara. U konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	2022		
		Plan	Fakt	%
1	Paga 600	160,191	158,423	99
2	Sigurime shoqërore 601	25,650	25,599	100
3	Shp.Oper.602+F.Rezervë	92,398	87,173	94
4	Kredia+Interesi 166-651	0	0	0
4	K. Q Emergj Civile 604	3,310	3,310	100
5	Nd/Ekonom invalid 606	361,015	359,279	100
6	Mjete ne ruajtje 466	0	0	0
7	Investime 230-231	37,889	37,888	100
	<b>Totali</b>	<b>680,453</b>	<b>671,672</b>	<b>99</b>

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

- Për **vitin 2022** janë realizuar 671,672 mijë lekë nga 680,453 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 99%.

Në 4 vitet e fundit peshën specifike me të madhe në buxhetin e planifikuar ndaj totalit ndër vitet 2019-2020-2021-2022e zënë shpenzimet për paga në masën rreth 67%, investimet në masën rreth 27%, por kemi ulje të shpenzimeve operative, tregues të cilët paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	EMËRTIMI	Në përqindja ndaj totalit			
		Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
1	Shpenzimet operative	52%	58%	64%	67%
2	Investime	24%	16%	8%	6%
3	Shpenzime për paga	25%	26%	28%	27%

• Miratimi i realizimit faktik të buxheteve.

Në fund të periudhës ushtrimore Bashkia Has ka miratuar buxhetin faktik vjetor. Gjithashtu janë paraqitur dhe miratuar edhe buxhetet faktike për çdo 4 muaj, si dhe janë paraqitur informacionet mujore në këshill, për ecurinë e zbatimit të buxhetit gjatë vitit ushtrimor.

Buxhetet faktike janë miratuar së bashku me analizat faktoriale për realizimin e fondeve, ku janë dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës. Këto veprime janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit nr.68, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, Kreu IX, neni 51 “Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor”, pika 4.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës.

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë dhe i kontigjencës, konkretisht:

-Për **vitin 2022**, është miratuar në vlerën 8,320 mijë lekë, nga e cila është përdorur vlera 7,373 mijë lekë, për:

- dhënie mbështetje financiare të punonjësve 5,410 mijë lekë.

- dhënie ndihma të menjëhershme të familjeve në nevojë, emergjenca civile dhe shpërblime për raste fatkeqësie 1,963 mijë lekë.

- *Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizmit të të ardhurave.*

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

- *Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të pa likuiduara*

Me fondet e vitit buxhetor 2022, janë planifikuar dhe shlyer edhe detyrimet për fatura të pa likuiduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale, sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e linjës apo FZSH, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB Nr. /datë Miratim Buxheti	Llog. 602	Llog. 230-231
Viti 2022	11,333,143.8	6,428,509	VKB Nr.96 date 22.12.2022 MP Nr.3/60 date 09.01.2023 VKB nr. 04 dt.28.01.2022	<b>2,329,120</b>	<b>9,004,023.8</b>

Burimi: Nga të dhënat e subjekti sipas pasqyrave.

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura” dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

*Raportimi në MFE i detyrimeve të prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2022:*

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31/12/2021/lekë	Detyrimi I krijuar në periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022 (lekë)	Total detyrime/lekë	Shlyerja e detyrimeve gjate vitit 2022/lekë	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022
					Lekë
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
INVESTIME	16,341,409.8	-	16,341,409.8	9,004,309	7,337,100.8
Investime nga FZSH	1,274,405	1,475,314	2,749,719	1,110,996	1,638,723
Mallra dhe shërbime	28,200	3,863,212	3,891,412	2,979,270	912,142
Vendime gjyqësore	395,178	0	395,178	0	395,178
Të tjera(Shpërblim lindje)	1,050,000	0	1,050,000	0	1,050,000
<b>Totali :</b>	<b>19,089,192.8</b>	<b>5,338,526</b>	<b>24,427,718.8</b>	<b>13,094,575</b>	<b>11,333,143.8</b>

Referuar tabelës dhe email-it të dërguar në MFE për raportimin e detyrimeve të prapambetura për vitin 2022 rezulton se, detyrimet në mbyllje të vitit 2022 janë në shumën **11,333,143.8** lekë, të cilat rakordojnë ndërmjet tyre dhe me gjendjen e llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” në bilancin e vitit 2022.

Në raportime janë përfshirë edhe detyrimet e prapambetura për investime të pa financuara nga Ministrinë e linjës, pasi dhe operatorët ekonomikë, që janë sipërmarrës të punimeve, pavarësisht se kanë përfunduar punimet në objektet e investimit, faturat i kanë prerë dhe sjellë pranë Bashkisë për likuidim.

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që, në fund të vitit 2022 janë të pa likuiduara gjithsej **7** fatura

me vlerë **10,937,965.8** dhe 1 faturë në vlerën 395,178lekë, që i përket detyrimeve trashëguara në vitin 2015 nga ish-Komunat, të cilat janë krijuar nga viti 2015 e para tij. Për vlerën 395,178 lekë të detyrimeve të trashëguara nga ish-Komunat nuk ka të dhëna dhe mungon dokumentacioni ligjor e financiar mbështetës. Detyrimet e prapambetura për fatura të pa likuiduara, në mënyrë analitike paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Objekti	Kreditori	Numri i Fatura	Kreditor me date	Likuiduar viti 2022	Shtesat 2022	Detyrime 31.12.2022
				31.12.2021			
1	Kolaudim punimesh rruga Zahrishtit	Xh & M..Shpk	21.11.2018	28,200	0	0	28,200
2	Shpenzi per ekzekutime VGJ (nga ish-komunat) pa dok.	VGJ A. I.	Para vitit 2015	395,178	0	0	395,178
3	Rehabilitim i Rrugeve Lagje Peka dhe Pazari I Vjeter	Z..	03.06.2019	13,168,101	5,831,000	0	7,337,101
4	Ndertim ujesjellesi Krume Zahrisht vazhdim Shtesa	L.SHPK	24.09.2018	163,409	0	0	163,409
5	Rikonstruksion i rruges lidhese fshati Perollaj	D.05	21.10.2019	3,173,308.8	3,173,309	0	0
6	Shperbl femije e lindur e rregjistruar brenda afatit ligjor	MB	Tetor 2016-dhjetor 2018	1,050,000	0	0	1,050,000
7	Komision poste	Dega e postes Has	Dhjetor 2021	0	1617,320	1,617,320	0
8	Ndertim lera plasmasi Gjinaj	V. group	28.12.2021	0	858,600	858,600	0
9	Blerje stufa per ngrohje	S. L. PF	27.12.2021	0	98,000	98,000	0
10	Blerje kartolina urimi per festat e fundvitit dhe zbukurime ambiente shkollore	C..2A	28.12.2021	0	117,000	117,000	0
11	Blerje materiale plastike per pastrim (kova,fshesa etj)	Punime gipsi PF	27.12.2021	0	97,350	97,350	0
12	Blerje plehra kimike dhe organike	S. L.PF	27.12.2021	0	49,400	49,400	0
13	Blerje sherbim interneti per nevoja te bashkise Has dhe NJA Golaj,Gjinaj,Fajza	B.C..PF	28.12.2021	0	141,600	141,600	0
14	Ndertim Ujesjellesi Rajonal per njesine administrative Golaj, Per fshatrat Dobrunë, Qarr i Vogël, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has	L.SHPK	05.08.2022	1,110,996	1,110,996	1,475,314	1,475,314
15	Blerje leter format,dosje,makna,kapse aktesh,kancelari	M&D.	31.08.2022	0	0	516,000	516,000
16	Komision Poste	Dega e postes Has	Tetor-nentor 2022	0	0	367,942	367,942
<b>Shuma Bashkia deri 31.12.2022</b>				<b>19,089,192.8</b>	<b>13,094,575</b>	<b>5,338,526</b>	<b>11,333,143</b>

**Konkluzion:** Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, Bashkia Has, ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej **11,333,143.8** lekë. Duke krahasuar me vitet në fund të periudhës ushtrimore paraardhëse, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura ka ardhur duke u ulur, pasi në fund të: **vitit 2019** këto detyrime ishin në shumën **39,176,090.8** lekë, në fund të **vitit 2020** detyrimet ishin në shumën **28,833,237.6** lekë, në fund të **vitit 2021** vlera e detyrimeve është **19,089,192.8** lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2022 rezultoi se, është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 09, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të e buxhetit”. Nga analiza e këtyre detyrimeve ndaj të tretëve vihet re se në vlerë të konsiderueshme janë detyrimet ndaj të treteve për dy projektet “Rehabilitim i rrugëve Lagje Peka dhe Pazar i Vjetër” i financuar nga Buxheti i Bashkisë Has dhe projekti “Ndërtim Ujesjellesi Rajonal për Njësinë Administrative Golaj, për fshatrat Dobrunë, Qarr i Vogël, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has” i financuar nga Buxheti Qendror (Ministria e Infrastrukturës), të cilat pasohen nga një vlerë e konsiderueshme e detyrimit për Shpërblimet e lindjes, që gjithashtu mbulohet me fondet e Buxhetit Qendror (Ministria e Brendshme).

**Detyrimet e papaguara ndaj të tretëve** në total në fund të vitit 2022 në vlerën **11,333,143.8** lekë, e cila e analizuar sipas viteve të krijimit janë: në vitin 2015 e para tij në vlerën 395,178 lekë, në vitin 2018 në vlerën 1,241,609 lekë, në vitin 2019-2020-2021 në vlerën 7,337,100.8 lekë dhe **në vitin 2022 në vlerën 2,359,256 lekë.**

#### Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Has

Nga auditimi rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore në vitin 2021 është në vlerën 395,178 lekë, për të cilën Bashkia Has ka Vendimin e Gjykatës nr. 940 dhe nr. 1011, datë 16.12.1994 dhe nuk ka dokumentacion tjetër përkatësisht një Urdhër nga zyra përmbarimore që të mund të shlyej detyrimin e krijuar për këtë çështje dhe si rezultat në fund të vitit 2021 rezulton e papaguar vlera 395,178 lekë.

### **Titulli gjetjes 3: Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara.**

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite, por gjithashtu gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Në fillim të vitit buxhetor 2022 detyrimet e prapambetura kanë vlerën **19,089,192.8** lekë, prej të cilave është likuiduar vlera 13,920,155 lekë, por është krijuar detyrim i ri në vlerën 5,338,526 lekë, duke e çuar vlerën e këtyre detyrimeve më 31.12.2022 në vlerën **11,333,143.8** lekë.

**Kriteri:** Udhëzimi i MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

**Impakti:** Mos shlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penalitetesh të panevojshme dhe pasaktësi në vlera dhe mangësi në raportime të detyrimeve të prapambetura

**Shkaku:** Moszbatim i kërkesave ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, vlera jo të besueshme.

**Rëndësia:** E lartë

**Për këtë rekomandojmë:** Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtoria Ekonomike , të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Has dhe kontraktorëve, brenda afatit 30 ditor pas ardhjes së faturës tatimore, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.

### **Vështirësia Financiare**

Nga auditimi është konstatuar se **detyrimet e papaguara (të akumuluar)** në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën **11,333,143.8 lekë** dhe **fondet e miratuara** për shpenzime të këtij viti janë në vlerën **319,438,000 lekë** (680,453,000 lekë totali i planifikuar –361,015,000 lekë transferta e kushtëzuar ndihmë ekonomike & invaliditet).Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj ndaj palëve të treta është 3,55 % kundrejt fondeve të miratuara. Kjo situatë tregon se, Bashkia Has nuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2022, pasi raporti i e detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është nën nivelin prej 25 %, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investimeve përmes FZHR dhe ministrive të linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transferta e pakushtëzuar, të ardhurat e veta të Bashkisë Has, fondet FZSHH, Ministrinë e linjës dhe Ministria e Financave.

- Për **vitin 2022** në buxhetin fillestar janë planifikuar fonde për investime në shumën 23,292,996 lekë për 4 projekte nga kontrata ne vazhdim, dy projekte të reja për të cilat nuk janë bere procedura prokurimi dhe 3 projekte gjithashtu me procedura te paplota.

Gjatë vitit ka pasur ndryshime si shtesa dhe pakësime të cilat janë shqyrtuar nga GMS, i cili ka vendosur miratimin e tyre dhe më pas janë miratuar me V.K.B për secilin rast.

Ne Maj te vitit 2022 është lidhur kontrata “Blerje automjet teknologjik (kamion) për Grumbullim-Kompaktim-Shkarkim te mbeturinave dhe konteniere (kosha) te përshtatshëm 1.1 m3 për grumbullimin e mbeturinave për Bashkinë Has.

Projekti “Ndërtim Ujësjellësi Rajonal për NJA Golaj, për fshatrat Dobrunë, Qarr i Vogël, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has” është gjithashtu kontratë në vazhdim me burim financimi të kushtëzuar nga pushteti qendror.

Nga këto projekte, janë kryer pagesa në vlerën 211,574,579 leke e cila është totali që nga fillimi i kontratës dhe mbetet për pagesë në vazhdim vlera 217,882,661 lekë , e cila i përket vlerës së kontratës së papaguar dhe jo vlerës së faturave të mbërritura pasi ka projekte që shtrihen në më shumë se një vit apo me procedura të paplotësuara.

Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Viti 2022											
Nr.	Institucioni	Burimi financimit	Objekti	Fondi (leke me TVSH)/ Buxhet	Operatori ekonomik fitues	Vlera e Kontrates me TVSH	Data e lidhjes se Kontrates	Afati parashikuar (dite)	Likuidimi faktik me TVSH	Likuj dim fakti në %	Mbetur pa likujduar vlera e kontrates
1	Bashkia	Buxheti Bashkise	Kolaudim punimesh Rruga Zahrisht	28,200	XH & M....	-	Nuk ka kontrate	-	-	-	-
2	Bashkia	Buxheti Bashkise	Rehabilitim rruges nga rruga kryesore lagje Dida deri ne lagjen Gec	5,000,000	Nuk ka	-	Nuk ka procedure	-	-	-	-
3	Bashkia	Buxheti Bashkise	Rehabilitim trotuare pergjate rruges nacionale dalje Qytetit Krume deri Rezervuari Pla	3,500,000	Nuk ka	-	Nuk ka procedure	-	-	-	-
4	Bashkia	Buxheti Bashkise	Rehabilitim i Rrugeve Lagje Peka dhe Pazari i Vjeter	56,331,587	Z....	55,795,631	19.09.2018	5 muaj (150 dite)	48,458,530	87%	<b>7,337,101 me fature te mbërritur</b>
5	Bashkia	Buxheti Bashkise	Ndertim Rruga e Bjeskes Gjinaj	11,400,000	H....	11,340,000	19.08.2020	90 dite (e shtrire sipas financimit)	11,340,000	100%	-
6	Bashkia	Buxheti Bashkise	Pallati	30,943,092	P.....	27,583,959	27.09.2019	12 muaj (dhe ne varesi te financimit)	24,499,084	89%	<b>3,084,876</b>
7	Bashkia	Buxheti Bashkise	Rruga e lagjes Ukperaj (Perollaj)	24,610,997	D..... 05	24,126,203	24.06.2019	12 muaj (dhe ne varesi te financimit)	24,126,203	100%	-
8	Bashkia	Qeverisja qendrore	Ndertim Ujesjellesi Rajonal per NJA Golaj, per fshatrat Dobrone, Qarr i Vogel, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has	300,000,000	L.....	298,847,798	22.05.2020	Pa afat (dhe ne varesi te financimit)	91,475,314	31%	<b>207,372,484 per fature te mbërritur ne vlerën 1,475,314</b>
9	Bashkia	Bashkia+Ambasada Japoneze	Blerje automjet teknologjik (kamion) per Grumbullim-Kompaktim-Shkarkim te mbeturinave dhe konteniere (kosha) te pershtatshem 1.1 m3 per grumbullimin e mbeturinave per Bashkine Has	12,000,000	T.....	11,675,448	12.05.2022	30 dite	11,675,448	100%	<b>0</b>
			<b>SHUMA Për vitin 2022</b>	443,813,676		429,397,24			211,574,579		<b>217,822,661</b>

Nga dokumentacioni zyrtar i mbajtur nga Bashkia Has për fondet akorduara për financimin e projekteve të investimeve rezulton se:

**Për vitin 2022** janë financuar nga të ardhurat e Bashkisë dhe Transferta e pakushtëzuar (grant) nga buxheti i shtetit dhe bashkëfinancimi me Ambasaden Japoneze, 8 projekte në infrastrukturë, mirëmbajtje objekte ndertimore dhe blerje pajisje pastrimi.

Ndërsa nga Ministria e Infrastrukturës është financuar 1 projekt me objekt “Ndërtim Ujësajesi Rajonal për NJA Golaj, për fshatrat Dobrunë, Qarr i Vogël, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has” me vlerë kontrate 298,847,798 lekë, me afat të pacaktuar nga data 22.05.2020 e lidhjes së kontratës, paguar deri në fund të vitit 2022 në vlerën 91,475,314 lekë, mbetur pa likuiduar vlera prej 207,372,484 lekë.

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e **9** projekteve të investimeve me fondeve të akorduara nga Ministria e Linjës, si dhe fondeve të veta të vëna në dispozicion nga Bashkia Has për periudhën 2022, rezultoi se janë ndjekur hapat:

Bashkia për këto investime ka marrë angazhime buxhetore një dhe disavjeçare, të cilat janë regjistruar kundrejt planit vjetor për tre vite në vijim në Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) nëpërmjet Degës së Thesarit Has.

Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Has. Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Has dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas planifikimit në PBA. Nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara me qëllim pagesën e saj dhe në rastet, kur fondi nga Ministria ka ardhur i ndarë në afate mujore kontrata është regjistruar e plotë, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

➤ Burimet e financimit të buxhetit vjetor.

Realizimi i buxhetit për vitin 2022 sipas burimit të financimit paraqitet :

Në mijë lekë

Nr	Emërtimi	2022		
		Plan	Fakt	Real.%
<b>1</b>	<b>Paga 600</b>	<b>160,140</b>	<b>158,373</b>	98.9%
a	Grant i kushtëzuar	2,200	2,200	100.0%
b	Grant i pakushtëzuar dhe specifikë	147,664	147,590	99.9%
c	Të ardhurat vendore	10,276	8,583	83.5%
<b>2</b>	<b>Sigurime shoqërore 601</b>	<b>25,651</b>	<b>25,599</b>	99.8%
a	Grant i kushtëzuar	340	340	100.0%
b	Grant i pakushtëzuar dhe specifikë	25,161	25,136	99.9%
c	Të ardhurat vendore	150	123	82.0%
<b>3</b>	<b>Shpenz.operative 602+ F.Rezervë</b>	<b>92,448</b>	<b>87,223</b>	94.3%
a	Grant i kushtëzuar	3,749	3,749	100.0%
b	Grant i pakushtëzuar dhe specifikë	73,560	73,188	99.5%
c	Të ardhurat vendore	15,139	10,286	67.9%
<b>4</b>	<b>Kredia dhe Interesi 166-651</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	0.0%
a	Të ardhurat vendore	0	0	0.0%
<b>5</b>	<b>K.Qarkut Emergj.civile 604</b>	<b>3,310</b>	<b>3,310</b>	100.0%
a	Grant i pakushtëzuar-specifikë	0	0	0.0%
b	Të ardhurat vendore	0	0	0.0%
c	Transferta nga Qeveria	3,310	3,310	100.0%
<b>6</b>	<b>Nd ekonomike dhe invalid 606</b>	<b>361,015</b>	<b>359,279</b>	99.5%
a	Grant i kushtëzuar	361,015	359,279	99.5%
b	Grant i pakushtëzuar-specifikë	0	0	0.0%
c	Të ardhurat vendore	0	0	0.0%
<b>7</b>	<b>Mjete në ruajtje 466</b>	<b>1,099</b>	<b>1,099</b>	100.0%
a	Grant i pakushtëzuar/kushtëzuar	630	630	100.0%
b	Të ardhurat vendore	469	469	100.0%
<b>8</b>	<b>Investime 230-231</b>	<b>36,790</b>	<b>36,789</b>	100.0%
8.1	Buxheti i bashkisë	26,490	26,489	100.0%
a	Grant i pakushtëzuar dhe specifikë	2,721	2,721	100.0%
b	Të ardhurat vendore	23,769	23,768	100.0%

8.2	Ministritë e linjës dhe FZHR	10,300	10,300	100.0%
TOTALI		680,453	671,672	98.7%

Referuar tabelës së mësipërme rezultojn se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 “paga e shpërblime” për vitin 2022 në masën 5.4 %.
- Shpenzimet në artikullin 601 “Kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore”, për vitin 2022 në masën 0.5%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “Shpenzime operative-mallra e shërbime” për vitin 2022 në masën 11.8%.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “Investime” për vitin 2022 në masën 64.6%.

Duke u nisur nga burimi i financimit shpenzimet buxhetore janë përballuar:

**Për vitin 2022**, nga të ardhurat e veta në shumën 43,229 mijë lekë ose në masën 6.4%, nga transfertat e pakushtëzuar dhe transfertat specifike në shumën 249,265 mijë lekë ose në masën 37.1%, nga transfertat e kushtëzuar në shumën 368,878 mijë lekë ose në masën 54.9%, nga FZHR dhe Ministritë e Linjës në shumën 10,300 mijë lekë ose në masën 1.5%.

- Raportet e Monitorimit.

Për vitin 2022, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, si dhe me Udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësive të Qeverisjes vendore”. Këto raporte janë përcjellë në MFE me shkresat përkatëse: me nr.prot.1123 datë 20.05.2022, me nr.prot.2042 datë 20.09.2022 dhe nr.prot.293 datë 07.02.2023.

- Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.

Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

**Për vitin 2022** numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr.79, datë 22.12.2021 dhe me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr.191 datë 01.04.2020 “Për miratimin e strukturës, organigramës e Bashkisë Has, viti 2022”, ku përfshihet edhe struktura e Sektorit të Taksave dhe tarifave Vendore, si pjesë e Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila përbëhet nga 4 punonjës, 1 përgjegjës dhe nga 3 specialistë.

- Të dhëna mbi numrin e subjekteve, regjistrimet dhe mbylljet

Nga të dhënat e paraqitura nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Has në lidhje me numrin e subjekteve aktiv, regjistrimeve të reja dhe atyre që kanë kërkuar mbyllje aktiviteti, rezultojn se:

Për periudhën objekt auditimi, gjendja dhe ndryshimet mbi statusin e subjekteve paraqiten: **në vitin 2022** janë **178** subjekte biznesi, nga të cilat 117 subjekte të biznesit të vogël dhe 46 subjekte të biznesit të madh, Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Has në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

NR	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të vitit	Biznese të palicencuar deri në fund të vitit ushtrimor
1	BIZNES I VOGEL	2022	113	9	5	117	-
2	BIZNESI MADH	2022	48	1	3	46	-
3	INSTITUCIONE	2022	15	0	0	15	-
	TOTALI	2022	176	10	8	178	-

- Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2022, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Has është miratuar me VKB nr. 78, datë 22.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në



Bashkinë Has”. Referuar planit vjetor të miratuar dhe bazuar në akt-rakordimet me Degën e Thesarit Tepelenë, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për Bashkinë Has për 2022 paraqitet i detajuar në Aneksin nr. 2/1

Për vitin 2022 realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore në Bashkinë Has paraqitet në masën 120%, nga 29,126 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 35,054 mijë lekë (plus 5,928 mijë lekë). Në këtë realizim kanë ndikuar pagesat e debive të viteve të kaluara në vlerën 2,514,241 lekë si dhe të ardhurat nga taksat e ndara të realizuara në shumën 14,653 mijë lekë nga 10,170 mijë lekë të planifikuara ose në masën 144% , ku përfshihen (Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme, Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura, Taksa e rentës minerare, Taksa mbi të ardhurat personale), për të cilat nuk është bërë i mundur planifikimi i saktë tyre.

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Kështu :

a. Taksat dhe tarifave e paraqitura me realizim mbi planin si:

- **Taksa mbi truallin** nuk është planifikuar ,ndërsa realizimi është 46 mijë lekë
- **Taksa e ndikimit në infrastrukturë** është realizuar 1,918 mijë lekë nga 1,575 mijë lekë e planifikuar ose në masën 122%,
- **Taksa e tabelës** është realizuar 187 mijë lekë nga 133 mijë lekë e planifikuar ose në masën 141%,
- **Tarifa e menaxhimit të mbetjeve** është realizuar 5,510 mijë lekë nga 4,859 mijë lekë e planifikuar ose në masën 113%,
- **Tarifa për gjelbërimin nga bizneset** është realizuar 144 mijë lekë nga 161 mijë lekë e planifikuar ose në masën 112%,
- **Qiraja nga asetet në pronësi të bashkisë** është realizuar 4,158 mijë lekë nga 3,527 mijë lekë e planifikuar ose në masën 118%,
- **Tarifa e pastrimit për biznesin** është realizuar 3,636 mijë lekë nga 2,627 mijë lekë e planifikuar ose në masën 138%,

b. Taksat dhe tarifave e paraqitura me realizim të planit si:

- **Taksa vendore mbi biznesin e vogël** është realizuar 30mijë lekë nga 400 mijë lekë e planifikuar ose në masën 8%,
- **Taksa mbi pasurinë e paluajtshme** është realizuar 1,061 mijë lekë nga 1,709 mijë lekë e planifikuar ose në masën 62%,
- **Taksa mbi ndërtesën** është realizuar 977 mijë lekë nga 1,642 mijë lekë e planifikuar ose në masën 60%,
- **Taksa mbi tokën bujqësore** është realizuar 35 mijë lekë nga 67 mijë lekë e planifikuar ose në masën 52%,
- **Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime** është realizuar 0 mijë lekë nga 147 mijë lekë e planifikuar ose në masën 0%,
- **Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit** është realizuar 414 mijë lekë nga 630 mijë lekë e planifikuar ose në masën 66%,
- **Kundërvajtjet administrative (Gjobat)** është realizuar 128 mijë lekë nga 300 mijë lekë e planifikuar ose në masën 43%,

➤ Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;

- Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022 .

Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar **niveli i lartë e debitorëve**. Në bazë të punimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave në Bashkinë Has, rezultoi se ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët,(për taksën e

ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie, tarifa e qirasë për objekte, toka, pyje, dru zjarri etj), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të vitit 2021 vlera debitorëve është **39,906,902 lekë** dhe në fund të vitit 2022 vlera debitorëve është **42,557,390 lekë**.

Nr	LLOJI I DEBITOREVE	Periudha (12 VJECARE) 31.12.2011 deri me 31.12.2022						
		Lloji i Detyrimeve		Shuma e Detyrimeve Progresiv 2021	Sistemime shtese ne gjendjen e vitit 2021	Shtesa	Pakesime	Shuma e Detyrimeve Progresiv 2022
1	Biznes i Vogel	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndricimi, gjelbrimi, Takse ndertese, Takse tabele	11,458,560		921,905	403,889	11,976,576
2	Biznes i Madh	Taksa e Tarifa vendore	Tarife pastrimi, ndricimi, gjelbrimi, reklame, Tarife leje e licenca, Takse ndertese, Takse Tabele, Qera fondi pyjor kullusor	15,184,624		1,667,819	2,003,280	14,849,163
3	Istytucione Shtetore	Taksa e Tarifa vendore		154,480		52,120	52,120	154,480
4	Kryefamilajre te pajisur me leje legalizimi	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet informale te legalizuara	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	9,281,297		1,337,708	-	10,619,005
5	Qeramarres te ambienteve te tregut (Markata)	Qera te ambienteve te tregut (Markata)	Qera ambienti hapsira publike	3,743,941	519,144	653,133	54,952	4,861,266
6	Qera Toke Bujqesore	Toke bujqesore		84,000	-	12,900	-	96,900
<b>TOTALI</b>				<b>39,906,902</b>	<b>519,144</b>	<b>4,645,585</b>	<b>2,514,241</b>	<b>42,557,390</b>

Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Has paraqitet:

**Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është 4,645,585 lekë nga të cilat:**

- Detyrimet nga taksat dhe tarifrat për personat fizikë/juridikë në shumën 2,589,724 lekë;
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 52,120 lekë;
- Detyrime nga qiratë e tregut (markata) në shumën 653,133 lekë;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **1,337,708 lekë**;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë në vlerën **12,900 lekë**

Në uljen e debitorëve ka ndikuar pagesat e kryera për detyrimet debitorë të viteve para vitit 2021 në vlerën 2,514,241 lekë e cila ka sjellë që **vlera debitorë për vitin 2022 të jetë 2,131,344 lekë**.

Për vitin 2022 gjendja e debitorëve progresiv është në vlerën 42,557,390 lekë:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifrat e bizneseve, detyrime nga autorizimet e subjekteve hidrokarbure, detyrime nga kontratat e fondit pyjor kullusor (kontrata aktive dhe jo aktive) rezultojnë në vlerën totale **26,825,739 lekë për 187 biznese** (taksa-tarifa dhe qira);
- Qira të ambienteve të tregut (Markata) detyrime në vlerën **4,861,266 lekë**;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën **10,619,005 lekë**;
- Detyrime nga institucione publike në vlerën **154,480 lekë**;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore të pandarë në vlerën **96,900 lekë**

• **Masat e marra për uljen e borxhit**

Spektori i Tatim Taksave në Bashkinë Has është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit

nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifatat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor të sipër cituar. Përkatësisht, janë nxjerrë urdhrat që ju janë dërguar bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare të 52 tatimpaguesve debitorë për vitin 2021 dhe 2 bllokime për vitin 2022.

Si rezultat i këtyre masave të marra nga debitorët që rezultonin se gjatë vitit 2022 kanë likuiduar detyrimet ndaj bashkisë **33 subjekte në vlerën 2,514,241 lekë**.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2010 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.

- **Akt marrëveshjet për pagesën me këste të detyrimeve**

Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Bashkia Has ka lidhur marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura me disa subjekte debitorë që sqarohen më të detajuara në vijim.

*Tabela nr. 8: Akt marrëveshjet e lidhura në vitin 2022*

Nr.	Akt-marrëveshja	Subjekti	Detyrimi në marrëveshje	Shuma e paguar në lekë	Shuma e mbetur në lekë	Afati
0	Nr. 2621 prot, 15.12.2021	V. M.	0	0	0	Deri më 16.09.2021
1	Nr 1107 Prot, date 18.05.2022	V. M.	447,912	100,000	347,912	Deri më 18.12.2022
2	Nr. 28 prot, 17.08.2021	R. R Shpk	124,796	31,120	93,676	Deri më 18.12.2021
3	Nr. 2841 prot, 15.10.2021	E. M.	98,000	42,000	56,000	Deri më 15.12.2022
4	Nr. 2697 prot, 03.11.2021	H. U.	52,770	31,680	21,090	Deri më 03.11.2022
5	Nr. 2769 prot, 08.11.2021	Sh. D.	70,700	66,000	4,700	Deri më 08.10.2022
6	Nr. 2776 prot, 08.11.2021	F.D.	82,897	33,431	49,466	Deri më 08.10.2022
7	Nr. ... prot, 15.12.2021	K. D.	130,754	99,694	31,060	Deri më 15.12.2022
8	Nr. 3176 prot, 29.12.2021	G. D.	120,432	45,602	74,830	Deri më 29.04.2022
9	Nr. 2870 prot, 17.11.2021	Klinike Dentare L.	136,825	40,075	96,750	Deri më 17.12.2022
10	Nr. 1093 prot, 18.05.2021	M. AL 2018	38,090	7,610	30,480	Deri më 17.11.2022
<b>Totali</b>			<b>1,303,176</b>	<b>497,212</b>	<b>805,964</b>	

Nga auditimi i zbatimit të kushteve të akt marrëveshjeve rezulton se, nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes 10 subjekte me vlerë 805,964 lekë të cilat duhet të kishin shlyer këstet deri në dhjetor të vitit 2022 Nga Bashkia Has, Sektori i Tatim Taksave nuk janë marrë masa për zgjidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 78.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. U. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.*

**Titulli gjetjes 4:** *Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Has dhe masat e marra për uljen e tij.*

**Situata:** Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Has paraqitet:

**Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është 4,645,585 lekë nga të cilat:**

- Detyrimet nga taksat dhe tarifave për biznesin në shumën 2,589,724 lekë;
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 52,120 lekë;
- Detyrime nga qiratë e tregut (markata) në shumën 653,133 lekë;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,337,708 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore në vlerën 12,900 lekë

Në uljen e debitorëve kanë ndikuar pagesat e kryera për detyrimet debitorë të viteve para vitit 2021 në vlerën 2,514,241 lekë, dhe për vitin 2022 në vlerën 2,131,344 lekë.

**Gjendja e debitorëve progresiv në fund të vitit 2022 është në vlerën 42,557,390 lekë e përbërë nga:**

- Detyrimet nga taksat dhe tarifave e bizneseve, detyrime nga autorizimet e subjekteve hidrokarbure, detyrime nga kontratat e fondit pyjor kullësor (kontrata aktive dhe jo aktive) rezultojnë në vlerën totale **26,825,739 lekë për 187 biznese** (taksa-tarifa dhe qira);
- Qira të ambienteve të tregut (Markata) detyrime në vlerën 4,861,266 lekë;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 10,619,005 lekë;
- Detyrime nga institucione publike në vlerën 154,480 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore në vlerën 96,900 lekë.

**Kriteri:** Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.

**Impakti:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Has.

**Shkaku:** Strukturat e Bashkisë Has nuk kanë respektuar përcaktimet e VKB-së për paketën fiskale duke mos ngarkuar familjet për detyrimet vendore.

**Rëndësia:** E lartë

**Për këtë rekomandojmë:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive **42,557,390 lekë** e përbërë nga:

- 26,825,739 lekë për 187 subjekte private;
- 4,861,266 lekë për qiratë e ambienteve të tregut;
- 10,619,005 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet;
- 96,900 lekë nga kontratat e dhënies me qira të aseteve;
- 154,480 lekë nga institucione publike;

*a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).*

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e*

Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Has, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

- **Taksat dhe tarifat familjare**

Në Bashkinë Has aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës. Nga të dhënat që disponon Bashkia Has rezulton se kanë paguar detyrimet për këto dy taksa/tarifa 1499 familje me vlerë 1,176,650 lekë. Bashkia Has, Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifat e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit. Bashkia Has nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitorë nuk ka një regjistër. Si rezultat, **procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitorë dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë.**

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e VKB nr. 78, datë 22.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has”, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. U. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.*

### **Titulli gjetjes 5: Mos ngarkim i familjeve për detyrimet vendore.**

**Situata:** Në Bashkinë Has aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës. Nga të dhënat që disponon Bashkia Has rezulton se kanë paguar detyrimet për këto dy taksa/tarifa 1499 familje me vlerë 1,176,650 lekë. Bashkia Has, Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifat e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit. Bashkia Has nuk ka agjent tatimor për mbledhjen e taksave/tarifave nga familjet, por i mbledh ato me paraqitjen e qytetarëve pranë zyrave të bashkisë/njësive administrative për të marrë shërbime të ndryshme. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitorë nuk ka një regjistër. Si rezultat, **procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitorë dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë.**

**Kriteri:** VKB nr. 78, datë 22.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has”, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

**Impakti:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Has.

**Shkaku:** Strukturat e Bashkisë Has nuk kanë respektuar përcaktimet e VKB-së për paketën fiskale duke mos ngarkuar familjet për detyrimet vendore.

**Rëndësia:** E lartë

**Për këtë rekomandojmë:** Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për krijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

- **Taksa mbi tokën bujqësore**

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23<sup>5</sup>.

Sipas Aneksit 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Has klasifikohet në kategorinë e katërt ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën mëposhtme

Tabela nr.6: Vlera e taksës së tokës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	1,400
II	1,200
III	1,100
IV	1,000
V	900
VI	800
VII-X	700

Referuar VKB-së nr. 78 datë 22.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2022”, toka bujqësore në Bashkinë Has klasifikohet në kategorinë VII-X me detyrim 700 lekë/ha/vit.

Nga auditimi konstatohet se, në Bashkinë Has familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe taksa e tokës bujqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021” pika 4/b. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet kur qytetarët paraqiten në bashki në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifatat vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Sektori i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 700 lekë/ha/vit kur bashkia ka të dhëna.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. U. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave dhe z. A. P. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Bujqësor.

**Titulli gjetjes 6:** Mos ngarkesë e familjeve në Bashkinë Has për taksën e tokës bujqësore.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se **taksa mbi tokën bujqësore** është realizuar 35 mijë lekë nga 67 mijë lekë e planifikuar ose në masën 52%. Në Bashkinë Has familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe taksa e tokës bujqësore. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet kur qytetarët paraqiten në bashki në

<sup>5</sup>Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, ankesi 1.

mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifave vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Sektori i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 700 lekë/ha/vit për tokë të kategorisë së VII-X.

**Kriteri:** Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021” pika 4/b.

**Impakti:** Bashkia Has nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që zotërojnë tokë bujqësore dhe sa është sipërfaqja që duhet të tatohet referuar paketës fiskale duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.

**Shkaku:** Mos angazhim i strukturave të bashkisë për të krijuar regjistrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore.

**Rëndësia:** E lartë

#### **Për këtë rekomandojmë:**

Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve, që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjister më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

#### **• Taksa e ndikimit në infrastrukturë**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c “*për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi*” dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5 “*Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi*”.

Në Bashkinë Has struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës dhe Sektori i Tatimeve.

*Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se, në Bashkinë Has ka detyrime të pa paguara për objekte që janë legalizuar që nga viti 2017 deri në 31.12.2020 është në vlerën **9,282,639 lekë për 239 objekte**. Nga korrespondenca zyrtare e Bashkisë Has me ASHK në vitin **2022** rezulton se:*

- **Për vitin 2021** janë kryer 25 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përlllogaritur prej 1,338,065 lekë, ku janë debitorë 19 individë në vlerën 1,090,592 lekë.

- **Për vitin 2022** janë kryer 15 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përlllogaritur prej 545,206 lekë, ku janë debitorë 8 individë në vlerën 247,216 lekë.

Për vitin 2022 vlera debitorë që i përket 34 individëve për taksën e infrastrukturës është 1,337,708 lekë, ndërsa në vlerë progresive deri në 31.12.2022 është 10,620,347 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, me ligjin nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e

taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, neni 27, pika 3, shkronja “c”, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 dhe me VKB nr. 78 datë 22.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2022”. Në mënyrë të detajuar debitorët për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emër	Mbiemri	Shuma	Mbetet Debitor
1	M.	Ll.	39,316	39,316
2	A.	Sh.	20,047	20,047
3	A.	Sh.	40,967	40,967
4	Sh.	K.	67,986	67,986
7	Y.	P.	6,799	6,799
8	S.	M.	6,799	6,799
9	Z.	P.	121,550	121,550
10	Xh.	B.	139,150	139,150
11	L.	G.	101,776	101,776
12	V.	C.	45,674	45,674
14	A.	M.	44,308	44,309
16	Sh.	Ll.	58,945	58,945
17	H.	A.	52,040	52,040
18	H.	C.	8,463	8,463
20	S.	D.	82,053	82,053
22	B.	Sh.	34,199	34,199
23	V.	M.	53,430	53,430
24	S.	Sh.	49,306	49,306
25	J.	C.	117,683	117,683
	Shtesat për vitin 2021		1,338,065	1,090,492
	<b>Shtesat në vitin 2022</b>			
Nr.	Emër	Mbiemri	Shuma	Ngelet Debitor
2	A.	P.	30,346	30,346
3	Y.	M.	40,194	40,194
4	I.	K.	32,527	32,527
5	M.	M.	22,195	22,195
7	E.	R.	32,225	32,225
10	A.	B.	37,712	37,712
11	Gj	K.	19,830	19,830
12	F.	U.	32,187	32,187
			<b>545,206</b>	<b>247,216</b>
			1,337,708	

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi z. U. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave dhe z. N. B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Planifikim Territorit dhe Urbanistikës.*

**Titulli gjetjes 7:** *Mos arkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve).*

**Situata:** Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet *rezulton se*, në Bashkinë Has ka detyrime të pa paguara për objekte që janë legalizuar që nga viti 2017 deri në 31.12.2020 është në vlerën 9,282,639 lekë për 239 objekte. Nga korrespondenca zyrtare e Bashkisë Has me ASHK **në vitin 2022** rezulton se:

- **Për vitin 2021** janë kryer 25 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përllogaritur prej 1,338,065 lekë, ku janë debitorë 19 individë në vlerën 1,090,592 lekë.

- **Për vitin 2022** janë kryer 12 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përllogaritur prej 545,206 lekë, ku janë debitorë 8 individë në vlerën 247,216 lekë.

Pra gjatë vitit 2022 listës së debitorëve i janë shtuar 37 individë për taksën e infrastrukturës është 1,337,708 lekë, ndërsa në vlerë progresive deri në 31.12.2022 është 10,620,347 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has.

**Kriteri:** Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni



9, pika 4, neni 27, me ligjin nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”, me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 dhe me VKB nr. 78 datë 22.12.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2022”.

**Impakti:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Has, nga mos arkëtimi i vlerës prej 10,620,347lekë për ndërtimet e reja që legalizohen.

**Shkaku:** Mos marrje e masave efektive nga Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës dhe Sektori i Tatimeve të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.

**Rëndësia:** E lartë

**Për këtë rekomandojmë:** Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 276 debitorë në vlerën 10,620,347 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Has të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

➤ Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave të kontratave të aseteve.

Bashkia Has në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi<sup>6</sup> për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 26 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 1-30 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, për aktivitet bujqësor, për pentari, objekte banimi, Antena, vend depozitim minerali dhe ngritje fabrike përpunimi ,studim-kërkim-zbulim, agroturizëm etj.

Tabela nr. 7: Kontratat aktive dhe jo aktive për asetet e dhëna me qira

Nr.	Subjekti	Kontrata nr. datë	Sip ha	Afati në vite	Vlera Vjetore e Qirasë	Debitor 31.12.2021	Detyrimi në 2022	Paguar	Debitore 31.12.2022
1	K. G. (toka)	Nr.4, datë 05.01.2021	8	30	48,000	0	48,000	48,000	
2	K. N.(toka) K. C.shpk	Nr.794 dt 11.12.2020	1.1607	30	6,964			7,928	
3	S. Xh.(toka)	.....Datë 16.03.2021	2.15	30	12,900	0			12,900
4	S. N.(toka)	.....Datë 01.02.2021	1.5	30	9,000	0		9,000	
5	G. I.(toka)	Nr.257, dt 12.06.2013	4	10	28,000	84,000		0	84,000
6	G. Guror (pyjor)	Nr.611, dt 01.04.2021	0.125	1	55,000	55,000		55,000	
7	F. Shpk hidrocentral “P...”(pyjor)	Nr 03, datë 12.01.2015 Nr.03, datë 01.06.2016	0.63 0.63	9 9	465,000 91,350	2,241,900 nga KLSH			2,241,900
8	E. Chrom	Nr.1412, dt 03.08.2021	0.73 ha/500 m <sup>2</sup>	1	156,940	0		156,940	
9	B... Kosturr 2010	Nr.2408, dt 17.11.2020	1.2	1	105,534	0		105,534	

<sup>6</sup> Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

10	Fabrika e Kromit P.	Nr.1, datë 29.07.2019	10.160	10	827,515	2,160,000 në proces gjyqësor		827,515	
11	O. T.	Nr.4063/6 datë 19.12.2012	0.03	9	261.500	0		261,500	
12	A. T. Sh.a	Nr.1836, datë 01.09.2020	0.02	9	160,000	0		160,000	
13	V. Albania	Nr.3126, datë 19.06.2019	0.03	9	369,500	0			369,500
14	V. Mining (krom)	Nr.22, datë 01.07.2019	7.048	6	549,744	0		549,744	
15	V.Mining	Nr.23, datë 01.07.2019	0.05	6	100,000	0		100,000	
16	N. 2004 (krom)	Pa kontratë	0.5		39,000	0		39,000	
17	N.... 2004	Pa kontratë	0.5		100,000	0		100,000	
18	<b>A. L. 08 shpk kerkim=zbullim</b>	Nr. 1178 prot. datë 04.06.2020	1.4	Afat mbaruar	134,400	0			
19	<b>V. M. Alb</b>	Pa kontratë qiraje	0.672		52,416	52,416			52,416
20	Drejtoria Rajon.Sigurim Shoqërore Kukës	Në bazë të VKB-ve Datë 01.01.2021			360,000	0		360,000	
21	A. K (krom)	Dt 01.01.2021 /pa kontratë	0.33	5 vjet	25,740	128,700	revokuar		128,700
22	A. K	Dt. 01.01.2021/pa kontratë	0.038	1 vit	76,000	76,000	revokuar		76,000
23	P. (kërkim-shpim)	Nr.1553 dt 16.07.2020	0.92	1 vit	88,320	88,320		88,320	
25	F.K. agroturizem	Nr.1109 dt 18.05.2022	0.6303 ha	10	47,902			82,688	
26	E.G. E. SHPK kërkim për energji alternative	Nr 2161 dt.06.10.2022	0.17 ha	2	31,280			25,120	
	Totali					<b>5,434,436</b>			2,965,416

Referuar tabelës së kontratave të qirave me të dhënat të nxjerrë dokumentacioni i dosjeve nga rezulton se në fund të vitit 2022 paraqiten 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 2,965,416 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has**. Për dy rasate kontratash duhet theksuar se:

- Qiramarrësi **“F.” SHPK** ka lidhur me Bashkinë Has kontratën me nr. 03, datë 12.01.2015 për marrjen e sipërfaqes 0.63 ha për 9 vjet me vlerë vjetore të kontratës 465,000 lekë. Rezulton se kjo kontratë është amenduar me kontratën nr. 3, datë 01.06.2016 ku sipërfaqja e marrë me qira dhe afati nuk ndryshon por ka ndryshuar vlera e kontratës në 91,350 lekë. Rezulton se, amendimi i kontratës nuk është i shoqëruar me asnjë relacion, ku të shpjegohen arsyet e ndryshimit të vlerës së qirasë vjetore. Qiramarrësi ka paguar rregullisht detyrimin sipas amendimit të kontratës përkatësisht për 6 vite x 91,350 = 548,100 lekë, ndërkohë detyrimi që duhet të paguajë sipas kontratës bazë është 6 vite x 465,000 = 2,790,000 lekë. **Diferenca prej 2,241,900 lekë (2,790,000 - 465,000) përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has**. Kjo vlerë detyrimi nuk është e përfshirë në listën e debitorëve progresiv si dhe nuk është kontabilizuar.

- Në rastin e Qiramarrësit Shoqëria **“Fabrika e Pasurimit të Kromit P.”** me vlerë debitore 2,241,900 lekë, që i përket të ardhurave të munguara të përlllogaritura nga grupi i auditimit për periudhat nga viti 2011-2018 nga ushtrimi i aktivitetit të kësaj shoqërie në parcelë nga fondi pyjor-kullosor në mungesë kontrate qiramarrje, nga Bashkia Has është nisur njoftimi i detyrimit qiramarrësit, i cili ka ngritur padi në Gjykatën Administrative Shkodër, ku dhe ka fituar shkallën e parë të gjykimit. Nga Bashkia është apeluar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, e cila është në proces. Për këtë arsye kjo vlerë nuk përfshihet në vlerën progresive të debitorëve në fund të vitit 2022. Në vitin 2019 është lidhur kontratë 10 vjeçare me tarifë qiraje në vlerën 828,515 lekë për 10 ha, që shfrytëzohet nga Shoqëria “P.” shpk, kontratë për të cilën nuk ka detyrime debitore, pasi janë kryer në mënyrë të rregullt detyrimet.

Gjithashtu, për qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet e qirasë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk është llogaritur kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.

Referuar tabelës mësipërme konstatohen 3 subjekte (N. 2004, V. M. A., A. K), të cilat shfrytëzojnë asete të Bashkisë Has dhe nuk kanë një kontratë të nënshkruar me bashkinë.

Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Has ushtrojnë aktivitetin 21 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullësor, asete të Bashkisë Has. Nga bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitimit të mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere dhe shtrati lumi, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të mungura për Bashkinë Has. Rastet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet nxjerrje prodhim minerale dhe inertesh në mënyrë të detajuar paraqiten në Aneksin nr. 2/2 bashkëlidhur.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

**Titulli gjetjes 8:** *Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave të kontratave të aseteve.*

**Situata:** Bashkia Has në kuadër të administrimit të aseteve për krijimin e të ardhurave ka lidhur 26 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi apo në përdorim. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik për afate kohore nga 1-30 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullësore, për aktivitet bujqësor, për pemtari, objekte banimi, Antena, venddepozitim minerali dhe ngritje fabrike përpunimi ,studim-kërkim-zbulim, agroturizëm etj. Referuar tabelës së kontratave të qirave me të dhënat të nxjerrë dokumentacioni i dosjeve nga rezulton se në fund të vitit 2022 paraqiten 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në ***vlerën 2,965,416 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has.*** Gjithashtu, për qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet e qirasë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk është llogaritur kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.

Theksojmë se në rastin e qiramarrësit “***F.***” ***SHPK*** kontrata bazë 9 vjeçare e datës 12.01.2015 me tarifë qiraje 465,000 lekë është amenduar me kontratën e datës 01.06.2016, ku sipërfaqja e marrë me qira dhe afati nuk ndryshon, por ka ndryshuar vlera e kontratës në 91,350 lekë i pa shoqëruar me relacion për shpjegimin arsyeve të ndryshimit të vlerës së qirasë vjetore. Kjo ka sjellë diferencën në pagesë nga qiramarrësi prej 2,241,900 lekë (2,790,000 - 465,000), e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has.

Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Has ushtrojnë aktivitetin 21 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullësor, asete të Bashkisë Has. Nga bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitimit të mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere dhe shtrati lumi, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Has.

**Kriteri:** Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

**Impakti:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Has nga mos arkëtimi i detyrimeve nga qiramarrësit.

**Shkaku:** Strukturat e Bashkisë Has nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirave nga subjektet qiramarrëse si dhe nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore për dhënien me qira të aseteve të tyre

**Rëndësia:** E lartë

**Për këtë rekomandojmë:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 2,965,416 lekë** dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave. Gjithashtu nga strukturat drejtuese për 21 rastet e subjekteve subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare e inertesh, që ushtrojnë aktivitetin e licencuar në parcelat e fondit pyjor-kullor, asete të Bashkisë Has, të shqyrtohet dokumentacioni i tyre dhe të kryhen kontrolli dhe matja në terren i parcelave që shfrytëzohen dhe finalizimi i procesit me lidhjen e kontratave të qiradhënies për sigurimin e të ardhurave dhe rehabilitimin e sipërfaqeve nga shfrytëzimi nga ana e këtyre subjekteve të aseteve të bashkisë. Nëse ka pengesë në realizimin e këtij procesi të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse deri në pezullimin e veprimtarisë.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. S. L. me Detyrë Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve si dhe z. U. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.*

• **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve**

Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur rezultoi se, në territorin e Bashkisë Has për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 9 subjekte të paraqitura në tabelën në vijim.

*Tabela nr. 8: Subjektet që ushtrojnë aktivitet në shitjen e lëndëve djegëse me pakicë*

Nr	Operatori Ekonomik	Adresa	Autorizimi Bazë	Niveli tarifës sipas VKM nr. 344	Pagesa viti 2021-2022	Detyrime për t'u paguar për autorizimet 31.12.2022	shënime
1	“S.”shpk	Krumë	10.09.2020 -09.09.2025	1,000,000	600,000	400,000	
2	“D. H”shpk	Krumë	18.11.2019 -17.11.2022	1,000,000	600,000	400,000	
3	“V.P.”shpk	Krumë	01.11.2021 - 16.10.2026	1,000,000	400,000	600,000	
4	“E...”shpk	Krumë	19.11.2020 - 19.11.2025	1,000,000	100,000		Mbyllur 1.6.2021
5	“K. L.”shpk	Golaj	18.04.2018 - 17.04.2021 20.08.2021 - 17.04.2023	1,000,000	293,000	707,000	Mbyllur 2023
6	“Xh. P.”shpk	Vranisht	19.04.2019 - 18.04.2024	1,000,000	400,000	600,000	
7	“G.Sh.”shpk	Vranisht	16.03.2021-16.03.2026	1,000,000	400,000	600,000	
8	“H.”shpk	Golaj	14.01.2020 - 13.01.2025	1,000,000	200,000	200,000	Mbyllur 8.6.2022
9	“D. M.”shpk	Krumë	29.03.2021 - 28.03.2022	100,000	40,000	60,000	
						<b>3,567,000</b>	

*Burimi: Bashkia Has*

*Nga auditimi rezultoi se, Bashkia Has ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje*

me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Konstatohet se 6 subjekte kanë paguar rregullisht detyrimin vjetor për autorizimin/licencën. Subjekti “D. H” shpk, të cilëve u ka përfunduar autorizimi më datë 17.11.2022 dhe “D.M.” shpk në datën 28.03.2022 nuk janë pajisur me autorizim të ri nga Bashkia Has.

Nisur nga të dhënat e dosjeve të subjekteve konstatohet se në 3 raste subjektet kanë mbyllur aktivitetin, të cilët nuk kanë paguar detyrimin deri në fund të vitit 2022 për vlerën 1,007,000 lekë duke sjellë të ardhura të munguar për vitin 2022 në buxhetin e bashkisë Has. Rastet e debitorëve paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Operatori Ekonomik	Adresa	Autorizimi Bazë	Niveli tarifës sipas VKM nr. 344	Pagesa viti 2021-2022	Detyrime për t'u paguar për autorizimet 31.12.2022	shënime
4	“E.”shpk	Krumë	19.11.2020 - 19.11.2025	1,000,000	100,000	100,000	Mbyllur 1.6.2021
5	“K. L.”shpk	Golaj	18.04.2018 - 17.04.2021 20.08.2021 - 17.04.2023	1,000,000	293,000	707,000	Mbyllur 2023
8	“H.”shpk	Golaj	14.01.2020 - 13.01.2025	1,000,000	200,000	200,000	Mbyllur 8.6.2022
	<b>Shuma</b>					<b>1,007,000</b>	

Kjo procedurë e ndjekur në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht:

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme”, neni 15 “...Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji...”, neni 20-Autorizimet pika 2, “Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e parashikuara në pikat “ç” dhe “d” të nenit 11<sup>7</sup>, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje”;

- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3 “Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. U. H. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave.

**Titulli gjetjes 9:** Mbi pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse.

**Situata:** Nga auditimi rezulton se, Bashkia Has ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për

<sup>7</sup>Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 11-Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë”.

5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Konstatohet se 6 subjekte nga 9 subjekte që kanë ushtruar aktivitetet kanë paguar rregullisht detyrimin vjetor për autorizimin/licencën. Subjekti “D.H” shpk, të cilëve u ka përfunduar autorizimi më datë 17.11.2022 dhe “D.M.” shpk në datën 28.03.2022 nuk janë pajisur me autorizim të ri nga Bashkia Has. Nisur nga të dhënat e dosjeve të subjekteve konstatohet se në 3 raste subjektet kanë mbyllur aktivitetin (“E.” shpk në vlerën 100,000 lekë, “K.L.” shpk në vlerën 707,000 lekë dhe “H.”shpk në vlerën 200,000 lekë), të cilët nuk kanë paguar detyrimin deri në fund të vitit 2022 për vlerën 1,007,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për vitin 2022 në buxhetin e bashkisë Has.

**Kriteri:** Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, nenet 4,15 dhe 20/2” dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.

**Impakti:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Has.

**Shkaku:** Puna jo efektive e Sektorit të Tatim Taksave në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitetet pa autorizim.

**Rëndësia:** E lartë

**Për këtë rekomandojmë:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjekteve “D.H” shpk dhe “D.M.” shpk të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur prej 1000,000 lekë ndaj Bashkisë Has për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

### **2.3 Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin mbi pasqyrat financiare për vitin 2022.**

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:*

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Has” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Has për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr. 475 prot, datë 27.02.2023. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Has dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtori i Financës.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke

(dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.
- Në përgjithësi janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore etj.

**Konkluzion:** Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **pika 2.2** “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik”, ku ndër të tjera theksohet se: “...- *Libra kontabiliteti, ditarë kontabiliteti, si dhe pasqyra financiare, që janë mbartës ose përmbledhës të regjistrimeve të kryera në kontabilitet.- Dokumente të tjera kontabiliteti, ku përfshihet çdo mbartës tjetër i informacionit kontabël dhe që nuk klasifikohet në asnjë nga grupet e mësipërme*” Kreu III, **pika 3.2**

“Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njërive të qeverisjes së përgjithshme” në të cilën përcaktohet: *Mbyllja e llogarive vjetore nga ana e njërive të qeverisjes së përgjithshme është një proces i domosdoshëm, i cili duhet të bëhet përpara përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, duke ndjekur rradhën kronologjike si më poshtë vijon: Nën-pika 43. Fillimisht, njësitë e qeverisjes së përgjithshme (në varësi të mënyrës së mbajtjes së kontabilitetit) përgatisin dokumentin përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditaret përkatës kronologjik, gjatë periudhës ushtrimore vjetore. Nën-pika 44. Këto njësi, në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësojnë pozicionin e çeljes së llogarive nga viti i më parshëm dhe të realizojnë transaksionin e transferimit të tepicës së llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë ushtrimore” në llogarinë 12 “Rezultat i mbartur”. Nën-pika 45. Pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, hartuesi i pasqyrave financiare duhet të realizojë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, për periudhën ushtrimore që raportohet.*

**Titulli gjetjes 10:** *Mbi mbajtjen e librave kontabël për evidentimin e veprimeve kontabël nga ditaret në bilanc.*

**Situata:** Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës i mungon libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditaret në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.

**Kriteri:** Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik” Kreu III, pika 3.2, nën-pikat 43,44,45.

**Impakti:** Pasaktësi në nxjerrjen e gjendjeve dhe pozicionimi i llogarive të bilancit.

**Shkaku:** Nga drejtoria e Buxhetit dhe Financës nuk është kryer procedurë e plotë në mbajtjen e kontabilitetit dhe të gjithë librave kontabël që të evidentojnë në çdo fazë këtë procedurë.

**Rëndësia:** I lartë

**Për këtë rekomandojmë:** Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare duke ndjekur fazat në mënyrë llogjike, që nga mbajtja e dokumenteve përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditaret përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i më parshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, të bëjë në fund kryerjen e veprimeve të mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaku e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i



miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

**Totali i Aktivit** për vitin 2021 është në vlerën 2,256,531,531 lekë dhe për vitin 2022 është 2,180,466,935lekë, i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari në Aneksin nr. 3/1 bashkëlidhur.

#### **A. AKTIVE AFATSHKURTRA.**

**Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”** në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 22.984.332 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 15.496.301 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica ne fillim te vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “ Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte”.

- ***Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”*** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 22,984,332 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 15,496,301 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në me formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022” të pasqyrave financiare.

**Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues”** të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 22,188,858 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,186,719 lekë, ku diferenca e tyre në ulje në vlerën prej 3,002,139 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- ***Gjendja e llogarisë 31 “Materiale”*** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 623,299 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 180,478 lekë, me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 442,299 lekë, e cila përfaqëson pakësim të gjendjes së mallrave në magazinë gjatë vitit 2022. Kjo llogari është e analizuar për gjendjen datë 31.12.2022 në shumën 180,478 lekë, duke bërë sondazhe për 4 artikuj në inventarin fizik.

- ***Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”*** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 21,565,559 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 në vlerën 19,006,241 lekë me një diferencë në ulje për vitin ushtrimor prej 2,559,318 lekë, e cila përfaqëson ulje të inventarit të imët për vitin 2022 nga dalja jashtë përdorimi.

**Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme”** paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 91,523,537 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2022 në vlerën 98,086,445 lekë, ku kemi shtim duke e

krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes së debitorëve krahasuar me vitin paraardhës.

**Konkluzion:** Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2021 dhe në fund të vitit 2022. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunitat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

**Titulli gjetjes 11:** Mbi saktësinë e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” veprimet kontabël të kryera në këtë llogari dhe analiza e saj.

**Situata:** Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2021 dhe në fund të vitit 2022. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunitat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson.

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik”.

**Ndikimi** Mungesë e analizës e gjendjes së llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”.

**Shkaku:** Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës nuk është kryer e mjaftueshme për kryerjen e veprimeve rregulluese të kësaj llogarie.

**Rëndësia:** I lartë

**Për këtë rekomandojmë:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin financiar të ish-komunës Gjinaj, mbi bazë të së cilës të analizojë dhe të përcaktojë të drejtat e konstatuara për arkëtim, duke përcaktuar personat përgjegjës material me shumatat përkatëse që i kanë detyrim Bashkisë për kthim. Nëse është e pamundur Bashkia Has të ndjekë hapat ligjorë për njohjen ose jot ë këtij detyrimi dhe më pas të kryejë veprimet e sistemit në kontabilitet.

- **Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”,** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 67,319,252 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 69,067,839 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 1,748,587 lekë, e cila ka ardhur nga rritja e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore, debitorët nga mos pagesa e qerave për tokën bujqësore, qerave së tregut për zënie hapësire publike, taksa ndikimit në infrastrukturë si dhe nga vlera e taksa tarifa nga biznesi i vogël dhe ai i madh të pa arkëtuara. Analiza e gjendjes së llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” me date 31.12.2022**

Nr	Përshkrimi	Dokument	Gjendje 31.12.2021	Shtesa 2022	Pagesa 2022	Gjendje 31.12.2022
1	Debitorë nga KLSH	Klsh	23,463,868	0	222,000	23,241,868
2	Debitorë nga APP	APP	3,429,338	0	160,757	3,268,581
3	Debitorë subjektet e medha 31.12.2022		15,184,624	1667,819	2,003,280	14,849,163
4	Debitorë subjekte e vogla 31.12.2022		11,458,560	921,905	403,889	11,976,576
5	Debitorë institucione buxhetore taksa vendore		154,480	52,120	52,120	154,480
6	Debitorë Markata Qytetit Krume		4,263,085	653,133	54,952	4,861,266
7	Debitorë Qera Toke		84,000	12,900	0	96,900
8	Debitorë Ndikimi në Infrastrukture		9,281,297	1,337,708	0	10,619,005

	<b>Totali</b>		<b>67,319,252</b>	<b>4,645,585</b>	<b>2,896,998</b>	<b>69,067,839</b>
--	---------------	--	-------------------	------------------	------------------	-------------------

- **Llogaria 4342** “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit përfaqëson detyrimet afatshkurtra për vitin ushtrimor, që trashëgoohen në vitin pasardhës. Gjendja e kësaj llogarie në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 28,103,657 lekë, e cila rakordon për vlerën 28,103,657 lekë me shumën e gjendjeve të llogarive të detyrimeve afatshkurtra në pasiv të bilancit, e cila përbëhet nga shuma e : llog.401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” për vlerën 9,893,612 lekë, llog.42 “Detyrime ndaj personelit” për vlerën 13,167,587 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 815,168 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 3,715,507 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 511,783 lekë.

**Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :**

Gjendja e llogarisë **486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 19,089,193 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 11,333,144 lekë, gjendje e cila rakordon me situacionin e thesarit për detyrimet e prapambetura.

**II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE**

**Auditimi i aktiveve afatgjata materiale.**

*Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale*, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

**2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:**

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse;
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

**3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:**

**a.** Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivët e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivët e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivët e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

**b.** Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “**Aktivet Afatgjata**” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e llog 231 “Investime”). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,989,654,979lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,919,652,500lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,720,215,641 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,752,003,771 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

#### **Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo Materiale” që përbëhet nga:**

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën prej 2,629,022 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,791,490 lekë, diferenca është vlera e amortizimit. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 9,729,027 lekë me të njëjtën vlerë gjendet dhe në mbyllje të vitit 2022. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon.

#### **Inventari i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime"**

Nr.	Emërtimi	Gjendja 31.12.2021	Gjendja date 31.12.2022
1	Studim, projektim rruga Tobel - Metaliaj	478,800	478,800
2	Studim, projektim 'Planif. Territori	100,000	100,000
3	Ujsjellsi Golaj miniere , Gjeologji(projekttime)	86,432	86,432
4	Asfaltim rruga fshatit Nikoliq(projekttime)	396,000	396,000
5	Ujs. Zgjec dhe stac. i pompave Letaj(projekttime)	400,000	400,000
6	Rik. rruga Vlahen-N/Satcioni elektr.(projekttime)	397,500	397,500
7	Ndertim Sifoni, Kanali vad. rez. Qarr(projekttime)	297,000	297,000
8	Nd. KUZB, lagjia Hasanaj, Golaj(projekttime)	395,000	395,000
9	Studim Hidro-gjeologjik ujsjellsi uji i pishem Zgjec(projekttime)	59,095	59,095
10	Sistemim, ndricim, trotuari Golaj(projekttime)	478,200	478,200
11	Studime Rik. Shkolla 9-Vjecare Krume	400,000	400,000
12	Studime ujerat e larta Fshati Krume	400,000	400,000
13	Studime Projektim Rik. Shkolla 9-Vjecare Zahrishit	399,000	399,000
14	Studime Projektim Bashkia Has (E re)	470,400	470,400
15	Rrjeti kanalizimeve Ujera te Zeza, ne zonen Kodra e Madhe 3km2	504,000	504,000
16	Hartimi I projektit zbatimit - Ndertim rruge Pusi I Thate	97,200	97,200
17	Studim & Projektim Rik Ujesjellesi Cahan	120,000	120,000
18	Studim & Projekt Trotuar qende Golaj, Mur Mbajit Fshat Breg Krume, Sistem shtrati gurra e Domaj	300,000	300,000
19	studim projektim per ndertimin e shkollës 9 vjecare fshati letaj	330,000	330,000
20	studim projektim preventiv zbatim rikonstruksion thertore bagetive qyteti krume	117,000	117,000
21	Studim projektim reabiliti trotuari rruga pashtig	57,000	57,000
22	studim projektim kanalit ushqyes te kanalit Llakaj	990,000	990,000
23	studim projektim reabiliti trotuari rruga pazari vjeter	984,600	984,600
24	studim-projektim lulishte qyteti krume	94,800	94,800
25	studim-projektim pallati nr3 firzamonika lagje 1 ne qender qyteti krume	117,000	117,000
26	studim-projektim ndertim trotuarve qendra vranisht, kodra e madhe, qender letaj, rruge malore qender gjinaj, bjeshke stanet gjinaj	576,000	576,000
27	studim-projektim rruga pashtrik-rrafsh, sheta, geca, peçaku e sistemim I projektit te tershenes	684,000	684,000
		9,729,027	9,729,027

**Konkluzion:** Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në fund të vitit 2022 , rezulton në vlerë neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike **9,729,027 lekë i përket 27** projekt-studimeve për investime të pa kryera dhe të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-

studimeve. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik **“Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata”** (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: *“Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëposhtëm:*

a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicionit financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:

- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;
- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).

**Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si:** programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM”.

**Kreu II.** “Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” **Pika 16/b.d** të cilat përcaktojnë: “Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:

b) Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23); dhe
- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).

d) Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjata, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës “b” më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:

- Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjata; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23).

**Titulli gjetjes 12:** Mbi saktësinë e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, veprimet kontabël të kryera në këtë llogari dhe analiza e saj.

**Situata:** Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në fund të vitit 2022, rezulton në vlerë neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike 9,729,027 lekë i përket 27 projekt-studimeve për investime të pa kryera dhe të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “Aneksi 1. “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” pika 2, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” (Përbërja dhe trajtimi kontabël), Pika 3.3 “Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), nënpika 62. Nënpika “Aktivet afatgjata jomateriale” Kreu II, pika 16/b.d

**Ndikimi:** Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit.

**Shkaku:** Nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financës nuk është kryer e mjaftueshme për kryerjen e

veprimeve rregulluese të kësaj llogarie.

**Rëndësia:** *I lartë*

**Për këtë rekomandojmë:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës 1,791,490 lekë që i përket 27 projekt-studimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Më pas të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

*U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve Materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2022.*

**Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale”** paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 1,917,861,010 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,741,189,744 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 1,074,183po më të njëjtën vlerë gjendet dhe në mbyllje të vitit 2022 . Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021 paraqiten në vlerën prej 1,074,183 dhe në mbyllje të vitit 2022 në të njëjtën vlerë prej 1,074,183lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

**Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" me date 31.12.2022**

Nr.	Emërtimi i Aktivit	Gjendja date 31.12.2020	Shtesa viti 2022	Gjendja 31.12.2022
1	Shpronësim për interes Publik (Ndertim rrugë e trotuare Qyteti Krume)	1,074,183	0	1,074,183
	<b>TOTALI</b>	<b>1,074,183</b>	<b>0</b>	<b>1,074,183</b>

- **Gjendja e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 733,469,916 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 696,890,331 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 966,447,807 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në të njëjtën vlerën 966,447,807 lekë. Pra nuk kemi ndryshim. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqiten në Aneksin nr. 3/2 bashkëlidhur.

**Konkluzion:** Në **gjendjen e Llogarisë 212 “Ndërtesa Konstruksione”** sipas inventarit kontabël përfshihen të gjithë aktivet “Ndërtesa e konstruksione” të Bashkisë Has dhe njësie Administrative në varësi (Golaj, Fajza dhe Gjinaj).

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,193,479,852lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,152,291,128lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,575,810,232 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,596,154,541 lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 20,344,309 lekë, ku janë kryer investime në rrugë si dhe pagesa nga detyrimet e prapambetura etj. Amortizimi për vitin 2022 është llogaritur 443,863,413 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet e aktiveve në këtë llogari paraqiten në tabelën e paraqitur në Aneks.

**Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 23,275,649dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën 33,174,975 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 61,161,153 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 73,366,691

lekë për të cilat ka inventar fizik. Shtesa prej 13,420,776 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2022 ne krahasim me vitin 2021 përfaqëson blerjet e bëra për makineri dhe konteniere pastrimi, si dhe hyrje falas për shkollat etj. Pakësimi në vlerën prej 1,215,238 lekë përbëhet nga nxjerrjet jashtë përdorimit gjatë vitit 2022. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet e aktiveve në këtë llogari paraqiten në tabelën e paraqitur në Aneks.

- **Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti"** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 19,873,350 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,080,206 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 30,985,206 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 31,190,166 lekë, vlera e amortizimit te akumuluar 12,109,960 leke. Gjatë vitit 2022 janë shtuar 204,960 lekë pajisje për mjetet zjarrfikëse (pompa).Për këto aktive është kryer inventari fizik, dhe inventari kontabël rakordon me vlerën në kontabilitet. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2021 deri në fund të vitit 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2022**

Nr	Nr. llogarisë	EMERTIMI	Gjendja 31.12.2021	Shtesa për vitin 2022	Gjendja kontab. 31.12.2022
1	2151110	motocikleta 125ccBrendKIEWAY model target125,nr LBBJ89007KBA38539,TARGA AZ118	323,252	0	323,252
2	2151110	motocikleta 125ccBrendKIEËAY model target125,nr LBBJ89007KBA41943,TARGA AZ311	323,252	0	323,252
		<b>Shuma</b>	<b>646,504</b>	<b>0</b>	<b>646,504</b>
3	2151120	Makine administrate ML	2,394,000	0	2,394,000
4	2151120	Makine tip JEEP	1,488,000	0	1,488,000
5	2151120	Makine WOLSVAGEN	374,000	0	374,000
6	2151120	Veture Benz (HS 0801 A)	1,099,996	0	1,099,996
7	2151120	Eskavator me zinxhire,Volvo FC220D,seri-16121209,me kave germimi+patrimi 1800mm seri322196 (pompe graso,celes 17-13,24-27,30-32,kacavide)	16,347,130	0	16,347,130
		<b>Shuma</b>	<b>21,703,126</b>	<b>0</b>	<b>21,703,126</b>
8	2151140	Kamion	2,343,200	0	2,343,200
9	2151140	automjet (kamion)APV me vinc	4,999,200	0	4,999,200
		<b>Shuma</b>	<b>7,342,400</b>	<b>0</b>	<b>7,342,400</b>
10	2151160	automjet (mercedez)viti 1990,nafte,10964CC,Nr.Shasie 61506425488919	545,173	0	545,173
11	2151160	mjeti tip mercedes benz, zjarrefikese me nr shasie 61506425495204	748,003	0	748,003
		<b>Shuma</b>	<b>1,293,176</b>	<b>0</b>	<b>1,273,176</b>
12	2151140	Pompa portative 20L per sherbimin zjarrfikes	0	204,960	204,960
		<b>Shuma</b>	<b>0</b>	<b>204,960</b>	<b>204,960</b>
		<b>TOTALI 215</b>	<b>30,985,206</b>	<b>204,960</b>	<b>31,190,166</b>

- **Gjendja e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik"** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,684,095 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 5,181,275 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 53,358,920 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 53,287,243 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 247,135 lekë te pajisjeve dhe transferimet kapitale nga institucionet e tjera qendrore dhe pakësime në vlerën kontabël 3,044,843 lekë si dhe sistemim veprimi për vlerën 39,665 lekë. Ndërsa vlera e amortizimit e përlllogaritur është në shumën 48,105,968 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 24 "Aktive te qëndrueshme te trupëzuara të dëmtuara"** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 me vlerën 20,564,113 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,669,113 lekë. Kjo shumë përfaqëson vlerën e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara, makineri e ndërtesa.

Nr	Nr. llogarisë	EMERTIMI	Gjendja 31.12.2021	Shtesa/pakësime për vitin 2022	Gjendja kontab. 31.12.2022
1	2420100	Shkolla 9-Vjecare Cahan	96,830		96,830
2	2420100	Ndertesha Muzeu Krume	97,420		97,420

3	2420100	Shkolla 9-Vjecare Kosturr	353,519	353,519
4	2420100	Depo Oksigjeni	6,205	6,205
5	2420100	Hangar 1 NB	48,890	48,890
6	2420100	Hangar 2 NB	124,450	124,450
7	2420100	Hangar 3 NB	50,000	50,000
8	2420100	Ish Zyrrat e sektorit te ujrave	21,615	21,615
9	2420100	Magazine e NB	86,022	86,022
10	2420100	Oficina 2kt	266,496	266,496
11	2420100	Oficina Krume	820,820	820,820
12	2420100	Rrethimi i oficines NB	35,866	35,866
13	2420100	Shkolla Qafe Tobel	722,579	722,579
14	2420100	Shtepia e Kultures Fajza	304,379	304,379
15	2420100	Vend Roja NB	3,084	3,084
16	2420100	Shkolla Gjeologji	2,024,891	2,024,891
17	2420100	Shkolla Gjeologji e Vjeter	2,500,000	2,500,000
18	2420100	Shkolla Pla i pates	1,500,000	1,500,000
19	2420100	Shkolla Qarr	4,796,737	4,796,737
		<b>Shuma</b>	<b>13,859,803</b>	<b>13,859,803</b>
20	2420100	Stacion Pompimi Fajza	315,310	315,310
21	2440100	Stacion pompimi Tregtan Nr.3	120,000	120,000
22	2440100	Stacion Pompimi Kosturr	149,500	149,500
		<b>Shuma</b>	<b>584,810</b>	<b>584,810</b>
23	2450100	Makine Mitsubish	999,500	999,500
24	2450100	Kamion Tip Benz	4,225,000	4,225,000
		<b>Shuma</b>	<b>5,224,500</b>	<b>5,224,500</b>
			19,669,113	19,669,113

- **Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:**

EMERTIMI		Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica në fund		Teprica Neto	
b	c	Kosto Historike	Amortizim Akumulua	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim.Aku mul.	Teprica Neto	
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	
20	<b>I. AAGJ/JO MATERIALE</b>	<b>10,814,027</b>	<b>8,185,005</b>	<b>2629,022</b>	<b>0</b>	<b>837,532</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>10,814,027</b>	9,022,537	1,791,490	
202	Studime dhe kerkime	9,729,027	7,100,005	2629,022	0	837,532	0	0	9,729,027	7,937,537	1,791,490	
203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	1,085,000	1,085,000	0	0	0	0	0	1,085,000	1,085,000	0	
21-28	<b>II. AAGJ/ MATERIALE</b>	<b>2,709,401,614</b>	<b>722,375,657</b>	<b>1987025,957</b>	<b>31,301,688</b>	<b>106,047,712</b>	<b>5,513,558</b>	<b>5,094,635</b>	<b>2,741,189,744</b>	823,328,734	1,917,861,010	
210	Toka,troje,Terene	1,074,183	0	1074,183	0	0	0	0	1,074,183	0	1,074,183	
211	Pyje,Kullota Plantacione	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
212	Ndertime e Konstruksione	966,447,807	232,977,891	733469,916	0	36,579,585	0	0	966,447,807	269,557,476	696,890,331	
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,575,810,232	382,330,380	1193479,852	20,344,309	61,533,033	0	0	1,596,154,541	443,863,413	1,152,291,128	
214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	61,161,153	37,885,504	23275,649	13,420,776	3,468,465	1,215,238	1,162,253	73,366,691	40,191,716	33,174,975	
215	Mjete transporti	30,985,206	11,111,856	19873,350	204,960	998,104	0	0	31,190,166	12,109,960	19,080,206	
216	Rezerva shtetore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
218	Inventar ekonomik	53,358,920	47,674,825	5684,095	3,331,643	3,468,525	3,403,320	3,037,382	53,287,243	48,105,968	5,181,275	
24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	20,564,113	10,395,201	10168,912	0	0	895,000	895,000	19,669,113	9,500,201	10,168,912	
28	Caktime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
	<b>TOTALI (I+II)</b>	<b>2,720,215,641</b>	<b>730,560,662</b>	<b>1989654,979</b>	<b>37,301,688</b>	<b>106,885,244</b>	<b>5,513,558</b>	<b>5,094,635</b>	<b>2,752,003,771</b>	<b>823,351,271</b>	<b>1,919,652,500</b>	

### **Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Has**

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Bashkinë Klos dhe Njësitë Administrative në varësi.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2022 ka dalë urdhri nr. 838/1, datë 15.12.2022 “Për Inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve për vitin 2022”, në të cilën janë përcaktuar komisionet e inventarizimit për Aparatin dhe 3 Njësitë Administrative.

Në bazë të këtyre urdhrave është kryer procedura e inventarizimit në zyrrat e Bashkisë, magazinave dhe në NJA, në shkolla, kopshte, Bibliotekë, vendparkimin e mjeteve. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Gjithashtu në fletët e inventarizimit në rubrikën e rezultati i inventarizimit janë bërë shënimet përkatëse në rastet e mungesave dhe tepricave, të cilat kanë rezultuar nga lëvizjet e aktiveve nga njëri objekt në tjetrin. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2022. Është mbajtur relacion përmbledhës për rezultatin e inventarizimit dhe



vlerësimit të aktiveve. Nga komisioni i ngritur me urdhrin nr. 838/1, datë 15.12.2022 është bërë inventarizimi dhe vlerësimi i aktiveve, ku janë mbajtur procesverbale për propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, që kanë humbur funksionin e tyre, në të cilat janë dhënë dhe shpjegimet përkatëse.

Komisioni ka hartuar relacionin përmbledhës për mbledhjen e aktiveve jashtë përdorimi nga subjektet e inventarizimit dhe argumentimin e vlerësimit të tyre jashtë përdorimi.

Rezulton se janë nxjerrë jashtë përdorimi aktive në vlerën lekë, ku sipas klasifikimit të llogarive janë:

1. Llog. 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 1,215,238 lekë
2. Llog. 218 “Inventar ekonomik” në vlerën 3,403,320 lekë.
3. Llog. 245 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” në vlerën 895,000 lekë
4. Llog.327 “Inventar i imët” në vlerën 3,787,683 lekë.

Për asgjësimin e materialeve të nxjerra është ngritur komisioni me nr.717 datë 15/12/2022 “Për ngritjen e komisionit të nxjerrjes jashtë përdorimit/tjetërsimit të aktiveve të panevojshme për vitin 2022”, i cili ka bërë shpërbërjen e aktiveve pa vlerë përdorimi dhe i ka mbledhur pranë magazinës me fletë hyrjen nr.27, datë18/11/2022. Komisioni në fund ka hartuar relacionin datë 27/12/2022 mbi kryerjen e procesit të nxjerrjes së Aktiveve nga përdorimi në të cilin ka bërë klasifikimin: aktive për asgjësim përfundimtar dhe aktive për hekurishte për skrap: me peshë1,405 kg dhe aktive për dru zjarri 2.9m<sup>3</sup> (të cilat u bënë hyrje në magazinë me nr.27, datë 18/11/2022).

- **Gjendja e llogarisë 219 “Amortizimi i AQ Materiale dhe jo Materiale”** paraqitet në bilanc në vlerën 832,351,271 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018”Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36. Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje të periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Për aktivet e llogarive: 202 “Studim-Projektme”; 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe 218 “Inventar Ekonomik”, në të cilat përfshihen pajisjet kompjuterike llogaritja e amortizimit është aktiv për aktiv, dhe mund të verifikoheshin se si janë llogaritur amortizimi për pajisjet kompjuterike.

-**Gjendja e llog. 231“Shpenzime në proces për rritjen e AQT”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet me vlerën prej 116,711,826 lekë dhe në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 111,090,632 lekë, për të cilën u paraqit analiza e detajuar.

NR.LLO G	OBJEKTET NË PROCES	VLERA GJENDJE 31.12.2022 (NE LEKE)
2312113	Mbjellje peme oborri i shkolles Golaj	326,708
2312113	Mbjellje peme oborri i shkolles Nikoliq	89,234
2312118	Rikonstruksion pallati 4kt, rruga Dardania	24,499,084
<b>Shuma llog. 212</b>		<b>24,915,026</b>
2313400	Ndertim Ujesjellesi Rajonal per njesine administrative Golaj, Per fshatrat Dobrone, Qarr i Vogel, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has	90,000,000
2313400	Supervizim Ndertim Ujesjellesi Rajonal per njesine administrative Golaj, Per fshatrat Dobrone, Qarr I Vogel, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has	1,796,800
<b>Shuma llog.213</b>		<b>91,796,800</b>
<b>SHUMA TOTALE 212 + 213</b>		<b>116,711,826</b>

**Pasivet afatshkurtra.** Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,256,531,531 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,180,466,935 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet

ndaj të tretëve për fatura të pa likuiduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 7,821,909 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 9,893,612 lekë, vlerë e cila ka ardhur në rritje me një shtesë në shumën 2,071,703 lekë krahasuar me vitin 2021. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie në mënyrë të detajuar paraqitet në Aneksin nr. 3/4 bashkëlidhur.

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 13,167,587lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën kontabël 815,168lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 3,715,507lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës e analizuar si vijon:

- Sigurimet shoqërore 9.5%punëmarrësi vlera 1,454,226 lekë.
- Sigurimet shoqërore 15% punëdhënësi vlera 2,220,530 lekë.
- Sigurime suplementare 3&5% punëmarrësi vlera 40,751 lekë

- **Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore”** në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 511,783 lekë, e cila përbëhet nga:

- Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarrësi vlera 260,226 lekë
- Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 260,227lekë.

**Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin ( detyrime)”** paraqitet si në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 68,234,201 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 69,982,788 lekë, vlera të cilat rakordojnë me gjendjet e llogarisë kundërpanti 468 “Debitorë të ndryshëm” në aktiv të bilancit.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuarra për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 14,839,033 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 18,599,508 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Has në mënyrë analitike.

Nr.	Objekt i investimit	5 % ne ruajtje	Te hyra	Te dala	5 % ne ruajtje
		31.12.2021	2022	2022	31.12.2022
1	Infrast e Qytetit Krume Faza II	98,042	0	0	98,042
2	Rikon.9-Vjecare Zahrisht	56,702	0	0	56,702
3	Ndertim Shkolla Perollaj	26,450	0	0	26,450
4	Rehabilitim I rruges Fshatit Zahrisht	2,557	0	0	2,557
5	Ndertim trotuari Rruga Pashtriku dhe tjera tbrendeshme	97,542	0	0	97,542
6	Rik Ujesjellesi Fshatit Zahrisht (Shtesa)	22,282	0	0	22,282
7	Rehabilitim Rruga Lagje Peka dhe Pazari Vjeter	2,131,377	291,550	0	2,422,927
8	Pallati 4kt rruga Dardania	1,074,800	150,155	0	1,224,955
9	Ndertim Rruge Malore Qender Fshati Gjinaj - Stanet, Bjeshka Gjinaj & Rkonstruksion I Rruges Segmenti Gjinaj - Pus I Thate.	409,095	157,905	567,000	0
10	Ndertim Ujesjellesi Rajonal per njesine administrative Golaj, Per fshatrat Dobrunë, Qarr I Vogel, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has	4,000,001	500,000		4,500,001
	<b>Shuma</b>	<b>7,918,848</b>	<b>1,099,610</b>	<b>567,000</b>	<b>8,451,458</b>

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 19,089,193 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 11,333,144 lekë, e cila përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Analiza e detajuar për çdo faturë paraqitet në aneks, ndërsa analiza në mënyrë sintetike e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet në tabelën e mëposhtme:

### Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”

Nr	Emërtimi	SUBJEKTI	Nr/v/fat/kont.	Data	Gjendja 31.12.2022
4864100	Shpenzime për ekzekutime VGJ	A.I.			395,178.0
	<b>Detyrime Vendime Gjyqesore</b>				<b>395,178.0</b>
4864200	Blerje letër format,dosje,makna,kapse aktesh,kancelari	M.& D.	86090/2022	31.08.2022	516,000.0
4864200	Komision Poste	Posta Sha Has	131/2022	04.11.2022	367,942.0
	<b>Shuma</b>				<b>833,942.0</b>
4864400	Kolaudim punimesh rruga Zahrishtit	Xh & M.Shpk	32	21.11.2018	28,000.0
4864400	Rehabilitim I Rrugeve Lagje Peka dhe Pazari i Vjeter	Z.	08	03.06.2019	7,337,101.0
	<b>TOTALI DETYRIME PRAPAMBETURA ME GRANT</b>				<b>8,644,421.0</b>
4864400	Ndërtim ujesjellesi Krume Zahrisht vazhdim Shtesa	L..Shpk	75	24.09.2018	163,409.0
4864400	Ndërtim Ujesjellesi Rajonal per njesine administrative Golaj, Per fshatrat Dobrunë, Qarr i Vogel, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen, Bashkia Has	L. Shpk	24/2022	05.08.2022	1,475,314.0
	<b>Shuma</b>				<b>1,638,723.0</b>
4864900	Shperblim per femijet e lindur dhe rregjistruar brenda afatit ligjor	MB	2017	2017-2018	1,050,000.0
	<b>Shuma</b>				<b>1,050,000.0</b>
	<b>TOTALI DETYRIME PRAPAMBETURA KUSHTEZUARA (Qeverisja Qendrore)</b>				<b>2,688,723.0</b>
	<b>SHUMA</b>				<b>11,333,144.0</b>

**Analizë e llogarive** sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr. 2 “Pasqyra e performancës financiare”(Aneksi nr. B/9)të PF të vitit 2022 paraqitet në Aneksin nr. 3/5 bashkëlidhur.

**Analiza e llogarive të të ardhurave** për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 680,453,185 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Has paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike **70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 7,296,526 lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike **7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 30,000lekë e cila përfshin *Taksën mbi Biznesin e vogël*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë **7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 1,011,209lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë **7029 “Te tjera tatime mbi pasurinë”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 644,856 lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën dhe truallin*, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

d. Gjendja e llogarisë **7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 5,610,461lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin etj.

- Gjendja e llogarisë **71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 10,217,759lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë **7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 4,158,195 lekë, e cila përfshin qiratë nga kullotat dhe nga pyjet, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë **711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare”** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 6,059,564 lekë, e cila përfshin tarifatat e parkimit, kamat vonesa, tarifa transporti, licenca etj. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

**Konkluzion:** Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 28,103,657 lekë, vlerë kjo, e cila nuk rakordon me shumën

e gjendjeve të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 28,103,657 lekë dhe llogarisë 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në vlerën 11,333,144 lekë të bilancit, pasi kjo gjendje duhet të pasqyrore detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara kur vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2022 është 39,436,801 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” **Pika 3.3** “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nën-pika 8 “Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin” në të cilën përcaktohet se:

*Llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabël në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:*

*a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi: - Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, “Shpenzime sipas natyrës”; - Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).*

*b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: - Debitohet llogaria 4342, “Operacione me shtetin (të drejta)”; - Kreditohet llogaria 7206, “Financim i pritshëm nga buxheti”.*

*c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi: - Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4); - Kreditohet llogaria 520, “Disponibilitete në thesar”.*

**Titulli gjetjes 13:** *Mbi kontabilizimet në llogarinë e fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.*

**Situata:** Gjendja e llogarisë së fondeve **7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 28,103,657 lekë, vlerë kjo, e cila nuk rakordon me shumën e gjendjeve të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 28,103,657 lekë dhe llogarisë 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në vlerën 11,333,144 lekë të bilancit, pasi kjo gjendje duhet të pasqyrore detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara kur vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2022 është 39,436,801 lekë.

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” Aneksi 1, Pika 3.3, nën-pika 59.

**Impakti:** Mos evidentim dhe kontabilizim jo i saktë i detyrimeve ndaj shtetit

**Shkaku:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit ka bërë kontabilizim të gabuar të detyrimeve ndaj shtetit.

**Rëndësia:** *I lartë*

**Për këtë rekomandojmë:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të kryejë veprimet e sistemimet kontabël për vlerat e detyrimeve, që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”). Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

**Analiza e llogarive të shpenzimeve** në vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 661,887,686 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë **600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 173,719,054lekë dhe sipas akt-rakordimit me thesarin është në vlerën 173,719,054lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 26,057,330 lekë dhe sipasakt-rakordimit me thesarin është në vlerën 26,057,330 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë **602 ‘Blerje mallra e shërbime’** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën89,711,567lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 89,711,567lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **604 ‘Transferime korrente te brendshme’** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 3,309,909lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 3,309,909lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve **606 ‘Transferime për Buxhetet familjare e Individë’** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 366,087,687lekë, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

**Për vitin 2021** totali i te ardhurave është 605,386,958lekë dhe totali i shpenzimeve është 590,321,474 lekë. Diferenca e tyre 15,065,484lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

**Po kështu për vitin 2022** totali i të ardhurave në vlerë është 668,932,529 lekë dhe totali shpenzimeve është 661,887,686 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 7,044,843lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”.

Gjithashtu gjendja e llogarisë **63 ‘Ndryshimi i gjendjes së inventarit’** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën 3,002,139 lekë .

#### **Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”**

- Zëri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën116,711,826lekë në analizë tregon burimet e investimit. Investimet sipas projekteve me të dhënat e kontratave të tyre dhe likuidimet e tyre sipas periudhës 3-vjecare paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Burimi i financimit	Objekti i kontrates	Fond /Planifikim	Nr.date	Afati	Vlere kontrate me Tvsh	Subjekti i kontraktuar	2020	2021	2022	Mbetja
Tranf.pakushtezuar										
Tranf.pakushtezuar										
Tranf.pakushtezuar	Kolaudim punimesh Rruges Fshati Zahrisht	28,200	-	-	Nuk ka	Xh & M.	0	0	0	28,200
Tranf.pakushtezuar	Pallati	30,943,092	27.09.2019	12 muaj	27,583,959	P.	13,999,908	7,496,075	3,003,101	3,084,876
Transf. e kushtezuar	Ndërtim Ujesjellesi Rajonal per NJA Golaj, per fshatrat Dobrunë, Qarr i vogël, Golaj, Nikoliq dhe Vlahen	300,000,000	22.05.2020	Pa afat (dhe ne varesi te financimit)	298,847,798	L.Shpk	60,000,000	20,000,000	11,475,314	207,372,484
Transf. e kushtezuar	Supervizim “Ndërtim ujesjellesi Rajonal”	3,600,000	22.12.2020	36 muaj	3,600,000	T.Shpk	796,800	200,000	800,000	1,803,200
<b>SHUMA</b>										

- Zëri **“Shpenzime për Aktive Afatgjata Materiale”** formati 6 e plotësuar për shumën 116,711,826 lekë në analizë rakordon me pasqyrën “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata” kolona 3 formati 7/a.

Nga testi kontrollit për vitin2022 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet e arkëtimit kryhen me arkë, për të gjitha rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore, pagesat e konviktit, ujit të pijshëm, tarifave të biznesit, pagesa për lëndë drusore, tarifat për sistemin e vaditjes, tarifat familjare, taksë toke dhe ndërtese...etj, dhe sipas rasteve brenda ditës apo në fund të çdo jave derdhjet e arkës bëhen në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III pika

34 dhe 35 germës a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 "Për limitin e arkës".

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë.

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave Materiale, veprimet me magazinën.

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga nen/Kryetari dhe Kryetari.

- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për të gjithë ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, është mbajtur edhe një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- Janë hapur kartela e zyrave për inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. P. C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore, në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe të hartuesit të pasqyrave financiare.

**2.4 Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve**

- Programimi i nevojës, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, nevojat për prokurime në Bashkinë Has janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat duke marrë për bazë kërkesat e sektorëve përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për secilin vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e studimit të nevojave reale që ka njësi vendore për punë, mallra e shërbime, si dhe në përputhje të parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB.

- Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve buxhetore

**Për vitin 2021:** Bashkia Has referuar regjistrin të realizimit të procedurave të prokurimit ka zhvilluar gjithsej **32** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit **42,218,733** lekë pa TVSh, vlerë të kontratës **33,186,637** lekë pa TVSh, diferenca midis tyre prej 9,032,096 lekë pa TVSh, ose në masën 21% të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

- **Blerje me vlerë të vogël**, 26 procedura, me fond limit në total prej 24,968,733 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 19,461,832 lekë, duke kursyer shumë prej 5,506,901 lekë;
- **E hapur**, 6 procedura, me fondin limit në total prej 17,250,000 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 13,724,805 lekë, duke kursyer shumë prej 3,525,195 lekë.

Janë audituar të 6 procedurat e hapura ku ka rezultuar si më poshtë vijon.

**1. “Blerje Karburanti për Mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave të Bashkisë Has” viti 2021**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Karburanti për Mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave të Bashkisë Has”, viti 2021.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 01, datë 25.01.2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. E. D. (Kryetare) 2. E. S. (Anëtare) 3. O. M. (Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave</b> <b>Urdhër Nr. 50, datë 23.01.2021:</b> 1. F. Th. (Kryetar) 2. P. C. (Anëtar) 3. N. B. (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Kërkesë për Propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 5,041,667 lekë	<b>6. Oferta fituese</b> V. P. ShPK, me vlerë 5,041,667 lekë pa TVSh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 0 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 08.02.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Nga buxheti i Bashkisë	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. V. P. ShPK
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> 01.03.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b>	6,050,000 lekë

Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve z. B. M., Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve të Konviktit z. Y. Ll. dhe Përgjegjësi i Sektorit të MZSh z. J. L., ka paraqitur kërkesë Kryetarit të Bashkisë dhe për dijeni Njesisë së Prokurimit Sektorit Ekonomik me objekt “Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave, Bashkia Has”. Titullari i Bashkisë Has ka hartuar Urdhrin nr. 17, datë 14.01.2021, “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit”, me përbërje z. F. Th., z. B. M. dhe z. E. D.. Është miratuar kërkesa për prokurim nga Titullari i Bashkisë Has me datë 22.01.2021.

**Hartimi i fondit limit**

Proces Verbali për “Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave, Bashkia Has” është hartuar nga Komisioni i Vlerësimit të Fondit Limit me vlerë totale 5,041,667 lekë pa TVSh sipas fondeve në dispozicion të Bashkisë Has.

### **Hartimi i specifikime teknike dhe DT**

Përgjegjëse për hartimin dhe përgatitjen e kërkesave të veçanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike të procedurave të prokurimit publik për vitin 2021” është Njësia e Prokurimit për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave, Bashkia Has*”. Gjatë hartimit të kriterëve është dhënë edhe argumentimi lidhur me treguesit e cilësisë sipas zërave të preventivit.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 1, datë 15.01.2022 ku ka ngarkuar NJP me përbërje zj. E. D., zj. E. S. dhe z. O. M. për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave, Bashkia Has*” me vlerë të fondit limit 5,041,667 lekë pa TVSh. Më datë 25.01.2021 NJP ka mbajtur proces verbal nr. 01/1 protokollin ku ka përcaktuar që lloji i procedurës së prokurimit të jetë “*Kërkesë për propozim*” dhe si kriter vlerësues të ofertave “*çmimin më të ulët*” dhe hartimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e hapur me objekt “*Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave, Bashkia Has*”.

Shpallja e procedurës është bërë në Buletinin e APP-së nr. 14 datë 01.02.2022.

Nga auditimi konstatohet se, rezulton se kriteret e vendosura janë në përputhje me objektin e kontratës.

### **Vlerësimi i ofertave**

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 50, datë 23.01.2021 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z. P. C. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar).

KVO më datë 08.02.2021 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt “*Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave, Bashkia Has*”, me fond limit 5,041,667 lekë. Konstatohet se për këtë procedurë ka aplikuar 1 operatorë ekonomik, “V.P. ShPK”, me Nipt K7...K me vlerë ekonomike të ofertës 5,041,667 lekë.

KVO më datë 22.02.2021 ka hartuar raportin e vlerësimit për procedurën e prokurimit “e hapur” me objekt “*Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave, Bashkia Has*”. Pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e OE, KVO ka kualifikuar Operatorin Ekonomik pjesëmarrës për plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.

**Nga auditimi konstatohet se,** për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave, Bashkia Has*” nuk është hartuar një raport përmbledhës, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th., z. P. C. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.*

### **Titulli i Gjetjes 14: Mungesë e raporteve përmbledhëse të procedurës së prokurimit**

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “*Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave*”, për vitin 2021 nuk është hartuar një raport përmbledhës.

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

**Ndikimi:** Mungesa e raporteve përmbledhëse sjell mangësi në informimin e titullarit lidhur me procedurën e prokurimit të zhvilluar.

**Shkaku:** Mos hartim i raportit përmbledhës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.



Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave KVO-ja ka vendosur që OE që plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit si dhe kriterin e “*çmimit më të ulët*” është **“V.P.” ShPK me ofertën e paraqitur në vlerën 5,041,667 lekë pa TVSh.**

Formulari i njoftimit të fituesit është hartuar më datë 24.02.2021 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 29 datë 01.03.2021.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin nr. 136, datë 29.03.2021, që do të kryejë mbikëqyrjen e kontratës me përbërje z. F.Th., z. Y. Ll. dhe z. P.C.dhe Urdhër nr. 281, datë 22.06.2021 “Për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të kontratës nr. 406, dhe 462 datë 01.03.2021 dhe 03.09.2021” me përbërje z. L. S., z. Sh. Th. dhe z. E. S., “Për lidhje dhe zbatim kontrate” me OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave, Bashkia Has*”, me OE “V.P.ShPK” është lidhur kontrata me nr. 406 Prot., datë 01.03.2021 me vlerë 5,041,667 lekë pa TVSh dhe 6,050,000 lekë me TVSh me afat 01.03.2021-31.12.2021. Formulari i njoftimit të kontratës është publikuar në buletin e APP-së nr. 34, datë 08.03.2021.

**Nga auditimi konstatohet se,** OE “V.P.ShPK”; Nuk plotëson kriterin e veçantë pika 2.3.8 ku citohet “*Operatori/et Ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira 1 (një) autobus të posaçëm për transport të lëndëve të rrezikshme së bashku me aparatën matës. Autoboti do të shërbejë për transportin e karburantit në vendin ku ndodhen depozitat (kryesisht kaldaja të shkollave) dhe mjetet e tonazhit të rëndë të autoritetit kontraktor. Autoboti duhet të jetë i pajisur me Leje Qarkullimi (në rastet kur janë në pronësi) ose kontratën e vlefshme të qirasë + leje qarkullimi (në rastet e marrjes me qira) si dhe Certifikatën e Kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit dhe pasaportën e mjetit. Për arsye të vendndodhjes së depozitave (kryesisht kaldaja të shkollave) dhe mjeteve të tonazhit të rëndë të autoritetit kontraktor dhe vështirësisë në rastet e furnizimit autoboti duhet të ketë vëllim 1000 (njëmijë)-2000(dymijë) litra.*

OE në paraqitjen e dokumentacionit, nuk vërteton që mjetin ta ketë në pronësi ka dorëzuar Leje Qarkullimi, Certifikatën e Kontrollit Teknik, siguracionin e mjetit dhe pasaportën e mjetit të cilën nuk e ka në pronësi, gjithashtu nuk ka marrëveshje qiraje për përdorimin e këtij mjeti.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th., z. P. C. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.*

**Titulli i gjetjes 15:** *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave*

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese u konstatua se:

OE “V.P.” nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3.8, OE në paraqitjen e dokumentacionit, pasi mjetin nuk e ka në pronësi, gjithashtu nuk ka marrëveshje qiraje për përdorimin e këtij mjeti.

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, pika 1, neni 92, pika 3.

**Ndikimi:** Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

**Shkaku:** Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Bashkia Has, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

## Zbatimi i kontratës

Grupi i punës është ngritur me Urdhrin nr. 136, datë 29.03.2021 dhe Urdhrin nr. 281, datë 22.06.2021 “Për ndjekjen e zbatimit të detyrimeve të kontratës nr. 406, dhe 462 datë 01.03.2021 dhe 03.09.2021”. Është mbajtur Akt Konfirmimin marrjen në dorëzim me datë 29.03.2021, 22.06.2021 dhe 03.09.2021, për dorëzimin e mallit nga OE, ku shprehen se sasia, çmim dhe vlerë sipas specifikimeve të përcaktuara në DST e kërkuara nga AK.

Blerja e “Karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave, Bashkia Has”, është paguar me Urdhër Shpenzimin, faturën dhe fletë hyrjet paraqitur si më poshtë:

Urdhër-Shpenzimi			Fatura			Fletë-hyrje				
Nr.	Datë	Vlerë	Nr.	Datë	Vlerë	Nr.	Datë	Sasia	Çmimi	Vlera
123	12.04.2021	1,999,936	1/2021	29.03.2021	1,999,936.14	05	29.03.2021	12 302	162.571	1,999,936.14
208	28.06.2021	1,999,990	7/2021	22.06.2021	1,999,990.20	10	22.06.2021	11 926	167.7	1,999,990.20
379	12.11.2021	2,049,962	17/2021	03.09.2021	2,049,962.40	14	03.09.2021	12 379	165.60	2,049,962.40

Nga auditimi konstatohet se, dosja e procedurës së prokurimit “Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave, Bashkia Has”, për vitin 2021, nuk është inventarizuar, në kundërshtim me Urdhrin nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

Për sa më lart mban përgjegjësi: zj. E. D., zj. E. S. dhe z. O. M., në cilësinë e njësisë së prokurimit.

**Titulli i Gjetjes 16:** Mungesë inventarizimi i dosjes së procedurave të prokurimit.

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “Blerje karburanti për mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave”, për vitin 2021 dosja e kësaj procedure nuk është inventarizuar.

**Kriteri:** Urdhri nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

**Ndikimi:** Mungesa e inventarizimit të dosjeve të prokurimit sjell risk për ndërhyrje dhe modifikim në përmbajtjen e dosjes.

**Shkaku:** Mos hartim i inventarizimit të dosjes së procedurës së prokurimit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të ngrejë grup pune dhe të inventarizojë dosjen e prokurimit si dhe në të ardhmen të ketë parasysh pas përfundimit të procedurës së prokurimit të inventarizojë dosjen.

## 2. “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” viti 2021

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” Bashkia –Has për vitin 2021”.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.02, datë 02/02/2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. E. D. (Kryetare) 2. E. S. (Anëtare) 3. O. M. (Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> <b>Nr. 38, datë 28.01.2021</b> 1. F. Th. (Kryetar) 2. P. C. (Anëtar) 3. N. B. (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Kërkesë për propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 1,761,345 lekë	<b>6. Oferta fituese</b> “B.H.”, Personit Fizik me vlerë 1,691,690 lekë pa TVSh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 69,655 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 08.02.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Nga buxheti i Bashkisë	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. “B. H.”, Personit Fizik

<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> 05.03.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b>	2,030,028 lekë

Autoriteti Kontraktor Bashkia Has ka vendosur që blerja me objekt: “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” Bashkia - Has për vitin 2021” bazuar në Ligjin nr. 6643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 914 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, neni 33, pika 1.

Lidhur me nevojat që ka Bashkia Has për prokurimin artikujve ushqimor për nevojat e konviktit “Kosova” pranë Njesisë së Prokurimit është paraqitur kërkesa pa datë nga Zv. Drejtor, Përgjegjës për Shërbimin e Konviktit. Është hartuar Urdhri nr. 34, datë 26.01.2021 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit të fondit limit” me përbërje z. F. Th., zj. E. D. dhe z. Y. Ll. Është miratuar kërkesa për prokurim nga Titullari i Bashkisë Has me datë 26.01.2021.

Mbështetur në kërkesën e sipër cituar Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) ka nxjerrë Urdhrin nr. 02 datë 02.02.2021, “Për zhvillimin e procedurës procedurën e prokurimit Kërkesë për Propozim “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” Bashkia –Has për vitin 2021”.

Referuar Urdhrit nr. 33, datë 25.01.2021 ngarkohet NJP me përbërje: zj. E. D., zj. E. S. dhe z. O. M. të zhvillojnë procedurën për blerjen e artikujve ushqimor për nevoja të konviktit “Kosova” me vlerë të Fondit Limit (FL) 1,761,345 lekë.

Lloji i procedurës “Kërkesë për propozim” është përcaktuar nga NJP me proces verbalin pa numër të mbajtur më datë 25.01.2021.

Njësia e Prokurimit me anë të proces verbalit të mbajtur më datë 25.01.2021 ka përcaktuar si kriter për vlerësimin e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” Bashkia –Has për vitin 2021” çmimin më të ulët.

### **Hartimi i kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike**

Struktura përgjegjëse për hartimin e kërkesave të veçanta dhe specifikimeve teknike është Njësia e Prokurimit. Kriteret e veçanta që Operatorët Ekonomik (OE) duhet të plotësojnë për kualifikim janë hartuar nga Njësia e Prokurimit, sipas Proces Verbalit me datë 25.01.2021 dhe shtojcës nr. 2. Sipas këtij dokumenti OE duhet të vërtetojë preventivin (njësinë, sasinë) për artikujt si më poshtë:

Nr.	Emërtim	Njësi matëse	Sasi
1	Çaj Mali	Kg	10
2	Dardhë	Kg	65
3	Djathë i Bardhë Vendi	Kg	160
4	Domate	Kg	150
5	Fasule Vendi	Kg	460
6	Gjalpë	Kg	105
7	Hudhra të thata	Kg	20
8	Kripë	Kg	40
9	Lakër Vendi	Kg	540
10	Makarona cilësi I	Kg	420
11	Mandarina	kg	80
12	Miell	Kg	19
13	Mish Viçi Vendi	Kg	240
14	Mish Pule (Fileto)	kg	100
15	Mollë	Kg	120
16	Oriz (Gold, La Perla)	Kg	300
17	Patate Vendi	Kg	400
18	Piper i Zi	Pako	15
19	Portokall	Kg	90
20	Qepë të thata	Kg	250
21	Qofte	Kg	100

22	Qumësht i freskët	Lit	1,300
23	Reçel	Kg	140
24	Salcë Gjelle	Copë/400g	26
25	Sallam Viçi	Kg	290
26	Sallatë Jeshile	Kg	10
27	Sheqer	Kg	160
28	Speca	Kg	160
29	Suxhuk	Kg	250
30	Tranguj	Kg	80
31	Vaj Gjelle Floriol	Kg	250
32	Vaj Ulliri	Lit	65
33	Veze Pularia Has	Kokërr	2,960

**Nga auditimi rezulton se,** Njësia e Prokurimit ka kërkuar sipas preventivit më lart artikuj ushqimorë, si orizi, njësia matëse e salcës për formatin e ambalazhimit, vaji dhe vezët duke përmendur markë prodhimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin Publik”, neni 36, pika 4.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: Zj. E. D., E. S. dhe O. M., në cilësinë e Njesisë së Prokurimit.*

**Titulli i gjetjes 17:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në përcaktimin e markave të artikujve.

**Situata:** Nga auditimi rezulton se Njësia e Prokurimit gjatë hartimit të preventivit me artikuj ushqimorë, si orizi, njësia matëse e salcës për formatin e ambalazhimit, vaji dhe vezët ka përmendur markën e prodhimit.

**Kriteri:** Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin Publik”, neni 36, pika 4.

**Ndikimi:** Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

**Shkaku:** Njësia e Prokurimit nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit për prokurimin publik lidhur me përcaktimin e markës.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandim:** Bashkia Has, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë lidhur me përmendjen e markës së prodhimit në përcaktimin e artikujve në preventiv në kundërshtim me kërkesat e ligjit të prokurimit publik.

### **Llogaritja e fondit limit**

Argumentimi i fondi limit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” Bashkia –Has për vitin 2021” është referuar çmimit të tregut, çmimet e publikuara në buletin e Ministrisë së Punëve të Brendshëm, më datë 26.01.2021, komisioni i përbërë nga Z. F. Th., Zj. E. D. dhe Z. Y. Ll., si mëposhtë:

Nr.	Emërtim	Njësi matëse	Sasi	Çmimi	Vlera
1	Çaj Mali	Kg	10	800	8,000
2	Dardhë	Kg	65	200	13,000
3	Djathë i Bardhë Vendi	Kg	160	550	88,000
4	Domate	Kg	150	200	30,000
5	Fasule Vendi	Kg	460	350	161,000
6	Gjalpë	Kg	105	700	73,500
7	Hudhra të thata	Kg	20	137	2,740
8	Kripë	Kg	40	60	2,400
9	Lakër Vendi	Kg	540	80	43,200
10	Makarona cilësi I	Kg	420	200	84,000
11	Mandarina	kg	80	200	16,000
12	Miell	Kg	19	210	3,990
13	Mish Viçi Vendi	Kg	240	900	216,000
14	Mish Pule (Fileto)	kg	100	500	50,000
15	Mollë	Kg	120	120	14,400
16	Oriz (Gold, La Perla)	Kg	300	200	60,000
17	Patate Vendi	Kg	400	80	32,000
18	Piper i Zi	Pako	15	45	675
19	Portokall	Kg	90	160	14,400

20	Qepë të thata	Kg	250	120	30,000
21	Qofte	Kg	100	600	60,000
22	Qumësht i freskët	Lit	1,300	95	123,500
23	Reçel	Kg	140	300	42,000
24	Salcë Gjelle	Copë/400g	26	110	2,860
25	Sallam Viçi	Kg	290	600	174,000
26	Sallatë Jeshile	Kg	10	242	2,420
27	Sheqer	Kg	160	144	23,040
28	Speca	Kg	160	210	33,600
29	Suxhuk	Kg	250	800	200,000
30	Tranguj	Kg	80	220	17,600
31	Vaj Gjelle Floriol	Kg	250	230	57,500
32	Vaj Ulliri	Lit	65	480	31,200
33	Vezë Pularia Has	Kokërr	2,960	17	50,320
	<b>Vlera pa TVSh</b>				<b>1,761,345</b>
	<b>TVSh 20%</b>				<b>352,269</b>
	<b>Vlera me TVSh</b>				<b>2,113,614</b>

### Hartimi i dokumenteve të tenderit

Për hartimin e dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” Bashkia –Has për vitin 2021” NJP ka mbajtur proces verbalin pa numër më datë 25.01.2021.

### Zhvillimi i procedurës së prokurimit / Vlerësimi i ofertave

Për vlerësimin e ofertave me Urdhrin e titullarit të AK nr. 38, datë 28.01.2021 është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave (KVO) me përbërje: z. F. Th. (Kryetar), z. P. C. dhe z. N. B..

Më datë 15.02.2021 KVO ka hartuar proces verbalin e hapjes së ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” Bashkia –Has për vitin 2021” me FL 1,761,345 lekë. Për këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertë “B. H.” me Nipt L...P. Më datë 16.02.2021 KVO ka hartuar proces verbalin e vlerësimit të procedurës së prokurimit “kërkesë për ofertë” me objekt “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” Bashkia –Has për vitin 2021” me FL 1,761,345 lekë. Është kualifikuar nga KVO operatori ekonomik “B.H.” **me vlerë oferte 1,691,690 lekë pa TVSh.**

### Nga auditimi konstatohet se, OE “B.H.”:

1. Nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.2.4 ku citohet “Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronësisë, Certificate e Kontrollit Teknik, Policën e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve, foto të mjetit si dhe lejen e transportit nga bashkia apo komuna” dhe;
2. 2.2.5 “Për mjetet e marra me qira, formularit dhe dokumenteve të mësipërm t'i bashkëlidhen kontrata përkatëse të qirasë, ku të jetë specifikuar detyrimisht edhe emri i objektit për të cilën është bërë kontrata e qiramarrjes/ si dhe duhet që afati i marrjes me qira, të përfshijë afatin e realizimit të kësaj kontrate në rast të shpalljes fitues” nga dokumentet e paraqitura nga OE mungon leja e qarkullimit dhe foto e mjetit për pikën 2.2.4 dhe kontrata e qirasë me nr. 50 rep., 33 kol. me datë 31.01.2020 për mjetin është për një afat nga data 31.01.2020-31.01.2021, pra nuk përfshin afatin e realizimit të kësaj kontrate që është deri në 31.12.2021;
3. Nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.3.6, ku citohet “Lejen higjeno-sanitare të mjetit të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë në rrethet përkatëse (Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit).(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)”, është sjellë një dokument i cili nuk

vërteton kërkesën për leje higjeno-sanitare, por vetëm kontrollin nga Qendra e Kontrollit Kukës me datë 20.10.2020;

4. Nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.3 “Kapaciteti Teknik”, shkronja a, ku citohet “Kontrata për furnizime të ngjashme të shoqëruara; ”Vërtetimin nga institucioni përkatës për kontratën e realizuar të lëshuara nga një ent publik dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasishtë e mallrave të furnizuara”, nga dokumentet e paraqitura nga OE mungon vërtetimi nga institucioni përkatës për kontratën e realizuar për vitin 2019;
5. Nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.3.2, pika 2 ku citohet “Lejen higjeno-sanitare të objektit të vlefshme të lëshuar nga organet kompetente të Ministrisë së Shëndetësisë në rrethet përkatëse (Inspektorati që mbulon fushën e shëndetit)”, janë sjellë nga OE proces verbale Inspektimi për periudhën 2019-2020.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th. z. P. C. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.*

**Titulli i gjetjes 18:** *Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave.*

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese u konstatua se:

OE “B.H.” nuk plotëson kriteret e vendosura në pikën 2.2.4, 2.2.5, 2.3.6, 2.3 dhe 3.3.2 pika 2, OE nuk ka plotësuar nga dokumentet e paraqitura nga OE mungon leja e qarkullimit dhe foto e mjetit për pikën 2.2.4 dhe kontrata e qirasë me nr. 50 rep., 33 kol. me datë 31.01.2020 për mjetin është për një afat nga data 31.01.2020-31.01.2021 (pra nuk përfshin afatin e realizimit të kësaj kontrate që është deri në 31.12.2021), nuk vërteton kërkesën për leje higjeno-sanitare, por vetëm kontrollin nga Qendra e Kontrollit Kukës me datë 20.10.2020, mungon vërtetimi nga institucioni përkatës për kontratën e realizuar për vitin 2019 si dhe nuk ka paraqitur leje higjeno-sanitare.

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, pika 1, neni 92, pika 3.

**Ndikimi:** Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

**Shkaku:** Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Bashkia Has, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

**Nga auditimi konstatohet se,** për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” Bashkia –Has për vitin 2021” nuk është hartuar një raport përmbledhës, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th., z. P. C. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.*

**Titulli i Gjetjes 19:** *Mungesë e raporteve përmbledhëse të procedurës së prokurimit*

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA”, për vitin 2021 nuk është hartuar një raport përmbledhës.

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

**Ndikimi:** Mungesa e raporteve përmbledhëse sjell mangësi në informimin e titullarit lidhur me procedurën e prokurimit të zhvilluar.

**Shkaku:** Mos hartim i raportit përmbledhës

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Formulari i njoftimit të fituesit është hartuar më datë 26.02.2021 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 34 datë 08.03.2021.

Në përfundim të procedurave për ofrimin blerje ushqime konvikti Kosova - Bashkia Has është lidhur kontratë sipërmarrje me OE “B. H.” me nr. 436 Prot., datë 05.03.2021.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë Urdhrin nr. 104, datë 08.03.2021 “Për ngritjen e komisionit të pranimit/konfirmimit të mallrave/shërbimeve për blerjet sipas rasteve gjatë vitit 2021” me Operatorin Ekonomik të shpallur fitues në procedurën e prokurimit. Me OE “B. H.” është lidhur kontrata me vlerë 1,761,345 lekë pa TVSh dhe 2,030,028 lekë me TVSh. Formulari i njoftimit të ofertës të kontratës është bërë më afat kohor për dorëzimin e ofertave brenda ditës dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 17, datë 08.02.2021.

### **Zbatimi i kontratës**

Grupi i punës është ngritur me Urdhrin nr. 104, datë 08.03.2021 “Për ngritjen e komisionit të pranimit/konfirmimit të mallrave/shërbimeve për blerjet sipas rasteve gjatë vitit 2021”, me përbërje z. Y. Ll.dhe zj. B.N.

Është mbajtur Proces-Verbali me datë 30.07.2021 dhe 25.11.2021 për dorëzimin e mallit nga OE, ku shprehen se sasia dhe cilësia e mallit është sipas specifikimeve të përcaktuara në DST e kërkuara nga AK marrë nga z. Y.Ll., Zv.Drejtor, Përgjegjës për Shërbimin e Konviktit dhe zj. B.N., Magazinieri Konviktit Kosova.

Blerja e “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” Bashkia –Has për vitin 2021”, është paguar me Urdhër Shpenzimin, faturën, fletë hyrjen paraqitur si mëposhtë:

Urdhër-Shpenzimi			Fatura			Fletë-hyrje		
Nr.	Datë	Vlerë	Nr.	Datë	Vlerë	Nr.	Datë	Vlera
255	04.08.2021	345,725	5/2021	30.07.2021	345,725	2/1	30.07.2021	345,725
390	25.11.2021	810,350	14/2021	25.11.2021	810,350	4	25.11.2021	810,350

**Nga auditimi konstatohet se,** dosja e procedurës së prokurimit “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA”, për vitin 2021, nuk është inventarizuar, në kundërshtim me Urdhrin nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: zj. E. D., zj. E. S. dhe z. O. M., në cilësinë e njësisë së prokurimit.*

**Titulli i Gjetjes 20:** Mungesë inventarizimi i dosjes së procedurave të prokurimit.

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA”, për vitin 2021 dosja e kësaj procedure nuk është inventarizuar.

**Kriteri:** Urdhri nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

**Ndikimi:** Mungesa e inventarizimit të dosjeve të prokurimit sjell risk për ndërhyrje dhe modifikim në përmbajtjen e dosjes.

**Shkaku:** Mos hartim i inventarizimit të dosjes së procedurës së prokurimit

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të ngrejë grup pune dhe të inventarizojë dosjen e prokurimit si dhe në të ardhmen të ketë parasysh pas përfundimit të procedurës së prokurimit të inventarizojë dosjen.

### 3. “Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujë-mbledhësve” viti 2021

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujë-mbledhësve” për Vitin 2021”.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.16, datë 20/04/2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. E.D. (Kryetare) 2. F. M. (Anëtar) 3. A. M. (Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër Nr. 171, datë 21.04.2021</b> 1. F. Th. (Kryetar) 2. P. C. (Anëtar) 3. N. B. (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Kërkesë për propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 4,467,291 lekë	<b>6. Oferta fituese</b> “Z...” ShPK me vlerë 3,838,200 lekë pa TVSh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 629,091 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 17.05.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Nga buxheti i Bashkisë	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. “Z.” ShPK 2. “L.” ShPK 3. “D.-G” ShPK
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> 03.06.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b>	4,605,840 lekë

#### Hartimi i dokumenteve të tenderit

Përgjegjësi i Sektorit të Bordit Kullimit dhe Ujitjes z. F. M., ka paraqitur kërkesë Kryetarit të Bashkisë dhe për dijeni Njesisë së Prokurimit Sektorit Ekonomik me objekt “Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujë-mbledhësve”, Bashkia Has. Titullari i Bashkisë Has ka hartuar Urdhrin nr. 162, datë 15.04.2021, “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit”, me përbërje z. F. Th., z. F. M. dhe z. N. B.. Është miratuar kërkesa për prokurim nga Titullari i Bashkisë Has me datë 16.04.2021.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka ngritur Njësinë e Prokurimit me Urdhrin nr. 16, datë 20.04.2021, e përbërë nga: zj. E. D., z. F. M. dhe z. A. M.. Për procedurën e prokurimit “Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujë-mbledhësve”, me vlerë të fondit limit 4,467,291 lekë pa TVSh.

Në sistemin elektronik janë ftuar që të marrin pjesë tre OE: “Z.” ShPK, “L.” ShPK, “D.-G” ShPK.

Është mbajtur Proces verbali pa numër me datë 17.04.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, nga Njësia e Prokurimit, me grafik të punimeve të llogaritur në 25 ditë pune.

#### Hartimi i fondit limit

Proces Verbali për “Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujë-mbledhësve”, është hartuar nga Komisioni i Vlerësimit të Fondit Limit me vlerë totale 4,465,291 lekë pa TVSh referuar çmimeve të Manualeve Teknike sipas VKM-së 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, të kontratave të viteve 2017-2020.

#### Vlerësimi i Ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

Komisioni i Vlerësimit të ofertave është ngritur me urdhër nr. 171, datë 21.04.2021, me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z. P. C. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar). KVO ka mbajtur proces verbalin e hapjes së ofertave më datë 17.05.2021, ku konstatohet se për procedurën “Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujë-mbledhësve” kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomikë:



1. OE "Z." ShPK me ofertë ekonomike 3,838,200 lekë pa TVSh;
2. OE "D." ShPK me ofertë ekonomike 4,257,960 lekë pa TVSh;
3. OE "L." ShPK me ofertë ekonomike 4,198,480 lekë pa TVSh.

Është mbajtur proces verbal përfundimtar për lidhje kontrate me datë 20.05.2021, ku KVO shprehet se nuk ka operatorë të skualifikuar, rrjedhimisht kualifikimi bëhet sipas ofertës ekonomike më të vogël.

Nga auditimit rezulton se 2 OE të cilët janë skualifikuar nuk kanë plotësuar kriteret si mëposhtë:

1. "D." ShPK, nuk plotëson kriterin 2.2 pasi nuk ka sjellë vërtetim për pagesë të taksave vendore për vitin 2019, kriterin 2.4 pika i dhe iii, nuk plotëson numrin e punonjësve për Nëntor 2020, Janar dhe Shkurt 2021 dhe nuk ka sjellë vërtetim që ka të punësuar një Inxhinier Hidraulik ose Ndërtimi.;
2. "L." ShPK, nuk plotëson kriterin 2.2 pasi nuk ka sjellë vërtetim për pagesë të taksave vendore për vitin 2019, kriterin 2.3, pasi nuk ka vërtetuar që ka kryer punë të ngjashme për vitin 2019 dhe 2020.

Këto më lart KVO nuk i ka identifikuar gjatë vlerësimit të ofertave.

**Nga auditimi konstatohet se, OE "Z.":**

1. Nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.2.2 ku citohet "*Kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve 2019, 2020, të paraqitura pranë administratës tatimore dhe të konfirmuara me nënshkrim dhe vulosura nga ky institucion (ç' do fletë)*", nga OE janë paraqitur bilancet për të dy vitet, por bilanci i vitit 2020 është i pa konfirmuara me nënshkrim dhe i pavulosur nga administrata tatimore;
2. Nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.6 ku citohet "*Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojitet për ekzekutimin e kontratës*".

	LLOJI I MAKINERIVE	PRONËSIA	SASIA Minimumi
1	Fadromë me Goma	në pronësi ose me qira	1 copë
2	Kamionçine mbi 1.5 Ton	në pronësi ose me qira	2 copë
3	Kamiona 8-10 ton	në pronësi ose me qira	1 copë
4	Karroca dore	në pronësi ose me qira	20 copë
5	Auto-vinc për vendosjen e tubave	në pronësi ose me qira	1 copë
6	Saldariçe për saldimin e tubave	në pronësi ose me qira	1 copë

Nga OE nuk është paraqitur dokumentacion vërtetues për makinerinë "Fadromë me goma" në kundërshtim me kriterin e lartpërmendur.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th., z. P. C. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.*

**Titulli i gjetjes 21:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese u konstatua se:

OE "Z" nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.2.2 dhe 2.6, nga OE janë paraqitur bilancet për të dy vitet, por bilanci i vitit 2020 është i pa konfirmuara me nënshkrim dhe i pavulosur nga administrata tatimore si dhe nuk është paraqitur dokumentacion vërtetues për makinerinë "Fadromë me goma".

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 80, pika 1, neni 92, pika 3.

**Ndikimi:** Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

**Shkaku:** Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Bashkia Has, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

**Nga auditimi konstatohet se,** për procedurën e prokurimit me objekt “*Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujë-mbledhësve*” nuk është hartuar një raport përmbledhës, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th., z. P. C. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.*

**Titulli i Gjetjes 22:** *Mungesë e raporteve përmbledhëse të procedurës së prokurimit*

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “*Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujë-mbledhësve*”, për vitin 2021 nuk është hartuar një raport përmbledhës.

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

**Ndikimi:** Mungesa e raporteve përmbledhëse sjell mangësi në informimin e titullarit lidhur me procedurën e prokurimit të zhvilluar.

**Shkaku:** Mos hartim i raportit përmbledhës

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Formulari i njoftimit të fituesit është hartuar më datë 25.05.2021 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 83 datë 31.05.2021.

Nuk ka patur ankesa nga OE pjesëmarrës.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë urdhrin nr. 288, datë 28.06.2021 “Për caktimin e komisionit marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve” me përbërje z. F. M., z. E. M. dhe z. A. M., me OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit me objekt “*Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujë-mbledhësve, Bashkia Has*”. Me OE “Z.” ShPK është lidhur kontrata me nr. 959 Prot., datë 28.05.2021 me vlerë 3,838,200 lekë pa TVSh dhe 4,605,840 lekë me TVSh. Formulari i njoftimit të kontratës është hartuar në datën 07.05.2021 është publikuar në buletin e APP-së nr. 70, datë 10.05.2021.

### **Lidhja e kontratës**

Me OE fitues është lidhur kontrata nr. 959 Prot, datë 28.05.2021. Vlera e kontratës është 4,605,840 lekë me TVSh. Është paguar me Urdhër shpenzimit nr. 237, datë 03.08.2021, dhe 260, datë 10.08.2021, me situacionin pa datë, me faturë me nr. 804/2021, datë 26.07.2021.

**Nga auditimi konstatohet se,** dosja e procedurës së prokurimit “*Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujë-mbledhësve*”, për vitin 2021, nuk është inventarizuar, në kundërshtim me Urdhrin nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: zj. E. D., z. F. M. dhe z. A. M., në cilësinë e njësisë së prokurimit.*

**Titulli i Gjetjes 23:** *Mungesë inventarizimi i dosjes së procedurave të prokurimit*

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “*Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujë-mbledhësve*”, për vitin 2021 dosja e kësaj procedure nuk është inventarizuar.

**Kriteri:** Urdhri nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

**Ndikimi:** Mungesa e inventarizimit të dosjeve të prokurimit sjell risk për ndërhyrje dhe modifikim në përmbajtjen e dosjes.

**Shkaku:** Mos hartim i inventarizimit të dosjes së procedurës së prokurimit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të ngrejë grup pune dhe të inventarizojë dosjen e prokurimit si dhe në të ardhmen të ketë parasysh pas përfundimit të procedurës së prokurimit të inventarizojë dosjen.

#### 4. “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime” viti 2021

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime Bashkia Has”, 2021		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 26, datë 18.06.2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. E.D. (Kryetare) 2. F. M. (Anëtar) 3. A. M. (Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> <b>Nr. 277, datë 18.06.2021</b> 1. F. Th. (Kryetar) 2. P. C. (Anëtar) 3. N. B. (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Kërkesë për propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 5,740,833 lekë	<b>6. Oferta fituese</b> BOE “D.” ShPK dhe “Xh...” ShPK me vlerë 4,647,550 lekë pa TVSh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 1,093,283 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 09.07.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Nga buxheti i Bashkisë	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. BOE “D.” dhe “Xh.” ShPK 2. “P.” ShPK 3. “M.” ShPK 4. “Z.K.” ShPK
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> 09.08.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b>	5,577,060 lekë

#### Hartimi i dokumenteve të tenderit

Përgjegjësi i Sektorit të Rrugëve Rurale z. A. M., ka paraqitur kërkesë Kryetarit të Bashkisë dhe për dijeni Njesisë së Prokurimit Sektorit Ekonomik me objekt “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime”, Bashkia Has. Titullari i Bashkisë Has ka hartuar Urdhrin nr. 261, datë 10.06.2021, “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit”, me përbërje z. F. Th., z. A. M. dhe zj. E. D.. Është miratuar kërkesa për prokurim nga Titullari i Bashkisë Has me datë 12.06.2021.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka ngritur Njësinë e Prokurimit me Urdhrin nr. 265, datë 14.06.2021, e përbërë nga: zj. E. D., z. F. M. dhe z. A. M.. Për procedurën e prokurimit “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime”, me vlerë të fondit limit 5,740,833 lekë pa TVSh.

Në sistemin elektronik janë ftuar që të marrin pjesë katër OE: BOE “D.” dhe “Xh.” ShPK, OE “Z. K.” ShPK, OE “M.” ShPK dhe OE “P.” ShPK.

Është mbajtur Proces verbali pa numër me datë 17.06.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”, nga Njësia e Prokurimit, me grafik të punimeve të llogaritur në 30 ditë pune.

#### Hartimi i fondit limit

Proces Verbali për “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime”, është hartuar nga Komisioni i Vlerësimit të Fondit Limit me vlerë totale 5,740,833 lekë pa

TVSh referuar çmimeve të Manualeve Teknike sipas VKM-së 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, të kontratave të viteve 2018-2020.

### **Vlerësimi i Ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**

Komisioni i Vlerësimit të ofertave është ngritur me urdhër nr. 277, datë 18.06.2021, me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z. P. C. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar). KVO ka mbajtur proces verbalin e hapjes së ofertave më datë 09.07.2021, ku konstatohet se për procedurën “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime” kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomikë:

4. BOE “D.” dhe “Xh.” ShPK me ofertë ekonomike 4,647,550 lekë pa TVSh;
5. OE “Z.K.” ShPK me ofertë ekonomike 5,405,500 lekë pa TVSh;
6. OE “M.” ShPK me ofertë ekonomike 5,225,300 lekë pa TVSh;
7. OE “P.” ShPK me ofertë ekonomike 5,105,485 lekë pa TVSh

Është mbajtur proces verbal përfundimtar për lidhje kontrate me datë 17.07.2021, ku KVO shprehet se nuk ka operatorë të skualifikuar, rrjedhimisht kualifikimi bëhet sipas ofertës ekonomike më të vogël.

Nga auditimit rezulton se 3 OE të cilët janë skualifikuar nuk kanë plotësuar kriteret si mëposhtë:

1. “Z. K.” ShPK, nuk plotëson kriterin 2.3.4 pasi nuk ka sjellë vërtetim të certifikatave ISO të përkthyer dhe të noterizuar;
2. “M.” ShPK, nuk plotëson kriterin 2.3.1 germa b pasi nuk ka sjellë vërtetim për leje ndërtimore për objektet e përfunduara nga punë të ngjashme të mëparshme dhe nuk plotëson kriterin 2.3.5, pasi nuk ka sjellë dokumentacionin e kërkuar për mjetet ekskavator me goma dhe fadromë (leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, siguracion mjeti, certifikatë transporti mjeti për transport mallrash brenda vendit), gjithashtu në foto nuk mund të identifikohet targa e këtyre dy mjeteve;
3. “P.” ShPK, nuk plotëson kriterin 2.3.1 germa b pasi nuk ka sjellë vërtetim për leje ndërtimore për objektet e përfunduara nga punë të ngjashme të mëparshme, nuk plotëson kriterin 2.3.3, pasi nuk ka sjellë CV për manovratorin, nuk plotëson kriterin 2.3.5, pasi nuk ka sjellë dokumentacionin e kërkuar për mjetet ekskavator me goma dhe fadromë (leje qarkullimi, certifikatë e kontrollit teknik, siguracion mjeti, certifikatë transporti mjeti për transport mallrash brenda vendit) dhe nuk plotëson kriterin 2.3.5 pika b, vërtetim për vendndodhje mjeteve.

Këto më lart KVO nuk i ka identifikuar gjatë vlerësimit të ofertave.

### **Nga auditimi konstatohet se, BOE “D.” dhe “Xh.” ShPK:**

1. Nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.2 pika 3 ku citohet “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2020, edhe detyrimet vendore për vitin 2021”, nga BOE janë paraqitur paraqitur vërtetimet përkatëse, por OE “Xh.” shpk nuk i ka paguar detyrimet e vitit 2021 dhe për këtë ka lidhur marrëveshje për pagesën e këtyre detyrimeve me vlerë 8,933,153 lekë;
2. Nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.3.3 ku citohet “Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se në listëpagesat e periudhës Dhjetor 2020- Maj 2021 të rezultojnë të punësuar personel teknik, të kualifikuar nga subjektet e licencuara për certifikimin e tyre si dhe të jenë të pajisur me kartela sigurie në punë të vlefshme i domosdoshëm për kryerjen e punimeve si më poshtë vijon:
  - Të paktën 1(një) Manovrator
  - Ofertuesi duhet shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:  
-Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)

-Diplomë

-CV”, por OE “Xh.” nuk ka sjellë CV për manovratorin;

3. Nuk plotëson kriterin 2.3.5 ku citohet “Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit (i vlefshëm); f) certifikatën për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme), g) licence e shoqërisë për transport, i) foto ku të evidentohen dhe targat.”

	LLOJI I MAKINERIVE	PRONËSIA	SASIA Minimumi
1	Eskavator me goma ose me zinxhirë	në pronësi ose me qira	1 copë
2	Fadromë 0.25 m <sup>3</sup>	në pronësi ose me qira	1 copë
3	Kamionin vetëshkarkuse me kapacitet mbajtës 1.5 -2 ton	në pronësi ose me qira	1 copë
4	Kamiona mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	1 copë

Nga BOE nuk është paraqitur dokumentacion vërtetues për makinerinë “Eskavator me goma ose me zinxhirë dhe Fadromë 0.25 m<sup>3</sup>” por vetëm faturë zhdoganimi dhe foto ku nuk identifikohet targa e mjeteve në kundërshtim me kriterin e lartpërmendur.

4. Nuk plotëson kriterin 2.3.5 pika b ku citohet “Makinëritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qira me qëllim verifikimi, në rast se ofertuesi është bashkim operatoreve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument)”, në asnjë deklaratë nuk është shënuar vendndodhja e mjeteve të kërkuara si më lart.

Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th., z. P. C. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.

**Titulli i gjetjes 24:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese u konstatua se:

BOE “D.” dhe “Xh.” ShPK nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.2 pika 3, 2.3.3, 2.3.5 dhe 2.3.5 germa b, nga BOE janë paraqitur paraqitur vërtetimet përkatëse, por OE “Xh.” shpk nuk i ka paguar detyrimet e vitit 2021 dhe për këtë ka lidhur marrëveshje për pagesën e këtyre detyrimeve me vlerë 8,933,153 lekë, OE “Xh.” nuk ka sjellë CV për manovratorin, nuk është paraqitur dokumentacion vërtetues për makinerinë “Eskavator me goma ose me zinxhirë dhe Fadromë 0.25 m<sup>3</sup>” por vetëm faturë zhdoganimi dhe foto ku nuk identifikohet targa e mjeteve si dhe në asnjë deklaratë nuk është shënuar vendndodhja e mjeteve të kërkuara.

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, pika 1, neni 92, pika 3.

**Ndikimi:** Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

**Shkaku:** Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Bashkia Has, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

**Nga auditimi konstatohet se,** për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime Bashkia Has” nuk është hartuar një raport

përmbledhës, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th., z. P. C. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.*

**Titulli i Gjetjes 25:** *Mungesë e raporteve përmbledhëse të procedurës së prokurimit.*

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime Bashkia Has”, për vitin 2021 nuk është hartuar një raport përmbledhës.

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

**Ndikimi:** Mungesa e raporteve përmbledhëse sjell mangësi në informimin e titullarit lidhur me procedurën e prokurimit të zhvilluar.

**Shkaku:** Mos hartim i raportit përmbledhës

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Formulari i njoftimit të fituesit është hartuar më datë 23.07.2021 dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 117 datë 02.08.2021.

Nuk ka patur ankesa nga OE pjesëmarrës.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë urdhrin nr. 471, datë 09.09.2021 “Për caktimin e komisionit marrjes në dorëzim përfundimtar të punimeve” me përbërje z. F. Th., z. A. M. dhe z. F. M. me OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit me objekt “*Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime, Bashkia Has*”. Me BOE “D.” dhe “Xh.” SHPK është lidhur kontrata nr. 1447, datë 09.08.2021 me vlerë 4,647,550 lekë pa TVSh dhe 5,577,060 lekë me TVSh. Formulari i njoftimit të kontratës është publikuar në buletin e APP-së nr. 122, datë 16.08.2021.

### **Lidhja e kontratës**

Me OE fitues është lidhur kontrata me nr. 1447, datë 09.08.2021. Vlera e kontratës është 5,577,060 lekë me TVSh. Është paguar me Urdhër shpenzimit nr. 267, datë 23.08.2021, dhe 297, datë 28.09.2021, me situacionin pa datë, me faturë me nr. 4/2021, datë 20.08.2021 dhe nr. 11/2021, datë 27.09.2021.

**Nga auditimi konstatohet se,** dosja e procedurës së prokurimit “*Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime*”, për vitin 2021, nuk është inventarizuar, në kundërshtim me Urdhrin nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: zj. E. D., z. F. M. dhe z. A. M., në cilësinë e njësisë së prokurimit.*

**Titulli i Gjetjes 26:** *Mungesë inventarizimi i dosjes së procedurave të prokurimit*

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime”, për vitin 2021 dosja e kësaj procedure nuk është inventarizuar.

**Kriteri:** Urdhri nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

**Ndikimi:** Mungesa e inventarizimit të dosjeve të prokurimit sjell risk për ndërhyrje dhe modifikim në përmbajtjen e dosjes.

**Shkaku:** Mos hartim i inventarizimit të dosjes së procedurës së prokurimit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të ngrejë grup pune dhe të inventarizojë dosjen e prokurimit si dhe në të ardhmen të ketë parasysh pas përfundimit të procedurës së prokurimit të inventarizojë dosjen.

## 5. “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore” viti 2021

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore” Bashkia Has viti 2021		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 33, datë 02.07.2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. E.D. (Kryetare) 2. E. S. (Anëtare) 3. A. M. (Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> <b>Nr. 303, datë 01.07.2021</b> 1. F. Th. (Kryetar) 2. P. C. (Anëtar) 3. N. B. (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Kërkesë për propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 2,527,900 lekë	<b>6. Oferta fituese</b> “D.H” ShPK me vlerë 2,302,065 lekë pa TVSh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 225,835 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 23.08.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Nga buxheti i Bashkisë	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1.“D.H” SHPK 2.“D.” SHPK
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> 13.09.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b>	2,762,478 lekë

### Hartimi i dokumenteve të tenderit

Zv. Kryetari z. F. Th. dhe Përgjegjësi i Sektorit shërbimeve të Konviktit z. Y. Ll., ka paraqitur kërkesë Kryetarit të Bashkisë dhe për dijëni Njesisë së Prokurimit Sektorit Ekonomik me objekt “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore”, Bashkia Has. Titullari i Bashkisë Has ka hartuar Urdhrin nr. 290, datë 29.06.2021, “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit”, me përbërje z. F. Th., z. N. B. dhe zj. E. D.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka ngritur Njësine e Prokurimit me Urdhrin nr. 298, datë 01.07.2021, e përbërë nga: zj. E. D., zj. E. S. dhe z. A. M.. Për procedurën e prokurimit “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore”, me vlerë të fondit limit 2,527,900 lekë pa TVSh, dhe Urdhrin e Prokurimit nr. 33, datë 02.07.2021.

Në sistemin elektronik janë ftuar që të marrin pjesë dy OE: OE “D.” dhe “D.H” ShPK.

Është mbajtur Proces verbali pa numër me datë 22.07.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”, nga Njësia e Prokurimit, me grafik të punimeve të llogaritur në 20 ditë pune.

### Hartimi i fondit limit

Proces Verbali për “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore”, është hartuar nga Komisioni i Vlerësimit të Fondit Limit me vlerë totale 2,527,900 lekë pa TVSh referuar çmimeve të Manualeve Teknike sipas VKM-së 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, të kontratave të viteve 2018-2020.

### Vlerësimi i Ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave

Komisioni i Vlerësimit të ofertave është ngritur me urdhër nr. 303, datë 01.07.2021, me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z. P. C. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar). KVO ka mbajtur proces verbalin e hapjes së ofertave më datë 23.08.2021, ku konstatohet se për procedurën “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore” kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë:

1. OE “D.H” ShPK me ofertë ekonomike 2,302,065 lekë pa TVSh;
2. OE “D.” ShPK me ofertë ekonomike 2,493,966 lekë pa TVSh.

Është mbajtur proces verbal përfundimtar për lidhje kontrate me datë 28.08.2021, ku KVO shprehet se nuk ka operatorë të skualifikuar, rrjedhimisht kualifikimi bëhet sipas ofertës ekonomike më të vogël.

**Nga auditimit rezulton se OE i skualifikuar ka plotësuar të gjithë kriteret e kërkuara por KVO nuk i ka identifikuar gjatë vlerësimit të ofertave.**

**Nga auditimi konstatohet se,** OE “D.Has” ShPK:

1. Nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.2 pika 2 ku citohet “Kopje të bilanceve të viteve ushtrimore 2019 dhe 2020 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse”, nga OE janë bilancet por jo të konfirmuara nga autoritete përkatëse;
2. Nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.3.1 germa a ku citohet “Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike ofertuesi duhet të paraqesë, Formularin e vlerësimit, shoqëruar me; Kontratë, Situacionin përfundimtar, Certifikatën e marrjes në dorëzim dhe Faturat tatimore”, por OE nuk ka bashkëlidhur certifikatën e marrjes në dorëzim për kontratën e vitit 2019 për punë të ngjashme me vlerë 785,500 lekë;
3. Nuk plotëson kriterin 2.3.2 ku citohet “Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit (i vlefshëm); f) certifikatën për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme), g) licence e shoqërisë për transport, i) foto ku të evidentohen dhe targat.”

	LLOJI I MAKINERIVE	PRONËSIA	SASIA
1	Kamionçin vetëshkarkuse me kapacitet mbajtës 1.5 -2 ton	në pronësi ose me qira	1 copë
2	Kamiona mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	1 copë

Nga OE janë paraqitur 4 mjete për të cilat asnjëra nuk ka foto sipas kërkesës çka bën të pidentifikueshëm mjetin;

4. Nuk plotëson kriterin 2.3.2 pika a ku citohet “Makinertë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qira me qëllim verifikimi, në rast se ofertuesi është bashkim operatorëve, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të paraqesë këtë dokument)”, në asnjë deklaratë nuk është shënuar vendndodhja e mjeteve të kërkuara si më lart.

Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th., z. P. C. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.

**Titulli i gjetjes 27:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese u konstatua se:

OE “D.Has” nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.2 pika 2, 2.3.1 germa c, 2.3.2 dhe 2.3.2 germa a, nga OE janë bilancet por jo të konfirmuara nga autoritete përkatëse, nuk është bashkëlidhur certifikatën e marrjes në dorëzim për kontratën e vitit 2019 për punë të ngjashme me vlerë 785,500 lekë, janë paraqitur 4 mjete për të cilat asnjëra nuk ka foto sipas kërkesës çka bën të pidentifikueshëm mjetin si dhe në asnjë deklaratë nuk është shënuar vendndodhja e mjeteve të kërkuara.

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, pika 1, neni 92, pika 3.

**Ndikimi:** Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.



**Shkaku:** Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Bashkia Has, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

**Nga auditimi konstatohet se,** për procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore Bashkia Has” nuk është hartuar një raport përmbledhës, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th., z. P. C. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.*

**Titulli i Gjetjes 28:** Mungesë e raporteve përmbledhëse të procedurës së prokurimit.

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore Bashkia Has”, për vitin 2021 nuk është hartuar një raport përmbledhës.

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

**Ndikimi:** Mungesa e raporteve përmbledhëse sjell mangësi në informimin e titullarit lidhur me procedurën e prokurimit të zhvilluar.

**Shkaku:** Mos hartim i raportit përmbledhës

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë urdhrin nr. 520, datë 04.10.2021 “Për caktimin e komisionit marrje në dorëzim përfundimtar të punimeve” me OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit me objekt “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore, Bashkia Has” me përbërje z. F. Th., z. N. B. dhe z. B. M., Me OE “D. Has” ShPK është lidhur kontrata nr. 1665, datë 13.09.2021 me vlerë 2,302,065 lekë pa TVSh dhe 2,762,478 lekë me TVSh. Formulari i njoftimit të kontratës është publikuar në buletin e APP-së nr. 122, datë 16.08.2021.

**Lidhja e kontratës**

Me OE fitues është lidhur kontrata me nr. 1665, datë 13.09.2021. Vlera e kontratës është 2,762,478 lekë me TVSh. Është paguar me Urdhër shpenzimin nr. 377, datë 10.11.2021, me situacionin pa datë, me faturë me nr. 9/2021, datë 08.11.2021.

**Nga auditimi konstatohet se,** dosja e procedurës së prokurimit “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore, Bashkia Has”, për vitin 2021, nuk është inventarizuar, në kundërshtim me Urdhrin nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: zj. E. D., zj. E. S. dhe z. A. M., në cilësinë e njësisë së prokurimit.*

**Titulli i Gjetjes 29:** Mungesë inventarizimi i dosjes së procedurave të prokurimit

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore, Bashkia Has”, për vitin 2021 dosja e kësaj procedure nuk është inventarizuar.

**Kriteri:** Urdhri nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

**Ndikimi:** Mungesa e inventarizimit të dosjeve të prokurimit sjell risk për ndërhyrje dhe modifikim në përmbajtjen e dosjes.

**Shkaku:** Mos hartim i inventarizimit të dosjes së procedurës së prokurimit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të ngrëjë grup pune dhe të inventarizojë dosjen e prokurimit si dhe në të ardhmen të ketë parasysh pas përfundimit të procedurës së prokurimit të inventarizojë dosjen.

## 6. “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë” viti 2021

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë”		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 41, datë 13.09.2021	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. E.D. (Kryetare) 2. S. L. (Anëtar) 3. K. L. (Anëtar)	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> <b>Nr. 473, datë 10.09.2021</b> 1. F. Th. (Kryetar) 2. A. Xh. (Anëtar) 3. N. B. (Anëtar)
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> “Kërkesë për propozim”		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 2,339,304 lekë	<b>6. Oferta fituese</b> “V.G.” ShPK me vlerë 1,940,660 lekë pa TVSh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 398,644 lekë
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 07.10.2021	<b>9. Burimi Financimit:</b> Nga buxheti i Bashkisë	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. “V. G.” ShPK 2. “V. P.” ShPK
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> 15.10.2021	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b>	2,328,792 lekë

### Hartimi i dokumenteve të tenderit

Zv. Kryetari z. F. Th. ka paraqitur kërkesë Kryetarit të Bashkisë dhe për dijeni Njesisë së Prokurimit Sektorit Ekonomik me objekt “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë”, Bashkia Has. Titullari i Bashkisë Has ka hartuar Urdhrin nr. 470, datë 13.09.2021, “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit”, me përbërje z. F. Th., z. N. B. dhe zj. E. D.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka ngritur Njësinë e Prokurimit me Urdhrin nr. 298, datë 01.07.2021, e përbërë nga: zj. E. D., zj. E. S. dhe z. A. M.. Për procedurën e prokurimit “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë”, me vlerë të fondit limit 2,339,304 lekë pa TVSh, dhe Urdhrin e Prokurimit nr. 41, datë 13.09.2021.

Në sistemin elektronik janë ftuar që të marrin pjesë dy OE: OE “V.P.” dhe “V.G.” ShPK.

Është mbajtur Proces verbali pa numër me datë 10.09.2021 “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim”, nga Njësia e Prokurimit.

Është hartuar kontratë shërbimi nr. 2092, datë 04.10.2021, për mbikëqyrje punimesh midis Bashkisë Has dhe “I” ShPK, me vlerë 48,500 lekë pa TVSh dhe 58,200 lekë me TVSh.

### Hartimi i fondit limit

Proces Verbali për “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë”, është hartuar nga Komisioni i Vlerësimit të Fondit Limit me vlerë totale 2,339,304 lekë pa TVSh referuar çmimeve të Manualeve Teknike sipas VKM-së 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, të kontratave të viteve 2018-2020.

### **Vlerësimi i Ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave**

Komisioni i Vlerësimit të ofertave është ngritur me urdhër nr. 473, datë 10.09.2021, me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z. A. Xh. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar). KVO ka mbajtur proces verbalin e hapjes së ofertave më datë 07.10.2021, ku konstatohet se për procedurën “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë” kanë marrë pjesë 2 operatorë ekonomikë:

1. OE “V.P.” ShPK me ofertë ekonomike 2,305,286 lekë pa TVSh;
2. OE “V.G.” ShPK me ofertë ekonomike 1,940,660 lekë pa TVSh.

Është mbajtur proces verbal përfundimtar për lidhje kontrate me datë 12.10.2021, ku KVO shprehet se nuk ka operatorë të skualifikuar, rrjedhimisht kualifikimi bëhet sipas ofertës ekonomike më të vogël.

Nga auditimit rezulton se OE i skualifikuar nuk plotëson kriteret:

1. Kriterin e veçantë pika 2.1 germa b, për sigurimin e ofertës;
2. Kriterin e veçantë 2.2 pika 2, pasi nuk ka sjellë bilanci për vitin 2019 dhe 2020;
3. Kriterin e veçantë 2.3 Kapaciteti teknik që përfshin të gjithë nënpikat, përkatësisht 2.3.1, 2.3.2 dhe 2.3.3, lidhur me vërtetim të numrit të punonjësve, vërtetim për inxhinier pyjesh dhe drejtues teknik, si dhe vërtetim për makineritë.

**Nga auditimi konstatohet se,** OE “V.G.” ShPK:

1. Nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.2 pika 2 ku citohet “Kopje të bilanceve të viteve ushtrimore 2019 dhe 2020 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse”, nuk është bilanci i vitit 2019;
2. Nuk plotëson kriterin e veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.3.3 ku citohet “Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë. Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë”, por OE ka bashkëlidhur vetëm 3 komplete, përkatësisht 1 komplet të ndihmës së shpejtë dhe 2 komplete pajisje të mbrojtjes në punë.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th., z. A. Xh. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.*

**Titulli i gjetjes 30:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP, në vlerësimin e ofertave

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese u konstatua se:

OE “V.G.” nuk plotëson kriterin e vendosur në pikën 2.2 pika 2 dhe 2.3.3, OE në paraqitjen e dokumentacionit nuk është bilanci i vitit 2019 dhe janë dokumentuar vetëm 3 komplete, përkatësisht 1 komplet të ndihmës së shpejtë dhe 2 komplete pajisje të mbrojtjes në punë nga 5 të kërkuara.

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 80, pika 1, neni 92, pika 3.

**Ndikimi:** Paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike.

**Shkaku:** Operatori Ekonomik është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Bashkia Has, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të Dokumenteve të Tenderit, me pasojë lidhjen e kontratave me OE që janë kualifikuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve publike.

**Nga auditimi konstatohet se,** për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë Bashkia Has” nuk është hartuar një raport përmbledhës, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: z. F. Th., z. A. Xh. dhe z. N. B., anëtarë të KVO.*

**Titulli i Gjetjes 31:** *Mungesë e raporteve përmbledhëse të procedurës së prokurimit*

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë Bashkia Has”, për vitin 2021 nuk është hartuar një raport përmbledhës.

**Kriteri:** Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99.

**Ndikimi:** Mungesa e raporteve përmbledhëse sjell mangësi në informimin e titullarit lidhur me procedurën e prokurimit të zhvilluar.

**Shkaku:** Mos hartim i raportit përmbledhës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Titullari i Autoritetit Kontraktor ka nxjerrë urdhrin nr. 717, datë 15.12.2021 “Për caktimin e komisionit marrje në dorëzim përfundimtar të punimeve” me OE të shpallur fitues në procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë, Bashkia Has” me përbërje z. F. Th., z. N. B. dhe z. B. M., Me OE “V. G.” ShPK është lidhur kontrata nr. 2360, datë 15.10.2021 me vlerë 1,940,660 lekë pa TVSh dhe 2,328,792 lekë me TVSh.

#### **Lidhja e kontratës**

Me OE fitues është lidhur kontrata me nr. 2360, datë 15.10.2021. Vlera e kontratës është 2,328,792 lekë me TVSh. Është paguar me Urdhër shpenzimin nr. 422, datë 03.12.2021, me situacionin pa datë, me faturë me nr. 50/2021, datë 01.12.2021, dhe Urdhër shpenzimin nr. 180, datë 01.04.2022, me proces verbal kolaudimi datë 15.12.2021, situacionin pa datë me faturë me nr. 1/2022, datë 15.12.2022.

**Nga auditimi konstatohet se,** dosja e procedurës së prokurimit “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë Bashkia Has”, për vitin 2021, nuk është inventarizuar, në kundërshtim me Urdhrin nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

*Për sa më lart mban përgjegjësi: zj. E. D., z. S. L. dhe z. K. L., në cilësinë e njësisë së prokurimit.*

**Titulli i Gjetjes 32:** *Mungesë inventarizimi i dosjes së procedurave të prokurimit.*

**Situata:** Për procedurën e prokurimit “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë Bashkia Has”, për vitin 2021 dosja e kësaj procedure nuk është inventarizuar.

**Kriteri:** Urdhri nr. 57, datë 12.06.2014, “Për standarde të auditit për prokurimin me vlerë më të madhe se 400,000 lekë pa TVSh dhe më të vogël se 400,000 lekë pa TVSh”, pika III, hapi 5.

**Ndikimi:** Mungesa e inventarizimit të dosjeve të prokurimit sjell risk për ndërhyrje dhe modifikim në përmbajtjen e dosjes.

**Shkaku:** Mos hartim i inventarizimit të dosjes së procedurës së prokurimit.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Bashkia Has të ngrejë grup pune dhe të inventarizojë dosjen e prokurimit si dhe në të ardhmen të ketë parasysh pas përfundimit të procedurës së prokurimit të inventarizojë dosjen.

## Viti 2022

### -Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, nevojat për prokurime në Bashkinë Has janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat e sektorëve përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për secilin vit ushtrimor. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e studimit të nevojave reale që ka njësia vendore për punë, mallra e shërbime, si dhe në përputhje të parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB.

### -Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.

**Për vitin 2022:** Bashkia Has ka zhvilluar gjithsej **46** procedura prokurimi me vlerë të fondit limit **65,329,233** lekë pa TVSH, vlerë të kontratës **59,901,210** lekë pa TVSH, diferencë midis tyre prej 5,428,023 lekë pa TVSH, ose në masën 8.3 % të fondit limit pa TVSH të prokuruar, nga të cilat:

- **Blerje me vlerë të vogël**, 38 procedura, me fondin limit në total prej 23,621,734 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 20,917,204 lekë, duke kursyer shumë prej 2,704,530 lekë;
- **E hapur**, 8 procedura, me fondin limit në total prej 41,707,499 lekë pa TVSH, kontrata të lidhura pa TVSH në total prej 38,984,006 lekë, duke kursyer shumë prej 2,723,493 lekë.

Janë audituar të 8 procedurat e hapura ku ka rezultuar si më poshtë vijon.

### **1. Procedura e prokurimit me objekt: “Pastrimi i kanaleve ujitëse, kryesore dhe dytësore të ujëmbledhësve”, viti 2022**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Pastrimi i kanaleve ujitëse, kryesore dhe dytësore të ujëmbledhësve”, viti 2022		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 21, datë 12.04.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1.E. D. Kryetar 2.A. R. Anëtar 3.O. M. Anëtar	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-</b> Urdhër Nr. 264, datë 13.05.2022 1. F. Th. Kryetar 2. P. C. Anëtar 3. N. B. Anëtar
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E Hapur e Thjeshtuar-Punë	<b>6. Oferta fituese</b> BOE V. G. SHPK, & I. G. SHPK: 4,783,363.0 lekë pa TVSh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 549,970.0 lekë pa TVSH
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 5,333,333.0 lekë	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i bashkisë Has	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. BOE “V. G.” SHPK, & I.G. SHPK 2. "J." SHPK
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 16.05.2022	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,</b> Nuk ka
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka		
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> datë 02.06.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 5,740,035.6 lekë.	

### **Kërkesa për realizim e procedurës së prokurimit**

Spektori i Bordit të Kullimit dhe Ujitjes ka paraqitur kërkesë (pa datë) tek Titullari i Autoritetit Kontraktor lidhur me nevojën për pastrimin e kanaleve ujitëse kryesore dhe dytësore të cilat shërbejnë për furnizimin e fermerëve me ujë për vaditjen e tokave bujqësore.

### **Llogaritja e fondit limit**

Me Urdhrin nr. 201 datë 08.04.2022 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje F. Th. (Zv.Kryetar), A. R. (Përgj. Sek. Bordi i Kullimit), N. B. (Përgj. Sektori i Urbanistikës) i cili ka për detyrë hartimin e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e fondit limit. Më datë 08.04.2022 komisioni ka mbajtur proces verbalin e për llogaritjen e fondit limit. Ku rezulton se do të pastrohen gjithsej 16 kanale ujitëse me vlerë totale të fondit limit **5,297,484 lekë pa TVSH** (6,356,980 lekë me TVSH).

Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezulton se zëri 3.An/3t në manual është me çmim 6,564 lekë ndërsa nga komisioni është llogaritur 2,500 lekë. Diferenca në çmim nuk është e argumentuar pasi në procesverbalin e mbajtur për llogaritjen e fondit limit komisioni shprehet se llogaritjet e çmimeve janë bërë referuar manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre”, i ndryshuar. Për zërat e tjerë të punimeve çmimet janë në përputhje me manualin e çmimeve. Miratimi i kërkesës për prokurim është bërë nga titullari i AK më datë 22.04.2022.

### **Hartimi i specifikime teknike dhe DT**

**Titulli i gjetjes 33:** *Mbi hartimin e fondit limit dhe preventivit të punimeve*

**Situata:** Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër nr. 263 datë 12.05.2022 “Për krijimin e Njësisë së Prokurimit me objekt “Pastrimi i kanaleve ujitëse, kryesore dhe dytësore të ujëmbledhësve”, ka ngritur NJP (me përbërje znj. E. D.-Kryetare/Juriste, z. A. R./Përgj. Sektori Bordi i Ujrave, z. O. M./Topograf. Komisioni ka për detyrë të hartojë dokumentet e tenderit dhe kriteret e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike.

Në zbatim të urdhrit të sipër cituar më datë 20.04.2022 NJP ka mbajtur procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 21 datë 12.04.2022 ku ka ngarkuar NJP për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt “Pastrimi i kanaleve ujitëse, kryesore dhe dytësore të ujëmbledhësve” me vlerë të fondit limit 5,333,333 lekë pa TVSH.

Referuar proces verbalit për hartimin e fondit limit dhe Urdhrit të Prokurimit vlera e fondit limit ndryshon me 35,849 lekë më shumë në urdhrin e prokurimit, diferencë e cila është e pa argumentuar.

Nga auditimi rezulton se ka ndryshime në zërat e punimeve nga procesverbali që është mbajtur për hartimin e fondit limit me preventivin e punimeve. Përkatësisht:

- Kanali ujitës Dobrum-Nikoliq 13.8 km, zëri gërmim dheu ndryshon nga 500 m3 në 600 m3 diferenca në vlerë 65,400 lekë.
- Kanali ujitës Pla-Kodra e madhe 3.8 km, në procesverbalin për llogaritjen e fondit limit është parashikuar vetëm gërmim dheu, ndërsa në preventivin e punimeve janë parashikuar dhe dy zëra shtesë punimesh si punime në urë kalimi dhe rehabilitim kanali ujitës K22. Vlera për punime në urë kalimi është 117,541 lekë, ndërsa shuma për rehabilitimin e kanalit ujitës është 224,698 lekë. Në total vlera referuar preventivit për këtë kanal ujitës është 636,390 pa TVSH lekë ndërsa në procesverbalin për llogaritjen e fondit limit vlera totale për këtë kanal është 294,300 lekë a TVSH.
- Kanali ujitës Pla-Zahrisht 25.8 km, në preventivin e punimeve ka një zë më shumë punimesh se në procesverbalin për llogaritjen e fondit limit, gërmim dheu me krahë 50 m3 me vlerë 45,100 lekë.
- Kanali ujitës Pla-Nënstacioni 11.2 km, në preventiv mungon zëri F.V tuba 500 të brinjëzuar i cili është parashikuar në procesverbalin për llogaritjen e fondit limit me sasi 50 ml dhe vlerë 125,000 lekë. Gjithashtu, edhe për zërat e parashikuar ndryshon sasia nga 400 m3 në 615 m3 dhe nga 30 m3 në 70 m3.
- Në kanalet ujitëse Tobel-Metaliaj 11.0 km, ndryshon sasia e m3 të parashikuar në procesverbalin për llogaritjen e fondit limit me atë të llogaritur në preventivin e punimeve nga 410 m3 në 510 m3, Trektan-Branogë 14.0 km, nga 200 m3 në 350 m3, Trektan 3.0 km nga 120 m3 në 245 m3, Vranisht-Fajza 11.2 km nga 803 m3 në 970 m3 si dhe janë parashikuar tuba të brinjëzuar 30 ml ndërkohë që nuk janë në preventivin e punimeve, Vranisht 4.8 km nga 360 m3 në 500 m3, Fajza 12.0 km nga 900 m3 në 1000 m3, si dhe nuk janë në preventivin e

punimeve zëri për tub çeliku dhe dhe struktura betoni 5 m3, Golaj 8.8 km nga 200 m3 në 400 m3, Helshan 13.2 km nga 300 m3 në 402 m3. Të gjitha këto ndryshime në zëra punimesh dhe volume pune nuk janë argumentuar. Gjithashtu, proces verbali për hartimin e fondit limit është firmosur nga i gjithë komisioni i ngritur për këtë proces ndërsa preventivi i punimeve i cili ndryshon nga proces verbali është firmosur vetëm nga Ing. F. Th. Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura janë në përputhje me objektin e kontratës.

*Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i hartimit të Fondit Limit z.F. Th., z. A. R., z. N. B., Njësia e Prokurimit znj. E. D., z. A. R., z. O. M..*

**Kriteri:** Kuadri ligjor për prokurimin publik

**Shkaku:** Komisioni i hartimit të Fondit dhe Njësia e Prokurimit nuk kanë argumentuar dhe dokumentuar ndryshimet e bëra në zërat e punimeve dhe a kanë ndikim këto në realizimin e kontratës.

**Ndikimi:** Ndryshimi i pa argumentuar i zërave dhe volumit të punimeve cenon arritjen e objektivit të procedurës.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Titullari i AK të marrë masa që Komisioni për Hartimin e Fondit limit të argumentojë zërat e punimeve, volumin dhe vlerën e tyre me qëllim shmangien e ndryshimit të pa argumentuar gjatë hartimit dhe miratimit të preventivit të punimeve.

### **Vlerësimi i ofertave**

**Titulli i gjetjes 34:** *Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE V.G. SHPK, & I.G. SHPK, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur.*

**Situata:** Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 264, datë 13.05.2022 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z, P. C. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar).

KVO më datë 16.05.2022 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Pastrimi i kanaleve ujitëse, kryesore dhe dytësore të ujëmbledhësve”, me fond limit 5,333,333 lekë. Konstatohet se për këtë procedurë kanë aplikuar 2 operatorë ekonomik, si më poshtë:

- “J.” SHPK me Nipt J.L me vlerë ekonomike të ofertës 4,878,142 lekë pa TVSH;

- “V.G” SHPK me Nipt L.E me vlerë ekonomike të ofertës 4,783,363 lekë pa TVSH.

KVO ka mbajtur procesverbalet përkatëse gjatë procesit të vlerësimit të ofertave si dhe ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave më datë 21.05.2022 ku ka kualifikuar të dy OE pasi ato i plotësonin kriteret e përcaktuara në DT dhe ka shpallur fitues OE “V.G” SHPK me Nipt L....E me vlerë ekonomike të ofertës 4,783,363 lekë pa TVSH me kriterin e klasifikimit sipas ofertës ekonomike më të vogël.

Nuk ka patur ankesa nga OE pjesëmarrës.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës dhe të kualifikuar u konstatua si vijon:

**Në pikën 2.3.1 të DT mbi kapacitetin teknik kërkohet që OE duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:**

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e zhvillimit të procedurës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 200 % i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

*Kontrata punimeve; - Situacioni përfundimtar; - Aktin e kolaudimit; - Certifikatë e marrjes në dorëzim dhe faturat tatimore për çdo situacion; - Reference (Formulari Vlerësimit) e lëshuar nga investitori për punimet e ngjashme të realizuara për tre vitet e fundit (2019, 2020, 2021), ku të jete e përcaktuar vlera e kontratës së realizuar, koha e realizimit të punimeve, natyra e punës së bërë.*

*Për raste të përvojës së mëparshme të realizuar në sektorin privat kërkohet të paraqitet formulari i vlerësimit i shoqëruar me: Kontratën e punimeve; - Lejen e ndërtimit dhe të shfrytëzimit lëshuar nga njësi vendore përkatëse; - Situacionin përfundimtar si dhe faturat tatimore për çdo situacion.*

BOE kanë sjellë për punë të ngjashme, “V.G.” SHPK një kontratë punimesh të vitit 2021 me vlerë 1,940,660 lekë ndërsa “I.” SHPK, një kontratë të vitit 2018 me vlerë 32,680,047 lekë pa TVSH. Në DT nuk përcaktohet si duhet të plotësohet ky kriter në rastin e bashkimit të operatorëve. OE “V.G.” SHPK që referuar kontratës së bashkëpunimit do të kryejë 53% të punimeve nuk e plotëson këtë kriter.

**Në pikën 2.3.3 të DT mbi kapacitetin teknik kërkohet që OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:**

*a) Një punësim mesatar i të paktën 20 (njëzet) punonjësve, të vërtetuar me:*

*Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Qershor 2021- Mars 2022 (vërtetime me nënshkrime elektronike).*

OE “V. G.” SHPK për periudhën e përcaktuar ka një numër mesatar prej 17 punonjësish duke qenë se do të kryejë 53% të punimeve e plotëson kriterin por OE “I.” SHPK ka sjellë dokumentacion vetëm për numrin e punonjësve për periudhën janar-mars 2022 ku numri mesatar i punonjësve është 33, për periudhën Qershor-Dhjetor 2021 nuk ka sjellë dokumentacion.

Gjithashtu, lidhur me mjetet dhe makineritë e kërkuara dokumentacioni për kamionin 8-10 ton nuk shoqërohet me foto.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 92 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” sipas të cilit “2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

*Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material.”.*

*Për trajtuar sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi NJP për mos përcaktimin në DT plotësimin e kriterëve në rastin e BOE dhe KVO për kualifikimin e BOE edhe me disa mangësi të konstatuara.*

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar.

**Shkaku:** KVO nuk ka zbatuar kuadrin ligjor në vlerësimin e ofertave.

**Ndikimi:** Janë kualifikuar OE në kushtet e mos plotësimit të kriterëve / dokumentacionit / makinerive / mjeteve të kërkuara.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, për të mirë përdorur fondet e



Bashkisë. Gjithashtu, të bëhet argumentimi i saktë i skualifikimit apo kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në përfundim procedura e prokurimit dhe shpallja e fituesit është miratuar nga Titullari i AK me Vendim nr. 298 datë 31.05.2022.

Me OE "V.G." SHPK është lidhur kontrata me nr. 1243 Prot, datë 02.06.2022 me vlerë 4,783,363 lekë pa TVSH dhe 5,740,035 lekë me TVSH me afat 30 ditë nga data e fillimit të punimeve. Formulari i njoftimit të kontratës është publikuar në buletin e APP-së nr. 83, datë 31.05.2021.

## 2. Procedura e prokurimit me objekt: "Rehabilitim dhe pastrim i sipërfaqe pyjore", viti 2022

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim dhe pastrim i sipërfaqe pyjore"		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 41, datë 20.07.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1.E. L. - Kryetare 2.S. L. - Anëtar 3.K. L. - Anëtar	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-</b> Urdhër Nr. 410, datë 14.07.2022 1. F. Th. - Kryetar 2. P. C. - Anëtar 3. A. Xh. - Anëtar ..... Urdhër Nr. 518, datë 30.08.2022 1. F. Th. - Kryetar 2. P. C. - Anëtar 3. N. B. - Anëtar
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E Hapur e Thjeshtuar-Punë		
<b>5. Fondi Limit</b> 1,833,333 lekë pa TVSH	<b>6. Oferta fituese</b> BOE "L." SHPK, & "D. C 2014" SHPK, 1,629,450 lekë pa TVSH	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 208,8333 lekë pa TVSH
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 22.08.2022 12.09.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i bashkisë Has	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. BOE "L."&"D.C2014" SHPK 2. "B.K 2010" SHPK
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> datë 05.10.2022	<b>15. Vlera e kontratës</b> 1,955,340 lekë me TVSH	

### Kërkesa për realizim e procedurës së prokurimit

Drejtorja e Shërbimit Pyjor ka paraqitur kërkesë (pa datë) tek Titullari i Autoritetit Kontraktor lidhur me nevojën e rehabilitimit të sipërfaqeve pyjore.

### Llogaritja e fondit limit

Me Urdhrin nr. 406 datë 12.07.2022 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje F. Th. (Zv.Kryetar), S. L. (Drejtor i Shërbimit Pyjor), E. D. (Juriste) i cili ka për detyrë hartimin e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e fondit limit.

Më datë 14.07.2022 komisioni ka mbajtur proces verbalin e për llogaritjen e fondit limit. Ku rezulton se do të pastrohen dhe rehabilitohen dy parcela me sipërfaqe 23.5 ha dhe 12 ha, me vlerë totale të fondit limit 1,833,333 lekë pa TVSH (2,200,000 lekë me TVSH).

Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezulton se çmimet e zërave të punimeve janë llogaritur duke iu referuar manualit të pyjeve, volumit të punës, normës ditore dhe ditëve të punës. Miratimi i kërkesës për prokurim është bërë nga titullari i AK.

## Hartimi i specifikime teknike dhe DT

**Titulli i gjetjes 35:** *Mos argumentim i kriterëve të vendosura për kualifikimin e operatorëve*

**Situata:** Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër nr. 41 datë 20.07.2022, ka ngritur NJP me përbërje znj. E. L.-Kryetare/Juriste, z. S. L./Inxh. Pyjesh, z. K. L./Inxh. Pyjesh. Komisioni ka për detyrë të hartojë dokumentet e tenderit dhe kriteret e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike.

Në zbatim të urdhrit të sipër cituar më datë 22.07.2022 NJP ka mbajtur procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Nga auditimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit konstatohet se janë vendosur kriteret specifike jo komplekse dhe në parim përputhen me objektin e procedurës së prokurimit. Argumentimi i tyre përgjithësisht është bërë duke iu referuar kuadrit ligjor dhe nuk janë dhënë argumentime specifike lidhur me llojin e licencës së kërkuar, numrin e punonjësve si dhe mjetet/makineritë (autoveturë) si vijon:

**Në pikën 2.3.2 të DT përcaktohet se,** “Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licencë Kodi: **III.7.A** (Shërbime profesionale për projektme, **Shërbime profesionale për zbatime**), Kategoria: Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë; Nënkatgoria: Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ose kullota; **Pika 2.3.3 e DT,** Ofertuesi duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve dhe e stafit të jetë jo me pak se 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës për periudhën Janar 2022 – Korrik 2022 (7 Muaj të fundit).

**Pika 2.3.4 e DT,** Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamionçine (Furgon) vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 1.5 -2 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamiona mbi 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Autoveture (4+1)	në pronësi ose me qira	Copë 1

Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar kërkesën për licencën, numrin e punonjësve dhe llojin e mjeteve dhe makinerive, veprime në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, pika 1, “Kërkesat për kualifikim...*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës*”, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 39, pika 4 “*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve*”.

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar.

**Shkaku:** NJP nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë hartimit të kriterëve për kualifikim.

**Ndikimi:** Aplikimi i kriterëve jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifikime teknike që janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar.

### Vlerësimi i ofertave

**Titulli i gjetjes 36:** *Kualifikim i operatorëve ekonomikë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.*

**Situata:** Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 410, datë 14.07.2022 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z. P. C. (Anëtar) dhe z. A. Xh. (Anëtar). Kjo procedurë është anuluar më datë 26.08.2022 me argumentimin se “*nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme*”. Lidhur me anulimin e procedurës KVO në një dokument të gjendur në dosjen e prokurimit “Klasifikimi përfundimtar” ka argumentuar se oferta nuk përmban çmim total dhe mungon lista e çmimeve sipas zërave të preventivit etj. Nga auditimi rezulton se, KVO nuk ka hartuar asnjë procesverbal lidhur me argumentimin që ka bërë i cili ka sjellë marrjen e vendimit për anulimin e procedurës. Nga auditimi i dokumentacionin të OE në sistem rezulton se dokumentacioni i ngarkuar nuk është i plotë. Procedura është hapur përsëri (Ref-40201-08-30-2022) dhe është publikuar në buletin e APP-së nr. 122 të datës 6 shtator 2022.

Titullari i AK me urdhrin nr. 518 datë 30.08.2022 ka ngritur një tjetër KVO për këtë procedurë me përbërje z. F. Th. – Kryetar; z. P. C. – Anëtar dhe z. N. B. – Anëtar.

KVO më datë 12.09.2022 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “*Rehabilitim dhe pastrim i sipërfaqeve pyjore*”, me fond limit 1,833,333 lekë pa TVSH. Konstatohet se për këtë procedurë kanë aplikuar 2 operatorë ekonomik, si më poshtë:

1. BOE "L" & "D.C. 2014" SHPK me vlerë ekonomike të ofertës 1,629,450 lekë pa TVSH.
2. "B.K. 2010" SHPK me vlerë ekonomike të ofertës 1,803,400 lekë pa TVSH.

KVO ka mbajtur procesverbalet përkatëse gjatë procesit të vlerësimit të ofertave si dhe ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave më datë 16.09.2022 ku ka kualifikuar të dy OE pasi ato i plotësonin kriteret e përcaktuara në DT dhe ka shpallur fitues BOE “L.” & “D.C. 2014” SHPK me vlerë ekonomike të ofertës 1,629,450 lekë pa TVSH me kriterin e klasifikimit sipas ofertës ekonomike më të vogël.

Nuk ka patur ankesa nga OE pjesëmarrës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës dhe të kualifikuar u konstatua se:

**Në pikën 2.3.2 të DT kërkohet që** “*Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë licencë Kodi: III.7.A (Shërbime profesionale për projekttime, Shërbime profesionale për zbatime), Kategoria: Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë; Nënkatëgoria: Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ose kullota*”, BOE “L.” & “D.C. 2014” SHPK nuk e plotëson këtë kriter.

**Në pikën 2.3.4 të DT kërkohet që** “*Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamionçine (Furgon) vetshkarkuse me kapacitet mbajtës 1.5 -2 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamiona mbi 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Autoveture (4+1)	në pronësi ose me qira	Copë 1

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e

mjetit (i vlefshëm); f) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme), g) license e shoqërisë për transport, i) foto ku të evidentohen dhe targat.

Referuar kontratës së bashkëpunimit OE “D.C.” SHPK në këtë procedurë do të ofrojë edhe mjetin e transportit tip kamionçinë. Nga auditimi i dokumentacionit për mjetin e transportit me targë AA593PA të deklaruar rezulton se, mungon - certifikata për transport mallrash brenda vëndit (e vlefshme), - licenca e shoqërisë për transport si dhe foto ku të evidentohen targat e mjetit.

Lidhur me mjetin autoveturë nga OE “L.” SHPK është paraqitur dokumentacion për mjetin e tipit Ford me targa A.B për të cilin siguracioni ka përfunduar më 06.12.2021, si dhe nuk është paraqitur certifikata e kontrollit teknik, certifikata për transport, licenca e shoqërisë për transport si dhe foto ku të evidentohen targat. Gjithashtu, për mjetin me targa A.F ka paraqitur vetëm kontratën e blerjes dhe certifikatën e kontrollit teknik e cila ka përfunduar më 23.09.2021.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 92 të Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” sipas të cilit “2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

*Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material.”*

*Sa më sipër trajtuar ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e KVO-së z. F. Th., z. P. C. dhe z. N. B.*

Me BOE “L.”&”D.C. 2014” SHPK është lidhur kontrata me nr. 2143 Prot, datë 05.10.2022 me vlerë 1,629,450 lekë pa TVSH dhe 1,955,340 lekë me TVSH me afat 30 ditë nga data e fillimit të punimeve.

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar

**Shkaku:** KVO nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë vlerësimit të ofertave.

**Ndikimi:** Janë kualifikuar OE duke mos plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në DT.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë. Gjithashtu, të bëhet argumentimi i saktë i skualifikimit apo kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

### 3. “Ndërtim KUZ, Fshati Gajrep, Krumë, Golaj”

3. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim KUZ, Fshati Gajrep, Krumë, Golaj (përkatësisht sipas lagjeve)”		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.66, datë 23.11.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. E. D. Kryetare 2. A. M. Anëtar 3. E. S. Anëtare	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër</b> Nr. 767, datë 21.11.2022 1. F. Th. Kryetar 2. P. C. Anëtar 3. N. B. Anëtar
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E Hapur e Thjeshtuar-Punë		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh):</b> 5,500,000.0 lekë pa tvsh	<b>6. Oferta fituese</b> BOE: “V. G.” SHPK & “A..-2A CO” SHPK; Vlera:4,948,900.0 lekë pa TVSH	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 551,100.0 lekë pa TVSH

<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 12.12.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i bashkisë Has.	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. BOE: "V.G" SHPK & "A.-2A CO" SHPK, 2. BOE: "P." SHPK & "I." SHPK 3. "O." SHPK 4. "Xh." SHPK
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> datë 30.12.2022	<b>15. Vlera e kontratës</b> 5,938,680.0 lekë me TVSH	

### **Kërkesa për realizim e procedurës së prokurimit**

Kërkesa për këtë procedurë prokurimi është bërë nga Zv/Kryetari i Bashkisë dhe nuk mban datë.

### **Llogaritja e fondit limit**

**Titulli i gjetjes 37:** *Nuk është argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritja e vlerës së kontratës.*

**Situata:** Me Urdhrin nr. 760 datë 18.11.2022 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje F. Th. (Zv. Kryetar), E. D. (Juriste), N. B. (Përgj. Sektori i Urbanistikës) i cili ka për detyrë hartimin e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e fondit limit.

Më datë 18.11.2022 komisioni ka mbajtur proces verbalin e për llogaritjen e fondit limit, ku rezulton se do të ndërtohen kanalizimet e ujërave të zeza për tre fshatra me vlerë totale të fondit limit 5,500,000 lekë pa TVSH (6,600,000 lekë me TVSH).

Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezulton se:

- Zëri 2.522, F.V tub plastik D=160mm është llogaritur më 750 lekë kur në manualin e çmimeve vlera për këtë zë është 1,673 lekë.
- Zëri 2.523 F.V tub plastik D=200mm është llogaritur më 1,150 lekë kur në manualin e çmimeve vlera për këtë zë është 2,009 lekë.

Gjithashtu, nga verifikimi i çmimeve të preventivit të administruar në dosje, rezulton se 3 zëra të preventivit me vlerë **528,525 lekë**, janë të shënuar "an" dhe nuk janë shoqëruar me analiza çmimi, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 76, pika 2 "Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës", sipas të cilit "*...Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet...*".

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje z. F. Th., znj. E. D., z. N. B..*

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar

**Shkaku:** Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit nuk ka dokumentuar llogaritjen e vlerës për 5 zëra punimesh.

**Ndikimi:** Llogaritja e vlerës së fondit limit është e pa argumentuar.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has të marrë masat që Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit të dokumentojë dhe argumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës.

### **Hartimi i specifikimeve teknike dhe DT**

**Titulli i gjetjes 38:** *Mos argumentim i kritereve të vendosura për kualifikimin e operatorëve*

**Situata:** Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër nr. 760 datë 18.11.2022 ka ngritur komisionin e vlerësimit të fondit limit për procedurën me objekt "Ndërtim KUZ, Fshati Gajrep, Krumë, Golaj", (me përbërje z. F. Th. – Ing-Kryetar, znj. E. D.-Juriste, z. N. B. /Përgj. Sektori

Urbanistikës. Komisioni ka për detyrë të hartojë specifikimet teknike dhe vlerësimin e fondit limit.

Në zbatim të urdhrin të sipër cituar më datë 18.11.2022 komisioni ka mbajtur procesverbalin për llogaritjen e fondit limit për rehabilitimin e tre lagjeve me vlerë totale 5,500,000 lekë pa TVSH.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 66 datë 23.11.2022 ku ka ngarkuar NJP për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim KUZ, Fshati Gajrep, Krumë, Golaj” me vlerë të fondit limit 5,500,000 lekë pa TVSH.

Njësia e Prokurimit më datë 22.11.2023 ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike për kualifikim.

Nga auditimi rezulton se **në pikën 2.3.4 të DT kërkohet që** “Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. Për realizimin e kontratës operatori duhet të ketë të punësuar dhe stafin teknik të më poshtëm: Inxhinier **Ndërtim** ose **Gjeodet** ose **Hidroteknik** 1(një) person; Teknikë ndërtimi të paktën **1(një) person** të cilët duhet të figurojnë në liste pagesat e kompanisë si të tillë të paktën **3 muajt e fundit të kërkuar (Korrik-Gusht 2022)**, të shoqëruar me Kontratë pune të **noterizuar**, **Diplome dhe CV, Libreze Pune**);
- b. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nga Administratori i Shoqërisë) **Drejtuesin/(t) Teknik** të punimeve në objekt dhe të deklarojë se ai/ata do të jete/jene i/te pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:
  - i. **Diplome + CV,**
  - ii. **Kontrate pune të noterizuar, të vlefshme deri në përfundimin e kontratës”.**

Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të noterizuar për punonjësit e kërkuar, nuk mbështetet në përcaktimet e Kodit të Punës neni 21.

Kërkesa për drejtuesin teknik të punimeve të pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt është në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit, Pika 2.1, ku citohet se: “Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, pika 1, “Kërkesat për kualifikim...Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 39, pika 4 “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi NJP znj. E. D., z.A. M., znj. E. S. Anëtare.

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar

**Shkaku:** NJP nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë hartimit të kriterëve për kualifikim.

**Ndikimi:** Aplikimi i kriterëve jo të mirë argumentuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifikime teknike që janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar.

### Vlerësimi i ofertave

**Titulli i gjetjes 39:** *Kualifikim i operatorëve ekonomikë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.*

**Situata:** Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 767, datë 21.11.2022 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z, P. C. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar).

KVO më datë 12.12.2022 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim KUZ, Fshati Gajrep, Krume, Gola”, me fond limit 5,500,000 lekë. Konstatohet se për këtë procedurë kanë aplikuar 4 operatorë ekonomik, si më poshtë:

1. BOE: “V. G.” SHPK & “A.-2A CO” SHPK NIPT: L.E & K.C, me vlerë oferte **4,948,900.0 lekë pa TVSH.**

2. BOE: “P.” SHPK & “I.” SHPK, NIPT: M.F & J.W me vlerë oferte **5,106,000.0.0 lekë pa TVSH.**

3. “O.” SHPK, NIPT: K.0, me vlerë oferte **5,214,025 lekë pa TVSH.**

4. “Xh.” SHPK, NIPT: K1, me vlerë oferte **5,248,250 lekë pa TVSH.**

KVO ka mbajtur procesverbalet përkatëse gjatë procesit të vlerësimit të ofertave si dhe ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit të ofertave më datë 18.12.2022 ku ka kualifikuar të katër OE pasi ato i plotësonin kriteret e përcaktuara në DT dhe ka shpallur fitues OE “V.G.” SHPK me Nipt L.E me vlerë ekonomike të ofertës 4,948,900 lekë pa TVSH me kriterin e klasifikimit sipas ofertës ekonomike më të vogël.

Nuk ka patur ankesa nga OE pjesëmarrës.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE fitues u konstatua si vijon:

**Në pikën 2.3.6 të DT kërkohet që** “Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr	LLOJI I MAKINERIVE	PRONËSIA	SASIA <i>Minimumi</i>
1	<i>Fadromë me goma:</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>
2	<i>Kamionçine mbi 1.5 Ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>2 copë</i>
3	<i>Kamiona 8-10 ton</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>1 copë</i>

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, dhe për mjetet e siguruara me qira (e noterizuar), dokumenti që vërteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

b) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet Licencë & Certifikatë Transporti, ...". **Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Nga auditimi rezulton se BOE nuk ka sjellë dokumentacionin që vërteton plotësimin e këtij kriteri. Në shtojcat nr. 8 të plotësuar nga të dy operatorët që janë bashkuar për këtë procedurë janë deklaruar nga operatori “V.” SHPK 2 mjete me qira (me targa AA916 GB, VL2373C) për të cilat nuk janë sjellë dokumentet e kërkuara në DT. Gjithashtu, edhe nga OE “A...-2A-CO” SHPK në shtojcën nr. 8 për këtë procedurë janë deklaruar 4 mjete me qira (me targa AFMT93, AB135DC, AA335XF, AA613LS) për të cilët nuk janë sjellë dokumentet e kërkuara në DT.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë dhe në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” sipas të cilit “2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material...”.

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO me përbërje z. F. Th., z. P. C. dhe z. N. B..*

Në përfundim procedura e prokurimit dhe shpallja e fituesit është miratuar nga Titullari i AK me Vendim nr. 96 datë 30.12.2022.

Me OE “V.G” SHPK është lidhur kontrata me nr. 2737 Prot, datë 29.12.2022 me vlerë 4,948,900 lekë pa TVSH dhe 5,938,680 lekë me TVSH me afat 60 ditë nga fillimi i punimeve.

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar

**Shkaku:** KVO nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë vlerësimit të ofertave.

**Ndikimi:** Janë kualifikuar OE duke mos plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në DT.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë. Gjithashtu, të bëhet argumentimi i saktë i skualifikimit apo kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

#### 4. Procedura e prokurimit me objekt: “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rrugë Rurale dhe Kanalizime Bashkia Has”, viti 2022

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rrugë Rurale dhe Kanalizime Bashkia Has”		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.28, datë 16.05.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> Urdhër nr. 260, datë 11.05.2022	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave</b> Urdhër Nr. 261, datë 11.05.2022 :
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E Hapur e Thjeshtuar-Punë	1.E. D. Kryetarë 2.A. M. Anëtar 3.O. M. Anëtar	1. F. Th. Kryetar 2. P. C. Anëtar 3. N. B. Anëtar
<b>5. Fondi Limit:</b> 5,740,833 pa TVSH	<b>6. Oferta fituese</b> “P.” SHPK me vlerë 5,284,250.0 lekë pa TVSH	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 456,583.0 lekë pa TVSH
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 27.06.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i bashkisë Has	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> “P.” SHPK
<b>11. Ankimime AK, Nuk ka</b>	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK, Nuk ka</b>	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> datë 28.07.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 6,341,100.0 lekë me TVSH	

#### Kërkesa për realizim e procedurës së prokurimit

Kërkesa për këtë procedurë prokurimi është bërë nga Sektori i Rrugëve Rurale.



### **Llogaritja e fondit limit**

Me Urdhrin nr. 264 datë 13.05.2022 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje F. Th. (Zv. Kryetar), E. D. (Juriste), A. M. (Përgj. Sektori i Rrugëve Rurale) i cili ka për detyrë hartimin e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e fondit limit.

Më datë 15.05.2022 komisioni ka mbajtur proces verbalin e për llogaritjen e fondit limit, ku rezulton se do të kryhen punime mirëmbajtje në 15 rrugë rurale me vlerë totale të fondit limit 5,740,800 lekë pa TVSH (6,888,960 lekë me TVSH).

Kërkesa për prokurim është miratuar nga titullari i AK më datë 15.05.2022 ku është ngarkuar NJP të fillojë procedurën.

Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezulton se çmimet e zërave të punimeve janë në përputhje me përcaktimet e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre”, i ndryshuar.

### **Hartimi i specifikime teknike dhe DT**

Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër nr. 260, datë 11.05.2022 ka ngritur NJP për procedurën e prokurimit me objekt “*Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rrugë Rurale dhe Kanalizime Bashkia Has*”, me përbërje znj. E. D. (Kryetare-Juriste), z. A. M. (Anëtar-Përgj. Sektori i Rrugëve Rurale) dhe z. O. M. (Anëtar Topograf). Komisioni ka për detyrë të hartojë dokumentet e tenderit dhe kriteret e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike.

Në zbatim të urdhrin të sipër cituar më datë 03.06.2022 NJP ka mbajtur procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 28 datë 16.05.2022 ku ka ngarkuar NJP për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt “*Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rrugë Rurale dhe Kanalizime Bashkia Has*” me vlerë të fondit limit 5,740,833 lekë pa TVSH.

Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura janë në përputhje me objektin e kontratës.

### **Vlerësimi i ofertave**

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 261, datë 11.05.2022 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z. P. C. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar).

KVO më datë 27.06.2022 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “*Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rrugë Rurale dhe Kanalizime Bashkia Has*” me fond limit 5,740,833 lekë pa TVSH. Konstatohet se për këtë procedurë ka aplikuar 1 operator ekonomik, “P.” SHPK, NIPT: K.M, me vlerë oferte **5,284,250.0 lekë pa TVSH.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës dhe të kualifikuar nuk u konstatuan parregullsi. U konstatua se OE i kualifikuar dhe shpallur fitues përmbush kriteret e vendosura në DT.

Në përfundim procedura e prokurimit dhe shpallja e fituesit është miratuar nga Titullari i AK me Vendim nr. 449 datë 01.08.2022.

Me OE “P.” SHPK është lidhur kontrata me nr. 1655 Prot, datë 28.07.2022 me vlerë 5,284,250 lekë pa TVSH dhe 6,341,100 lekë me TVSH me afat 30 ditë nga data e fillimit të punimeve.

#### **4. Procedura e prokurimit me objekt: “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore”, Bashkia Has, viti 2022**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore”		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.40, datë 15.07.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1.E. D. Kryetare 2.A. M. Anëtar 3.E. S. Anëtare	<b>3. Komisioni Vlerësimi Ofertave-</b> Urdhër Nr. 409, datë 13.07.2022: 1. F. Th. Kryetar 2. P. C. Anëtar 3. N. B. Anëtar
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E Hapur e Thjeshtuar-Punë		
<b>5. Fondi Limit:</b> 3,000,000 lekë pa TVSH	<b>6. Oferta fituese</b> "H.-G. C."SHPK, dhe "C." SHPK, me vlerë: 2,490,953.0 pa TVSH	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 509,047.0 lekë pa TVSH
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 01.08.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Bashkisë Has	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> "H.-G. C." SHPK dhe "C." SHPK
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> datë 11.08.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 2,989,143.6	

### Kërkesa për realizim e procedurës së prokurimit

Kërkesa për këtë procedurë prokurimi është bërë Zv/Kryetari i Bashkisë dhe Drejtori i Shërbimeve Konvikt.

### Llogaritja e fondit limit

**Titulli i gjetjes 40:** *Pasaktësi në përlllogaritja e vlerës së kontratës / fondit limit dhe ndryshim i zërave të punimeve nga proces verbal i hartimit të fondit limit në preventivin e punimeve.*

**Situata:** Me Urdhrin nr. 407 datë 12.07.2022 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje F. Th. (Zv. Kryetar), E. D. (Juriste), N. B. (Përgj. Sektori i Urbanistikës) i cili ka për detyrë hartimin e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e fondit limit.

Më datë 13.07.2022 komisioni ka mbajtur proces verbalin e për llogaritjen e fondit limit, ku rezulton se do të kryhen punime mirëmbajtje në 13 institucione arsimore me vlerë totale të fondit limit 3,000,000 lekë pa TVSH (3,600,000 lekë me TVSH).

Nga auditimi rezulton se ka gabime matematikore në vlerën e shpenzimeve për çdo institucion duke sjellë që totali i fondit limit i llogaritur në proces verbalin përkatës dhe i mbledhur nga grupi i auditimit të jetë **2,747,996 lekë pa TVSH (3,297,595 lekë me TVSH).**

Kërkesa për prokurim është miratuar nga titullari i AK ku është ngarkuar NJP të fillojë procedurën.

*Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezulton se çmimet e zërave të punimeve janë në përputhje me përcaktimet e manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit, miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për Miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre”, i ndryshuar.*

Nga auditimi i preventivit të punimeve konstatohet se, zërat e punimeve nuk kanë ndryshuar, ndërsa çmimet për zërat kanë pësuar një rritje nga çmimet e llogaritura në proces verbalin e hartimit të fondit limit të cilat ishin në përputhje me manualin e çmimeve. Edhe pse çmimet e zërave të punimeve janë rritur përsëri totali nuk ka ndryshuar nga ai në proces verbalin e llogaritjes së fondit limit (3,000,000 lekë pa TVSH, 3,600,000 lekë me TVSH).

Nuk janë dhënë argumente lidhur me ndryshimin e çmimeve në disa zëra në preventiv duke i rritur ato. Referuar preventivit të punimeve totali i fondit limit i rillogaritur nga grupi i auditimit është **3,034,987 lekë pa TVSH (3,641,984 lekë me TVSH)** pra kemi një diferencë prej 34,987 lekë më shumë se vlera e fondit limit të përcaktuar në urdhrin e prokurimit. Preventivi është

firimosur vetëm nga Ing. F. Th., ndërsa proces verbali i hartimit të fondit limit nga të gjithë anëtarët e komisionit të ngritur për këtë qëllim.

**Fondi limit referuar proces verbalit për hartimin e fondit limit i llogaritur nga grupi i auditimit është 2,747,996 lekë pa TVSH, ndërsa vlera e punimeve referuar preventivit të punimeve llogaritur nga grupi i auditimit është 3,034,987 lekë pa TVSH (diferenca 286,991)**

*Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje z. F. Th., znj. E. D., z. N. B.*

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar

**Shkaku:** Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit dhe NJP kanë bërë gabime në llogaritjen e vlerës së fondit limit si dhe nuk kanë dhënë argumente lidhur me ndryshimin e çmimeve në disa zëra në preventiv duke i rritur ato.

**Ndikimi:** Llogaritja e vlerës së fondit limit është e pa saktë dhe e pa argumentuar.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has të marrë masat që Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit dhe NJP të dokumentojë dhe argumentojë për llogaritjen e saktë të vlerës së kontratës.

### **Hartimi i specifikime teknike dhe DT**

Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër nr. 405, datë 11.07.2022 ka ngritur NJP për procedurën e prokurimit me objekt “*Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore*”, me përbërje znj. E. D. (Kryetare-Juriste), znj. E. S. (Anëtare-Ekonomiste) dhe z. A. M. (Anëtar Inxhinier). Komisioni ka për detyrë të hartojë dokumentet e tenderit dhe kriteret e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike.

Në zbatim të urdhrin të sipër cituar më datë 18.07.2022 NJP ka mbajtur procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 40 datë 15.07.2022 ku ka ngarkuar NJP për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt “*Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore*” me vlerë të fondit limit 3,000,000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura janë në përputhje me objektin e kontratës.

### **Vlerësimi i ofertave**

**Titulli i gjetjes 41:** *Kualifikim i operatorëve ekonomikë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.*

**Situata:** Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 409, datë 13.07.2022 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z. P. C. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar).

KVO më datë 01.08.2022 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “*Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore*” me fond limit 3,000,000 lekë pa TVSH. Konstatohet se për këtë procedurë ka aplikuar 1 BOE “H.-G. C.” SHPK dhe “C.” SHPK me vlerë oferte 2,490,953.0 pa TVSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të BOE pjesëmarrës dhe të kualifikuar u konstatua:

Në kontratën e bashkëpunimit OE angazhohen për kryerjen e punimeve në masën 60% nga OE “C.” SHPK dhe 40% nga “H.-G. C.” SHPK.

**Në pikën 2.3.3 të DT kërkohet që,** “*Ofertuesi duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve dhe e stafit të jetë jo me pak se 10 (dhjetë) punonjës për periudhën Janar2021 – Qershor 2021 (6 Muaj të fundit), të vërtetuar nga: Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në periudhën e lartëpërmendur. Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të konfirmuar nga autoriteti përkatës*”.

Nga auditimi rezultoi se OE "H.-G. C." SHPK që do të kryejë 40% të punimeve referuar listë pagesave ka vetëm 3 punonjës (1 Administrator/Arkitekt, 1 Teknik Ndërtimi dhe 1 Shofer) të cilët për muajt Janar-Mars 2022 kanë 0 ditë pune.

OE "H.-G. C." SHPK nuk ka paraqitur asnjë vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore.

**Në pikën 2.3.5 të DT kërkohet që, "Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
3	Kamionçine vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 1.5 -2 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
4	Kamiona mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1

*Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit (i vlefshëm); f) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme), g) licensë e shoqërisë për transport, i) foto ku të evidentohen dhe targat.*

*Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit (i vlefshëm); f) çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme); Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerese/furnizimit (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, qirasë ku të specifikohet objekti i prokurimit në fjalët si dhe afati i saj)".*

Nga auditimi rezultoi se OE "H.-G. C." SHPK në shtojcën nr. 8 ka deklaruar se për këtë procedurë ka mjetin kamioncinë benz me targa MT.A të marrë me qira. Nga auditimi i dokumentacionit të mjetit rezulton që mjete të jetë i llojit autovinç dhe nuk shoqërohet me foto. OE "C." SHPK për mjetet e kërkuara më sipër dhe të deklaruara në shtojcën nr. 8 nuk ka sjellë çertifikatën për transport brenda vëndit.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë dhe në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 92, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" sipas të cilit "2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material...".

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për Vlerësimin e Ofertave me përbërje z. F. Th., z. P. C., z. N. B..*

Në përfundim procedura e prokurimit dhe shpallja e fituesit është miratuar nga Titullari i AK me Vendim nr. 471 datë 15.08.2022.

Me BOE "H.-G. C." SHPK dhe "C." SHPK është lidhur kontrata me nr. 1769 Prot, datë 11.08.2022 me vlerë 2,490,953 lekë pa TVSH dhe 2,989,143 lekë me TVSH me afat 25 ditë nga data e fillimit të punimeve.

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar

**Shkaku:** KVO nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë vlerësimit të ofertave.

**Ndikimi:** Janë kualifikuar OE duke mos plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në DT.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, për të mirë përdorur fondet e

Bashkisë.Gjithashtu, të bëhet argumentimi i saktë i skualifikimit apo kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

**6. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i ambienteve të brendshme, ish shkolla mesme Krume- Kati I-rë (Teknik), në funksion të kopshtit të fëmijëve Qyteti Krumë”.**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i ambienteve të brendshme, ish shkolla mesme Krumë- Kati I-rë (Teknik), në funksion të kopshtit të fëmijëve Qyteti Krumë”.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr. 56, datë 28.09.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. E. D. Kryetare 2. A. M. Anëtar 3. E. S. Anëtare	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër Nr. 589, datë 26.09.2022</b> 1. F. Th. Kryetar 2. P. C. Anëtar 3. N. B. Anëtar
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E Hapur e Thjeshtuar-Punë		
<b>5. Fondi Limit:</b> 4,200,000.0 lekë pa TVSH	<b>6. Oferta fituese</b> "D.-G" SHPK Vlera:4,017,950.0 lekë pa TVSH	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 182,050 lekë pa TVSH
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 10.10.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i Bashkisë Has	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. "D. - G" SHPK 2. "H." SHPK
<b>11. Ankimime AK</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> datë 31.10.2022	<b>15. Vlera e kontratës</b> 4,821,540.0 lekë me TVSH	

**Kërkesa për realizim e procedurës së prokurimit**

Kërkesa për këtë procedurë prokurimi është bërë nga Zv, Kryetari i Bashkisë.

**Llogaritja e fondit limit**

**Titulli i gjetjes 42:** *Nuk është argumentuar dhe dokumentuar për llogaritja e vlerës së kontratës /fondit limit.*

**Situata:** Me Urdhrin nr. 587 datë 23.09.2022 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje F. Th. (Zv.Kryetar), E. D. (Juriste), N. B. (Përgj. Sektori i Urbanistikës) i cili ka për detyrë hartimin e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e fondit limit.

Më datë 23.09.2022 komisioni ka mbajtur proces verbalin e për llogaritjen e fondit limit me vlerë totale 4,200,000 lekë pa TVSH (5,040,000 lekë me TVSH).

Kërkesa për prokurim është miratuar nga titullari i AK ku është ngarkuar NJP të fillojë procedurën.

Nga auditimi i hartimit të fondit limit sipas zërave të punimeve rezulton se çmimet për 13 zëra punimesh janë më të ulta se vlerat përcaktuara në manualin e çmimeve dhe nuk është bërë argumentimi për këtë fakt si dhe nëse çmimi më i ulët ndikon në cilësinë e zërave të punimeve apo jo.

Gjithashtu, nga verifikimi i çmimeve të preventivit të administruar në dosje, rezulton se 21 zëra të preventivit me vlerë **1,488,884 lekë**, janë të shënuar “an” dhe nuk janë shoqëruar me analiza çmimi, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 76, pika 2 “Për llogaritja e vlerës limit të kontratës”, sipas të cilit “...Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë për llogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet...”.

*Për sa më sipër ngarkohet më përgjegjësi Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje z. F. Th., znj. E. D., z. N. B..*

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar.

**Shkaku:** Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit nuk ka dokumentuar llogaritjen e vlerës për 34 zëra punimesh.

**Ndikimi:** Llogaritja e vlerës së fondit limit është e pa argumentuar.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has të marrë masat që Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit të dokumentojë dhe argumentojë për llogaritjen e vlerës së kontratës.

### **Hartimi i specifikime teknike dhe DT**

**Titulli i gjetjes 43:** *Mos argumentim i kriterëve të vendosura për kualifikimin e operatorëve.*

**Situata:** Titullari i Autoritetit Kontraktor ka ngritur NJP për procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruksion i ambienteve të brendshme, ish shkolla mesme Krume- Kati I-rë (Teknik), në funksion të kopshtit të fëmijëve Qyteti Krumë*”, me përbërje znj. E. D. (Kryetare-Juriste), z. A. M. (Anëtar-Përgj. Sektori i Rrugëve Rurale) dhe znj. E. S. (Anëtare-Financiere). Komisioni ka për detyrë të hartojë dokumentet e tenderit dhe kriteret e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike.

Në zbatim të urdhrin të sipër cituar më datë 26.09.2022 NJP ka mbajtur procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 56 datë 28.09.2022 ku ka ngarkuar NJP për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruksion i ambienteve të brendshme, ish shkolla mesme Krume- Kati I-rë (Teknik), në funksion të kopshtit të fëmijëve Qyteti Krumë*” me vlerë të fondit limit 4,200,000 lekë pa TVSH, nga të cilat 50% financim i vitit 2022 dhe 50% financim i vitit 2023.

Nga auditimi rezulton se në DT mungojnë Specifikimet Teknike, në përmbushje të përcaktimeve të pikës 3/a, të nenit 15, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Informacioni specifik për kontratat e punëve përfshin të paktën:*

- *projektin dhe specifikimet;*
- *preventivin e hollësishëm dhe kostot;*
- *grafikun e zbatimit;*
- *kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit”.*

AK duhet të plotësojë dokumentet, me të dhënat e nevojshme të cilat do t’i shërbejnë ofertuesve për të hartuar një ofertë të përgjegjshme.

Kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me pikën 1, të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, dhe nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cenuar kështu edhe përcaktimet e nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Në Pikën 2.3.4 të DT është kërkuar: “*Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:*

a. *Për realizimin e kontratës operatori duhet të ketë të punësuar dhe stafin teknik të mëposhtëm: Inxhinier Ndërtim ose Gjeodet ose Hidroteknik 1 (një) person; Teknikë ndërtimi të paktën 1 (një) person të cilët duhet të figurojnë në listë pagesat e kompanisë si të tillë të paktën 3 muajt Qershor-Gusht 2022. (të shoqëruar me kontratë pune të noterizuar, Diplomë dhe CV, Librezë Pune):*

b. *Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i Shoqërisë) Drejtuesin/(t) Teknik të punimeve në objekt dhe të deklarojë se ai/ata do të jetë/jenë*

*i/të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:*

*i. Diplomë +CV*

*ii. Kontratë pune të noterizuar, të vlefshme deri në përfundimin e kontratës”.*

Kërkesa për paraqitjen e kontratës individuale të punës të noterizuar për punonjësit e kërkuar, nuk mbështetet në përcaktimet e Kodit të Punës neni 21.

Kërkesa për drejtuesin teknik të punimeve të pranishëm gjatë gjithë kohës në objekt është në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu I, Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit, Pika 2.1, ku citohet se: “*Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rasti, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi”.*

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, ligjit nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 77, pika 1, “Kërkesat për kualifikim...Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”, VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 39, pika 4 “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

*Për veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NJPNJP znj. E. D., z. A. M. dhe znj. E. S..*

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar

**Shkaku:** NJP nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë hartimit të kriterëve për kualifikim.

**Ndikimi:** Aplikimi i kriterëve jo të mirë argumentuara dhe jo në përputhje me procedurën e zhvilluar, janë veprime të cilat direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedure.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** AK në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifitime teknike që janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar.

## **Vlerësimi i ofertave**

**Titulli i gjetjes 44:** *Kualifikim i operatorëve ekonomikë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.*

**Situata:** Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 589, datë 26.09.2022 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z. P. C. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar).

KVO më datë 10.10.2022 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “*Rikonstruksion i ambienteve të brendshme, ish shkolla mesme Krume-Kati I-rë (Teknik), në funksion të kopshtit të fëmijëve Qyteti Krumë*” 4,200,000 lekë pa TVSH. Konstatohet se për këtë procedurë kanë aplikuar 2 operatorë ekonomikë:

1. “D.-G” SHPK, NIPT: L.H, me vlerë oferte **4,017,950 lekë pa TVSH.**

2. “H.” SHPK, NIPT: J.G, me vlerë oferte **4,871,250 lekë pa TVSH.**

Në vijim janë hartuar proces verbalet përkatëse si dhe më datë 12.10.2022 proces verbali përfundimtar ku është bërë dhe klasifikimi i OE, sipas ofertës ekonomike më të vogël.

Raporti përfundimtar i vlerësimit të ofertave është hartuar më datë 25.10.2022 ku është kualifikuar OE “D.-G” SHPK, me vlerë oferte 4,017,950.0 lekë pa TVSH. Ndërsa OE “H.” SHPK, me vlerë oferte 4,871,250.0 lekë pa TVSH është skualifikuar nga KVO me argumentimin se nuk ka sjellë të gjitha dokumentet e kërkuara në DT.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës, u konstatua se OE “D.-G” SHPK, nuk plotëson të gjitha kriteret e DT, konkretisht: Nuk plotëson kriteret e pikës 2.2.3. ku kërkohet: “Vërtetim të lëshuar nga autoritetet lokale (ku operatori ka selinë dhe aktivitetin sipas QKB) për shlyerjen e detyrimeve taksave-tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2020, 2021,2022) në vendet ku ka ushtruar aktivitet sipas Ekstraktit...”.

Gjatë viteve 2020, 2021 e 2022 OE “D.-G” SHPK, ka ushtruar aktivitet edhe në NjQV por nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore si vijon:

- Gjatë vitit 2020 OE “D.-G” SHPK, ka ushtruar aktivitet në bashkitë: Lezhë, Kavajë, Tiranë, Durrës, Vlorë e Lezhë dhe nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave vendore.

- Gjatë vitit 2021 OE “D.-G” SHPK, ka ushtruar aktivitet në bashkitë: Tiranë, Gramsh, Durrës, Krujë, Kavajë, Elbasan, Lezhë, Roskovec e Vlorë, dhe nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave vendore.

- Gjatë vitit 2022 OE “D.-G” SHPK, ka ushtruar aktivitet në: Bashkitë: Fier, Kuçovë, Lezhë, Tiranë, Librazhd, Vlorë, Krujë, Kavajë e Gramsh, dhe nuk ka paraqitur vërtetime për shlyerjen e taksave vendore.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë dhe në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82, pika 2 “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material...”.

*Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët KVO-së: z. F. Th., z. P. C. e z. N. B.*

Në përfundim procedura e prokurimit dhe shpallja e fituesit është miratuar nga Titullari i AK me Vendim nr. 748 datë 15.11.2022.

Me OE “D.-G” SHPK është lidhur kontrata me nr. 2334 Prot, datë 31.10.2022 me vlerë 4,017,950 lekë pa TVSH dhe 4,821,540 lekë me TVSH me afat 45 ditë nga data e fillimit të punimeve.

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar

**Shkaku:** KVO nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë vlerësimit të ofertave.

**Ndikimi:** Janë kualifikuar OE duke mos plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në DT.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë. Gjithashtu, të bëhet argumentimi i saktë i skualifikimit apo kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

## **7. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje Automjet Teknologjik (kamion) për Grumbullim-Kompaktim-Shkarkim të mbeturinave”, viti 2022.**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje Automjet Teknologjik (kamion) për Grumbullim-Kompaktim-Shkarkim të mbeturinave dhe konteniere (kosha) të përshtatshëm 1.1m <sup>3</sup> për grumbullimin e mbeturinave, për Bashkinë Has”.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.12, datë 04.03.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1.E. D. Kryetare	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-Urdhër Nr. 146, datë 09.03.2022:</b>



<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E Hapur e Thjeshtuar-Mallra;	2.E. S. Anëtare 3.K. L. Anëtar	1. F. Th. Kryetar 2. P. C. Anëtar 3. N. B. Anëtar
<b>5. Fondi Limit</b> 10,000,000 lekë pa TVSH	<b>6. Oferta fituese</b> "T..." SHPK, me vlerë 9,729,540.0 lekë pa TVSH	<b>7. Diferenca me fondin limit</b> 270,460.0 lekë pa TVSH
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 11.04.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Grandi Japonez (84.28% e vlerës plotë me TVSH) dhe Buxheti i Bashkisë Has (15.72% e vlerës plotë me TVSH).	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> 1. "T." SHPK 2. "L. - 2007" SHPK
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës datë 16.05.2022</b>	<b>15. Vlera e kontratës me TVSH</b> 11,675,448.0 lekë.	

### **Kërkesa për realizim e procedurës së prokurimit**

Kërkesa për këtë procedurë prokurimi është bërë nga Sektori i Shërbimeve dhe Njësia Administrative Golaj.

### **Llogaritja e fondit limit**

**Titulli i gjetjes 45:** *Nuk është argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritja e vlerës së kontratës.*

**Situata:** Me Urdhrin nr. 129 datë 02.03.2022 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje F. Th. (Zv.Kryetar), K. L. (Ing.Mekanik), B. M. (Përgj. Sektori i Shërbimeve Komunale) i cili ka për detyrë hartimin e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e fondit limit.

Më datë 03.03.2022 komisioni ka mbajtur proces verbalin për llogaritjen e fondit limit, me vlerë totale 10,000,000 lekë pa TVSH (12,000,000 lekë me TVSH).

Kërkesa për prokurim është miratuar nga titullari i AK më datë 03.03.2022 ku është ngarkuar NJP të fillojë procedurën.

Nga auditimi i hartimit të fondit limit rezulton se komisioni nuk ka argumentuar vlerat e parashikuara për blerjen e automjetit dhe të konteinerëve. Konstatohet se hartimi i fondit limit nuk është shoqëruar me analiza çmimi apo me testim të tregut, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 76, pika 2 "Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës", sipas të cilit "....Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet...".

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje z. F. Th., z. K. L., z. B. M.*

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar

**Shkaku:** Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit nuk ka dokumentuar llogaritjen e vlerës së fondit limit.

**Ndikimi:** Llogaritja e vlerës së fondit limit është e pa argumentuar.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has të marrë masat që Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit të dokumentojë dhe argumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës.

## **Hartimi i specifikime teknike dhe DT**

Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër nr. 12, datë 04.03.2022 ka ngritur NJP për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje Automjet Teknologjik (kamion) për Grumbullim-Kompaktim-Shkarkim të mbeturinave*”, me përbërje znj. E. D. (Kryetare-Juriste), z. K. L. (Anëtar-Ing.Mekanik) dhe znj. E. S. (Anëtare-Ekonomiste). Komisioni ka për detyrë të hartojë dokumentet e tenderit dhe kriteret e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike.

Në zbatim të urdhrin të sipër cituar më datë 03.03.2022 NJP ka mbajtur procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 12 datë 04.03.2022 ku ka ngarkuar NJP për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje Automjet Teknologjik (kamion) për Grumbullim-Kompaktim-Shkarkim të mbeturinave*” me vlerë të fondit limit 10,000,000 lekë pa TVSH. Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura janë në përputhje me objektin e kontratës.

## **Vlerësimi i ofertave**

**Titulli i gjetjes 46:** *Kualifikim i operatorëve ekonomikë në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.*

**Situata:** Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 146, datë 09.03.2022 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z, P. C. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar).

KVO më datë 11.04.2022 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje Automjet Teknologjik (kamion) për Grumbullim-Kompaktim-Shkarkim të mbeturinave*” me fond limit 10,000,000 lekë pa TVSH. Konstatohet se për këtë procedurë kanë aplikuar 2 operatorë ekonomik:

1. “T.” SHPK, NIPT: M.U, me vlerë oferte **9,729,540 lekë pa TVSH.**

2. “L. 2007” SHPK, NIPT: K.L, me vlerë oferte **9,850,000 lekë pa TVSH.**

Në vijim janë hartuar proces verbalet përkatëse si dhe më datë 15.04.2022 proces verbali përfundimtar ku është bërë dhe klasifikimi i OE, nuk ka OE të skualifikuar dhe kualifikimi bëhet sipas ofertës ekonomike më të vogël.

Raporti përfundimtar i vlerësimit të ofertave është hartuar më datë 18.04.2022 ku është kualifikuar OE “T.” SHPK, me vlerë oferte 9,729,540.0 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës dhe të kualifikuar u konstatua se OE “T.” SHPK, nuk plotëson të gjitha kriteret e DT, konkretisht:

- **Pikën 2.2.2 të DT** “*OE duhet të paraqesin bilancet vjetore, kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2019, 2020 të paraqitur në autoritetet përkatëse dhe të konfirmuara nga ky autoritet, me nënshkrim dhe vulë. Si dhe raportin e auditimit të pavarur.....kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në të dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”.

- **Pikën 2.2.3 të DT** “*OE duhet të paraqesin një dokument që vërteton se subjekti ofertues ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2018, 2019, 2020... referuar ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatorit ekonomik lëshuar nga QKB*”. Mungojnë vërtetimet e pagesës së taksave dhe tarifave vendore për bashkitë Kukës, Mirditë, Përmet, Roskovec, Përmet, Belsh, Elbasan, Tropojë, Lushnje, Lezhë, Mat e Krujë.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë dhe në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 92, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” sipas të cilit “2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson

ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material...”.

Për veprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi KVO me përbërje z. F. Th., z. P. C., z. N. B..

Në përfundim procedura e prokurimit dhe shpallja e fituesit është miratuar nga Titullari i AK me Vendim nr. 267 datë 16.05.2022.

Me OE “T.” SHPK është lidhur kontrata me nr. 1061 Prot, datë 12.05.2022 me vlerë 9,729,540 lekë pa TVSH dhe 11,675,448 lekë me TVSH me afat 30 ditë.

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar.

**Shkaku:** KVO nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë vlerësimit të ofertave.

**Ndikimi:** Janë kualifikuar OE duke mos plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në DT.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë. Gjithashtu, të bëhet argumentimi i saktë i skualifikimit apo kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

## 8. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje karburanti për nevoja të mjeteve motorikë dhe ngrohjen e shkollave të Bashkisë Has gjatë vitit 2022”.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje karburanti për nevoja të mjeteve motorike dhe ngrohjen e shkollave të Bashkisë Has gjatë vitit 2022”.		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> Nr.02, datë 27.01.2022	<b>2. Njësia e Prokurimit:</b> 1. E. D. Kryetare 2. E. S. Anëtare 3. E. L. Anëtare	<b>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave-</b> Urdhër Nr. 34, datë 19.01.2022: 1. F. Th. Kryetar 2. P. C. Anëtar 3. N. B. Anëtar
<b>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:</b> E Hapur e Thjeshtuar-Mallra		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 6,100,000 lekë	<b>6. Oferta fituese</b> “V. P.” SHPK, me vlerë 6,099,600 lekë pa TVSh	<b>7. Diferenca me fondin limit</b>
<b>8. Data e hapjes së ofertave:</b> 25.02.2022	<b>9. Burimi Financimit:</b> Buxheti i bashkisë	<b>10. Operatorët Ekonomikë</b> “V.P.” SHPK
<b>11. Ankimime AK,</b> Nuk ka	<b>12. Përgjigje ankesës nga AK,</b> Nuk ka	<b>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,</b> Nuk ka
<b>b. Kontrata</b>		
<b>14. Lidhja e kontratës (datë)</b> 23.03.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 7.319.520 lekë	

### Kërkesa për realizim e procedurës së prokurimit

Kërkesa për këtë procedurë prokurimi është bërë nga Sektori i Shërbimeve

### Llogaritja e fondit limit

Me Urdhrin nr. 42 datë 24.01.2022 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit me përbërje F. Th. (Zv. Kryetar), E. D. (Juriste), B. M. (Përgj. Sektori i Shërbimeve) i cili ka për detyrë hartimin e specifikimeve teknike dhe vlerësimin e fondit limit.

Më datë 25.01.2022 komisioni ka mbajtur proces verbalin e për llogaritjen e fondit limit me vlerë 6,100,000 lekë pa TVSH (42,272 litra). Llogaritja e fondit limit është bërë referuar çmimeve në bursë.

Kërkesa për prokurim është miratuar nga titullari i AK më datë 25.01.2022 ku është ngarkuar NJP të fillojë procedurën.

### **Hartimi i specifikime teknike dhe DT**

Titullari i Autoritetit Kontraktor me Urdhër nr. 34, datë 19.01.2022 ka ngritur NJP për procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje karburanti për nevoja të mjeteve motorikë dhe ngrohjen e shkollave të Bashkisë Has gjatë vitit 2022”*, me përbërje znj. E. D. (Kryetare-Juriste), znj. E. L. (Anëtare-Juriste) dhe znj. E. S. (Anëtare-Ekonomiste). Komisioni ka për detyrë të hartojë dokumentet e tenderit dhe kriteret e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike.

Në zbatim të urdhrin të sipër cituar më datë 27.01.2022 NJP ka mbajtur procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim.

Për zhvillimin e procedurës Titullari i AK ka nxjerrë urdhrin e prokurimit nr. 02 datë 27.01.2022 ku ka ngarkuar NJP për të vijuar me procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje karburanti për nevoja të mjeteve motorikë dhe ngrohjen e shkollave të Bashkisë Has gjatë vitit 2022”* me vlerë të fondit limit 6,100,000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi rezulton se kriteret e vendosura janë në përputhje me objektin e kontratës.

### **Vlerësimi i ofertave**

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 35, datë 27.01.2022 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. F. Th. (Kryetar), z. P. C. (Anëtar) dhe z. N. B. (Anëtar).

KVO më datë 25.02.2022 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e ofertave për procedurën e prokurimit me objekt *“Blerje karburanti për nevoja të mjeteve motorikë dhe ngrohjen e shkollave të Bashkisë Has gjatë vitit 2022”* me fond limit 6,100,000 lekë pa TVSH. Konstatohet se për këtë procedurë ka aplikuar 1 operator ekonomik, “V.P.” SHPK, NIPT: K.K, me vlerë oferte marxh fitimi 14.0%, ose në vlerë absolute 14.00 lekë/litër pa TVSH. Në vijim janë hartuar proces verbalet përkatëse si dhe më datë 01.03.2022 proces verbalin përfundimtar ku është bërë dhe klasifikimi i OE, nuk ka OE të skualifikuar.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të OE pjesëmarrës dhe të kualifikuar nuk u konstatuan parregullsi. U konstatua se OE i kualifikuar dhe shpallur fitues përmbush kriteret e vendosura në DT.

Në përfundim procedura e prokurimit dhe shpallja e fituesit është miratuar nga Titullari i AK me Vendim nr. 167 datë 23.03.2022.

Me OE “V. P.” SHPK është lidhur kontrata me nr. 630 Prot, datë 23.03.2022 me vlerë 6,099,600 lekë pa TVSH dhe 7,319,520 lekë me TVSH.

**Titulli i gjetjes 47:** *Mbi protokollimin e dokumenteve të brendshme në Bashkinë Has dhe arkivimin e dosjeve të prokurimit.*

**Situata:** Në të gjitha dosjet e audituara në Bashkinë Has vihet re se të gjitha shkresat që ndodhen në dosjet e prokurimit proces verbale, urdhra të Kryetarit për ngritjen e NJP, KVO, Vendime të Kryetarit etj, nuk kanë numër protokolli. Bashkia Has i regjistron urdhrat dhe vendimet në një regjistër elektronik që administrohet nga Zv/Kryetari i Bashkisë, ndërsa punonjësja e protokoll-arkivës nuk ka asnjë informacion lidhur me këto urdhra dhe vendime. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e:

- Vendimin nr. 4, datë 19.06.2017 *“Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë”* neni 4 Dokumentet administrative pika 1, *“Titullari i institucionit fond krijues miraton me urdhër të brendshëm, të përpiluar nga sekretaria, sekretari-arkivi apo punonjësi i ngarkuar me urdhër të titullarit me punët me dokumentet, modelin e njësuar të dokumentit administrativ në Republikën e*

Shqipërisë, bazuar në nenet 12 dhe 13 e në vijim të Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. Pika 2, Urdhri duhet të jetë në përputhje me shtojcën nr. 1, që është pjesë e kësaj rregulloreje”.

- Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 12, neni 13, neni 19, “Të gjitha dokumentet që krijohen nga subjekti shtetëror apo joshetëror si dhe ato që vijnë nga subjekte të tjera, evidencohen në regjistrin e korrespondencës (Mod. 1). Në të regjistrohen të gjitha dokumentet që krijohen apo që vijnë në organin shtetëror e joshetëror.”

Konkretisht modeli nr. 3 për dokumentet e brendshme, si urdhra apo vendime, përcakton qartë që urdhri apo vendimi i brendshëm merr numër protokolli në regjistrin e korrespondencës si dhe numrin e aktit në rastin konkret urdhër apo vendim i brendshëm.

Referuar nenit 18 të Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 të sipër cituar të gjitha autoritetet publike duhet të zbatojnë përcaktimet e kësaj rregulloreje.

#### Mbi arkivimin e dosjeve

Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimit u evidentua se për asnjë dosje nuk është bërë inventarizimi dhe arkivimi, veprime këto në kundërshtim me kuadrin rregullator për arkivat dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor.

*Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi z. L. M. në cilësinë e Titullarit të Bashkisë Has, z. F. Th. në cilësinë e Zv/Kryetarit.*

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipër cituar

**Shkaku:** Mos zbatim i kuadrit ligjor për protokollimin e shkresave të brendshme dhe për arkivimin e dosjeve.

**Ndikimi:** Mos protokollimi i akteve të brendshme dhe mos arkivimi i dosjeve lë hapësira për abuzime.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has të marrë masa të menjëhershme që shkresat e brendshme si urdhri apo vendimi etj të regjistrohen në regjistrin e korrespondencës si dhe të marrin numër protokolli dhe numrin e aktit në rastin konkret urdhër apo vendim i brendshëm. Gjithashtu, të marrë masa për arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të përfunduara dhe dosjeve që do të mbyllen në vijimësi.

## 2.5 Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

Bashkia Has ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 15.04.2021.

### **Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2022**

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Has, gjatë periudhës 01.01.2021 deri më 31.12.2022, janë zhvilluar aplikimet dhe miratimet për lejet e ndërtimit të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2022 nga sistemi e-Leje			
Nr.	Përshkrimi i lejes	Numri i aplikimeve	Numri i lejeve të miratuara
1	Certifikatë përdorimi	8	7
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	3	3
3	Leje infrastrukture	-	-
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	6	6

5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	2	2
6	Leje për ndryshim funksioni	-	-
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	-	-
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	-	-
9	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	2	2
10	Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	-	-
11	Leje zhvillimi	9	9
12	Njoftim për fillim punimesh	7	7
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	-	-
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	2	2
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	2	2
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	2	2
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	-	-

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Has, janë miratuar **14 leje ndërtimi**, ndër të cilat leje për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **2 leje**, leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **2 leje**, leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **6 leje**, ndërsa leje për shtesë në ndërtimin ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup> janë miratuar **2 leje** ndërtimi dhe **2 leje** ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet përmbledhja elistës së lejeve të ndërtimit të miratuara nga Bashkia Has, për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2022 :

Nr.	Vendimi Leje ndërtimi	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Aplikanti	Zhvilluesi	Sipërfaqe totale ndërtimi	Preventivi Sipas subjektit
1	Vendim Nr.13, datë 09/03/2021	Magazinë bujqësore 2 kat dhe rrethim prone	B. Sh.	K.-2013	382.5 m2	676,894.00
2	Vendim Nr. 25, datë 28/03/2022	Lokal 2 kat+Podrum	E.M	D.H.	1654.3 m2	52,791,719.00
3	Vendim Nr. 26, datë 20/05/2022	Shtëpi Banimi 2kat në 1kat ekzistues	Dh. P.	Q. P.	417.40 m2	9,672,306.00
4	Vendim Nr. 20, datë 07/09/2021	Shtëpi Banimi 2kat me papafingo	T. C.	V. M.	195.00 m2	5,605,472.00
5	Vendim Nr. 27, datë 09/06/2022	Shtëpi Banimi 2 kat	T. C.	P. B.	232.00m2	5,684,000.00
6	Vendim Nr. 19, datë 26/08/2021	Shtëpi Banimi 2kat me papafingo	T. C.	S. S.	240.00,m2	6,958,450.00
7	Vendim Nr. 23 , datë 16/03/2022	“Ambjente shërbimi, punime dhe infrastrukture mbështetëse për pemtoren me arra”	K.P.	K. N.	174.28 m2	32,318,252.11

8	Vendim Nr. 24 , datë 16/03/2022	Ambjente shërbimi, punime dhe infrastrukture mbështetese për pemtoren me arra” (Depozita e Ujit dhe Hangari i Makinerive)	K.P.	K. N.	95.00 m2	3,624,512.28
9	Vendim Nr. 15, datë 19/03/2021	Shtesë strukture banimi me objekt 4 kat	A.-V.	Sh. M.	160.00m2	6,554,035.00
10	Vendim Nr. 17, datë 30/04/2021	Rikonstruksion dhe shtesë 1 kat mbi 2 kate ekzistuese	A.K.	G. D.	198.00,m2	3,205,970.00
11	Vendim Nr. 16 , datë 15/04/2021	Rikonstruksion i objektit dhe shtesë në objekt ekzistues	A.-V.	S. K.	182.60 m2	5,461,695.60
12	Vendim Nr. 22, datë 14/12/2021	Shtëpi banimi 1kat	A.M.	A.D.	63.50 m2	1,676,492.00
13	Vendim Nr. 14, datë 16/03/2021	Strukturë në funksion të prodhimit, përpunimit dhe distribucionit të produkteve bujqësore dhe blegtorale"	U.H.	R. T.	100.00 m2	5,433,427.00
14	Vendim Nr. 18, datë 26/08/2021	Shtesë anësore dhe 2- kat në lartësi në ndërtim ekzistues	T. C.	A. Sh.	467.43 m2	15,389,185.00

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar rastet e mëposhtme të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 m<sup>2</sup>:

Nr	Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Aplikanti	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi	Preventivi Sipas subjektit
1	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	Lokal 2 kat + podrum	E.M	D.H.	Nr. 25, datë 28/03/2022	52,791,719.00
2	Leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 m <sup>2</sup>	“Ambjente shërbimi, punime dhe infrastrukture mbështetese për pemtoren me arra”	K.P	K. C. 2020	Nr. 23 , datë 16/03/2022	32,318,252.11
3	Leje ndërtim për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	Shtesë anësore dhe 2kat në lartësi në ndërtim ekzistues	T. Ç.	A. Sh.	Nr. 18, datë 26/08/2021	18,480,000
4	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtimin ekzistues, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	Projektzbatimi për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues”	Dh. P.	Q. P.	Nr. 26, datë 20/05/2022	9,672,306

5	Leje ndërtimi per ndertim te ri,me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	Objekt banimi 2-katësh me papafingo	T. Ç.	S. S.	Nr. 19, datë 26/08/2021	8,350,139
---	---	-------------------------------------	-------	-------	-------------------------	-----------

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek e cila nuk pasqyrohej dokumentacioni i plotë i pronësisë për të gjithë sipërfaqen që do të zhvillohet, në përputhje me dokumentacionin e paraqitur në lejen e zhvillimit dhe me planvendosjen e miratuar.

**Titulli i gjetjes 48:** *Mospasqyrimi i plotë i dokumentacionit të pronësisë në aplikimin për leje ndërtimi, në përputhje me aplikimin për lejen e zhvillimit dhe me planvendosjen e miratuar.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se dokumentacioni i pronësisë ngarkuar në sistem për aplikimin e lejes së ndërtimit nuk ishte i plotë dhe në përputhje me lejen e zhvillimit dhe me planvendosjen e miratuar. Gjetja e cila u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratua për leje ndërtimi, me objekt: "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D. H. ShPK dhe aplikues E.M, në fshatin "Vranisht", Has. Në dokumentacionin e pronësisë të paraqitur në aplikimin për leje ndërtimi, sipërfaqja e truallit që do të zhvillohet objekti është 1200 m<sup>2</sup>, të vërtetuar me Certifikatë Pronësie. Në planvendosjen e miratuar, në pozicionin kadastral dhe në skemën e vendosjes së truallit të ndërtimit, sipërfaqja e paraqitur nuk përputhet me sipërfaqen e truallit për të cilin po aplikojnë për leje ndërtimi, por është më e madhe se 1200 m<sup>2</sup>. Në lejen e zhvillimit është ngarkuar dokumentacioni i pronësisë për një sipërfaqë prej 8273.00 m<sup>2</sup>, me llojin e pasurisë arë. Ndërsa në lejen e ndërtimit është aplikuar vetëm për një pjesë të sipërfaqes, prej 1200 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e konvertuar në truall. Ndonëse zhvilluesi ka dokumentacion pronësie për të gjithë sipërfaqen që do të zhvillojë ndërtimin, nuk e ka ngarkuar në sistemin e-leje dhe nuk e ka pasqyruar te plotë në aplikimin për leje ndërtimi, por ka pasqyruar vetëm sipërfaqen që ka konvertuar nga statusi arë, në statusin truall.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: VKM 408, Neni 15, Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi, pika 1.b) Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;

**Ndikimi:** Mospasqyrimi i plotë i dokumentacionit të pronësisë në aplikimin për leje ndërtimi, ndikon në mosrespektimin e kritereve, kondicioneve urbane të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Has.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë përpara miratimit të lejes së ndërtimit, në përputhje me lejen e zhvillimit dhe planvendosjen e propozuar. Për zhvillimin e ndërtimeve, të aplikohet për leje ndërtimi duke ngarkuar në sistemin e-leje dokumentacionin e pronësisë që përfshin të gjithë sipërfaqen e pasurisë në të cilën do të zhvillohet objekti, në përputhje me planvendosjen dhe të dhënat e treguesve të zhvillimit.

*Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi: Z.L. M., me detyrë Kryetari i Bashkisë Has; Z.N. B., përgjegjës i sektorit të urbanistikës, rregullimit të territorit, e pronave, të Bashkisë Has, nga data 19.05.2014 e në vijim.; Z.A. U., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim; Z.B. H., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim..*



Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat nuk ishte konvertuar statusi i pronësisë nga tokë "arë" në tokë "truall", për të gjithë sipërfaqen e parcelës që do të zhvillohej ndërtimi, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Titulli i gjetjes 49:** *Moskonvertimi i statusit të pronësisë nga tokë "arë" në tokë "truall", për të gjithë sipërfaqen e parcelës që do të zhvillohej ndërtimi, përpara miratimit të lejes së ndërtimit e në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe legjislacionin në fuqi.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se statusi nga tokë arë në tokë truall nuk është konvertuar për të gjithë sipërfaqen e parcelës që do të zhvillohet ndërtimi, por vetëm sipërfaqja e gjurmës së objektit, gjetje e cila u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

- "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H. ShPK dhe aplikues E.M, në fshatin "Vranisht", Has. Nga aplikimi i lejes së zhvillimit në aplikimin e lejes së ndërtimit nuk është konvertuar e gjithë sipërfaqja e pronësisë në truall, por vetëm sipërfaqja e gjurmës së objektit.

- "Objekt Banimi 2-katesh me papafingo", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has. Nga aplikimi i lejes së zhvillimit në aplikimin e lejes së ndërtimit nuk është konvertuar e gjithë sipërfaqja e pronësisë në truall, por vetëm sipërfaqja e gjurmës së objektit.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon: **Vendim Nr. 440, datë 3.6.2020, pika 6** përcakton se: "1. Për kalimet dhe ndryshimet e kategorive të resurseve, të miratuara sipas rastit me akte ligjore apo nënligjore, me planet e detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planet e përgjithshme vendore dhe planet e detajuara vendore dhe mbështetur në to, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, e qarkut, ZMMT-ja në bashki, si dhe Drejtoria Rajonale Pyjore bëjnë përditësimin në dokumentacionin kadastral përkatës."

**Ndikimi:** Moskonvertimi i të gjithë sipërfaqes së parcelës nga "arë" në "truall", ndikon në mosrespektimin dhe zhvillimin e territorit në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor, si edhe cënimin dhe dëmtimin e tokës bujqësore nga ndërtimet.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Has

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar statusin e pronësisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e njësisë përkatëse dhe konvertimin e të gjithë sipërfaqës së pasurisë në truall për të vijuar më tej me zhvillimin e ndërtimit.

*Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi: Z.L. M., me detyrë Kryetari i Bashkisë Has: Z.N. B., përgjegjës i sektorit të urbanistikës, rregullimit të territorit, e pronave, të Bashkisë Has, nga data 19.05.2014 e në vijim.; Z.A. U., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim: Z. B. H., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim.*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 4 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensitetit të ndërtimit, lartësia e ndërtimit, të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit.

**Titulli i gjetjes 50:** Mosrespektimi i kushteve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 15.04.2021 dhe Planit të Detajuar Vendor.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se nuk respektohen të gjitha kushtet në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar. Gjetja e konstatuar në lejen e ndërtimit të të miratur me objekt :

1-Gjetja e konstatuar në lejen e ndërtimit të të miratur me objekt: "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H.ShPK dhe aplikues E.M., në fshatin "Vranisht", Has. Duke u bazuar në PPV Has, zona bën pjesë në njësinë strukturore HS\_UB\_S1\_4/1 dhe duhet të plotësojë kondicionet e mëposhtme:

Intensiteti i ndërtimit I=1.2

Koeficienti i shfrytëzimit të territorit KShT= 50 %

Nga verifikimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e treguesve të zhvillimit, rezulton që koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 92 % nga 50 % që është e lejuar në planin e përgjithshëm vendor. Ndërsa intensiteti i ndërtimit është 1.38 nga intensiteti 1.2 i lejuar në zonë.

2-Gjetja e konstatuar në lejen e ndërtimit të të miratur me objekt: Gjetja e konstatuar në lejen e ndërtimit të të miratur me objekt: "Shtesë anësore dhe 2-kat në lartësi në ndërtimin ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç., Krumë ,Has. Duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Has dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 15.04.2021, zona bën pjesë në njësinë strukturore HS\_UB\_S1\_9/1 dhe duhet të plotësojë kondicionet e mëposhtme:

-Kategoria e përdorimit\_Shërbime 100%

-Intensiteti i ndërtimit I=1

-Koeficienti i shfrytëzimit të territorit KShT= 50%

-Numri i kateve\_3 kate

-Lartësia në metra\_11.2 metra

Nga verifikimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e treguesve të zhvillimit, rezulton që koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 78 % nga 50 % që është e lejuar në planin e përgjithshëm vendor. Ndërsa intensiteti i ndërtimit është 1.3 nga intensiteti 1 i lejuar në zonë.

Lartësia maksimale e lejuar e strukturës është 11.2 metra, ndërsa objekti ka lartësinë e 13.9 metra, jo në përputhje me VKM-në 408 dhe me PPV të Bashkisë Has.

3-Gjetja e konstatuar në lejen e ndërtimit të të miratur me objekt: "Projekt zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 26, datë 20/05/2022, me zhvillues Q. P. dhe aplikues Dh. P., Rruga e Kukësit, Has.

Duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Has dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 15.04.2021, zona bën pjesë në njësinë strukturore HS\_UB\_A1\_1/22 dhe duhet të plotësojë kondicionet e mëposhtme:

-PDV\_Po

-Kategoria e përdorimit\_A banim 100%

-Intensiteti i ndërtimit I=1

-Koeficienti i shfrytëzimit të territorit KShT= 50%

-Numri i kateve\_3 kate

-Lartësia në metra\_11.2 metra

Në bazë të PPV të Bashkisë Has, në zonë është parashikuar zhvillimi i saj me Plan të Detajuar Vendor PDV dhe nuk mund të miratohen leje ndërtimi pa paraqitur dhe pa u miratuar një plan i detajuar vendor. Të lejuar janë vetëm punime të cilat nuk kanë nevojë për leje ndërtimit. Objekti nuk bën pjesë në rastet e punimeve në të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe ose i nevojshëm, duke ju referuar Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, pika 4.13. Por edhe nga verifikimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e treguesve të zhvillimit, rezulton që kondicionet urbane nuk janë respektuar, pasi koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 59

% nga 50 % që është e lejuar në planin e përgjithshëm vendor. Ndërsa intensiteti i ndërtimit është 1.97 nga intensiteti 1 i lejuar në zonë, me sipërfaqe totale ndërtimi 417.4 m<sup>2</sup>.

Gjithashtu lartësia maksimale e lejuar e strukturës është 11.2 metra, ndërsa objekti ka lartësinë e 13.9 metra, jo në përputhje me VKM-në 408 dhe me PPV të Bashkisë Has.

4-Gjetja e konstatuar në lejen e ndërtimit të të miratur me objekt: “Objekt Banimi 2-katesh me papafingo” për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has.

Duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Has dhe Rregullores së Planit të miratur me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 15.04.2021, zona bën pjesë në njësinë strukturore HS\_UB\_A1\_1/22 dhe duhet të plotësojë kondicionet e mëposhtme:

-Kategoria e përdorimit\_A banim 100%

-Intensiteti i ndërtimit I=0.6

-Koeficienti i shfrytëzimit të territorit

KShT= 35%

-Numri i kateve\_3 kate

-Lartësia në metra\_11.2 metra

Por edhe nga verifikimi i të dhënave të paraqitura në tabelën e treguesve të zhvillimit, rezulton që kondicionet urbane nuk janë respektuar, koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 100 % nga 35 % që është e lejuar në planin e përgjithshëm vendor. Ndërsa intensiteti i ndërtimit është 2 nga intensiteti 0.6 i lejuar në zonë, me sipërfaqe totale ndërtimi 240 m<sup>2</sup>.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

- **Në bazë Ligjit 107, Neni 20**, Plani i Përgjithshëm Vendor:

a) balancimi i nevojave dhe interesave kombëtarë e vendorë për zhvillimet në territor; b) krijimi i kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm në territor dhe sipas parimeve të këtij ligji; c) drejtimi i zhvillimit të sistemeve të banimit e sistemeve të tjera të ndërtueshme; ç) rregullimi i përdorimeve të tokës, intensitetit e shtrirjes së ndërtimit në sistemet natyrore, bujqësore dhe urbane të territorit; d) planifikimi i programeve dhe masave për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, të tokës së kultivueshme, peizazheve dhe hapësirave të gjelbra; dh) rregullimi i vendndodhjes dhe programeve për infrastrukturën publike e servitutet publike, sipas këtij ligji; e) rregullimi i ruajtjes, përdorimit dhe, sipas rastit, mbarështimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe historike, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

- **Në bazë të VKM-së 408, Neni 32**, Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie, pika 1, në të cilën përcaktohen kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie përcaktohen nga autoriteti i planifikimit në PPV dhe/ose PDV dhe janë, si më poshtë :- Kategoria dhe/ose nënkategoria e lejuar e përdorimit të tokës; Lloji i ndërhyrjes në territor (sipas përcaktimve të rregullores së planifikimit); Intensiteti lejuar i ndërtimit; Koeficienti i shfrytëzimit të territorit; Numri i kateve; Lartësia e strukturave; Treguesit e distancave; Tipologjia e ndërtimit; Vija e kuqe/ndërtimit; Koeficienti minimal i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike për njësinë; Numri minimal i vendparkimeve publike në përputhje me rregulloren e planifikimit; Koeficienti minimal i shfrytëzimit të territorit për rrugë për njësinë; Kushte për infrastrukturën; Kushte të tjera, sipas rastit të përcaktuara në rregulloren e planifikimit dhe legjislacionit të posaçëm sektorial.

-**Në bazë të VKM-së 408, Neni 38**, Intensiteti i ndërtimit (I), përcaktohet nga dokumenti i planifikimit në nivel njësie strukturore.

-**Në bazë të VKM-së 408, Neni 39**, Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim, Ksht-ja për ndërtim përcaktohet nga dokumentet e planifikimit për njësi dhe zonë dhe zbatohet si e tillë për çdo parcelë të ndërtueshme

- Në bazë të pikës 4.13 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i kritereve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, ndikon në:

- a) lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re;
- b) normat e lejuara të distancave;
- c) vlerat mjedisore dhe ekologjike në zonë;
- ç) vlerat e trashëgimisë kulturore në zonë;
- d) diellëzimin dhe orientimin;
- dh) respektimin e normave mjedisore
- e) infrastruktura publike
- f) hapësirat publike

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Has

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar të gjitha materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, dokumnetacionin e pronësisë, planvendosjen me të gjithë elementët përbërës të saj, projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.

*Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi: Z.L. M., me detyrë Kryetari i Bashkisë Has; Z.N. B., përgjegjës i sektorit të urbanistikës, rregullimit të territorit, e pronave, të Bashkisë Has, nga data 19.05.2014 e në vijim.; Z. A. U., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim; Z. B. H., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim..*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat evidentohet e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen në planvendosje të distancës nga kufiri i pronës dhe mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës.

**Titulli i gjetjes 51:** Mosparaqitja në planvendosje e distancës nga kufiri i pronës dhe mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës në njërin rast nuk pasqyrohet dhe në dy rastet e tjera nuk respektohet në bazë të lëgjisllacionit në fuqi.

1. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt: "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H. ShPK dhe aplikues E.M., në fshatin "Vranisht", Has. Në planvendosjen e miratur nuk paraqitet konturi i pronës dhe nuk pasqyrohen distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës, duke krijuar hapësirë për mosrespektimin e distancës minimale nga kufiri i pronës. Objekti duhet të respektohet distancën me 3 metra nga të gjitha anët e kufiri të pronës.

2. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt: "Shtesë anësore dhe 2 kat në lartësi në ndërtimin ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr.18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has. Distancat nga objekti 2 kate dhe kufirit të pronës ruhet vetëm 0.43 m dhe 0.96m, ndërsa për objektin në lartësinë e 3 kateve ruhet distanca vetëm 2 m dhe 1.98 m. Objekti duhet të respektohet distancën me **4 metra** nga kufiri i pronës për objektin në lartësinë e 3 kateve dhe distancën **3 metra** nga kufiri i pronës për objektin në lartësinë e 2 kateve.

3. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt: "Objekt Banimi 2-katesh me papafingo" për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has. Në përendim distanca nga kufiri i pronës është ruajtur 3 metra për objektin në lartësinë e 3 kateve, ndërsa në orjentimin

jugor 3.6 metra nga kufiri i pronës. Objekti duhet të respektonte distancën me 4 metra nga kufiri i pronës për objektin në lartësinë e 3 kateve.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

**VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës:** -Me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në planin e përgjithshëm vendor, distanca minimale e lejuar e ndërtimit nga kufiri i pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m ( $d = nr. k + 1m$ ) ku: d - distanca minimale e ndërtimit nga kufiri i pronës dhe nr. k - numri i kateve.

**Ndikimi:** Mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës çënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe çënon zhvillimin e ndërtimve të reja në parcelat kufitare, në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Has

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Has të merren masa që të verifikohen pasqyrimi i distancave ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës në planvendosjen e miratuar, si edhe distancat të jenë në përputhje me distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

*Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi: Z.L. M., me detyrë Kryetari i Bashkisë Has; Z.N. B., përgjegjës i sektorit të urbanistikës, rregullimit të territorit, e pronave, të Bashkisë Has, nga data 19.05.2014 e në vijim.; Z. A. U., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim; Z. B. H., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim.*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat evidentohet e njëjta situatë, në lidhje me mospërcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe respektimin e distancave midis ndërtimeve, në bazë të legjislacionit në fuqi.

**Titulli i gjetjes 52:** Mospërcaktimi i saktë i numrit të kateve në planvendosje dhe respektimi i distancave midis ndërtimeve.

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në planvendosje dhe në të dhënat e treguesve të parametrave të zhvillimit, nuk pasqyrohet saktë numri i kateve dhe lartësia e objektit sipas projektit të ndërtimit.

1.Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt:“Projekt-zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 26, datë 20/05/2022, me zhvillues Q. P. dhe aplikues Dh. P., Rruga e Kukësit ,Has. Në planin e vendosjes së miratuar nuk paraqiten numrat e kateve të objekteve që kufizohet dhe evidentohet që me objektin në krah që kufizohet, nuk respekton distancën minimale midis ndërtimeve.

2.Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt:

“Shtesë anësore dhe 2-kat në lartësi në ndërtimin ekzistues”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç., Krumë.

Në planvendosje nuk pasqyrohet i saktë numri i kateve të godinës, pasi objekti është në lartësinë e 2 dhe 3 kateve, jo në lartësinë e 1-2 kate .

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

**VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, Neni 37,** lartësia e ndërtimeve.

**VKM 408, Neni 34**, Distancat minimale midis ndërtimeve do të matet me shumën e numrit të kateve mbi tokë të ndërtimeve që përballen plus 2 m, sipas formulës më poshtë:  $d = nr. k \text{ obj.A} + nr. k \text{ obj.B} + 2m$ , ku: d - distanca minimale midis dy ndërtimeve. nr. k - numri i kateve. ku të paktën njëra ka dritare, sipas këtij neni garantojnë kushtet minimale të standardeve të ndriçimit e mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të faqeve që përballin njëra-tjetrën.

**Ndikimi:** Mosparaqitja e saktë e numrit të kateve në planvendosje, tek të dhënat e treguesve të parametrave të zhvillimit, ndikon në mosrespektimi e distancave të lejuara midis ndërtimeve. Duke mos respektuar kushtet minimale të standardeve të ndriçimit e mbrojtjes nga zjarri dhe përcaktohen si gjatësia e vijës pingule midis planeve më të afërta të faqeve që përballin njëra-tjetrën. Ndryshimi i të dhënave për numrat e kateve ndikon në elementët e mëposhtëm:

- a) lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re;
- b) normat e lejuara të distancave;
- c) vlerat mjedisore dhe ekologjike në zonë;
- ç) vlerat e trashëgimisë kulturore në zonë;
- d) diellëzimin dhe orientimin;
- dh) respektimin e normave mjedisore
- e) mbrojtjen e tokës

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Has

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Has të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në lidhje me përcaktimin e numrit të kateve të objektit, duke i verifikuar me projektin e ndërtimit dhe respektimin e distancave ndërmjet ndërtimeve.

*Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi: Z.L. M., me detyrë Kryetari i Bashkisë Has; Z.N. B., përgjegjës i sektorit të urbanistikës, rregullimit të territorit, e pronave, të Bashkisë Has, nga data 19.05.2014 e në vijim.; Z.A. U., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim; Z. B. H., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim..*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktika tek e cila nuk pasqyrohej e saktë distanca ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës, duke krijuar hapësirë për të mos respektuar distancën minimale të lejuar.

**Titulli i gjetjes 53:** Mospasqyrimi i saktë distancës ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në planvendosje nuk pasqyrohej distanca ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës, duke lënë hapësirë për të mos respektuar kushtet në bazë të Rregullores së Zhvillimit të Territorit dhe Kodit Rrugor. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt: “Projekt-zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues” me zhvillues Q. P. dhe aplikues Dh. P., Rruga e Kukësit, Has. Në planvendosje nuk pasqyrohet e saktë distanca nga trupi i rrugës, por pasqyrohet vetëm distanca ndërmjet objektit dhe aksit të rrugës.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

**VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, neni 36**, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe trupit të rrugës. Distanca minimale e një ndërtimi nga trupi i rrugës matet nga plani më i afërt i faqes së ndërtimit me kufirin e rrugës.

**Ndikimi:** Mospasqyrimi i saktë i distancave ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës mund të cojë në mosrespektimin e saj, duke cënuar sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Has

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandime:** Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar në planvendosje paraqitjen e të gjitha distancave të nevojshme që nevojiten të respektohen ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës.

*Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi: Z.L. M., me detyrë Kryetari i Bashkisë Has; Z.N. B., përgjegjës i sektorit të urbanistikës, rregullimit të territorit, e pronave, të Bashkisë Has, nga data 19.05.2014 e në vijim.; Z. A. U., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim; Z. B. H., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim..*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila tipologjia e ndërtimit dhe e objektit nuk është në përputhshmëri me tipologjinë e ndërtimit të lejuar në zonë.

**Titulli i gjetjes 54:** *Tipologjia e objektit jo në përputhshmëri me tipologjinë e ndërtimit dhe konstruksionin e lejuar në njësinë përkatëse.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se tipi i konstruksionit të ndërtimit nuk përputhej me tipin e lejuar në tokat bujqësore, gjetje e cila u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratuar për leje ndërtimi, me objekt: 1-Gjetja e konstatuar në lejen e ndërtimit të të miratur me objekt : “Ambjente sherbimi, punime dhe infrastrukture mbështetese per pemtoren me arra”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 23, datë 16/03/2022, me zhvillues K.C.2020 ShPK dhe aplikues K. P., Fshati Helshan ,Has.

Duke u bazuar në Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Has dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, Nr. 2, datë 15.04.2021, zona bën pjesë në njësinë strukturore HS\_B\_B1\_105/6 dhe duhet të plotësojë kondicionet e mëposhtme:  
-Kategoria e përdorimit\_Tokë bujqësore 100%  
-Intensiteti i ndërtimit I=0  
-Koeficienti i shfrytëzimit të territorit KShT= 0  
-Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore"

Leja e ndërtimit miratohet për zhvillimin e një objekti në funksion të bujqësisë, përkatësisht ambjente sherbimi, punime dhe infrastrukture mbështetëse për pemtoren me arra, ndërsa projekti i ndërtimit dhe raportet paraqesin propozimin për një vilë banimi në lartësinë e 2 kateve mbi tokë e me çati. Tipologjia e ndërtimit nuk është e lejuar në zonë sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të Miratuar.

Bashkia Has, e përfaqësuar nga Kryetari Z.L. M. ka lidhur një kontratë "Për dhënien me qira të tokës bujqësore, të pandarë me sipërfaqe 1.607 ha tokë" me subjektin K. C. 2020 ShPK. Pasuria është objekt i legjislacionit në fuqi, konkretisht ligjit Ligjin Nr. 9244, datë 17.06.2004, për "Mbrojtjen e tokës bujqësore". Në përcaktimin e Nenit 2, pika c, e kontratës përcaktohet se pasuria duhet të përdoret sipas kritereve të mëposhtme:

Toka duhet të përdoret vetëm për veprimtari bujqësore dhe blegtorale.

**Në bazë të, Nenit 14,** për mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet, pika 4, përcaktohet se: "Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral." Në projektin e ndërtimit të miratuar në lejen e ndërtimit, **lloji i strukturës është në kundërshtim me pikën 4 të ligjit Nr.9244** dhe me kushtet e kontratës së dhënies më qera të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, pasi objekti nuk është një

ndërtim me strukturë të përkohshme, por ka elementë konstruktiv themele me beton që lidhen në mënyrë të qëndrueshme e të përhershme me tokën.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

**Në bazë të Ligjit Nr. 9244, datë 17.6.2004**, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, Nenit 14, për mbrojtjen e tokës bujqësore nga ndërtimet, pika 4, përcaktohet se: "Në tokat bujqësore lejohen vetëm ndërtimet e përkohshme, të cilat nuk janë të lidhura në mënyrë të qëndrueshme dhe të përhershme me tokën, që janë të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit bujqësor dhe blegtoral."

**Ndikimi:** Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi:

-konstrukcioni lidhet në mënyrë të qëndrueshme e të përhershme me tokën dhe nuk janë ndërtime të përkohshme e të lehta

-dëmton tokën bujqësore nga me tipin e konstrukcionit

-ndryshon tipologjinë e ndërtimit të lejuar

**Shkak:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Has

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar projektin e ndërtimit, në përputhje me kondicionet urbane të lejuara në zonë dhe në përputhje me të gjithë dokumentacionin e ngarkuar në sistem, duke përfshirë edhe marrëveshjet dhe kontratat e qirave. Nëse evidentohet mospërputhshmëri ndërmjet projektit të miratuar dhe kushteve të kontratës së qirasë, të rishikohet vlefshmëria e kontratës për dhënien me qira të tokës bujqësore.

*Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi: Z.L. M., me detyrë Kryetari i Bashkisë Has; Z.N. B., përgjegjës i sektorit të urbanistikës, rregullimit të territorit, e pronave, të Bashkisë Has, nga data 19.05.2014 e në vijim.; Z. A. U., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim; Z. B. H., me detyrë specialist urbanistike, nga data 08.05.2020 e në vijim..*

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila tipologjia e ndërtimit dhe e objektit nuk ishte në përputhshmëri me tipologjinë e ndërtimit të lejuar në zonë.

**Titulli i gjetjes 55:** *Mosllogaritja në mënyrën e duhur e taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe në njoftimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk paraqitet mënyra e llogaritjes së saj.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur në bazë të vlerës së preventivit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtëm të miratur për leje ndërtimi, me objekt: "Ambjente shërbimi, punime dhe infrastrukture mbështetëse për pemptoren me arra", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 23, datë 16/03/2022, me zhvillues K.C.2020 ShPK dhe aplikues K.P., Fshati Helshan, Has.

**Duke u bazuar tek ligji nr. 9632, datë 30.10.2006** "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit Bashkiak Has, përlllogaritja është në mënyrën e mëposhtme:

Vlera e investimit në bazë të preventivit të ngarkuar në sistem është 32,318,252.11 lekë.

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas paketës fiskale të miratuar është 1%.

Llogaritja e vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë:

$32,318,252.11 \text{ lekë} \times 1\% = \mathbf{323,182.521 \text{ lekë}}$

Në bazë të faturës së arkëtuar, vlera e taksës së ndikimit në mjedis është llogaritur **57,337 lekë**. Bashkëngjitur fatura e arkëtuar për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Fatura e përlllogaritur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Bashkisë Has është **57,337 lekë**, ndërsa llogaritja e saktë ka vlerën **323,182.521 lekë**, e pasqyruar mësipër. Mënyra e



përlllogaritjes nuk është e rregullt. Diferenca ndërmjet dy vlerave të mësipërme, prej **265,845.521 lekë** përbën dëm ekonomik shkaktuar **Bashkisë Has**.

Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në njoftimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk paraqitet mënyra e llogaritjes së saj. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuar për leje ndërtimi, me objekt:

1. "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H. ShPK dhe aplikues E.M, në fshatin "Vranisht", Has.

2. "Shtesë anësore dhe 2-kat në lartësi në ndërtimin ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has.

3. "Projekt-zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 26, datë 20/05/2022, me zhvillues Q. P. dhe aplikues Dh. P., Rruga e Kukësit, Has.

4. "Objekt Banimi 2-katesh me papafingo" për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

**Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Neni 27, taksa e ndikimit në infrastrukturë.**

**Ligji Nr. 107/2014, për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit, neni 46, Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja :**

-Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritjet mbi çmimin referencë ose preventivin e investimit të ri që kërkohet të kryhet, duke përzgjedhur atë që ka vlerën më të lartë.

**Ndikimi:** Diferenca e konstatuar e vlerës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, përbën dëm ekonomik për Bashkinë Has.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Has.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:** Nga Bashkia Has të merren masa për arkëtimin e vlerës 265,845.521 lekë që përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë dhe në njoftimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë të pasqyrohet mënyra e llogaritjes së taksës.

*Për sa më lart, për lejet e ndërtimit të trajtuar më sipër mbajnë përgjegjësi: Z.L. M., me detyrë Kryetari i Bashkisë Has; Z.N. B., përgjegjës i sektorit të urbanistikës, rregullimit të territorit, e pronave, të Bashkisë Has, nga data 19.05.2014 e në vijim.; Z.U. H., me detyrë përgjegjës i sektorit të tatim-taksave, nga data 05.07.2019 e në vijim.*

**2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtës së Territorit të Njësisë Vendore.**

**Titulli i gjetjes 56:** Mbi mos funksionimin e IMTV-së në Bashkinë Has.

**Situata:** Referuar Urdhrit nr. 191 datë 01.04.2022 "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Has për vitin 2022", në Bashkinë Has **nuk është e ngritur struktura** e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor. Në strukturën e vitit 2022 janë 2 punonjës të emëruar në pozicionin e Inspektorit të terrenit (1 në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës dhe 1 në NjA Golaj).

Gjatë vitit 2022 nga inspektorët e IMTV-së janë mbajtur 15 proces verbale të konstatimit të kundërvajtjeve në fushën e mbrojtjes së territorit të cilat paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr.2.6/1: Kundërvajtjet e konstatuara nga IMTV-viti 2022

Nr.	Emër-Mbiemër	Proces verbal	Kundërvajtja
1	A. G.	Nr.40/01.02.2022	Mos respektim i afateve të lejes së ndërtimit
2	E.	Nr.41/07.03.2022	Mos respektim i afateve të lejes së ndërtimit
3	A. K.	Nr.42/17.03.2022	Punime pa leje/hapje kanali/themele
4	S. D.	Nr.43/28.03.2022	Ndërtim pa leje/shtëpi banimi
5	M. M.	Nr.44/17.05.2022	Ndërtim pa leje/shtëpi banimi
6	A. G.	Nr.45/27.05.2022	Ndërtim pa leje/shtesë kati
7	Sh. N.	Nr.46/30.05.2022	Ndërtim pa leje/shtëpi banimi
8	I. K.	Nr.47/01.07.2022	Ndërtim pa leje/shtëpi banimi
9	O. P.	Nr.48/01.07.2022	Ndërtim pa leje/shtëpi banimi
10	S. T.	Nr.49/01.07.2022	Ndërtim pa leje/mur mbajtës dhe soletë
11	R. N.	Nr.51/18.08.2022	Ndërtim pa leje/hapje themelesh
12	G. R.	Nr.52/23.08.2022	Ndërtim pa leje/shtëpi banimi
13	R. K.	Nr.53/25.08.2022	Ndërtim pa leje/shtëpi banimi
14	A. T.	Nr.54/02.09.2022	Ndërtim pa leje/shtëpi banimi
15	F. B.	Nr.55/20.09.2022	Ndërtim pa leje/shtëpi banimi

Burimi: Bashkia Has, punoi grupi auditimit

Nga 15 rastet e kundërvajtjeve të konstatuara nga IMTV është marrë masa administrative gjobë vetëm për 2 raste, kundërvajtësin A. G. me vlerë 100,000 lekë e cila është paguar dhe për Entin Kombëtar të Banesave gjobë me vlerë 500,000 lekë e cila nuk është paguar.

- Bashkia Has nuk ka blloqe për procesverbalet që mban në rastet e konstatimit të kundërvajtjes, në rastet e marrjes së masës së pezullimit të punimeve apo në rastet e marrjes së masës së prishjes së ndërtimit. Proces verbalet e konstatimit të kundërvajtjes janë një model që inspektorët i printojnë rast pas rasti dhe i plotësojnë kur janë në terren. Duke mos patur një bllok të mirëfilltë i cili të ketë një numër serial të fletëve lindin mundësi për gabime apo dhe abuzime. Përkatësisht, po të shikohen të dhënat e paraqitura në tabelën më sipër inspektorët e IMTV-së nuk mund të vërtetojnë nëse ka patur raste të mbajtjes së procesverbaleve para datës 01.02.2022 dhe pas datës 20.09.2022. Gjithashtu, proces verbali numër 50 mungon.

- Inspektorët nuk kanë plane pune mujore ku të jetë parashikuar edhe mbikëqyrja që ato duhet të bëjnë në vazhdimësi për zbatimin e kushteve të lejeve të dhëna nga bashkia.

- Gjatë inspektimeve në terren janë mbajtur proces verbale dhe janë vendosur gjoba vetëm me firmën e një inspektori (gjoba nr. 002 datë 01.02.2022, proces verbal nr. 42 datë 17.03.2022, nr. 43 datë 28.03.2022, nr. 46 datë 30.05.2022, nr. 51 datë 18.08.2022, nr. 52 datë 23.08.2022, nr. 53 datë 25.08.2022).

- Në Bashkinë Has për vitin 2022 struktura e IMTV-së nuk ka qenë funksionale. Kjo vjen si rezultat i mungesës së një Sektori të Mbrojtjes së Territorit dhe mungesës së Kryeinspektorit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, **neni 4** “Pranë çdo njësie vendore ngrihet inspektorati i mbrojtjes së territorit, i cili, nëpërmjet kryeinspektorit e inspektorëve, brenda territorit administrativ të kësaj njësie, ushtron përgjegjësinë e kontrollit të territorit dhe zbatimit të ligjshmërisë së standardeve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera. Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore drejtohet nga kryeinspektori, i cili emërohet nga kryetari i njësisë vendore përkatëse”, **neni 13** “Brenda 10 ditëve nga mbajtja e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori”, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit

të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, **pika 1/b/ii** ...kryen kontrolle në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, **pika 1/c/i** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit të njësisë vendore realizon kontrolle nëpërmjet „... një grupi inspektimi, i cili ka në përbërje jo më pak se dy inspektorë; **pika 4...**Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori.

Bashkia Has nuk ka respektuar përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 06.07. 2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4. Gjithashtu, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Has nuk janë marrë masa për të ngritur Inspektoratin e Kontrollit të Territorit.

Si përfundim, nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Has nuk mund të vendosen gjopa apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. L. M. në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Has.*

**Kriteri:** Kuadri ligjor i cituar më sipër.

**Ndikimi:** Nuk kryhet kontrolli i territorit dhe zbatimi i ligjshmërisë dhe i standardeve teknike në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Has nuk mund të vendosen gjopa apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.

**Shkaku:** Bashkia Has nuk ka zbatuar detyrimet ligjore për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Has të marrë të gjitha masat për të plotësuar strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit. Kryeinspektori të marrë masat e nevojshme për të hartuar planet mujore të punës ku të parashikohet edhe mbikëqyrja që ato duhet të bëjnë në vazhdimësi për zbatimin e kushteve të lejeve të dhëna nga bashkia. Kryeinspektori të marrë masa që të verifikohen në terren të gjitha proces verbalet që janë mbajtur vetëm me firmën e një inspektori. Në përfundim të këtyre verifikimeve të merren masat administrative përkatëse për të gjithë kundërvajtësit. Kryeinspektori të marrë masat që për inspektimet që do të kryhen të përdoren dokumentet e duhura duke filluar nga procesverbalet që mbahen në rastet e konstatimit të kundërvajtjes, për pezullimin e punimeve, për prishjen e ndërtimit apo në rastet e vendosjes së gjobave. Këto dokumente të kenë një numër serial të fletëve duke zvogëluar mundësinë për gabime apo abuzime.

## **2.7 Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër pika 7, u auditua “Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së”.

### 1. Auditimi i fundit në Bashkinë Has

Auditimi i fundit në Bashkinë Has është kryer në vitin 2022 për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 569/6 datë 15.09.2022. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:

- 16 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 5 masa për uljen e borxhit tatimor në shumën 43,950.144 lekë, pranuar nga subjekti;
- 1 masë disiplinore, pranuar nga subjekti.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, germa j, Bashkia Has duhet të hartojë planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimit. Nga auditimi u konstatua se, Bashkia Has për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 866/07 datë 30.12.2021 nuk ka kthyer përgjigje në KLSH brenda afatit ligjor prej 20 ditësh. Ndërkohë rezultoi se ka hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës nr. 569/6 datë 15.09.2022 për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve nuk është plotësuar ende afati 6 muajor për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH

Sikurse është cituar më lart, Bashkia Has nuk ka hartuar një plan veprimi të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 569/6 datë 15.09.2022, si dhe nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”.

**Titulli i gjetjes 57:** Mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.

**Situata:** Bashkia Has nuk ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH si dhe nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”.

**Kriteri:** Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

**Ndikimi:** Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Has të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

**Shkaku:** Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Has me qëllim zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandim:** Bashkia Has të marrë masa për të hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lënë nga KLSH, si dhe të kryej raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

#### 5. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Bashkinë Has

Në përfundim të auditimit në Bashkinë Has me shkresën nr. 866/07 datë 30.12.2021 janë dërguar rekomandimet si vijon:

##### *Masa organizative*

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Has 16 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Has nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim.

Nuk është miratuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike, si prokurimet publike, shpenzimet, të ardhurat etj.

Nga titullari nuk është nxjerrë akt i brendshëm ku të përcaktohen detyrat e punonjësit dhe strukturave përkatëse të Bashkisë Has gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës.

Nga ana e titullarit të njësisë publike Bashkia Has nuk është hartuar dhe miratuar Strategji e Menaxhimit të Riskut, por është plotësuar vetëm Format i Regjistrimit të Riskut.

Nuk është bërë ndarja e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

Këto veprime janë në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, kreu II, neni 8, pika 2, 8\ b, neni 9 pika ç dhe neni 16 pika 2 dhe 3;

- VKM nr. 124, datë 17.02.2016 “Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil” Kreu III, pika 27;

- VKM nr. 171, datë 26.03.2014 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, Kreu VII, pika 49, 52, 52;

- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike”;

- Ligjit nr. 68-2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 datë 29.3.2012 “Procedura e përgatitjes së Buxhetit afatmesëm”, Kap. V.

**1.1 Rekomandim:** Bashkia Has të marrë masa që hartohet dhe miratohet strategjia e riskut. Titullari i Bashkisë Has të miratojë gjurmën e auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme.

Koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore me qëllim vlerësimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave të MFK-së.

Spektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has të marrë masa që për çdo largim punonjësish nga puna të ndiqet procedura për dorëzimin e detyrës.

**1.2 Nga verifikimi rezultoi se, Spektori i Burimeve njerëzore ka marrë masa vetëm për dorëzimin e inventarëve për punonjësit, pas largimit nga puna.**

**Rekomandimi është zbatuar pjesërisht**

**2. Gjetje nga auditimi:** Struktura e auditit të brendshëm për vitin 2021 ka funksionuar vetëm më një auditues, nga tre që përcakton kuadri rregullator në fuqi. Rezulton se për vitin 2021 nga

Bashkia Has nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim, duke mos kryer detyrën funksionale dhe duke mos i dhënë titullarit të njësisë publike këshilla për përmirësimin e veprimitarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe siguri për realizimin e objektivave.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, pika 1, Të gjitha njësitë publike, të përfshira në neni 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm dhe neni 11, Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3.

**2.1 Rekomandim:** Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë ose, shërbimi i auditit të brendshëm të kryhet nga njësia e auditit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse.

**2.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Has ka ngritur një strukturë të Auditit të Brendshëm, por që aktualisht është vetëm një punonjës specialist i emëruar me Urdhërin nr. 696, datë 31.10.2022.**

**Rekomandimi është pa zbatuar**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite, por gjithashtu gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Në fillim të vitit buxhetor 2021 detyrimeve e prapambetura kanë vlerën 28,833,238 lekë, prej të cilave është likuiduar vlera 13,920,155 lekë, por është krijuar detyrim i ri në vlerën 4,176,110 lekë, duke e çuar vlerën e këtyre detyrimeve më 31.12.2021 në vlerën 19,089,192.8 lekë.

Detyrimet e reja të prapambetura janë krijuar nga mos realizimi i të ardhurave dhe nga marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, veprime të cilat janë në kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

**3.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtorja Ekonomike, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Has dhe kontraktorëve, brenda afatit 30 ditor pas ardhjes së faturës tatimore, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.

**3.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtorja e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave ka ulur përqindjen e detyrimeve të prapambetura nga 7% në 3.7% për vitin 2022.**

**Rekomandimi është zbatuar pjesërisht**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se në Bashkinë Has nuk është hartuar regjistër dhe nuk llogaritet detyrim për kategorinë e taksapaguesve familjar për taksën mbi tokën bujqësore. Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet taksa e tokës bujqësore. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin

e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021” pika 4/b.

**4.1 Rekomandim:** Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

**4.2 Nga verifikimi rezultoi se, nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Has për zbatimin e rekomandimit të lënë.**

#### **Rekomandimi është pa zbatuar**

**5. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitore ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifatat e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak si, taksa e truallit, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e VKB-në nr. 104 datë 25.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021”. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistrojnë vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitore nuk ka një regjistër. Si rezultat, procesi i llogaritjes së detyrimit të familjeve për taksat dhe tarifatat vendore nuk është i dokumentuar, duke sjellë si pasojë mos njohjen e numrit të familjeve debitore dhe vlerën totale që ato kanë ndaj bashkisë.

**5.1 Rekomandim:** Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për krijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

**5.2 Nga verifikimi rezultoi se, nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Has për zbatimin e rekomandimit të lënë.**

#### **Rekomandimi është pa zbatuar**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kushteve të akt marrëveshjeve që Bashkia Has ka lidhur me subjektet debitore rezultoi se dy prej tyre nuk kanë zbatuar kushtet e akt marrëveshjes. Subjekti “V. M.” i cili është debitor në vlerën 73,260 lekë edhe pse duhet t’i kishte paguar që më datë 16.09.2021 dhe subjekti “R.2ER” SHPK është debitor në vlerën 93,676 lekë, ndërkohë që duhet t’i kishte paguar që më datë 18.12.2021. Nga Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk janë marrë masa për zgjidhjen e marrëveshjes së pagesës me këste në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 78.

**6.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të monitorojë me përgjegjësi zbatimin e kushteve të akt marrëveshjeve që ka lidhur me subjektet debitore dhe të marrë masat e duhura në rast të mos zbatimit të kushteve të përcaktuara në akt marrëveshje nga bizneset debitore.

**6.2 Nga verifikimi rezultoi se, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, për subjektin “V. M. A” për shkak të rrethanave ekonomike të subjektit dhe pamundësisë për pagesë janë bërë edhe një akt-marreveshje për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura për vlerën 73,260 lekë dhe detyrimeve të vitit 2021 dhe të detyrimeve të vitit 2022 në shumën total 447,912 lekë me datë 18.05.2022 dhe nr. 1107 Prot., për deri 18.12.2022. Për subjektin “R. -2ER” shpk kemi bërë bllokim llogarie ndaj subjektit sipas urdhrit të bllokimit nr. 2644 prot., datë 13.12.2022 mbi llogarite bankare të tij.**

## **Rekomandimi është zbatuar**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Has për vitin 2021 nuk është ngritur si strukturë e veçantë Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit Vendor. Në strukturën aktuale të bashkisë identifikohen 2 punonjës të emëruar në pozicionin e inspektorit të terrenit (1 në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës dhe 1 në NjA Golaj). Këto punonjës edhe pse me detyrë inspektor terreni nuk e bëjnë funksionale strukturën e IMTV-së si rezultat i mungesës së Kryeinspektorit, i cili ka kompetencat ligjore për të nënshkruar marrjen e masave dhe dhënien e sanksioneve administrative. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 13, si dhe VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”, pika 1/b/ii, pika 1/c/i, pika 4. Nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Has nuk mund të vendosen gjopa apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.

**7.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë të marrë të gjitha masat për të krijuar të plotë strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Has me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit.

**7.2 Nga verifikimi rezultoi se,** Bashkia Has ka ngritur strukturën e IMTV me Urdhërin nr. 95, datë 01.02.2023.

## **Rekomandimi është zbatuar**

**8. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 468 “Debitor të ndryshëm”, në pasqyrat financiare ka vlerën 67,319,252 lekë, ndërsa analiza e kësaj llogarie në librat e kontabilitetit ka vlerën 60,807,896 lekë, situatë e cila tregon se për diferencën prej 6,511,356 lekë midis këtyre dy vlerave, nuk ka dokumentacion justifikues, i cili të shpjegojë origjinën e krijimit të këtij detyrimi ndaj njësisë vendore. Në bilanc nuk janë futur detyrimet e nxjerra nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së mbi individët dhe furnitorët debitor nga mos arkëtimi i dëmeve ekonomike edhe pse janë rekomandime të pranuar për tu zbatuar.

**8.1 Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues, të përfshijë në llogarinë 468 “Debitor të ndryshëm” edhe dëmet e konstatuara nga KLSH në auditimet e mëparshme si dhe të justifikojë diferencën prej 6,511,356 lekë të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

**8.2 Nga verifikimi rezultoi se,** Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave ka sistemuar llogaritë përkatëse.

## **Rekomandimi është zbatuar**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i analizës analitike të llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, konstatohet se vlera e studimeve dhe projekteve të paraqitura në bilanc, i përkasin edhe objekteve të përfunduara përpara vitit ushtrimor 2021, duke kryer vlerësimin jo real të llogarisë 202 dhe AAJM, në vlerën 1,613,998 lekë.

**9.1 Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues, të kryej veprimet e sistemimit për llogarinë 202 “Studime dhe Kërkime” duke siguruar përfshirjen në këtë llogari të studimeve dhe kërkimeve vetëm për objektet ende të papërfunduara në vitin ushtrimor të mbylljes së bilancit.

**9.2 Nga verifikimi rezultoi se,** Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave nuk e ka sistemuar llogaritë përkatëse në bilancin e vitit 2021.

## **Rekomandimi është pa zbatuar**

**10. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has është aksionare 100% e shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Has” Sha, në vlerën e investimit prej 77,334,000 lekë, por nga auditimi i pasqyrave financiare u konstatua se nuk janë reflektuar në gjendjen e llogarisë 26 “Aktivet Afatgjata



Financiare” fitim-humbjet nga pjesa e aksioneve për vitet 2001-2021. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr. 8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP” pika 2.1, ndryshuar me Udhëzimin nr. 5, datë 21.02.2022.

**10.1 Rekomandim:** Nëpunësi Zbatues të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të “Ujësjetllës Kanalizime Has SHA me vlerë kontabël 77,334,000 lekë në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**10.2 Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Has me kalimin e Ujësjetllësit në Pushtetin Qëndror në datë 01.01.2023, nuk është aksionere për pasojë detyrimet vazhdojnë të jenë me Ujësjetllësin dhe nuk janë pjesë e Bashkisë. Për këtë këto, detyrime nuk paraqiten në bilancin e Bashkisë Has, në vijim.**

**Rekomandimi është zbatuar**

**11. Gjetje nga auditimi:** Kryetari i Bashkisë Has dhe Nëpunësi Zbatues nuk kanë marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve për llogarinë 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe llogarinë 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” të cilat në pasqyrat financiare paraqiten në vlerën zero lekë. Mos kryerja e inventarizimit ka sjellë mos njohjen e gjendjes faktike të këtyre pronave në terren, si ekzistenca fizike e ndërtesave, nëse ka prona të zaptuara në mënyrë të paligjshme etj. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 433, datë 08.06.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV, Udhëzimin nr. 8/2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP”, pika 16,18 dhe VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”.

**11.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Has dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale të pa inventarizuara deri më sot, përkatësisht për zërin 211 “Pyje, Kullota, Plantacione” dhe zërin 210 “Toka, troje, terrene”. Të hartohet regjistri i aktiveve për këto prona me të gjithë elementët e nevojshëm, si data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, etj.

**11.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave nuk e ka sistemuar llogaritë përkatëse.**

**Rekomandimi është pa zbatuar**

**12. Gjetje nga auditimi:** Aktivitet afatgjata materiale të llogarisë 212 “Ndërtesa e Konstruksione” në vlerën 733,469,916 lekë, janë kontabilizuar në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, ku gjatë auditimit u evidentua se Bashkia Has nuk ka iniciuar procesin për regjistrimin e tyre.

**12.1 Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has dhe Nëpunësi Zbatues të marrin masa për nisjen e procesit të regjistrimit pranë ASHK-së së aktiveve afatgjata materiale për llogarinë të Bashkisë Has.

**12.2 Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave ka sistemuar llogaritë sipas Urdhër pagesave përkatëse janë paguar një pjesë e regjistrimeve të pronave.**

## **Rekomandimi është në proces zbatimi**

**13. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has nuk ka marrë masa të plota për likuidimin në afat të detyrimit prej 5% të mbajtur si garanci punimesh nga kontraktorët të cilët kanë kryer punime në investime të ndryshme të realizuara në këtë njësi vendore.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” e cila rezultoi se vlera në fund të vitit 2021, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i ish Komunave dhe mungesës së informacionit. Në këtë rast garanci të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur, janë në vlerën 303,575 lekë.

**13.1 Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të njoftojë subjektet sipas kontratave përkatëse të investimeve, për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale 303,575 lekë dhe të kryejë sistemimet përkatëse në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”.

**13.2 Nga verifikimi rezultoi se,** Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave nuk ka marrë masa për zbatimin e rekomandimit.

## **Rekomandimi është pa zbatuar**

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Has nga sistemi SIFQ i thesarit, janë identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2022, por të paregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2021. Mosparaqitja e tyre në kontabilitet, edhe pse janë kompetencë e vitit ushtrimor 2021 ka nënvlerësuar llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” me 3,173,309 lekë për vitin 2021. Kjo procedurë mos pasqyrimi në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” të detyrimeve për faturat e likuiduara në 2022, por me kompetencë vitin 2021, përbën mos pasqyrim të drejtë të informacionit financiar, duke qenë se detyrimet e prapambetura për vitin 2021 të përcjella në Ministrinë e Financave janë nënvlerësuar me 3,173,309 lekë.

**14.1 Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit të bëjnë sistemimet për të pasqyruar në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm” detyrimet për faturat e likuiduara 3,173,309 lekë për vitin 2021. Gjithashtu, pas saktësimit të detyrimeve të prapambetura, duhet të merren masa për raportimin e tyre në Ministrinë e Financave, raportim i cili aktualisht nuk është real.

**14.2 Nga verifikimi rezultoi se,** Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave nuk e ka sistemuar llogaritë përkatëse.

## **Rekomandimi është pa zbatuar**

**15. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has nuk ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 866/07 datë 30.12.2021, si dhe nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5.

**15.1 Rekomandim:** Bashkia Has të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

**15.2 Nga verifikimi rezultoi se,** nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Has për zbatimin e rekomandimit të lënë.

## Rekomandimi është pa zbatuar

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së rezulton se nga 21 rekomandime të lëna niveli i realizimit është si vijon:

- Nga 13 masa organizative janë zbatuar 3 masa (rekomandimet 8.1, 9.1, 11.1) dhe nuk janë zbatuar 10 masa organizative (rekomandimet 1.1, 2.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 7.1, 10.1, 12.1, 13.1):

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtorja e Financës dhe Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë me përgjegjësi dhe të marrin masa të menjëhershme për të sistemuar diferencën e pa argumentuar e rezultuar ndërmjet gjendjes debitorë në pasqyrat financiare dhe gjendjes debitorë e pasqyruar nga sektori taksave tarifave vendore në vlerën prej 2,329,317 lekë detyrime debitorë, nga mos pagimi nivelit të taksa/tarifa nga bizneset dhe subjektet familjarë, bazuar në listën e personave e subjekteve debitorë.

2.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtorja e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (202) “Studime dhe kërkime” dhe të paraqesë në këtë llogari vetëm vlerat e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Kjo llogari të pakësohet për vlerën 9,729,027 lekë dhe të shtohet në vlerën e investimit të përfunduara sipas objektit përkatës.

3.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtorja e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (203) “Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme”, duke e pakësuar këtë llogari me vlerën 1,085,000 lekë dhe shtuar në vlerën e investimit të përfunduar sipas objektit përkatës.

4.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtorja e Financës të marrin masa për të pasqyruar në llog. (210) “Toka, Troje, Terrene” edhe vlerën e trojeve nën objektet ndërtesa e pasqyruar në llog. (212) “Ndërtime e konstruksione”, të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi si asete publike të Bashkisë Has, njëkohësisht të kryhet procesi i inventarizimit fizik i trojeve me komision inventarizimi.

5.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Drejtorja e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, të marrin masa për inventarizimin fizik të pronave asete publike në pronësi të Bashkisë Has, si dhe të bëhet pasqyrimi i saktë i tyre në dokumentet kontabël i vlerës së administruar në llog. (211) “Pyje, kullota, plantacione”.

6.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtorja Financës të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për llog. (212) “Ndërtime e konstruksione”, duke shtuar në vlerën fillestare, vlerën e shpenzimit i cili përbën investim të ri për secilin objekt (rikonstruksion etj.). Nëpunësi autorizues e Nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve afatgjata materiale (AAGJM) në përfundim komisioni të hartojë relacion për titullarin në lidhje me rezultatet e inventarizimit.

7.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtorja e Financës të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për llog. (213) “Rrugë, rrjete vepra ujore”, duke shtuar në vlerën e tij fillestare, vlera e shpenzimit që përbën investim të ri për secilin objekt. Nëpunësi autorizues e Nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve afatgjata materiale (AAGJM) në përfundim komisioni të hartojë relacion për titullarin në lidhje me rezultatet e inventarizimit.

10.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtorja e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (466) “Kreditorë për mjete në ruajtje” për të evidentuar e dokumentuar në mënyrë analitike për diferencën në vlerën 7,256,213 lekë e pa analizuar në mënyrë analitike, megjithëse është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Të analizojë në origjinë të krijimit të tyre, cilat janë shkaqet e mos likuidimit të vlerës e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve për 12 objekte të përfunduara të marra në dorëzim. Titullari dhe Drejtorja e financës të marrin masa për likuidimin e vlerës së mësipërme, duke

analizuar më parë gjendjen nëse është përmbyllur garancia e defekteve të punimeve dhe nëse janë bërë korrigjimet e punimeve për çdo kontratë së cilës nuk i është likuiduar kjo garanci.

12.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has të analizojë e nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të vazhdojë ndjekja dhe zbatimin e masave që rezultojnë ende të pa zbatuara, apo të përshpejtojë ato rekomandime që janë në proces. Për të cilat Titullari i njësisë vendore të hartojë një program pune të veçantë.

13.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori i Planifikimit e Urbanistikës të marrin masa të menjëhershme për të saktësuar oponencën teknike dhe të përshtatë atë me objektin e ndërtuar në territorin e Bashkisë Has, në të kundërt të aplikojë masa administrative nga zhvilluesi (EKB) për kundërvajtjen e konstatuar e parashikuar në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni (51), pika (1), germa (gj).

- Nga 2 masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar, ndërsa 2.1 nuk është pranuar:

1.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlllogaritur sa më të saktë nivelin e tarifës dysHEME për dhënë në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor/kullor me kontratë të lidhur për ndërtimin e HCE-it në territorin e bashkisë Has, dhe për të kërkuar nga operatori ekonomik “F.” SHPK kthim të vlerës prej 1,120,950 lekë e konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë Has, si diferencë në vlerësim të nivelit të tarifës së përlllogaritur.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Drejtoria e Financës të marrë masa dhe të sistemojë në kontabilitet në llog. (468) “Debitor të ndryshëm” vlerën prej 75,389 lekë e konsideruar dëm ekonomik në ngarkim të personave material përgjegjës, për mungesë rezultuar nga inventarizimi fizik i aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabile (vlera historike) për 4 artikujt “inventar ekonomik”.

- Nga 6 masa për uljen e borxhit tatimor nuk është pranuar 1 masë (rekomandimi 3.1), nuk janë zbatuar 2 masa (rekomandimet 5.1, 6.1) si dhe janë në proces zbatimin 3 masa (rekomandimet 1.1, 2.1, 4.1):

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme, për arkëtimin e detyrimeve debitore të rezultuara nga mos pagesa e nivelit të taksave e tarifave vendore të parashikuara në paketa fiskale për subjekte ekonomike që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi dhe nga subjekte familjare me vlerën prej 10,362,754 lekë, si dhe përlllogaritjen të detyrimeve të lindura nga mos realizimi i nivelit për taksën e tokës nga subjekte familjare debitor ndaj njësisë vendore Bashkia Has.

2.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të rinovuar e pajisur me (licencë/autorizim) me afat 5 (pesë) vite kalendarike, ndërkohë që operatorët ekonomik të cilët ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi me veprimtari tregtimi në stacione karburanti e gaz i lëngshëm për përdorim nga konsumatorët fundorë në territorin e bashkisë Has, të cilët bashkia i ka pajisur me afat për 1(një) vit kalendarik, si pasojë e mos administrimit të autorizimit bazë, apo të mos pagesës së nivelit të tarifës përkatëse pas rinovimit të autorizimit bazë e pa përfshirë në paketat fiskale, për pasojë shuma e përlllogaritur prej 7,980,000 lekë, konsiderohet e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkisë Has.

3.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlllogaritur detyrimin që rrjedh nga mos aplikimi dhe mos zbatimin i nivelit për tarifën vendore nga 9 OE edhe me seli jashtë territorit të Bashkisë Has, të cilët ushtrojnë aktivitetet dhe kanë lidhur kontrata punë publike nga fondet e aplikuar për investime në Bashkinë Has, për pasojë shuma 897,500 lekë, konsiderohet e

ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Has. Rekomandimi është pranuar pjesërisht nga Bashkia Has.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Sektori i Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të analizuar dhe kërkuar pagesën e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet informale (pa leje) të kryera nga subjekte ekonomik dhe subjekte familjare në territori bashkisë Has e parashikuar edhe në paketat fiskale shuma prej 3,671,328 lekë e konsiderohet e ardhur e munguar për buxheti bashkisë Has.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Sektori Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të kontabilizuar vlerën e penalitetit sipas vlerës së masës së gjobës dhe të kërkojë arkëtimin e shumës 4,600,000 lekë e konsideruar e ardhur e munguar e pa planifikuar për buxheti Bashkinë Has.

6.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar nga operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve dhe të pajisur me leje minerare e miratuar nga (MEIT) për të lidhur kontrata qiraje me të gjithë OE dhe për të gjithë sipërfaqen e dhënë në përdorim për t'u shfrytëzuar nga fondi pyjor/kullosor, brenda territorit të bashkisë Has në sipërfaqen totale prej 746,2 ha e pa kontraktuar me diferencë në vlerën prej 52,330,090 lekë e konsideruar e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Has.

**16.1 Rekomandim:** Bashkia Has të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm si vijon:

1. Të zbatojë urdhrat nr. 38/1 deri në 38/8, datë 21.01.2022 “Për realizimin e detyrave të lëna nga KLSH referuar Raportit Përfundimtar të Auditimit nr. 866/07 datë 30.12.2021”.

2. Drejtoria e Financës të sistemojë diferencën e pa argumentuar e rezultuar ndërmjet gjendjes debitorë në pasqyrat financiare dhe gjendjes debitorë e pasqyruar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore në vlerën prej 2,329,317 lekë detyrime debitorë.

3. Drejtoria e Financës të sistemojë llog. (203) “Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme”;

4. Drejtoria e Financës të pasqyrojnë saktë në dokumentet kontabël vlerën e secilit aktiv afatgjatë material për llog. (213) “Rrugë, rrjete vepra ujore”;

5. Titullari i Bashkisë Has, Sektori i Planifikimit e Urbanistikës të marrin masa të menjëhershme lidhur me lejen zhvillimore nr. 3, datë 24.03.2020; leje ndërtimi nr. 2 Prot, datë 18.09.2020 “Për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> për objekt banimi dhe shërbimi 8 kat+1 Kat nëntokë”, për të saktësuar oponentin teknik dhe të përshtatë atë me objektin e ndërtuar në territorin e Bashkisë Has, në të kundërt të aplikojë masa administrative nga zhvilluesi (EKB) për kundërvajtjen e konstatuar e parashikuar në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni (51), pika (1), germa (gj).

6. Drejtoria e Financës të sistemojë në kontabilitet në llog. (468) “Debitor të ndryshëm” vlerën prej 75,389 lekë e konsideruar dëm ekonomik në ngarkim të personave material përgjegjës, për mungesë rezultuar nga inventarizimi fizik i aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabile (vlera historike) për 4 artikujt “inventar ekonomik”.

7. Titullari Bashkisë Has, Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlogaritur detyrimin që rrjedh nga mos aplikimi dhe mos zbatimi i nivelit për tarifave vendore nga 9 OE edhe me seli jashtë territorit të Bashkisë Has, të cilët ushtrojnë aktivitetet dhe kanë lidhur kontrata punë publike nga fondet e aplikuara për investime në Bashkinë Has, në shumën 897,500 lekë.

8. Bashkia Has, Sektori Planifikimit Territorit Urbanistikës, të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të kontabilizuar vlerën e penalitetit sipas vlerës së masës së gjobës dhe të kërkojë arkëtimin e shumës 4,600,000 lekë.

9. Titullari i Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar nga operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve dhe të

pajisur me leje minerare e miratuar nga (MEIT) për të lidhur kontrata qiraje me të gjithë OE dhe për të gjithë sipërfaqen e dhënë në përdorim për t'u shfrytëzuar nga fondi pyjor/kullozor, brenda territorit të Bashkisë Has në sipërfaqen totale prej 746,2 ha e pa kontraktuar me diferencë në vlerën prej 52,330,090 lekë.

10. Titullari Bashkisë Has të analizojë e nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme. Të vazhdojë ndjekja dhe zbatimin i masave që rezultojnë ende të pa zbatuara, apo të përshpejtojë ato rekomandime që janë në proces. Titullari i njësisë vendore të hartojë një program pune të veçantë: për 9 masa për shpërbllim dëmi në vlerën 16,717 mijë lekë e kontabilizuar, por pa arkëtuar; lidhur me zbatimin e vendimit nr. 12, datë 12.02.2019 dërguar nga Agjencia e Prokurimit Publik, në të cilin është vendosur të dënohen me gjobë 11 punonjës në vlerën 2,490,000 lekë, ndërsa ka filluar arkëtimi nga 2 punonjës në masën 600,000 lekë dhe ka mbetur pa arkëtuar vlera prej 1,890,000 lekë.

**16.2 Nga verifikimi rezultoi se, nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Has për zbatimin e rekomandimit të lënë.**

### **Rekomandimi është pa zbatuar**

#### *Masa për uljen e borxhit tatimor*

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Has, 5 masa për uljen e borxhit tatimor në vlerën **43,950,144 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht të gjitha.

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet rezulton se në Bashkinë Has ka detyrime të pa paguara për objekte që janë legalizuar që nga viti 2017 deri në 31.12.2020 në vlerën 9,282,639 lekë për 239 objekte që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has. Për vitin 2021 Bashkia Has nuk ka marrë asnjë shkresë nga ASHK për objektet që mund të jenë legalizuar gjatë këtij viti. Gjithashtu, bashkia nga ana e saj nuk ka dërguar asnjë shkresë drejt ASHK-së për të kërkuar informacion. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" pika 5.

**1.1 Rekomandim:** Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 239 debitorë në vlerën 9,282,639 lekë si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Has të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

**1.2 Nga verifikimi rezultoi se, Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës dhe Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore kanë kërkuar informacion nga ASHK me shkresë nr. 1960/1, datë 22.07.2022 dhe është dërguar lista e përfituesve të Legalizimeve për periudhën janar 2021 deri Qershor 2022. Gjithsej 25 objekte të legalizuara për vitin 2021 dhe 15 objekte të legalizuara deri në Qershor 2022. Janë njoftuar të gjithë përfituesit e këtyre lejeve nga të cilët 13 përfitues kanë paguar plotësisht, ndërsa 27 përfitues janë nxjerrë debitorë. Në lidhje me debitorët e mëparshëm 2020 e me pas, për 239 subjekte në vlerën 9,282,639 lekë po punohet për ndjekjen e procedurave tatimore për arkëtimin e detyrimeve.**

## Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pagesave të kontratave aktive të qirave rezulton se:

- 7 qiramarrës nuk kanë paguar detyrimin për vitin 2021 apo edhe më herët, në vlerën totale 5,434,436 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has. Gjithashtu, për qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet e qirasë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave vendore nuk është llogaritur kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.

- Qiramarrësi G. I. nuk ka paguar detyrimin referuar kontratës nr. 257, datë 12.06.2013 në vlerë 84,000 lekë, detyrim ky që është kontabilizuar nga Drejtoria e Financës, por nuk është i përfshirë në listën e debitorëve progresiv.

- Qiramarrësi F.SHPK ka lidhur me Bashkinë Has kontratën me nr. 03, datë 12.01.2015 për marrjen e sipërfaqes 0.63 ha për 9 vjet me vlerë vjetore të kontratës 465,000 lekë. Rezulton se kjo kontratë është amenduar me kontratën nr. 3, datë 01.06.2016 ku sipërfaqja e marrë me qira dhe afati nuk ndryshon por ka ndryshuar vlera e kontratës në 91,350 lekë. Amendimi i kontratës nuk është i shoqëruar me asnjë relacion ku të shpjegohen arsyet e ndryshimit të vlerës së qirasë vjetore. Qiramarrësi ka paguar rregullisht detyrimin sipas amendimit të kontratës përkatësisht për 6 vite  $\times 91,350 = 548,100$  lekë, ndërkohë detyrimi që duhet të paguajë sipas kontratës bazë është 6 vite  $\times 465,000 = 2,790,000$  lekë. Diferenca prej 2,241,900 lekë (2,790,000 - 465,000) përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has. Kjo vlerë detyrimi nuk është e përfshirë në listën e debitorëve progresiv si dhe nuk është kontabilizuar. Nga vlera totale e detyrimit për pagesat e qirave të kontratave aktive është e përfshirë te lista e debitorëve progresiv detyrimi për 5 qiramarrës në vlerën 2,560,436 lekë dhe nuk është i përfshirë detyrimi në vlerën 2,325,900 lekë (84,000 + 2,241,900) që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has.

Gjithashtu, konstatohen 3 subjekte (N. 2004, V. M.Alb., A.K), të cilat shfrytëzojnë asete të Bashkisë Has dhe nuk kanë një kontratë të nënshkruar me bashkinë, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

**2.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për qiramarrësin G. I. për vlerën 84,000 lekë dhe subjektin F.ShPK për vlerën 2,241,900 lekë. Gjithashtu, në vijimësi Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit, si dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave.

**2.2 Rekomandim:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për lidhjen e menjëhershme të kontratave të qirasë me subjektet “N. 2004”, “V. M. A.” dhe “A.K”, që kanë në përdorim objekte/prona/sipërfaqe në pronësi të Bashkisë Has.

**2.3 Nga verifikimi rezultoi se, për rekomandimin:**

*2.1, Sektori i i Taksave dhe Tarifave Vendore për subjektin “A.K” nuk ka lidhur më kontratë qiraje pasi subjekti ka bërë revokim të lejes minerare në territorin e Bashkisë Has për vitin 2022 si rezultat nuk ushtron më aktivitetet minerar për lidhje kontrate. Për subjektin “V. M. A.” është lidhur akt-marrëveshje. Për subjektin “N.2004”. Për subjektin ”F. “ shpk, është njoftuar për vitin 2022 në lidhje me detyrimet e kontratës së qirasë prej 465,000 lekë në vit.*

## Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

2.2, *Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomadimit të lënë.*

## Rekomandimi është pa zbatuar

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave lidhur me detyrimet që tatimpaguesit kanë ndaj Bashkisë Has rezultoi se gjatë vitit 2021 borxhi i krijuar është në shumën 4,166,512 lekë dhe përbëhet nga detyrimet nga taksat dhe tarifatat për personat fizikë/juridikë në shumën 3,419,026 lekë, detyrimet nga institucionet shtetërore në shumën 104,240 lekë dhe detyrimet nga qiratë e tregut në shumën 643,246 lekë.

Detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore më mënyrë progresive më 31.12.2021 në Bashkisë Has janë në vlerën 32,867,505 lekë të përbëra nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifatat e bizneseve, detyrime nga autorizimet e subjekteve hidrokarbure, detyrime nga kontratat e fondit pyjor kullor (kontrata aktive dhe jo aktive) rezultojnë në vlerën totale 26,643,184 lekë për 187 biznese;

- Qira të ambienteve të tregut (Markata) detyrime në vlerën 3,743,941 lekë;

- Detyrime nga kontratat e dhënies me qira të aseteve në vlerën 2,325,900 lekë;

- Detyrime nga institucione publike në vlerën 154,480 lekë.

Rezulton se Bashkia Has nuk ka aplikuar të gjitha masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.

**3.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën:

- 26,643,184 lekë për 187 subjekte private;

- 3,743,941 lekë për qiratë e ambienteve të tregut;

- 2,325,900 lekë nga kontratat e dhënies me qira të aseteve;

- 154,480 lekë nga institucione publike;

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Has, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

**3.2 Nga verifikimi rezultoi se, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has ka nxjerrë urdhra bllokimi në llogarite bankare të tatim paguesve për 4 subjekte gjatë vitit 2022 përkatësisht, tre karburante dhe R. 2ER me shkresë nr. 2644, datë 13.12.2022. Është punuar për mbledhjen e detyrimeve të subjekteve duke bërë të mundur që gjatë vitit 2022 të mbledhen nga 33 subjekte të kontabilizuara si debitorë për vlerën 2,514,241 lekë.**



#### **Rekomandimi është zbatuar pjesërisht**

**4. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has ka pajisur me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitetet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Konstatohet se subjekti “G.Sh.” SHPK të cilit i ka përfunduar autorizimi më datë 14.03.2020 nuk është pajisur me autorizim të ri nga Bashkia Has në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014, neni 4, neni 15, neni 20, si dhe VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3.

Edhe pse nuk është pajisur me autorizim, subjekti “G.Sh.” SHPK ka paguar vlerën prej 200,000 lekë, për të cilën nuk ka dokumentacion nga Bashkia Has se për cilën periudhë është kjo pagesë. Vlera e mbetur për t’u paguar nga subjektet që janë pajisur me autorizim por me marrëveshje detyrimin e paguajnë me këste është 5,607,000 lekë dhe është e regjistruar të lista e debitorëve progresiv.

**4.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjektit “G.Sh.” SHPK dhe të marrë masa që ky subjekt të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën e mbetur prej 800,000 lekë ndaj Bashkisë Has për 5 vjet duke filluar nga data 14.03.2020. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

**4.2 Nga verifikimi rezultoi se, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimit të lënë.**

#### **Rekomandimi është pa zbatuar**

##### *Masa Disiplinore pika D*

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Has:

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Has t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.**

**1.2 Nga verifikimi rezultoi se, nuk është marrë asnjë masë nga Bashkia Has për zbatimin e rekomandimit të lënë.**

#### **Rekomandimi është pa zbatuar**

##### **Përmbledhëse e Masave**

Lloji i Rekomandimit	Rekomandime Gjithsej në numër	Pranuar	Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar
Masa organizative	16	16	4	2	1	9
Masa për uljen e borxhit tatimor	5	5	-	3	-	2
Masa Disiplinore	1	1	-	-	-	1

## **Konkluzion**

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Has me shkresën nr. 569/6 datë 15.09.2022. Grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së ku rezultoi se nga Bashkia Has kanë filluar të merren disa masa lidhur me zbatimin e 21 rekomandimeve dhe 1 masë disiplinore të lëna në total të cilat janë pranuar nga Bashkia Has.

### *Masa organizative*

*Nga 16 masa organizative, janë zbatuar 4 rekomandime, 2 rekomandime janë zbatuar pjesërisht, 1 masë është në proces dhe 9 rekomandime nuk janë zbatuar.*

### *Masa për uljen e borxhit tatimor*

*Nga 5 masa për uljen e borxhit tatimor, janë zbatuar pjesërisht 3 rekomandime dhe 2 rekomandime nuk janë zbatuar.*

### *Masa Disiplinore pika D*

*Masa disiplinore e lënë, nuk është zbatuar.*

Në përfundim rezultoi se:

- Janë zbatuar gjithsej 4 rekomandime organizative, përkatësisht 6.1, 7.1, 8.1 dhe 10.1;
- Janë zbatuar pjesërisht 5 rekomandime, 2 rekomandime organizative përkatësisht, 1.1 dhe 3.1, 3 rekomandime për uljen e borxhit tatimor përkatësisht, 1.1, 2.1 dhe 3.1;
- Është në proces zbatimi 1 rekomandime organizativ përkatësisht, 12.1;
- Nuk janë zbatuar 11 rekomandime, 9 rekomandime organizative përkatësisht, 2.1, 4.1, 5.1, 9.1, 11.1, 13.1, 14.1, 15.1, 16.1 dhe 2 rekomandime për uljen e borxhit përkatësisht, 2.2 dhe 4.1.

***Lidhur me rekomandimet e tjera referuar afateve të zbatimit dhe çështjeve që adresojnë janë trajtuar gjatë auditimit të pikave të programit të auditimit sikurse janë rekomandimet që lidhen me hartimin e pasqyrave financiare, buxhetit dhe rekomandimeve që lidhen me uljen e borxhit tatimor.***

## **A. Masa organizative**

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSH-së në vitin 2021, rezultoi se nga 21 rekomandime të lëna niveli i realizimit është si vijon:

- Nga 13 masa organizative janë zbatuar 3 masa (rekomandimet 8.1, 9.1, 11.1) dhe nuk janë zbatuar 10 masa organizative (rekomandimet 1.1, 2.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 7.1, 10.1, 12.1, 13.1):  
1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtorja e Financës dhe Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë me përgjegjësi dhe të marrin masa të menjëhershme për të sistemuar diferencën e pa argumentuar e rezultuar ndërmjet gjendjes debitorë në pasqyrat financiare dhe gjendjes debitorë e pasqyruar nga sektori taksave tarifave vendore në vlerën prej 2,329,317 lekë detyrime debitorë, nga mos pagimi nivelit të taksa/tarifa nga bizneset dhe subjektet familjarë, bazuar në listën e personave e subjekteve debitorë.  
2.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtorja e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (202) “Studime dhe kërkime” dhe të paraqesë në këtë llogari vetëm vlerat e projekteve, për të cilat investimet e lidhura me to nuk kanë përfunduar. Kjo llogari të pakësohet për vlerën 9,729,027 lekë dhe të shtohet në vlerën e investimit të përfunduara sipas objektit përkatës.

3.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (203) “Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme”, duke e pakësuar këtë llogari me vlerën 1,085,000 lekë dhe shtuar në vlerën e investimit të përfunduar sipas objektit përkatës.

4.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës të marrin masa për të pasqyruar në llog. (210) “Toka, Troje, Terrene” edhe vlerën e trojeve nën objektet ndërtesa e pasqyruar në llog. (212) “Ndërtime e konstruksione”, të cilat me VKM kanë kaluar në pronësi si asete publike të Bashkisë Has, njëkohësisht të kryhet procesi i inventarizimit fizik i trojeve me komision inventarizimi.

5.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik dhe Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, të marrin masa për inventarizimin fizik të pronave asete publike në pronësi të Bashkisë Has, si dhe të bëhet pasqyrimi i saktë i tyre në dokumentet kontabël i vlerës së administruar në llog. (211) “Pyje, kullota, plantacione”.

6.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtoria Financës të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për llog. (212) “Ndërtime e konstruksione”, duke shtuar në vlerën fillestare, vlerën e shpenzimit i cili përbën investim të ri për secilin objekt (rikonstruksion etj.). Nëpunësi autorizues e Nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve afatgjata materiale (AAGJM) në përfundim komisioni të hartojë relacion për titullarin në lidhje me rezultatet e inventarizimit.

7.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has dhe Drejtoria e Financës të marrin masa për pasqyrimin e saktë në dokumentet kontabël të vlerës së secilit aktiv afatgjatë material për llog. (213) “Rrugë, rrjete vepra ujore”, duke shtuar në vlerën e tij fillestare, vlera e shpenzimit që përbën investim të ri për secilin objekt. Nëpunësi autorizues e Nëpunësi zbatues të marrin masa për ngritjen e komisionit për inventarizimin fizik të aktiveve afatgjata materiale (AAGJM) në përfundim komisioni të hartojë relacion për titullarin në lidhje me rezultatet e inventarizimit.

10.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Drejtoria e Financës të marrin masa për sistemimin e llog. (466) “Kreditorë për mjete në ruajtje” për të evidentuar e dokumentuar në mënyrë analitike për diferencën në vlerën 7,256,213 lekë e pa analizuar në mënyrë analitike, megjithëse është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Të analizojë në origjinë të krijimit të tyre, cilat janë shkaqet e mos likuidimit të vlerës e cila përfaqëson vlerën e garancisë së punimeve për 12 objekte të përfunduara të marra në dorëzim. Titullari dhe Drejtoria e financës të marrin masa për likuidimin e vlerës së mësipërme, duke analizuar më parë gjendjen nëse është përmbyllur garancia e defekteve të punimeve dhe nëse janë bërë korrigjimet e punimeve për çdo kontratë së cilës nuk i është likuiduar kjo garanci.

12.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has të analizojë e nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm. Të vazhdojë ndjekja dhe zbatimin i masave që rezultojnë ende të pa zbatuara, apo të përshpejtojë ato rekomandime që janë në proces. Për të cilat Titullari i njësisë vendore të hartojë një program pune të veçantë.

13.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori i Planifikimit e Urbanistikës të marrin masa të menjëhershme për të saktësuar oponencën teknike dhe të përshtatë atë me objektin e ndërtuar në territorin e Bashkisë Has, në të kundërt të aplikojë masa administrative nga zhvilluesi (EKB) për kundërvajtjen e konstatuar e parashikuar në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni (51), pika (1), germa (gj).

- Nga 2 masa për shpërblim dëmi, rekomandimi 1.1 nuk është zbatuar, ndërsa 2.1 nuk është pranuar dhe as nuk është zbatuar:

1.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës, të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlloritur sa më të saktë nivelin e tarifës dysHEME për dhënë në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor/kullosor me kontratë të lidhur për ndërtimin e HCE-it në territorin e bashkisë Has,

dhe për të kërkuar nga operatori ekonomik "F." SHPK kthim të vlerës prej 1,120,950 lekë e konsideruar dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë Has, si diferencë në vlerësim të nivelit të tarifës së përlogaritur.

2.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Drejtoria e Financës të marrë masa dhe të sistemojë në kontabilitet në llog. (468) "Debitor të ndryshëm" vlerën prej 75,389 lekë e konsideruar dëm ekonomik në ngarkim të personave material përgjegjës, për mungesë rezultuar nga inventarizimi fizik i aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabile (vlera historike) për 4 artikujt "inventar ekonomik".

- Nga 6 masa për uljen e borxhit tatimor nuk është pranuar 1 masë (rekomandimi 3.1), nuk janë zbatuar 2 masa (rekomandimet 5.1, 6.1) si dhe janë në proces zbatimi 3 masa (rekomandimet 1.1, 2.1, 4.1):

1.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme, për arkëtimin e detyrimeve debitore të rezultuara nga mos pagesa e nivelit të taksave e tarifave vendore të parashikuara në paketa fiskale për subjekte ekonomike që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi dhe nga subjekte familjare me vlerën prej 10,362,754 lekë, si dhe përlogaritjen të detyrimeve të lindura nga mos realizimi i nivelit për taksën e tokës nga subjekte familjare debitor ndaj njësisë vendore Bashkia Has.

2.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të rinovuar e pajisur me (licencë/autorizim) me afat 5 (pesë) vite kalendarike, ndërkohë që operatorët ekonomik të cilët ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi me veprimtari tregtimi në stacione karburanti e gaz i lëngshëm për përdorim nga konsumatorët fundorë në territorin e bashkisë Has, të cilët bashkia i ka pajisur me afat për 1(një) vit kalendarik, si pasojë e mos administrimit të autorizimit bazë, apo të mos pagesës së nivelit të tarifës përkatëse pas rinovimit të autorizimit bazë e pa përfshirë në paketat fiskale, për pasojë shuma e përlogaritur prej 7,980,000 lekë, konsiderohet e ardhur e munguar e pa programuar për buxhetin e Bashkisë Has.

3.1 Rekomandimi: Titullari Bashkisë Has, Sektori Taksave e Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlogaritur detyrimin që rrjedh nga mos aplikimi dhe mos zbatimi i nivelit për tarifën vendore nga 9 OE edhe me seli jashtë territorit të Bashkisë Has, të cilët ushtrojnë aktivitetet dhe kanë lidhur kontrata punë publike nga fondet e aplikuar për investime në Bashkinë Has, për pasojë shuma 897,500 lekë, konsiderohet e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Has. Rekomandimi është pranuar pjesërisht nga Bashkia Has.

4.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Sektori i Taksave e Tarifave Vendore të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të analizuar dhe kërkuar pagesën e nivelit të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet informale (pa leje) të kryera nga subjekte ekonomik dhe subjekte familjare në territori bashkisë Has e parashikuar edhe në paketat fiskale shuma prej 3,671,328 lekë e konsiderohet e ardhur e munguar për buxheti bashkisë Has.

5.1 Rekomandimi: Bashkia Has, Sektori Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës, të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të kontabilizuar vlerën e penalitetit sipas vlerës së masës së gjobës dhe të kërkojë arkëtimin e shumës 4,600,000 lekë e konsideruar e ardhur e munguar e pa planifikuar për buxheti Bashkinë Has.

6.1 Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar nga operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve dhe të pajisur me leje minerare e miratuar nga (MEIT) për të lidhur kontrata qiraje me të gjithë OE dhe për të gjithë sipërfaqen e dhënë në përdorim për t'u shfrytëzuar nga fondi pyjor/kulloror, brenda territorit të bashkisë Has në sipërfaqen totale prej 746,2 ha e pa kontraktuar me diferencë në vlerën prej 52,330,090 lekë e konsideruar e ardhur e munguar për Buxhetin e Bashkisë Has.

**16.1 Rekomandim:** Bashkia Has të marrë masat për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm si vijon:

1. Të zbatohet urdhrat nr. 38/1 deri në 38/8, datë 21.01.2022 “Për realizimin e detyrave të lëna nga KLSH referuar Raportit Përfundimtar të Auditimit nr. 866/07 datë 30.12.2021”.
2. Drejtoria e Financës të sistemojë diferencën e pa argumentuar e rezultuar ndërmjet gjendjes debitorë në pasqyrat financiare dhe gjendjes debitorë e pasqyruar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore në vlerën prej 2,329,317 lekë detyrime debitorë.
3. Drejtoria e Financës të sistemojë llog. (203) “Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme”;
4. Drejtoria e Financës të pasqyrojnë saktë në dokumentet kontabël vlerën e secilit aktiv afatgjatë material për llog. (213) “Rrugë, rrjete vepra ujore”;
5. Titullari i Bashkisë Has, Sektori i Planifikimit e Urbanistikës të marrin masa të menjëhershme lidhur me lejen zhvillimore nr. 3, datë 24.03.2020; leje ndërtimi nr. 2 Prot, datë 18.09.2020 “Për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup> për objekt banimi dhe shërbimi 8 kat+1 Kat nëntokë”, për të saktësuar oponencën teknike dhe të përshtatë atë me objektin e ndërtuar në territorin e Bashkisë Has, në të kundërt të aplikojë masa administrative nga zhvilluesi (EKB) për kundërvajtjen e konstatuar e parashikuar në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni (51), pika (1), germa (gj).
6. Drejtoria e Financës të sistemojë në kontabilitet në llog. (468) “Debitor të ndryshëm” vlerën prej 75,389 lekë e konsideruar dëm ekonomik në ngarkim të personave material përgjegjës, për mungesë rezultuar nga inventarizimi fizik i aktiveve, ndërmjet gjendjes fizike dhe kontabile (vlera historike) për 4 artikujt “inventar ekonomik”.
7. Titullari Bashkisë Has, Sektori Taksave dhe Tarifave Vendore të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të përlllogaritur detyrimin që rrjedh nga mos aplikimi dhe mos zbatimi i nivelit për tarifatat vendore nga 9 OE edhe me seli jashtë territorit të Bashkisë Has, të cilët ushtrojnë aktivitetet dhe kanë lidhur kontrata punë publike nga fondet e aplikuar për investime në Bashkinë Has, në shumën 897,500 lekë.
8. Bashkia Has, Sektori Planifikimit Territorit Urbanistikës, të analizojë situatën dhe të marrë masa të menjëhershme për të kontabilizuar vlerën e penalitetit sipas vlerës së masës së gjobës dhe të kërkojë arkëtimin e shumës 4,600,000 lekë.
9. Titullari i Bashkisë Has, Sektori Juridik, Drejtoria e Pyjeve e Kullotave dhe Drejtoria e Financës të analizojnë situatën dhe të marrin masa të menjëhershme për të kërkuar nga operatorët ekonomik që ushtrojnë aktivitetet për qëllime biznesi në fushën e mineraleve dhe të pajisur me leje minerare e miratuar nga (MEIT) për të lidhur kontrata qiraje me të gjithë OE dhe për të gjithë sipërfaqen e dhënë në përdorim për t’u shfrytëzuar nga fondi pyjor/kullosor, brenda territorit të Bashkisë Has në sipërfaqen totale prej 746,2 ha e pa kontraktuar me diferencë në vlerën prej 52,330,090 lekë.
10. Titullari Bashkisë Has të analizojë e nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimet e mëparshme. Të vazhdojë ndjekja dhe zbatimi i masave që rezultojnë ende të pa zbatuara, apo të përshpejtojë ato rekomandime që janë në proces. Titullari i njësisë vendore të hartojë një program pune të veçantë: për 9 masa për shpërblim dëmi në vlerën 16,717 mijë lekë e kontabilizuar, por pa arkëtuar; lidhur me zbatimin e vendimit nr. 12, datë 12.02.2019 dërguar nga Agjencia e Prokurimit Publik, në të cilin është vendosur të dënohen me gjobë 11 punonjës në vlerën 2,490,000 lekë, ndërsa ka filluar arkëtimi nga 2 punonjës në masën 600,000 lekë dhe ka mbetur pa arkëtuar vlera prej 1,890,000 lekë.

*Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, Z. L. M., Kryetar i Bashkisë Has.*

## 2.8 Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Trajtimi i ankesës së paraqitur në Kontrollin e Lartë të Shtetit nga Presidenti i Shoqatës Atdhetare Kulturore “Bogdanët” z. Xh. A.

**Titulli i gjetjes 58:** *Mos ndjekja e përcaktimeve ligjore gjatë vendosjes së përmendores së Pjetër Bogdanit në Qytetin e Hasit.*

**Situata:** Në Kontrollin e Lartë të Shtetit është regjistruar ankesa me nr. 183/1 prot., datë 08.03.2023, nga z. Xh. A. me objekt “Mbi vendosjen e bustit të Pjetër Bogdanit në qytetin e Hasit”. Ankuesi pretendon se:

*“Nuk është bërë konkursi apo studimet e domosdoshme për projektin dhe ndërtimin e përmendores së Pjetër Bogdanit, pasi ka cenuar rëndë elementin funksional të veprës së Bogdanit. Pra, Bogdani ishte Kardinal në shërbimin e tij publik-fetar dhe jo një prift i thjeshtë, ku cenohet vlera e tij si dhe në të tjera si dijetar i rrallë. Dyshojmë se, nuk është bërë studimi dhe përshtatja urbanistike e arkitekturës në bazë të akteve konkurruese, me grupet e interesit dhe të parashikuar në ligj për evidentimin me dokumente administrative dhe proces verbale me grupet e interesit për të plotësuar dosjen ligjore në përputhje me ligjin. Kompania “E.” përfaqësuar nga z. K. M. dhe vetë Bashkia vendosin emrin e tyre në bazament për qëllime komerciale politike për përfitim personal duke cenuar vlerën e figurës së Bogdanit. Nuk ka asnjë përmendore, bust që i kushtohet një figure kombëtare kudo në vend apo në botë që të shtohen emra të tjerë përveç asaj apo atij figure që i dedikohet vepra. Cilido që kontribuon për një vepër të kësaj natyre, futet në dosje dhe arkivohet por kurrë nuk ekspozohet në pjesët përbërëse të përmendores. Dyshojmë se ka interesa të paligjshme dhe cenojnë rëndë figurën e Imzot Pjetër Bogdanit me akte që Bashkia Has dhe Kadri Morina kanë zbatuar në këtë proces”.*

Në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Kreu, VII, neni 25 bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, “1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. 2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve”.

Nga verifikimi rezulton se procesi për vendosjen e bustit të Pjetër Bogdanit ka filluar që në vitin 2013. Me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 07, datë 18.02.2013, “Për vendosjen e monumentit të Pjetër Bogdanit, në qendër të sheshit “Dëshmorët e Hasit” është miratuar vendosja e monumentit “Pjetër Bogdani”. Vendimi shoqërohet me projekt preventivin përkatës. Për zbatimin e këtij vendimi janë ngarkuar Sektori i Urbanistikës dhe Sektori i Kulturës. Që nga viti 2013 kur është miratuar kjo VKB deri në vitin 2021 nuk ka patur asnjë përprjekje për ta vënë atë në zbatim. Në vitin 2021 procesi ka filluar përsëri.

Projekti është planifikuar me bashkëfinancim nga fondet e Bashkisë Has dhe nga donatorë.

Vetë projekti është i ndarë në pjesën e bazamentit i cili do të financohet nga Bashkia dhe Këshilli i Qarkut Kukës dhe busti i cili do të financohet nga donatorët.

### 1. Financimi i bazamentit-kolonës

Për financimin e bazamentit Bashkia Has i është drejtuar me shkresën nr. 919 Prot. datë 25.05.2021 Këshillit të Qarkut Kukës për financimin e këtij projekti i cili referuar projekt preventiv ka vlerën 829,648 lekë.

Në vijim ka filluar zhvillimi i procedurës së prokurimit e llojit “blerje e vogël” për realizimin e bazamentit. Është hartuar kërkesë për prokurim me objekt “Ndërtim Bazamenti-Kolonës Statujës Pjetër Bogdani”, nga z. D. G., Përgjegjës Sektori Kulturës dhe Arsimit, drejtuar titullarit të AK dhe Njesisë së Prokurimit dhe Sektorit Ekonomik.

Titullari i Bashkisë Has ka nxjerrë Urdhrin nr. 595, datë 13.10.2021, “Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit”, me përbërje z. F. Th. – Kryetar/Inxhinier, z. D. G. – Anëtar/Përgjegjës i Sektorit të Kulturës dhe Arsimit dhe z. O. M. – Anëtar/ Teknik Ndërtimi. Komisioni më datë 14.10.2021 ka hartuar proces verbalin për llogaritjen e fondit limit për 10 zëra me vlerë totale të punimeve 800,000 lekë pa TVSH.

Kërkesa për prokurim është miratuar nga Titullari i Bashkisë Has me datë 14.10.2021.

Për zhvillimin e procedurës është nxjerrë Urdhër Prokurimi me vlerë të vogël nr. 47, datë 15.10.2021. Komisioni i prokurimit për realizimin e kësaj procedure është krijuar me autorizim nr. 2777 Prot. datë 08.11.2021 dhe përbëhet nga znj. E. D., znj. E. L. dhe znj. E. S.. Ftesa për ofertë e shoqëruar me preventivin pa çmime me nr. 2778 Prot. datë 08.10.2021 është publikuar në sistem, ku data 10.11.2021 është përcaktuar si data e zhvillimit të procedurës. Për këtë procedurë ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar OE “D. H” SHPK me vlerë oferte 794,000 lekë pa TVSH. Në përfundim të procedurës më datë 16.11.2021 Bashkia Has ka nënshkruar kontratën e shërbimit me OE “D. H” SHPK me vlerë kontrate 794,000 lekë pa TVSH dhe 952,800 lekë me TVSH, me afat realizimi 7 ditë. Për marrjen në dorëzim të objektit është nxjerrë Urdhri nr. 679 datë 22.11.2021, me përbërje komisioni marrje në dorëzim z. N. B., z. O. M. dhe z. D. G.. Objekti është marrë në dorëzim më datë 23.11.2021 referuar aktit të marrjes në dorëzim dhe situacionit përfundimtar të punimeve.

## 2. Financimi i bustit

Financimi i bustit është bërë nga donatorë privatë dhe nuk ka dokumentacion se sa ka qenë vlera e tij si dhe nuk është dokumentuar procesi.

### **Nga auditimi rezulton se:**

- VKB nr. 07, datë 18.02.2013, “Për vendosjen e monumentit të Pjetër Bogdanit, në qendër të sheshit “Dëshmorët e Hasit” nuk shoqërohet me një relacion shpjegues se si është marrë nisma për këtë projekt. Bashkëlidhur VKB-së janë skicat dhe plane dhe vendndodhja për vendosjen e bustit.

- Komisioni për hartimin e fondit limit nuk ka argumentuar llogaritjen e vlerave të zërave, ku për 8 zëra të preventivit është shënuar “An” dhe nuk janë shoqëruar me analiza çmimi, në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 56 pika 4 “*Në çdo rast, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga titullari i autoritetit/entit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës, duhet të përlllogarisë fondin për sasinë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurojë, në përputhje me nenin 76 të këtyre rregullave, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar paraprakisht një strukture të posaçme*” neni 76 pika 2 “*Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet*”.

- Nuk ka një vlerë totale të veprës për të llogaritur se sa % është financuar nga Bashkia Has dhe sa % nga donatorët. Dihet vetëm vlera që bashkia ka investuar për bazamentin (794,000 lekë pa TVSH dhe 952,800 lekë me TVSH).

- Në dokumentacionin e audituar nuk është identifikuar se kush është donatori edhe pse në kolonën e bustit emri i donatorit është K. M.. Nuk ka asnjë korrespondencë shkresore midis Bashkisë Has dhe donatorit K. M.. Strukturat e bashkisë deklarojnë se komunikimi për këtë projekt ka qenë verbal.

- Busti i dhuruar nuk është shoqëruar me dokumentacionin përkatës, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 57, “*Për hyrjet e aktiveve të dhuruara dokumentacioni shoqëruar përbehet nga Marrëveshja/akti i dhurimit ose letrën zyrtare të njësisë donatore; Faturën që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre; Dokumentet e zhdoganimit dhe Certifikatën e origjinës (ne rast*

importi); *Proces verbali i marrjes ne dorëzim te konfirmuar nga sektori i shërbimeve. Ne rastet kur dhurimet ne natyre te aktiveve nga donatore të ndryshëm jepen vetëm në sasi (pa çmim apo kosto), ato pranohen nga njësia përfituese dhe titullari autorizon vlerësimin e tyre*".

- Investimi i bërë nga bashkia (bazamenti) nuk është bërë hyrje nga Bashkia Has por është klasifikuar si shpenzim në zërin 602. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar.

**Kriteri:** Kuadri ligjor i sipërcituar.

**Shkaku:** Mos zbatim i përcaktimeve ligjore nga strukturat e Bashkisë Has gjatë procesit të vendosjes së bustit Pjetër Bogdanit.

**Ndikimi:** Mos rregjistikim i donacionit të bërë.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Has të ngrëjë një grup pune për të verifikuar dhe dokumentuar procesin e ndjekur për vendosjen e bustit të Pjetër Bogdanit si dhe të merren masa për të plotësuar dokumentacionin me qëllim vlerësimin e veprës dhe regjistrimin e saj në inventarin e Bashkisë Has.

#### **IV. GJETJE DHE REKOMANDIME**

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Has nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash të shkruara për këtë qëllim. Nuk është miratuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat, proceset dhe transaksionet që lidhen me veprimtarinë kryesore në njësinë publike, si prokurimet publike, shpenzimet, të ardhurat etj. Nga titullari nuk është nxjerrë akt i brendshëm ku të përcaktohen detyrat e punonjësit dhe strukturave përkatëse të Bashkisë Has gjatë marrjes dhe dorëzimit të detyrës. Nga ana e titullarit të njësisë publike Bashkia Has nuk është hartuar dhe miratuar Strategji e Menaxhimit të Riskut, por është plotësuar vetëm Format i Regjistrimit të Riskut. Ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin, sipas udhëzimit të Ministrit të Financave.

Këto veprime janë në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 8, pika 2, 8\B, neni 9 pika ç dhe neni 16 pika 2 dhe 3;

- VKM nr. 124, datë 17.02.2016 "Për pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil" Kreu III, pika 27;

- VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", Kreu VII, pika 49, 52, 52;

- Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike";

- Ligjit nr. 68-2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 32 dhe UMF Plotësues nr. 8 datë 29.3.2012 "Procedura e përgatitjes së Buxhetit afatmesëm", Kap. V. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa që hartohet dhe miratohet strategjia e rrisku. Titullari i Bashkisë Has të miratojë gjurmën e auditimit për proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme.



Koordinatori i Grupit të Menaxhimit Strategjik të organizojë takimet periodike të GMS-së për të siguruar marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore me qëllim vlerësimin e progresit të bërë në arritjen e objektivave të MFK-së.

Sektori i Burimeve Njerëzore në Bashkinë Has të marrë masa që për çdo largim punonjësish nga puna të ndiqet procedura për dorëzimin e detyrës.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Struktura e auditit të brendshëm për vitin 2022 ka funksionuar vetëm më një auditues, nga tre që përcakton kuadri rregullator në fuqi.

Rezulton se për vitin 2022 nga Bashkia Has nuk është planifikuar dhe realizuar asnjë auditim, duke mos kryer detyrën funksionale dhe duke mos i dhënë titullarit të njësisë publike këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe siguri për realizimin e objektivave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 10, Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm, pika 1, Të gjitha njësitë publike, të përfshira në neni 3, të këtij ligji, duhet të marrin masa për krijimin e shërbimit të auditimit të brendshëm dhe neni 11, Vendimin Nr. 83, datë 3.2.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 17-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa për ngritjen e strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm, që të jetë një mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm si dhe një organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë ose, shërbimi i auditit të brendshëm të kryhet nga njësia e auditit të brendshëm të një njësie tjetër publike, në bazë të një marrëveshje ndërmjet titullarëve të njësive publike përkatëse.

### *Në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk janë marrë masa të plota për likuidimin e detyrimeve të prapambetura, pasi nga njëra anë kryhen pagesa gjatë vitit për detyrimet e trashëguara ndër vite, ndërsa gjatë vitit buxhetor krijohen detyrime të reja të prapambetura. Në fillim të vitit buxhetor 2022 detyrimet e prapambetura kanë vlerën **19,089,192.8** lekë, është krijuar detyrim i ri gjatë vitit 2022 në vlerën 5,338,526 lekë, prej të cilave është likuiduar vlera 13,920,155 lekë, duke e çuar vlerën e këtyre detyrimeve më 31.12.2022 në vlerën **11,333,143.8** lekë. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Has dhe Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për likuidimin e vlerës së kontratave të lidhura midis Bashkisë Has dhe kontraktorëve, brenda afatit 30 ditor pas ardhjes së faturës tatimore, duke eliminuar në këtë mënyrë shkakun e krijimit të detyrimeve të reja prapambetura. Lidhja e kontratës të bëhet vetëm pasi fondi që parashikon procedura e prokurimit do të jetë në dispozicion (në llogarinë e thesarit) të autoritetit kontraktor.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat

vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Vlera totale e borxhit tatimor në Bashkinë Has paraqitet:

**Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2022 është 4,645,585 lekë nga të cilat:**

- Detyrimet nga taksat dhe tarifatat për biznesin në shumën 2,589,724 lekë;
- Detyrime nga institucionet shtetërore në shumën 52,120 lekë;
- Detyrime nga qiratë e tregut (markata) në shumën 653,133 lekë;
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,337,708 lekë;
- Detyrime kontraktore nga qiradhënie të tokës bujqësore në vlerën 12,900 lekë

Në uljen e debitorëve kanë ndikuar pagesat e kryera për detyrimet debitorë të viteve para vitit 2021 në vlerën 2,514,241 lekë, dhe për vitin 2022 në vlerën 2,131,344 lekë.

**Gjendja e debitorëve progresiv në fund të vitit 2022 është në vlerën 42,557,390 lekë.**

Mosarkëtimi i taksave dhe të ardhurave nga kjo njësi vendore është në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1 Rekomandim** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive **42,557,390 lekë** e përbërë nga:

- 26,825,739 lekë për 187 subjekte private (biznesi i madh dhe i vogël);
- 4,861,266 lekë për qiratë e ambienteve të tregut (Markata e Qytetit Krume);
- 10,619,005 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet;
- 96,900 lekë nga kontratat e dhënies me qira të aseteve;
- 154,480 lekë nga institucione publike;

*a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).*

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.*

*e- Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Has, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.*

*f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.*

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**5. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu,

familjet në Bashkinë Has nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifave të tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si, taksa e truallit. Si rezultat, procesi i llogaritjes së detyrimit të familjeve për taksat dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar, duke sjellë si pasojë mos njohjen e numrit të familjeve debitore dhe vlerën totale që ato kanë ndaj Bashkisë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr. 78, datë 22.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has”, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1 Rekomandim:** Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa për krijimin e regjistrimit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

### *Brenda vitit 2023*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se **taksa mbi tokën bujqësore** është realizuar 35 mijë lekë nga 67 mijë lekë e planifikuar ose në masën 52%. Nga auditimi konstatohet se në Bashkinë Has nuk është hartuar regjistër dhe nuk llogaritet detyrim për kategorinë e taksapaguesve familjar për taksën mbi tokën bujqësore. Sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet taksa e tokës bujqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe VKB-së nr. 104 datë 25.12.2020 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2021” pika 4/b (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1 Rekomandim:** Bashkia Has, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Has.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ecurisë së pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet *rezulton se*, në Bashkinë Has ka detyrime të pa paguara në vlerën 9,282,639 lekë për 239 objekte objekte që janë legalizuar që nga viti 2017 deri në 31.12.2020 Nga korespondenca zyrtare e Bashkisë Has me ASHK **në vitin 2022** rezulton se:

- **Për vitin 2021** janë kryer 25 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përlllogaritur prej 1,338,065 lekë, ku janë debitorë 19 individë në vlerën 1,090,592 lekë.

- **Për vitin 2022** janë kryer 12 legalizime me vlerën e taksës së infrastrukturës të përlllogaritur prej 545,206 lekë, ku janë debitorë 8 individë në vlerën 247,216 lekë.

Pra gjatë vitit 2022 listës së debitoreve i janë shtuar 37 individë për taksën e infrastrukturës është 1,337,708 lekë, ndërsa në vlerë progresive deri në 31.12.2022 është 10,620,347 lekë për 276 objekte, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has. Kjo procedurë është në kundërshtim me ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” pika 5 dhe me VKB nr. 78 datë 22.12.2021 “Për miratimin e taksave

dhe tarifave vendore në Bashkinë Has për vitin 2022” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1 Rekomandim:** Sektori i Planifikimit, të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Has të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 276 debitorë në vlerën 10,620,347 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Has të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen si dhe për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has në kuadër të administrimit të aseteve për krijimin e të ardhurave ka lidhur 26 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi apo në përdorim. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik për afate kohore nga 1-30 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, për aktivitet bujqësor, për pemtari, objekte banimi, Antena, venddepozitim minerali dhe ngritje fabrike perpunimi, studim-kerkim-zbulim, agroturizëm etj. Referuar tabelës së kontratave të qirave me të dhënat të nxjerrë dokumentacioni i dosjeve nga rezultoni se në fund të vitit 2022 paraqiten 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 2,965,416 lekë të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Has**. Gjithashtu për qiramarrësit, që nuk kanë paguar detyrimet e qirasë nga Sektori i Taksave dhe Tarifave nuk është llogaritur kamatëvonesa prej 0.01% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% e vlerës së kontratës.

Theksojmë se në rastin e qiramarrësit “F” SHPK kontrata bazë 9 vjeçare e datës 12.01.2015 me tarifë qiraje 465,000 lekë është amenduar me kontratën e datës 01.06.2016, ku sipërfaqja e marrë me qira dhe afati nuk ndryshon, por ka ndryshuar vlera e kontratës në 91,350 lekë i pa shoqëruar me relacion për shpjegimin arsyeve të ndryshimit të vlerës së qirasë vjetore. Kjo ka sjellë diferencën në pagesë nga qiramarrësi prej 2,241,900 lekë (2,790,000 - 465,000), e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Has, e cila është pjesë e shumës debitorë të mësipërme.

Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezultoni se në territorin e Bashkisë Has ushtrojnë aktivitetin 21 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullor, asete të Bashkisë Has. Nga bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitimin mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere dhe shtrati lumi, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Has. Këto veprime janë në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjit nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 8 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në **vlerën 2,965,416 lekë** dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave. Gjithashtu nga strukturat drejtuese për 21 rastet e subjekteve subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare e inertesh, që ushtrojnë aktivitetin e licencuar në parcelat e fondit pyjor-

kullosor, asete të Bashkisë Has, të shqyrtohet dokumentacioni i tyre dhe të kryhen kontrolli dhe matja në terren i parcelave që shfrytëzohen dhe finalizimi i procesit me lidhjen e kontratave të qiradhënies për sigurimin e të ardhurave dhe rehabilitimin e sipërfaqeve nga zhfrytëzimi nga ana e këtyre subjekteve të aseteve të bashkisë. Nëse ka pengesë në realizimin e këtij procesi të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse deri në pezullimin e veprimtarisë.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se, Bashkia Has ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Konstatohet se 6 subjekte nga 9 subjekte që kanë ushtruar aktivitet kanë paguar rregullisht detyrimin vjetor për autorizimin/licencën. Subjekti “D.H” shpk, të cilëve u ka përfunduar autorizimi më datë 17.11.2022 dhe “D. M.” shpk në datën 28.03.2022 nuk janë pajisur me autorizim të ri nga Bashkia Has. Nisur nga të dhënat e dosjeve të subjekteve konstatohet se në 3 raste subjektet kanë mbyllur aktivitetin (“E.”shpk në vlerën 100,000 lekë, “K.L.”shpk në vlerën 707,000 lekë dhe “H.” shpk në vlerën 200,000 lekë), të cilët nuk kanë paguar detyrimin deri në fund të vitit 2022 për vlerën 1,007,000 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për vitin 2022 në buxhetin e bashkisë Has. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, nenet 4,15 dhe 20/2” dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, kreu II, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjekteve “D.H” shpk dhe “D.M.” shpk të marrë masa, që këta subjekte të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur prej 1000,000 lekë ndaj Bashkisë Has për 5 vjet, duke filluar nga data e mbarimit në vitin 2022. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Procedurës së mbajtjes së kontabilitetit nga Sektori i Financës i mungon libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese, çka tregon se veprimet me llogaritë nuk kanë ndjekur rrjedhën logjike kontabël për nxjerrjen e bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu II pika 2.2 “Dokumentet kontabël që përdoren në sektorin publik” Kreu III, pika 3.2, nënpikat 43,44,45. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 46-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Buxhetit, Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të marrë masa, që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave

financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare duke ndjekur fazat në mënyrë llogjike, që nga mbajtja e dokumentave përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, të bëjë në fund kryerjen e veprimeve të mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar dhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat të kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**11. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 423-429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba” paraqitet në të njëjtën vlerë prej 914,949 lekë si në fund të vitit 2021 dhe në fund të vitit 2022. Kjo vlerë është trashëguar nga konsolidimi i pasqyrave financiare të aparatit të Bashkisë Has me ish komunat me reformën territoriale të vitit 2015. Kjo vlerë i përket bilancit të ish-komunës Gjinaj, për të cilën nuk ka analizë të detajuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 46-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandim:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin financiar të ish-komunës Gjinaj, mbi bazë të së cilës të analizojë dhe të përcaktojë të drejtat e konstatuara për arkëtim, duke përcaktuar personat përgjegjës material me shumat përkatëse që I kanë detyrim Bashkisë për kthim. Nëse është e pamundur Bashkia Has të ndjekë hapat ligjorë për njohjen ose jo të këtij detyrimi dhe më pas të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet.

***Brenda datës 31.03.2024***

**12. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime” në fund të vitit 2022, rezulton në vlerë neto 1,791,490 lekë dhe vlerë historike 9,729,027 lekë, që i përket 27 projekt-studimeve për investime të kryera në vitet e mëparshme, vlerë e cila nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv apo në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme “Aneksi 1. pika 2, Klasa 2 “Aktivet Afatgjata” Pika 3.3 nën-pika 62 dhe Kreu II, pika 16/b.d (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 46-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1 Rekomandim:** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Taksave dhe Tarifave Vendore të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës 1,791,490 lekë që i përket 27 projekt-studimeve sipas investimeve të kryera dhe për cdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij. Më pas të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

***Brenda datës 31.03.2024***

**13. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën prej 28,103,657 lekë, vlerë kjo, e cila nuk

rakordon me shumën e gjendjeve të llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në vlerën 28,103,657 lekë dhe llogarisë 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme” në vlerën 11,333,144 lekë të bilancit, pasi kjo gjendje duhet të pasqyrohet detyrimin e plotë, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara, ndërkohë që vlera e tyre në fakt në fund të vitit 2022 është 39,436,801 lekë. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 46-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1 Rekomandim;** Drejtoria e Buxhetit, Financës, Takasve dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Has të kryejë veprimet e sistemimit kontabël për vlerat e detyrimeve, që ka shteti ndaj institucionit, të cilat janë paraqitur gabim në llogaritë e fondeve në pasqyrën e performancës (llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”). Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2022, si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2023 të ketë në konsideratë, që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

*Brenda datës 31.03.2024*

**14. Gjetje nga auditimi:** Gjatë zhvillimit të të gjithë procedurave të prokurimit publik nga Bashkia Has për vitet 2021-2022 u vu re mungesa e hartimit të raporteve përmbledhëse. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 99. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 63-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1 Rekomandimi:** Bashkia Has, të marrë masa për shqyrtimin e kërkesave ligjore për hartimin e raporteve përmbledhëse gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Në të gjitha dosjet e audituara në Bashkinë Has për periudhën 2021-2022, vihet re se të gjitha shkresat që ndodhen në dosjet e prokurimit proces verbale, urdhra të Kryetarit për ngritjen e NJP, KVO, Vendime të Kryetarit etj, nuk kanë numër protokolli. Bashkia Has i regjistron urdhrat dhe vendimet në një regjistër elektronik që administrohet nga Zv/Kryetari i Bashkisë, ndërsa punonjësja e protokoll-arkivës nuk ka asnjë informacion lidhur me këto urdhra dhe vendime. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Vendimin nr. 4, datë 19.06.2017 “Për miratimin e Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” neni 4 Dokumentet administrative pika 1, Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 12, neni 13, neni 19. Gjithashtu, u evidentua se për asnjë dosje nuk është bërë inventarizimi dhe arkivimi, veprime këto në kundërshtim me kuadrin rregullator për arkivat dhe normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor, si dhe Urdhrit nr. 57, datë 12.06.2014, pika III, hapi 5. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 63-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1 Rekomandim:** Titullari i Bashkisë Has të marrë masa të menjëhershme që shkresat e brendshme si urdhri apo vendimi etj të regjistrohen në regjistrin e korrespondencës si dhe të marrin numër protokolli dhe numrin e aktit në rastin konkret urdhër apo vendim i brendshëm. Gjithashtu, të marrë masa për arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të përfunduara dhe dosjeve që do të mbyllën në vijimësi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**16. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatua 1 praktikë tek e cila nuk pasqyrohet dokumentacioni i plotë i pronësisë për të gjithë sipërfaqen që do të zhvillohet, në përputhje me dokumentacionin e paraqitur në lejen e zhvillimit dhe me planvendosjen e miratuar, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H. ShPK dhe aplikues

E.M, në fshatin "Vranisht", Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me VKM 408, Neni 15, pika 1.b), dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1 Rekomandim:** Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar dokumentacionin e pronësisë përpara miratimit të lejes së ndërtimit, në përputhje me lejen e zhvillimit dhe planvendosjen e propozuar. Për zhvillimin e ndërtimeve, të aplikohet për leje ndërtimi duke ngarkuar në sistemin e-leje dokumentacionin e pronësisë që përfshin të gjithë sipërfaqen e pasurisë në të cilën do të zhvillohet objekti, në përputhje me planvendosjen dhe të dhënat e treguesve të zhvillimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat nuk ishte konvertuar statusi i pronësisë nga tokë "arë" në tokë "truall", për të gjithë sipërfaqen e parcelës që do të zhvillohej ndërtimi, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, në përputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor dhe legjislacionin në fuqi, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt: 1. "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H. ShPK dhe aplikues E.M, në fshatin "Vranisht", Has dhe 2. "Objekt Banimi 2-katesh me papafingo", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë ,Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Vendim Nr. 440, datë 3.6.2020, pika 6, për kalimet dhe ndryshimet e kategorive të resurseve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1 Rekomandim:** Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar statusin e pronësisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara për zhvillimin e njësive përkatëse dhe konvertimin e të gjithë sipërfaqës së pasurisë në truall për të vijuar më tej me zhvillimin e ndërtimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**18. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 4 praktika tek të cilat pasqyrohej e njëjta situatë, në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane, të tilla si koeficienti i shfrytëzimit të territorit, intensitetit të ndërtimit, lartësia e ndërtimit, të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt: 1. "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H. ShPK dhe aplikues E.M, në fshatin "Vranisht", Has; 2. "Shtesë anësore dhe 2-kat në lartësi në ndërtimin ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç., Krumë ,Has; 3. "Projekt zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 26, datë 20/05/2022, me zhvillues Q. P. dhe aplikues Dh. P., Rruga e Kukësit, Has; 4. "Objekt Banimi 2-katesh me papafingo" për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me **Ligjin 107, Neni 20**, Plani i Përgjithshëm Vendor, me **VKM-së 408, Neni 32, Kushtet bazë të zhvillimit në nivel njësie, pika 1, me VKM-së 408**, Neni 38, Intensiteti i ndërtimit, me **VKM-së 408**, Neni 39, Koeficienti i shfrytëzimit të territorit për ndërtim, me Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1 Rekomandim:** Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar të gjitha materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, dokumentacionin e pronësisë, planvendosjen me të gjithë



elementët përbërës të saj, projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**19. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 3 praktika tek të cilat evidentohet e njëjta situatë, në lidhje me mosparaqitjen në planvendosje të distancës nga kufiri i pronës dhe mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt: 1. "Lokal 2 kate+ podrum", për të cilën është marrë vendimi me Nr.25, datë 28/03/2022, me zhvillues D.H.ShPK dhe aplikues E.M, në fshatin "Vranisht", Has; 2. "Shtesë anësore dhe 2 kat në lartësi në ndërtimin ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr.18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç.,Krumë ,Has; 3."Objekt Banimi 2-katesh me papafingo" për të cilën është marrë vendimi me Nr. 19, datë 26/08/2021, me zhvillues S. S. dhe aplikues T. Ç., Krumë, Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me **VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, neni 35**, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**19.1 Rekomandim:** Nga DPZHT Has të merren masa që të verifikohen pasqyrimi i distancave ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës në planvendosjen e miratuar, si edhe distancat të jenë në përputhje me distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**20. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 2 praktika tek të cilat evidentohet e njëjta situatë, në lidhje me mospërcaktimin e saktë të numrit të kateve në planvendosje dhe respektimin e distancave midis ndërtimeve, në bazë të legjislacionit në fuqi, përkatësisht në lejet e ndërtimit të miratuar me objekt: 1."Projekt-zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 26, datë 20/05/2022, me zhvillues Q. P. dhe aplikues Dh. P., Rruga e Kukësit ,Has; 2. "Shtesë anësore dhe 2-kat në lartësi në ndërtimin ekzistues", për të cilën është marrë vendimi me Nr. 18, datë 26/08/2021, me zhvillues A. Sh. dhe aplikues T. Ç., Krumë. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me **VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, Neni 37**, lartësia e ndërtimeve dhe me **VKM 408, Neni 34**, distancat minimale midis ndërtimeve. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1 Rekomandim:** Nga DPZHT Has të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në lidhje me përcaktimin e numrit të kateve të objektit, duke i verifikuar me projektin e ndërtimit dhe respektimin e distancave ndërmjet ndërtimeve.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**21. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktika tek e cila nuk pasqyrohet e saktë distanca ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës, duke krijuar hapësirë për të mos respektuar distancën minimale të lejuar, përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: "Projekt-zbatim për shtëpi banimi 2 kate shtesë mbi një kat ekzistues" me zhvillues Q. P. dhe aplikues Dh. P., Rruga e Kukësit ,Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me **VKM Nr. 408, datë 13.5.2015, neni 36**. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**21.1 Rekomandim:** Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar në planvendosje paraqitjen e të gjitha distancave të nevojshme që nevojiten të respektohen ndërmjet objektit dhe trupit të rrugës.

## *Menjëherë dhe në vijimësi*

**22. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila tipologjia e ndërtimit dhe e objektit nuk ishte në përputhshmëri me tipologjinë e ndërtimit të lejuar në zonë , përkatësisht në lejen e ndërtimit të miratuar me objekt: “Ambjente sherbimi, punime dhe infrastrukture mbeshetese per pemtoren me arra”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 23, datë 16/03/2022, me zhvillues K.C.2020 ShPK dhe aplikues K. P., Fshati Helshan, Has. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me Ligjin Nr. 9244, datë 17.6.2004, "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", të ndryshuar, Nenit 14 dhe me kontratën e qirasë "Për dhënien me qira të tokës bujqësore. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**22.1 Rekomandim:** Nga DPZHT Has të merren masa për të verifikuar projektin e ndërtimit, në përputhje me kondicionet urbane të lejuara në zonë dhe në përputhje me të gjithë dokumentacionin e ngarkuar në sistem, duke përfshirë edhe marrëveshjet dhe kontratat e qirave. Nëse evidentohet mospërputhshmëri ndërmjet projektit të miratuar dhe kushteve të kontratës së qirasë, të rishikohet vlefshmëria e kontratës për dhënien me qira të tokës bujqësore.

## *Menjëherë dhe në vijimësi*

**23. Gjetje nga auditimi:** Në njoftimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, nuk paraqitet mënyra e për llogaritjes së saj, e evidentuar në të gjitha lejet e ndërtimit të miratuara. Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me **Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006** "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit Bashkiak Has. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**23.1 Rekomandim:** Nga Bashkia Has të merren masa për të pasqyruar në njoftimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë mënyrën e për llogaritjes së taksës, me qëllim që të jetë e qartë dhe e argumentuar vlera e taksës së ndikimit në infrastrukturë që duhet likuiduar.

## *Menjëherë dhe në vijimësi*

**24. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Has për vitin 2022 struktura e IMTV-së nuk ka qenë funksionale. Kjo vjen si rezultat i mungesës së një Sektori të Mbrojtjes së Territorit dhe mungesës së Kryeinspektorit. Në strukturën e vitit 2022 janë 2 punonjës të emëruar në pozicionin e Inspektorit të Terrenit, 1 në Sektorin e Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës dhe 1 në NjA Golaj. Inspektorët nuk kanë plane pune mujore ku të jetë parashikuar edhe mbikëqyrja që ato duhet të bëjnë në vazhdimësi për zbatimin e kushteve të lejeve të dhëna nga bashkia. Bashkia Has nuk ka blloqe që të kenë një numër serial të fletëve për procesverbalet që mban në rastet e konstatimit të kundërvajtjes, të marrjes së masës së pezullimit të punimeve apo të marrjes së masës së prishjes së ndërtimit. Proces verbalet e konstatimit të kundërvajtjes janë një model që inspektorët i printojnë rast pas rasti dhe i plotësojnë kur janë në terren. Gjatë inspektimeve në terren janë mbajtur proces verbale dhe janë vendosur gjopa vetëm me firmën e një inspektori. Nga mos funksionimi i plotë i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit nga Bashkia Has nuk mund të vendosen gjopa apo të merren masa të tjera për veprimet e kundërligjshme të konstatuara në mbrojtjen e territorit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 13 pika 1/b/ii, pika 1/c/i, pika 4. Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 122-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**24.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Has të marrë të gjitha masat për të plotësuar strukturën e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit me qëllim zbatimin e ligjshmërisë në fushën e kontrollit dhe zhvillimit të territorit. Kryeinspektori të marrë masat e nevojshme për të hartuar

planet mujore të punës ku të parashikohet edhe mbikëqyrja që ato duhet të bëjnë në vazhdimësi për zbatimin e kushteve të lejeve të dhëna nga bashkia. Kryeinspektori të marrë masa që të verifikohen në terren të gjitha proces verbalet që janë mbajtur vetëm me firmën e një inspektori. Në përfundim të këtyre verifikimeve të merren masat administrative përkatëse për të gjithë kundërvajtësit. Kryeinspektori të marrë masat që për inspektimet që do të kryhen të përdoren dokumentet e duhura duke filluar nga procesverbalet që mbahen në rastet e konstatimit të kundërvajtjes, për pezullimin e punimeve, për prishjen e ndërtimit apo në rastet e vendosjes së gjobave. Këto dokumente të kenë një numër serial të fletëve duke zvogëluar mundësinë për gabime apo abuzime.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**25. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Has nuk ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH si dhe nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 124-143 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**25.1 Rekomandimi:** Bashkia Has të marrë masa për të hartuar një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lënë nga KLSH, si dhe të kryej raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i ankesë së paraqitur në KLSH lidhur me vendosjen e bustit të Pjetër Bogdanit rezulton se:

- Projekti është planifikuar me bashkëfinancim nga fondet e Bashkisë Has (*bazamenti*) dhe nga donatorë (*busti*).

- Nuk ka një vlerë totale të veprës për të llogaritur se sa % është financuar nga Bashkia Has dhe sa % nga donatorët. Dihet vetëm vlera që bashkia ka investuar për bazamentin (794,000 lekë pa TVSH dhe 952,800 lekë me TVSH).

- Lidhur me financimin e bustit që është bërë nga donatorë privatë nuk ka dokumentacion se sa ka qenë vlera e tij dhe nuk është dokumentuar procesi.

- Në dokumentacionin e audituar nuk është identifikuar se kush është donatori. Nuk ka asnjë korrespondencë shkresore midis Bashkisë Has dhe donatorit. Strukturat e bashkisë deklarojnë se komunikimi për këtë projekt ka qenë verbal.

- Busti i dhuruar nuk është shoqëruar me dokumentacionin përkatës, në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 57.

- Investimi i bërë nga bashkia (bazamenti) nuk është bërë hyrje nga Bashkia Has por është klasifikuar si shpenzim në zërin 602. Veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 143-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**26.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Has të ngrëjë një grup pune për të verifikuar dhe dokumentuar procesin e ndjekur për vendosjen e bustit të Pjetër Bogdanit si dhe të merren masa për të plotësuar dokumentacionin me qëllim vlerësimin e veprës dhe regjistrimin e saj në inventarin e Bashkisë Has.

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se mënyra e përlllogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë nuk është llogaritur në mënyrën e duhur, në bazë të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratura për leje ndërtimi, me objekt: “Ambjente sherbimi, punime dhe infrastrukture mbeshtetese per pemtoren me arra”, për të cilën është marrë vendimi me Nr. 23, datë 16/03/2022, me zhvillues K. C. 2020 ShPK dhe aplikues K.P., Fshati Helshan, Has, me diferencë të taksës së ndikimit në infrastrukturë prej **265,845.521 lekë**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 46 dhe ligjit Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 110-122 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandim:** Nga Bashkia Has të merren masa për arkëtimin e vlerave që përbëjnë një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.

*Menjëherë*

**1.2 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Has të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës **265,845.521 lekë**, nga subjekti "K.C. 2020" ShPK, përfitues në mënyrë të pa drejtë të kësaj vlere, si rezultat i llogaritjes së gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

*Deri më 31.12.2023*

## **C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1.1 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimin e 6 procedurave të prokurimit për vitin 2021 me vlerë të fondit limit 21,878,340 lekë pa TVSh, ka rezultuar se në të 6 procedurat janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore për prokurimet publike. Në këto 6 procedura ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të dokumenteve të tenderit, si dhe përmendja e markës së prodhimit në preventivin e artikujve në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 21,878,340 lekë, si vijon:

**1.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje Karburanti për Mjetet motorike dhe ngrohjen e shkollave të Bashkisë Has” viti 2021, me fond limit 5,041,667 lekë pa TVSh, me fitues OE “V.P.” ShPK, me vlerë oferte 5,041,667 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 5,041,667 lekë pa TVSh;

**2.** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje artikuj ushqimor për nevojat e konviktit “KOSOVA” viti 2021, me fond limit 1,761,345 lekë pa TVSh, me fitues OE “B. H.” ShPK, me vlerë oferte 1,761,345 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 1,761,345 lekë pa TVSh, si dhe rezulton se Njësia e Prokurimit gjatë hartimit të preventivit me artikujt ushqimorë, si orizi, njësia matëse e salcës për formatin e ambalazhimit, vaji dhe vezët ka përmendur markën e prodhimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin Publik”, neni 36, pika 4;

3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Pastrimi i Kanaleve Ujitëse të Ujëmbledhësve” viti 2021, me fond limit 4,467,291 lekë pa TVSh, me fitues OE “Z.” SHPK, me vlerë oferte 4,467,291 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 4,467,291 lekë pa TVSh;

4. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shpenzime Rehabilitimi, Mirëmbajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime” viti 2021, me fond limit 5,740,833 lekë pa TVSh, me fitues BOE “D.” SHPK dhe “Xh.” SHPK, me vlerë oferte 5,740,833 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 5,740,833 lekë pa TVSh;

5. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore” viti 2021, me fond limit 2,527,900 lekë pa TVSh, me fitues OE “D.H.” SHPK, me vlerë oferte 2,527,900 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 2,527,900 lekë pa TVSh;

6. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtim Lera Uji Plasmasi në Territorin e Fshatit Pusi Thatë” viti 2021, me fond limit 2,339,304 lekë pa TVSh, me fitues OE “V. G” SHPK, me vlerë oferte 2,339,304 lekë pa TVSh, KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, në kundërshtim me legjislacionin për prokurimet publike duke sjellë përdorim pa ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike për vlerën 2,339,304 lekë pa TVSh.

**1.2 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimin i 8 procedurave të prokurimit për vitin 2022 me vlerë totale të fondit limit 41,707,499 lekë pa TVSh, kanë rezultuar me shkelje të kuadrit ligjor për prokurimin publik 6 procedura me vlerë totale të fondit limit 29,866,666 lekë pa TVSh ose 72% e fondit limit. Përkatësisht, shkelje janë konstatuar në hartimin e fondit limit dhe të preventivit të punimeve në 5 procedura. Në hartimin e kriterëve të vendosura jo në përputhje me objektin e kontratës si dhe nuk është bërë argumentimi i tyre në rastin e 3 procedurave. Janë kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë kriteret e vendosura në DT dhe kanë mangësi në dokumentacionin e paraqitur në 6 procedura, përkatësisht si vijon:

1. Procedura e prokurimit me objekt: “*Pastrimi i kanaleve ujitëse, kryesore dhe dytësore të ujëmbledhësve*”, *Fondi Limit 5,333,333.0 lekë pa TVSH*. Ka ndryshime në zërat e punimeve nga procesverbali që është mbajtur për hartimin e fondit limit me preventivin e punimeve. Komisioni i hartimit të Fondit dhe Njësia e Prokurimit nuk kanë argumentuar dhe dokumentuar ndryshimet e bëra në zërat e punimeve dhe çfarë ndikimi kanë këto në realizimin e kontratës. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka kualifikuar dhe ka shpallur fitues BOE V.G. SHPK, & I.G. SHPK me vlerë oferte 4,783,363.0 lekë pa TVSH, i cili nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe ka mangësi në dokumentacionin e paraqitur.

2. Procedura e prokurimit me objekt: “*Rehabilitim dhe pastrim i sipërfaqe pyjore*”, *Fondi Limit 1,833,333 lekë pa TVSH*. Njësia e Prokurimit nuk ka zbatuar detyrimet ligjore gjatë hartimit të kriterëve për kualifikim duke vendosur kriteret e pa argumentuara. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "L." SHPK, & "D.C. 2014" SHPK, me vlerë oferte 1,629,450 lekë pa TVSH në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.

3. Procedura e prokurimit me objekt: “*Ndërtim KUZ, Fshati Gajrep, Krumë, Golaj*”, *Fondi Limit 5,500,000.0 lekë pa TVSH*. Nuk është argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritja e vlerës së kontratës. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE “V.G.” SHPK & “A.-2A CO” SHPK me vlerë oferte 4,948,900.0 lekë pa TVSH, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.

4. Procedura e prokurimit me objekt: “Shpenzime Mirëmbajtje Objekte Ndërtimore”, Bashkia Has, Fondi Limit 3,000,000 lekë pa TVSH. Ka pasaktësi në përlllogaritja e vlerës së fondit limit dhe ndryshim i zërave të punimeve nga proces verbali i hartimit të fondit limit në preventivin e punimeve. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues BOE "H.-G. C." SHPK, dhe "C" SHPK, me vlerë oferte 2,490,953 pa TVSH, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.

5. Procedura e prokurimit me objekt: “Rikonstruksion i ambienteve të brendshme, ish shkolla mesme Krume- Kati I-rë (Teknik), në funksion të kopshtit të fëmijëve Qyteti Krumë”, Fondi Limit 4,200,000.0 lekë pa TVSH. Nuk është argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritja e vlerës së fondit limit. Komisioni për Vlerësimin e Fondit Limit nuk ka dokumentuar llogaritjen e vlerës për 34 zëra punimesh. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "D.-G" SHPK me vlerë oferte 4,017,950.0 lekë pa TVSH, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT.

6. Procedura e prokurimit me objekt: “Blerje Automjet Teknologjik (kamion) për Grumbullim-Kompaktim-Shkarkim të mbeturinave”, Fondi Limit 10,000,000 lekë pa TVSH. Nuk është argumentuar dhe dokumentuar përlllogaritja e vlerës së kontratës. Komisioni nuk ka argumentuar vlerat e parashikuara për blerjen e automjetit dhe të konteinerëve. KVO ka kualifikuar dhe shpallur fitues OE "T." SHPK, me vlerë oferte 9,729,540.0 lekë pa TVSH, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në DT. *Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 63-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1-1.2/1 Rekomandim:** Titullari i AK të marrë masa që Komisioni për Hartimin e Fondit Limit të argumentojë zërat e punimeve, volumin dhe vlerën e tyre me qëllim shmangien e ndryshimit të pa argumentuar gjatë hartimit dhe miratimit të preventivit të punimeve.

**1.1-1.2/2 Rekomandim:** Titullari i AK duhet të marrë masa që NJP në hartimin e DT, duhet të formulojë detyrimisht specifikime teknike që janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar.

**1.1-1.2/3 Rekomandim:** Titullari i AK dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të kualifikimit të OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë. Gjithashtu, të bëhet argumentimi i saktë i skualifikimit apo kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## D. MASA DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 germa b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore”, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, “Masa disiplinore”, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Has** t’i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

## V. ANEKSET

Aneksi nr. 2/1: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për Bashkinë Has për 2022.

Në 000 lekë

	<b>TË ARDHURAT viti 2022</b>	<b>Plan</b>	<b>Fakt</b>	<b>Realizimi ne %</b>
<b>A</b>	<b>Të Ardhura nga Burimet e Veta</b>	29,126	35,054	120
<b>A.1</b>	<b>Të Ardhura nga Taksat Lokale</b>	<b>3,817</b>	<b>3,196</b>	0.84
<b>A.1.1</b>	<b>Taksa vendore mbi biznesin e vogël</b>	<b>400</b>	<b>30</b>	0.08
<b>A.1.2</b>	<b>Taksa mbi pasurinë e paluajtshme</b>	<b>1,709</b>	<b>1,061</b>	0.62
A.1.2.1	Taksa mbi ndërtesën	1,642	977	0.60
A.1.2.2	Taksa mbi tokën bujqësore	67	35	0.52
A.1.2.3	Taksa mbi truallin	-	49	pa plan
<b>A.1.3</b>	<b>Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja</b>	<b>1,575</b>	<b>1,918</b>	122
<b>A.1.4</b>	<b>Taksa e tabelës</b>	<b>133</b>	<b>187</b>	141
<b>A.2</b>	<b>Të Ardhurat nga Taksat e Ndara</b>	<b>10,170</b>	<b>14,653</b>	144
<b>A.2.1</b>	<b>Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme</b>	-	645	pa plan
<b>A.2.2</b>	<b>Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura</b>	7,500	9,017	120
<b>A.2.3</b>	<b>Taksa e rentës minerare</b>	250	25	0.10
<b>A.2.4</b>	<b>Taksa mbi të ardhurat personale</b>	2,420	4,966	205
<b>A.3</b>	<b>Të Ardhurat nga Tarifat Vendore</b>	<b>9,926</b>	<b>9,387</b>	0.95
<b>A.3.1</b>	<b>Tarifa e menaxhimit të mbetjeve</b>	4,859	5,510	113
A.3.1.1	Tarifa e pastrimit për familjet	1,632	1,314	0.81
A.3.1.2	Tarifa e pastrimit për institucionet	600	560	0.93
A.3.1.3	Tarifa e pastrimit për biznesin	2,627	3,636	138
<b>A.3.2</b>	<b>Tarifa për ndriçimin publik</b>	<b>370</b>	<b>355</b>	0.96
A.3.2.1	Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet	60	56	0.93
A.3.2.2	Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi	310	299	0.96
<b>A.3.3</b>	<b>Tarifa për gjelbërimin</b>	<b>191</b>	<b>203</b>	1.06
A.3.3.1	Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet	47	42	0.89
A.3.3.2	Tarifa për gjelbërimin nga bizneset	144	161	112
<b>A.3.4</b>	<b>Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë</b>	<b>2,872</b>	<b>2,379</b>	0.83
A.3.4.1	Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura	63	-	-
A.3.4.2	Tarifa e liçensimit të veprimtarive të transportit	224	176	0.79
A.3.4.3	Tarifa për dhënie liçense për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj	1,200	1,020	0.85
A.3.4.4	Tarifa për pyjet dhe kullotat	840	647	0.77
A.3.4.5	Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja	20	5	0.25
A.3.4.6	Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave	525	531	101
<b>A.3.5</b>	<b>Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj</b>	<b>300</b>	<b>111</b>	0.37
A.3.5.1	Mensa (Konviktet)	300	111	0.37

A.3.6	Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime	147	-	-
A.3.7	Tarifa për shërbimin e ujitjes dhe kullimit	630	414	0.66
A.3.8	Tarifa të tjera	557	415	0.75
A.4	<b>Të Ardhurat e Tjera</b>	<b>5,213</b>	<b>7,818</b>	<b>150</b>
A.4.1	Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë	3,527	4,158	118
A.4.2	Kundravajtjet administrative (Gjobat)	300	128	0.43
A.4.3	Trasferta dhe ndihma nga njësitë e tjera vendore	-	2,500	pa plan
A.4.4	Grante nga ndihma ndërkombëtare	1,386	1,032	0.74
	<b>TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË</b>	<b>29,126</b>	<b>35,054</b>	<b>120</b>

Burimi: Bashkia Has, përpunoi grupi i auditimit

Aneksi nr. 2/2: Rastet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet nxjerrje prodhim minerale dhe inertesh.

Nr.	Nr. Leje	Datë akt-miratimi	Emri i subjektit	Emërtimi i vendburimit	Lloji i mineralit	Ha	Lloji i lejes
1	645/1	27.08.2001	V. M. A. Shpk	Qafa e Perrollajt	Krom	11.9	Shfrytëzimi
2	687/1	06.01.2003	2. - G. shpk	Rrethi Has, Qarku Kukës	Gur Gëlqeror	2.5	Shfrytëzimi
3	769	28.06.2004	N. - 2004 shpk	Miniera Vllahen, profili XXVXXV deri XLII-XLII	Krom	8.9	Shfrytëzimi
4	1340	11.05.2009	I. M. P. -Al shpk	Bregu i Skatines - dalja 1	Krom	13.7	Shfrytëzimi
5	1346	20.05.2009	E.. - 06 SHPK	Vllahna Lindore	Krom	24	Shfrytëzimi
6	1347	20.05.2009	A. K shpk	Gajrep	Krom	6.6	Shfrytëzimi
7	1353/1	26.05.2009	Fabrika e Pasurimit te Kromit	Gjelaj 4	Krom	10.8	Shfrytëzimi
8	1405	31.08.2009	Bulqize shpk	Vllahna Veriore	Krom	14.6	Shfrytëzimi
9	1468	29.04.2010	E.C.2011 shpk	Objekti Gajrep	Krom	3.783	Shfrytëzimi
10	1534	23.02.2011	A.K shpk	Objekti Cahan, Vendoset ne afersi te rruges automobilistike	Hekur Nikel	31.9	Shfrytëzimi
11	1629	30.05.2013	B. K 2010 shpk	Maç - Perrollaj	Krom	100	Shfrytëzimi
12	1636	20.06.2013	B.K 2010 shpk	Zejeç	Krom	103.8	Shfrytëzimi
13	1668	06.09.2013	M. - export - import shpk	Vllahna, Komuna Golaj	Krom	113.5	Shfrytëzimi
14	1705	23.05.2014	B. K 2010 shpk	Vllahnë	Krom	6	Shfrytëzimi
15	1721/1	19.06.2014	B. K 2010 shpk	Gezhimë, Rrethi Has	Krom	19.3	Shfrytëzimi
16	1725	10.09.2014	M. F. N shpk	Qafa e Gomurit	Krom	15	Shfrytëzimi
17	1762/2	29.07.2015	E.shpk	Objekti Myç	Hekur Nikel	20.7	Shfrytëzimi
18	1818	28.09.2016	K.M.	Objekti Gjinaj	Hekur Nikel	64.6	Shfrytëzimi
19	1860/1	12.07.2018	V. M. shpk	Vllahen	Krom	184.8	Shfrytëzimi
20	1885	19.12.2019	P.	Gjina	Krom	107.9	Kërk - Zbulim
21	1919	12.07.2021	2. - G. shpk	Përroi i Sefallit	Gëlqeror	2	Shfrytëzimi
					<b>TOTAL</b>	<b>866.283</b>	

Aneksi nr. 3/1: *Formati nr.1 Aktivi i Bilancit 2022 Në lekë*

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	<b>A K T I V E T</b>	<b>2,180,466,935</b>	<b>2,256,531,531</b>
2		<b>I.Aktivët Afat shkurtra</b>	<b>144,102,609</b>	<b>155,785,920</b>
3		<b>1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre</b>	<b>15,496,301</b>	<b>22,984,332</b>
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	15,496,301	22,984,332
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provizjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		<b>2.Gjendje Inventari qarkullues</b>	<b>19,186,719</b>	<b>22,188,858</b>
12	31	Materiale	180,478	623299



13	32	Inventar I imet	19,006,241	21,565,559
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvleresimin e inventarit (-)		
21		<b>3.Llogari te Arketushme</b>	<b>98,086,445</b>	<b>91,523,537</b>
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba	914,949	914,949
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbuloohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitorre te ndryshem	69,067,839	67,319,252
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	28,103,657	23,289,336
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		<b>4.Te tjera aktive afatshkurtra</b>	<b>11,333,144</b>	<b>19,089,193</b>
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te peruidhate te ardhshme	11,333,144	19,089,193
42		<b>II.Aktivitet Afat gjata</b>	<b>2,036,364,326</b>	<b>2,100,745,611</b>
43	<b>20</b>	<b>1.Aktive Afatgjata jo Materiale</b>	<b>1,791,490</b>	<b>2,629,022</b>
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	1,791,490	2,629,022
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	<b>21</b>	<b>2.Aktive Afatgjata Materiale</b>	<b>1,1917,861,010</b>	<b>1,987,025,957</b>
48	210	Toka, T,roje, Terene	1,074,183	1,074,183
49	211	Pyje, Plantacione		
50	212	Ndertesat e Konstruksione	696,890,331	733,469,916
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujqore	1,152,291,128	1193,479,852
52	214	linstalime teknike, makineri e paisje	33,174,975	23,275,649
53	215	Mjete Transporti	19,080,206	19,873,350
54	216	Rezerva Shteterore		
55	217	Kafshe pune e prodhimi		
56	218	Inventar ekonomik	5,181,275	5,684,095
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	10,168,912	10,168,912
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>		
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		<b>4.Investime</b>	<b>116,711,826</b>	<b>111,090,632</b>
63	230	Per Aktive Afatgjata jo Materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata Materiale	116,711,826	111,090,632

*Aneksi nr. 3/2: Inventari kontabël i llogarisë 212 "Ndërtesa" (kosto historike) me 31.12.2022*

Nr.	Emertimi i aktivitet	Gjendja 31.12.2021	Shtesa viti 2022	Gjendja 31.12.2022	Nr.	Emertimi i aktivitet	Gjendja 31.12.2021	Shtesa viti 2022	Gjendja 31.12.2022
1	Çerdhe Qyteti Krume (Kopeshti)	194,840	0	194,840	61	Ambulanca Tregtan	2,336,503	0	2,336,503
2	Ndertesat Çerdhe Fshati Krume	29,050	0	29,050	62	Ambulanca Vranisht	2,372,352	0	2,372,352
3	Ndertesat Kopeshti Zahrisht	19,370	0	19,370	63	Gjendja Civile	298,000	0	298,000

4	Shkolla 9-Vjecare Vlahen	6,502,030	0	6,502,030	64	Godina Njesise Administrative	3,232,730	0	3,232,730
5	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	6,997,095	0	6,997,095	65	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	56,900	0	56,900
6	Amb.Q. Shendetsore Fajza	155,538	0	155,538	66	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	474,000	0	474,000
7	Konvikti Kosova Krume	5,303,666	0	5,303,666	67	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	2,494,532	0	2,494,532
8	Konvikti Kosova Krume	9,687,324	0	9,687,324	68	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	2,238,992	0	2,238,992
9	Ndertesa Markata -Banja	2,585,436	0	2,585,436	69	ndertesa zjarrefikesve(ish dega e mobilizimit)	1,600,000	0	1,600,000
10	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	7,246,245	0	7,246,245	70	Varreza, (rrethim varreza Perollaj)	41,600	0	41,600
11	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	4,972,260	0	4,972,260	71	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	14,296,987	0	14,296,987
12	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	14,269,275	0	14,269,275	72	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	3,552,690	0	3,552,690
13	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	72,000	0	72,000	73	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	38,860,734	0	38,860,734
14	Shkolla 9 - Vjecare Zahrisht	9,000	0	9,000	74	Komuna Fajza	7,182,906	0	7,182,906
15	Ndertesa Poliklinika Krume	29,050	0	29,050	75	Shkolla 9-Vjecare Vranisht	2,500,000	0	2,500,000
16	Ndertesa Pallatit Kultures	5,538,043	0	5,538,043	76	Kopshti Fajza	162,191	0	162,191
17	Ndertim rrethimi Pallatit Kultures	399,960	0	399,960	77	Shkolla 9-Vjecare Zgjec	4,175,247	0	4,175,247
18	Shkolla 9-Vjecare Dobrone	3,698,263	0	3,698,263	78	Ndertesa Bashkia Has	4,066,810	0	4,066,810
19	Shkolla 9-Vjecare Domaj	23,178,411	0	23,178,411	79	Rrethim varreza F.Fajza	150,000	0	150,000
20	Shkolla 9-Vjecare Gjinaj	9,086,045	0	9,086,045	80	Rrethim varreza L.Kuq	318,000	0	318,000
21	Shkolla 9-Vjecare Helshan	34,886,486	0	34,886,486	81	Shkolla 9 - Vjecare Metaliaj	150,000	0	150,000
22	Shkolla 9-Vjecare Helshan	2,520,660	0	2,520,660	82	Shkolla 9 - Vjecare Metaliaj	4,370,355	0	4,370,355
23	Shkolla 9-Vjecare Helshan	2,768,457	0	2,768,457	83	Shkolla 9 Vjeqare Tregtan	3,516,905	0	3,516,905
24	Shkolla 9-Vjecare Helshan	1,420,131	0	1,420,131	84	Shkolla E Mesme Fajza	5,004,230	0	5,004,230
25	Shkolla 9-Vjecare Helshan	151,200	0	151,200	85	Shkolla e re Fajza	24,275,674	0	24,275,674
26	Ambulanca Branoge	1,987,137	0	1,987,137	86	Shkolla 9 - Vjecare Metaliaj	25,903,878	0	25,903,878
27	Ambulanca Liqe-Kuq	1,511,860	0	1,511,860	87	Sholla Fillore B.Krumes	1,754,835	0	1,754,835

28	Ambulanca Metaliaj	1,875,248	0	1,875,248	88	Zyra e Ndermarrjes Has	1,637,488	0	1,637,488
29	Ambulance lagjia Kastrat	129,800	0	129,800	89	Zyrat e vjetra te Llogarise	19,430	0	19,430
30	Ambulance fshati Mujaj	129,800	0	129,800	90	Shkolla 9-Vjecare Golaj	62,252,392	0	62,252,392
31	Shkolla 9-Vjecare Kishaj	12,063,500	0	12,063,500	91	Shkolla Mesme Krume (Fillore)	5,576,799	0	5,576,799
32	Ndertim Rrethimi i Kopeshtit Krume	480,000	0	480,000	92	Shkolla Mesme Krume (Fillore)	2,000,000	0	2,000,000
33	Tregu Agro Ushqimor	49,828,433	0	49,828,433	93	Shkolla Mesme Krume (Fillore)	2,134,942	0	2,134,942
34	Ambulanca Shendetesore Pla te Krumes	1,041,764	0	1,041,764	94	Shkolla Mesme Krume (Ish Shkolla 9-Vjecare)	3,158,778	0	3,158,778
35	Rrethimi i Varrezave te Qytetit Krume	1,998,000	0	1,998,000	95	Shkolla Mesme Krume (Ish Shkolla 9-Vjecare)	3,127,979	0	3,127,979
36	Shkolla 9-Vjecare Krume (Mesme)	4,556,579	0	4,556,579	96	Shkolla Mesme Krume (Ish Shkolla 9-Vjecare)	33,600	0	33,600
37	Shkolla 9-Vjecare Krume (Mesme)	8,143,047	0	8,143,047	97	Shkolla Mesme Krume (Ish Shkolla 9-Vjecare)	3,000	0	3,000
38	Shkolla 9-Vjecare Krume (Mesme)	10,150,000	0	10,150,000	98	Rehabilitim pallatet Qyteti Krume	49,891,610	0	49,891,610
39	Shkolla 9-Vjecare Krume (Mesme)	23,939,794	0	23,939,794	99	Rehabilitim pallatet Qyteti Krume	408,000	0	408,000
40	Ndertesat Pallatit Kultures	414,721	0	414,721	100	Spektori Pyjor Fajza	1,464,500	0	1,464,500
41	Shkolla 9-Vjecare Krume (P Cilesi Barazi Ne Arsim)	80,979,727	0	80,979,727	101	Spektori Pyjor Golaj	1,488,400	0	1,488,400
42	Shkolla 9-Vjecare Krume (P Cilesi Barazi Ne Arsim)	87,724,256	0	87,724,256	102	Spektori Pyjor Helshan	1,741,220	0	1,741,220
43	Shkolla 9-Vjecare Krume (P Cilesi Barazi Ne Arsim)	1,795,875	0	1,795,875	103	posbllok Helshan	426,600	0	426,600
44	Tregu Agro Ushqimor	299,998	0	299,998	104	Rehabilitim pallatet Qyteti Krume	749,029	0	749,029
45	Shkolla 9-Vjecare Mujaj	116,200	0	116,200	105	Shkolla 9-Vjecare Tregtan (rikonstruksion)	4,419,384	0	4,419,384
46	Shkolla 9-Vjecare Myc Has	7,500,239	0	7,500,239	106	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	2,000,000	0	2,000,000
47	Shkolla 9-Vjecare Nikoliq	33,205,088	0	33,205,088	107	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	12,018,238	0	12,018,238
48	Shkolla 9-Vjecare Perollaj	9,571,280	0	9,571,280	108	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	7,031,998	0	7,031,998
49	Shkolla 9-Vjecare Perollaj	5,490,180	0	5,490,180	109	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	6,931,275	0	6,931,275

50	Zbatim per eficencen e energjise Ndertesa 4kt Qender Qytetit Krume	17,388,718	0	17,388,718	110	Pasuria 4/80-N1(zyrat e sig shoqerore)	2,860,988	0	2,860,988
51	Zbatim per eficencen e energjise ndertese 4kt Qender qytetit Krume	117,600	0	117,600	111	Shkolla 9-Vjecare Tregtan	20,132,317	0	20,132,317
52	Rrethim I varrezave te lagjes Nikoliq dhe Krume	1,485,624	0	1,485,624	112	Rindertim I Shkolles 9-Vjecare Letaj	44,033,121	0	44,033,121
53	Zbatim per eficencen e energjise ndertese 4kt Qender qytetit Krume	11,760	0	11,760	113	Shkolla 9-Vjecare Tregtan	117,000	0	117,000
54	Rrethim I varrezave te lagjes Nikoliq dhe Krume	11,520	0	11,520	114	Rindertim I Shkolles 9-Vjecare Letaj	180,000	0	180,000
55	Rehabilitim pallatet Qyteti Krume	52,749,685	0	52,749,685	115	Lulishte qytetit Krume	33,000	0	33,000
56	Rehabilitim pallatet Qyteti Krume	540,000	0	540,000	116	Lulishte qytetit Krume	15,000	0	15,000
57	Shkolla 9-Vjecare Pusi Thate	250,000	0	250,000	117	Lulishte qytetit Krume	1,844,959	0	1,844,959
58	Objekt me vlere historike, Golaj	767,188	0	767,188	118	Tregu Agro Ushqimor	1,359,780	0	1,359,780
59	Zyrat e komunes, Golaj + Z Gjendjes Civile	10,191,609	0	10,191,609	119	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	17,086	0	17,086
60	Ambulanca Sefoll	1,486,778	0	1,486,778	120	Rindertim Shkolla 9-Vjecare Letaj	300,000	0	300,000
	Shuma					<b>Totali 212</b>	966,447,8		966,447,8

*Aneksi nr. 3/3: Analiza e Llogarive të Pasivitet të Bilancit Kontabël*

Në lekë

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
			viti 2022	viti 2021
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	117,871,047	118,531,578
66		I.Pasivet Afat shkurtra	117,871,047	118,531,578
67		1. Llogari te Pagushme	117,871,047	118,531,578
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	9,893,612	7,821,909
69	42	Detyrime ndaj personelit	13,167,587	11,388,568
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	815,168	619,410
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	3,715,507	3,003,242
76	436	Sigurime Shendetsores	511,783	456,207
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		

78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie mes institucione apo njesi ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	8,451,458	7,918,848
82	467	Kreditore te ndryshem	11,333,144	19,089,193
83	4341	Operacione me shtetin( detyrime)	69,982,788	68,234,201
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		<b>2.Te tjera pasive afatshkurtra</b>		
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		<b>II.Pasivet Afat Gjata</b>		
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>2,062,595,888</b>	<b>2137,999,953</b>
97	<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR :</b>	<b>2,062,595,888</b>	<b>2137,999,953</b>
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti akumuluar	2,055,551,045	2,112,934,469
99	12	Rezultatet e mbartura		
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	7,044,843	15,065,484
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE(B+C)</b>	<b>2,180,466,935</b>	<b>2,256,531,531</b>

*Aneksi 3/4: Analiza e llogarisë 401 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”*

Llog.	Emertimi	Emri i Furnitorit	Nr.Fature	Date Fature	Gjendje me datë 01.01.2021	Likuiduar	Shtesa	Gjendje datë 31.12.2022
401	Bler materiale plastike per pastrim (kova fshesa shtupa)	A.K.	Nr.01/2021	27/12/2021	97,350	97,350	0	
401	Bl kartolina, urimi fest fundvitit & zbukuri ambien shkoll	C.2A	nr.36/2021	28/12/2021	117,000	117,000	0	
401	Ndertim bazament kolones per statujen e P Bogranit	D. Shpk	Nr.17/2021	23.12.2021	952,800	952,800	0	
401	blerje plehra kimike	S. L.	Nr.01/2021	21.12.2021	49,400	49,400	0	
401	Blerje stufa	S.L.	Nr.02/2021	27/12/2021	98,000	98,000	0	
401	Dru zjarri	Punonjes	Dhjetor 2021	Dhjetor 2021	44,944	44,944	0	
401	Transport nxenesit e QKF-se	V. P.	Nr.61/2021	31.12.2021	117,000	117,000	0	
401	Sherbim Interneti per vitin 2021	B.C.	Nr.10/2021,	28/12/2021	141,600	141,600	0	
401	Sherbim Postar	P. Has	Dhjetor 2021	Dhjetor 2021	1,982,240	1,982,240	0	
401	Shpenzime telefoni	A.T.	Dhjetor 2021	Dhjetor 2021	19,160	19,160	0	
401	Energji Elektrike	FSHU	Dhjetor 2021	Dhjetor 2021	657,564	657,564	0	
401	Sherbim transport produkte ushqimore gjate vitit 2021	C.2A	nr.50/2021	30.12.2021	117,000	117,000	0	
401	Shpenzime Uji	Ujesjelles Sha Has	Nr.90/2021	30.12.2021	210,888	210,888	0	
401	Sherbim mirmbajtje mjete transporti	K.B.	Nr.14/2021	29/12/2021	1,160,886	1,160,886	0	
401	Supervizim punimesh ndertim lera uji	I.-18 Shpk	Nr.60/2021	24.12.2021	58,200	58,200	0	
401	Kolaudim punimesh ndertim lera uji	K.CO	Nr.53/2021	24.12.2021	28,200	28,200	0	
401	Shpenzime mirmbajtje rezervuari Tobel	N.D.	Nr.36/2021	25.12.2021	866,400	866,400	0	
401	Ndertim lera uji NJA Gjinaj, Bashkia Has	V. G.	Nr.01/2021	28/12/2021	858,600	858,600	0	
401	Mospagese per mosdhenie te sakte te dhenave bankare	Shtypshkr P.	-	-	24,000	0	0	24,000
401	Shpenz mirembajt rrug e vepra ujore(Emergjencia civile)	H. G	Nr.6/2022,	28.10.2022	0	0	1,108,728	1,108,728
401	Shperblim keshilltare,Shperblim kryetar fshatrash	Bashkia Has	Dhjetor 2022	Dhjetor 2022	0	0	361,944	361,944
401	Sherbim Postar	P. Sha Has	Dhjetor 2022	Dhjetor 2022	0	0	200,685	200,685
401	Shpenzime telefoni	A.T.	Dhjetor 2022	Dhjetor 2022	0	0	19083	19083
401	Shpenzime mirembajtje rruge e vepra ujore	D.Shpk	Nr.28/2022	23.12.2022	0	0	1145424	1145424
401	Nafte per nevoja te bashkise Has	V.P.	Nr.232/2022	30.12.2022	0	0	981969	981969
401	Blerje dhe vendosje automate ne funksion te pompave ujesjells Krume dhe ndricimit te qytetit Krume	H.C.PF	Nr.31/2022	30.12.2022	0	0	98900	98900
401	Sherbime per mirembajtje mjete motorike	K. B.	Nr.23/2022	28.12.2022	0	0	1132968	1132968
401	Blerje sherbimi dizifektimi, dizinsektimi dhe deratizimi per mjediset e sektoreve te Bashkise Has dhe NJA	S. Shpk	Nr.2713	22.12.2022	0	0	97500	97500
401	Shpenzime mirembajtje rruge e vepra ujore	H..C.	Nr.30/2022	30.12.2022	0	0	885270	885270
401	Sherbime te pritimimit dhe publikimit	H.B.	Nr.9/2022	26.12.2022	0	0	96900	96900
401	Materiale dekor vitin e ri, aktivitetet p festat e fundvitit.	B..66	Nr.34	29.12.2022	0	0	408275	408275
401	Aktivitet me rastin e festave olimpike dhe projektit Ekipet Sportive ne Shkollë	N.T	Nr.3/2022	28.12.2022	0	0	99000	99000
401	Sherbim larje automjeteve,tapicerive 2022	Q.B.	Nr.2/2022	29.12.2022	0	0	83935	83935
401	Blerje, ngarkim transport skorie sipas destinacioneve	H. G	Nr.7/2022	31.12.2022	0	0	480000	480000

401	Diference e moslikujdimit te kartave te telefonit te perdorur nga Kryetari Komunes	V.			45,000	0	0	45,000
401	Sherbim I kryer nga MI per projektin e linjes elektrike ujesjellesit Golaj, shume e cila eshte paguar me leke ne dore nga punonjesit e ngarkuar me kete pune	Ministria Energjitikes			5,000	0	0	5,000
401	Blerje iniforma per punonjes	G.S.	Nr.146/2022	23.12.2022	0	0	549600	549600
401	Pritje percjellje dhe aktivite ne funksion te ceremonive,dekorimet nga Keshilli Bashkiak	S. L.	Nr.4/2022	29.12.2022	0	0	97500	97500
401	Sherbime dhe punime rehabilitimi dhe sistemimi I mbetjeve Qafe Barak Mjeti Buldozer	Xh. Shpk	Nr.100/2022	28.12.2022	0	0	117600	117600
401	Furniz me dru zjarri, sipas kontrates	Gj. Shpk			36,000	0		36,000
401	Diference e cmimit mes kohes se kontrates e fatures				685	0		685
401	Miremb ujesjellesit Golaj, për sjelles te fatur me vonese.	K.Shpk			133,992	0		133,992
401	Sherbim Interneti	B. C.	Nr.34/2022	29.12.2022	0	0	216000	216000
401	Shpenzime energjie elektrike	FSHU	Dhjetor 2022	Dhjetor2022	0	0	471854	471854
401	Aktivitet festë fundvitit 2022 e promov produkt vendor	L.Q.	Nr.1/2022	28.12.2022	0	0	995800	995800
	<b>Shuma 401</b>				<b>7,821,909</b>	<b>7,577,232</b>	<b>9,648,935</b>	<b>9,893,612</b>

*Aneksi nr. 3/5: Formati nr.2 "Pasqyra e performancës financiare"*

Nr. rreshti	Nr. Llogari	P E R S H K R I M I I O P E R A C I O N E V E	VITI USHTRIMOR	VITI I MEPARSHEM
a	b	c	1	2
<b>1</b>	<b>A</b>	<b>TE ARDHURAT</b>	<b>668,932,529</b>	<b>605,386,958</b>
<b>2</b>	<b>70</b>	<b>I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET</b>	<b>7,296,526</b>	<b>6,746,712</b>
<b>3</b>	<b>700</b>	<b>1.Tatimi mbi te Ardhurat</b>	<b>30,000</b>	<b>371,964</b>
<b>4</b>	7000	Tatim mbi te ardhurat personale		
<b>5</b>	7001	Tatim mbi Fitimin		
<b>6</b>	7002	Tatim mbi Biznesin e vogel	30,000	371,964
<b>7</b>	7009	<i>Te tjera Tatime mbi te ardhurat</i>		
<b>8</b>	<b>702</b>	<b>2.Tatimi mbi Pasurine</b>	<b>1,656,065</b>	<b>1,116,935</b>
<b>9</b>	7020	Tatim mbi Pasurine e palujtshme	1,011,209	1,045,819
<b>10</b>	7021	Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshme		
<b>11</b>	7029	Te tjera tatime mbi Pasurine	644,856	71,116
<b>12</b>	<b>703</b>	<b>3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit</b>	<b>5,610,461</b>	<b>5,257,813</b>
<b>17</b>	7035	Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	5,610,461	5,257,813
<b>25</b>	<b>709</b>	<b>7.Gjoha e Kamat vonesa</b>		
<b>26</b>	<b>75</b>	<b>II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE</b>		
<b>33</b>	756	KONTRIBUTE NGA BUXHETI PER SIGURIME SHENDETESORE		
<b>34</b>	<b>71</b>	<b>III.TE ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>10,217,759</b>	<b>10,211,671</b>
<b>35</b>	<b>710</b>	<b>1.Nga ndermarrjet dhe pronesia</b>	<b>4,158,195</b>	<b>3,783,947</b>
<b>36</b>	7100	Nga Ndermarrjet publike jo financiare		
<b>37</b>	7101	Nga Ndermarrjet publike financiare		
<b>38</b>	7109	Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia	4,158,195	3,783,947
<b>39</b>	<b>711</b>	<b>2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare</b>	<b>6,059,564</b>	<b>6,427,724</b>
<b>40</b>	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	5,815,202	6,200,682
<b>41</b>	7111	Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh	111,362	90,042
<b>42</b>	7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve	5,000	17,000
<b>43</b>	7114	Te ardhura nga biletat	128,000	
<b>45</b>	7115	Gjoha, kamasvonesa, sekuestrime e zhdemtime		120,000
<b>46</b>	7116	Te ardhura nga transferim prones,Legalizim ndertimeve pa leje		
<b>47</b>	<b>719</b>	<b>3.Te tjera te ardhura jo tatimore</b>		
<b>48</b>	<b>76</b>	<b>IV.TE ARDHURA FINANCIARE</b>		
<b>53</b>	<b>72</b>	<b>V.GRANTE KORENTE</b>	<b>651,418,244</b>	<b>588,428,575</b>
<b>54</b>	<b>720</b>	<b>1.Grant korent I Brendshem</b>	<b>650,752,509</b>	<b>577,964,335</b>
<b>55</b>	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	2,500,000	
<b>56</b>	7201	Nga Buxheti per NJQP(Vendore)	607,003,659	545,079,226
<b>59</b>	7204	Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale	12,779,583	9,595,773
<b>60</b>	7205	Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit		
<b>61</b>	7206	Financim i pritshem nga buxheti	28,103,657	23,289,336
<b>62</b>	7207	Sponsorizime te brendshme( nga te trete)	365,610	
<b>63</b>	7209	Te tjera grante korente te brendshme		
<b>64</b>	<b>721</b>	<b>2.Grant korent I Huaj</b>	<b>665,735</b>	<b>10,464,240</b>
<b>65</b>	7210	Nga Qeveri te Huaja	465,735	10,113,600
<b>66</b>		Nga Organizata Nderkombetare	200,000	350,640
<b>67</b>		<b>VI.TE ARDHURA TE TJERA</b>		
<b>73</b>	<b>73</b>	<b>VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE</b>		
<b>74</b>	<b>B</b>	<b>SHPENZIMET</b>	<b>661,887,686</b>	<b>590,321,474</b>
<b>75</b>	<b>600</b>	<b>IPAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE</b>	<b>173,719,054</b>	
<b>76</b>	6001	Paga, personel I perhershem	169,178,097	
<b>77</b>	6002	Paga personel I Perkohshem	4,540,957	2,354,564
<b>78</b>	6003	Shperblime		

79	6009	Shpenzime te tjera per personelin		
80	601	<b>II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE</b>	<b>26,057,330</b>	<b>27,629,376</b>
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqerore	23,406,122	24,724,761
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shendetesore	2,651,208	2,904,615
83	602	<b>III.BLERJE MALLRA E SHERBIME</b>	<b>89,711,567</b>	<b>77,446,770</b>
84	602	Mallra dhe sherbime te tjera		
85	6020	Materiale zyre e te pergjitheshme	1,719,787	1,554,241
86	6021	Materiale dhe sherbime speciale	1,864,545	2,587,776
87	6022	Sherbime nga te trete	30,132,402	26,277,554
88	6023	Shpenzime transporti	10,291,100	11,336,903
89	6024	Shpenzime udhetimi	6,279,340	5,181,340
90	6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	33,859,676	23,967,153
91	6026	Shpenzime per qeramarrje		
92	6027	Shpenzime per detyrime per kompesime legale		815,240
93	6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua		
94	6029	Shpenzime te tjera operative	5,564,717	5,726,563
95	603	<b>IV.SUBVECIONE</b>		
101		<b>V.TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>369,397,596</b>	<b>322,245,844</b>
102	604	<b>1.Transferime korente te brendshme</b>	<b>3,309,909</b>	<b>711</b>
103	6040	Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise	3,309,909	711
112	606	<b>3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe</b>	<b>366,087,687</b>	<b>322,245,133</b>
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		6,901,195
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	366,087,687	315,343,938
115		<b>VI.SHPENZIME FINANCIARE</b>		
125		<b>VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA</b>		
130	63	<b>VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT</b>	<b>3,002,139</b>	<b>3,448,415</b>
131		<b>IX.SHPENZIME TE TJERA</b>		
132	85	<b>TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUHES</b>	<b>7,044,843</b>	<b>15,065,484</b>
		<i>(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)</i>		

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

## KONTROLI I LARTË I SHTTIT